

TABELA E PËRPTHSHMËRISË

| Direktiva 2018/1972/EU të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2018, “Mbi krijimin e Kodit Europian për Komunikimet Elektronike”, EUR-Lex - 32018L1972 – EN | | Projektligji “Mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” <i>Përafrim i pjesshëm</i> | | | | |
|--|---|---|----------------------------|---|----------------------|---------|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| Neni | Teksti | Referenca | Neni (projektligji) | Teksti | Përputhshmëria F/P/N | Shënime |
| Neni 1 | <p align="center">PJESA I KUADRI LIGJOR (RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR ORGANIZIMIN E SEKTORIT)</p> <p align="center">TITULLI I</p> <p align="center">QËLIMI, OBJEKTIVAT DHE PËRKUFIZIMET</p> <p align="center">KAPITULLI 1</p> <p align="center">Lënda, qëllimi dhe përkufizimet e temës</p> <p align="center">Neni 1 Lënda dhe qëllimi</p> <p>1. Kjo Direktivë krijon një kuadër të harmonizuar për rregullimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, lehtësirat shoqëruese dhe shërbimet e ofruara, si dhe aspekte të caktuara të pajisjeve fundore. Ajo përcakton detyrat e autoriteteve rregullatore kombëtare dhe kur është e mundur të autoriteteve të tjera kompetente, dhe krijon një seri procedurash për të siguruar zbatimin e harmonizuar të kuadrit rregullator në të gjithë Bashkimin Evropian.</p> <p>2. Qëllimet e kësaj direktive janë: (a) implementimi i një tregu të brendshëm në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike që rezulton në shtrirjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, konkurrencë të qëndrueshme, ndërveprimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, aksesueshmërinë, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve dhe përfitimet e përdoruesve fundorë; dhe (b) sigurimi i ofrimit të shërbimeve me cilësi të mirë në të gjithë Bashkimin Evropian, çmime të përballueshme, shërbime në dispozicion të publikut të ofruara përmes konkurrencës dhe zgjedhjes efektive, për t'u marrë me rrethanat në të cilat nevojat e përdoruesve fundorë përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara, për të aksesuar shërbimet në mënyrë të barabartë me të tjerët, të cilat</p> | 1 | Neni 1 Neni 2 Neni 3 | <p align="center">KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME FUSHA, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT, PËRKUFIZIMET</p> <p align="center">Neni 1 Qëllimi i ligjit</p> <p>Qëllimet e këtij ligji janë:</p> <p>a) të promovojë zhvillimin e tregut të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bazuar në shtrirjen dhe përdorimin e rrjeteve të shpejtësisë shumë të lartë, konkurrencën e qëndrueshme, ndërveprueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike, aksesueshmërinë e tyre, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve si dhe përfitimet e përdoruesit fundor.</p> <p>b) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun në Republikën e Shqipërisë, me cilësi të mirë dhe çmime të përballueshme, me mundësi zgjedhjeje për përdoruesit në konkurrencë efektive dhe që janë të afta të plotësojnë nevojat e përdoruesve fundorë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, duke përcaktuar të drejtat e nevojshme të përdoruesve fundorë, në rastet kur tregu nuk përmbush në mënyrë të kënaqshme, kërkesat e aksesimit të shërbimeve në mënyrë të barabartë me të tjerët.</p> <p align="center">Neni 2 Objekti i ligjit</p> <p>Objekti i këtij ligji është:</p> <p>a) përcaktimi i kuadrit rregullator, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, faciliteteve e shërbimeve shoqëruese të tyre dhe rregullat për disa aspekte të pajisjeve fundore.</p> <p>b) përcaktimi i kompetencave të ministrit, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të autoriteteve të tjera kompetente, për aq sa është e zbatueshme, si dhe të procedurave për zbatimin e harmonizuar të kuadrit</p> | F | |

| | | | | | | |
|----------------------|---|--|--|---|----------|--|
| | <p>nuk janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme nga tregu dhe të përcaktojnë të drejtat e nevojshme të përdoruesve fundorë.</p> <p>3.Kjo Direktivë nuk cenon:</p> <p>(a)detyrimet e vendosura nga ligji kombëtar në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian ose nga ligji i Bashkimit Evropian, në lidhje me shërbimet e ofruara që përdorin rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike;</p> <p>(b)masat e marra në Bashkimin Evropian ose në nivel kombëtar, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, për të ndjekur objektivat e interesit të përgjithshëm, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, rregullimin e përmbajtjes dhe politikën audiovizuale;</p> <p>(c)veprimet e ndërmarra nga shtetet anëtare për rendin publik dhe qëllimet e sigurisë publike dhe për mbrojtjen;</p> <p>(d)Rregulloret (BE) Nr. 531/2012 dhe (BE) 2015/2120 dhe Direktivën 2014/53 / BE.</p> <p>4.Komisioni, Trupi i Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike ("BEREC") dhe autoritetet e interesuara duhet të sigurojnë pajtueshmërinë e përpunimit të tyre të të dhënave personale me rregullat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave.</p> | | | <p>rregullator për komunikimet elektronike, në Republikën e Shqipërisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Përjashtëmi nga fusha e zbatimit</p> <p>Ky ligj nuk zbatohet për:</p> <p>a) pajisjet e komunikimeve, në veçanti sistemet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve, të ndërtuara dhe të përdorura ekskluzivisht për qëllime të mbrojtjes civile, mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Përdorimi i frekuencave edhe në këtë rast, do të kryhet sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p> <p>b) fushën e veprimtarisë të medias audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre për transmetimet radiotelevizive, të përcaktuara në ligjin që rregullon fushën e medias audiovizive në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë nuk është përcaktuar ndryshe në legjisllacionin në fuqi.</p> <p>c) përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përdorin rrjetet e komunikimeve elektronike dhe shërbimet mbështetëse të tyre.</p> | | |
| <p>Neni 2</p> | <p style="text-align: center;">Neni2 Përkufizimet</p> <p>Për qëllime të kësaj Direktive, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:</p> <p>1. "Rrjet i komunikimeve elektronike" janë sistemet e transmetimit, të bazuara ose jo mbi një infrastrukturë të përhershme ose mbi kapacitete administrimi të qendëruara, dhe kur është e aplikueshme, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllorve elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllorë televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.</p> <p>2. "Rrjet me kapacitet shumë të lartë" nënkupton një rrjet komunikimi elektronik i cili përbëhet tërësisht nga elementë të fibrave optike, të paktën deri në pikën e shpërndarjes në vendin e shërbimit, ose një rrjet komunikimi elektronik i cili është në gjendje të ofrojë, në kushtet e zakonshme të kohës së pikut, një performancë rrjeti të ngjashme në termat e gjerësisë së disponueshme të brezit për shkarkim "downlink" dhe ngarkim "uplink", qëndrueshmërisë, parametrave të lidhura me</p> | | <p>Neni 4, pg. 1, 2, 4, 6, 11, 12, 14, 17, 18, 20, 21, 25, 26, 29, 32, 34, 35, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 48, 50, 51, 53, 55, 60, 62, 63, 64, 65, 67, 71, 77, 78.</p> | <p style="text-align: center;">Neni 4 Përkufizime</p> <p>Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:</p> <p>1. "Akses" është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një sipërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë përdorimin e tyre për shpërndarjen e shërbimeve të shoqërisë së informacionit ose shërbimeve të transmetimit të përmbajtjes. Aksesit, ndërmjet të tjerash, përfshin akses në elementet e rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse, në veçanti aksesin e hapur në rrjetin lokal dhe aksesin në facilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal; akses në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; akses në sistemet e software-ve përkatës, përfshirë sistemet mbështetëse operacionale; akses në sistemet e informacionit ose bazat e të dhënave për porositë paraprake, sigurimin, porositjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kërkesave dhe faturimin; akses në përkthimin e numrit (<i>number translation</i>), apo në sistemet që ofrojnë funksionalitet të njëvlehtës; aksesin në rrjetet fikse apo të lëvizshme, në veçanti për <i>roaming-un</i>; akses në sistemet e aksesit të kushtëzuar për shërbimet televizive digjitale dhe aksesin në shërbimet e rrjeteve virtuale.</p> | <p>F</p> | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>gabimet, vonesat dhe ndryshimet e saj; Performanca e rrjetit konsiderohet e ngjashme pavarësisht nëse përvoja e përdoruesit fundor ndryshon, për shkak të karakteristikave të ndryshme të qenësishme të mjedisit me të cilin ai lidhet përfundimisht me pikën fundore të rrjetit.</p> <p>3. “Tregjet ndërkombëtare” nënkupton tregjet e identifikuar në përputhje me nenin 65, që mbulon bashkimin ose një pjesë të rëndësishme të tij të lokalizuar në më shumë se disa shtete anëtare.</p> <p>4. “Shërbim i komunikimeve elektronike” është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i përfutur nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, i cili duke përfshirë shërbimet që ofrojnë, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së transmetuar duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, përfshin llojet e mëposhtme të shërbimeve:</p> <p>(a) "shërbim aksesi në internet" sic përcaktohet në pikën (2) të paragrafit të dytë të nenit 2 të Rregullores (EU)2015/2120;</p> <p>(b) shërbim i komunikimit ndërpersonal; dhe</p> <p>(c) shërbimet që konsistojnë tërësisht ose kryesisht në përcjelljen e sinjaleve të tilla si, shërbime transmetimi që përdoren për ofrimin e komunikimeve makinë – makinë dhe për transmetime radiotelevizive.</p> <p>5. "Shërbimi i komunikimit ndërpersonal" nënkupton një shërbim që ofrohet normalisht me pagesë, i cili mundëson shkëmbimin e drejtpërdrejtë ndërpersonal dhe ndërveprues të informacionit, nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike për një numër të kufizuar personash, ku personat që inicijojnë ose marrin pjesë në komunikim përcaktojnë marrësin(it) e tij. Ky shërbim nuk përfshin shërbimet që mundësojnë komunikimin ndërpersonal dhe ndërveprues, thjesht si një veçori ndihmëse e vogël që është e lidhur thelbësisht me një shërbim tjetër.</p> <p>6. "Shërbim i komunikimit ndërpersonal i bazuar në numër", nënkupton një shërbim komunikimi ndërpersonal, i cili lidhet me burimet numerike të caktuara publikisht, domethënë, një numër ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit, ose që mundëson komunikimin me një numër ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit;</p> <p>7. "Shërbim i komunikimit ndërpersonal i pavarur nga numri" nënkupton një shërbim komunikimi ndërpersonal i cili nuk lidhet me burimet numerike të caktuara publikisht, domethënë, një numër ose numra në planin kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit, ose që nuk e mundëson komunikimin me një numër ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit;</p> <p>8. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose</p> | | <p>2. “Aplikimi i programit të ndërfaqes” ose API, nënkupton ndërfaqen <i>software</i> ndërmjet aplikacioneve e vënë në dispozicion nga transmetuesit ose ofruesit e shërbimit televiziv, burimet në pajisjet televizive digjitale të përmirësuar dhe shërbimet radio;</p> <p>4.“Autorizim i përgjithshëm”, është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor i përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AKEP në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha, ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas këtij ligji.</p> <p>6.“Caktimi i frekuencave”, është dhënia e autorizimit për një kanal frekuence, ose frekuencë sipas kushteve specifike.</p> <p>11.“Facilitetet shoqëruese”, janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera, ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi, ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllo e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.</p> <p>12.“Incident sigurie”, është çdo ngjarje, veprim ose mosveprim, që ka një efekt aktual negativ në sigurinë e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.</p> <p>14.“Informacion për vendndodhjen e telefonuesit”, janë të dhënat e përpunuara në një rrjet telefonik të lëvizshëm, që gjenerohen nga infrastruktura e rrjetit ose nga pajisja fundore, duke treguar pozicionin gjeografik të pajisjes fundore të një përdoruesi dhe në një rrjet publik fiks të dhënat për adresën fizike të pikës fundore të rrjetit.</p> <p>17.“Interferencë e dëmshme”, është ndërhyrja, e cila rrezikon funksionimin e shërbimit të radio-navigimit ose shërbimeve të tjera të radio- komunikimeve, të ofruara për qëllime sigurie, ose ndërhyrja që seriozisht përkeqëson, pengon ose ndërpret në mënyrë të përsëritur, shërbimet e radio-komunikimeve, që janë duke punuar në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore.</p> <p>18.“Interkoneksion”, është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti operator apo operatorë të ndryshëm, në mënyrë që t’i lejojë përdoruesit e një operatori, të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit operator ose të një operatori tjetër, ose të lejojë aksesin për shërbimet e ofruara nga një operator tjetër. Shërbimet mund të ofrohen nga palët e përfshira ose palët e tjera që kanë akses në rrjet. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesi, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit.</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | <p>kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që suporton transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.</p> <p>9. “Pika fundore e rrjetit” është pika fizike, në të cilën një përdorues fundor ka akses në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin, pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një përdoruesi fundor.</p> <p>10. “Facilitetet shoqëruese”, janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera, ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi, ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.</p> <p>11. “Shërbime shoqëruese” janë ato shërbime, të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi, ose kanë potencial për ta bërë këtë dhe që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, përkthimin e numrave ose sistemet e ofrimit të funksionalitetit ekuivalent, sistemet e aksesit të kushtëzuar dhe udhëzuesit e programit elektronik, gjithashtu, shërbime të tjera të tilla, si shërbimet e identitetit, vendndodhjes dhe prezencës.</p> <p>12. “Sistemi i aksesit të kushtëzuar” nënkupton çdo masë teknike, sistem autentikimi dhe/ose rregullimi, ku aksesit në një shërbim të mbrojtur të transmetimit radio ose televiziv në formë të kuptueshme, kushtëzohet me abonim ose një formë tjetër të autorizimit paraprak individual;</p> <p>13. “Përdorues” është cilido që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.</p> <p>14. “Përdorues fundor” është një përdorues, i cili nuk ofron rrjetet ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun</p> <p>15. “Konsumator” nënkupton çdo person që përdor ose kërkon një shërbim të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin, zanatin ose ushtrimin e profesionit.</p> <p>16. “Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike” është ndërtimi, operimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë;</p> | | | <p>20.“Komunikim emergjence”, është komunikimi me anë të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal midis një përdoruesi fundor dhe pikës së përgjigjes për sigurinë publike, PSAP-së, me qëllim kërkimi dhe marrje të ndihmës nga shërbimet e emergjencës.</p> <p>21.“Konsumator”, është çdo person që përdor, ose kërkon një shërbim të komunikimeve elektronike, të disponueshëm për publikun, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin, zanatin ose ushtrimin e profesionit.</p> <p>25.“Numër gjeografik”, është një numër nga plani kombëtar i numeracionit, ku një pjesë e strukturës së tij shifrore përmban domethënie gjeografike të përdorur për drejtimin e thirrjeve në vendndodhjen fizike të pikës fundore të rrjetit, në një rajon gjeografik të caktuar.</p> <p>26.“Numrat jo-gjeografikë”, janë numrat nga plani kombëtar i numeracionit, që nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar dhe përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) numrat për akses në rrjetet publike të lëvizshme të komunikimit; b) numrat për akses në shërbimet me vlerë të shtuar, numrat me tarifë premium; c) numrat për akses në shërbimet, për të cilat e gjithë tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet nga ofruesi i shërbimeve, pra drejt numrave që janë pa pagesë për përdoruesit; ç) numrat për akses në shërbimet, për të cilat tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve, paguhet pjesërisht nga thirrësi dhe pjesërisht nga ofruesi i shërbimit, pra drejt numrave, të cilët i janë dhënë përdoruesit, përkundrajt një marrëdhënieje të paracaktuar, numra me ndarje të koston, ose numër blu; d) numrat për shërbim publik telefonik nomadik. <p>29. “Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike”, është ndërtimi, operimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë.</p> <p>32.“Operator”, është një sipërmarrës, që ofron, ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese.</p> <p>34.“Pajisje fundore”, është pajisja e lidhur direkt ose indirekt në pikën fundore të rrjetit publik të telekomunikacionit, e cila shërben për transmetimin, marrjen dhe përpunimin e informacionit. Në çdo rast, lidhja direkte ose indirekte, mund të jetë me tel, fibër optike ose në mënyrë elektromagnetike. Një lidhje është indirekte, nëse pajisja është e vendosur midis pikës fundore dhe ndërfaqes së rrjetit.</p> <p>35.“Pajisje televizive digjitale e përmirësuar” nënkupton pajisjen e destinuar për t’u lidhur me marrësin televiziv ose televizorë digjital të integruar, dhe që është e aftë për të marrë shërbime televizive digjitale interaktive.</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>17. "Pajisje televizive dixhitale e përmirësuar" nënkupton kutitë e televizorit të destinuar për t'u lidhur me televizorë ose televizorë dixhitalë të integruar, të aftë për të marrë shërbime televizive dixhitale interaktive;</p> <p>18. "Ndërfaqja e programimit të aplikacionit" ose "API" nënkupton ndërfaqen e softuerit ndërmjet aplikacioneve, të vëna në dispozicion nga transmetuesit ose ofruesit e shërbimeve, dhe burimet në pajisjet e zgjeruara televizive dixhitale për shërbimet e televizionit dhe radios dixhitale;</p> <p>19. "Përcaktimi i një brezi frekuencash" është destinimi i një brezi të dhënë frekuencash për përdorim nga një ose më shumë shërbime radio-komunikimi, kur është e përshatshme, sipas kushteve specifike.</p> <p>20. "Interferencë e dëmshme" është ndërhyrja, e cila rrezikon funksionimin e shërbimit të radio-navigimit ose shërbimeve të tjera të sigurisë, ose që përndryshe përkeqëson seriozisht, pengon ose ndërpret, në mënyrë të përsëritur, shërbimet e radio-komunikimeve, që funksionojnë në përputhje me rregulloret e zbatueshme ndërkombëtare, të Bashkimit ose kombëtare.21. "Siguria e rrjeteve dhe shërbimeve" nënkupton aftësinë e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike për t'i rezistuar, në një nivel të caktuar besimi, çdo veprimi që rrezikon disponueshmërinë, origjinalitetin, integritetin ose konfidencialitetin e këtyre rrjeteve dhe shërbimeve, çdo veprimi që rrezikon të dhënat e ruajtura ose të transmetuara ose të përpunuara, ose të shërbimeve përkatëse të ofruara nga, ose të aksesueshme nëpërmjet këtyre rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;</p> <p>22. "Autorizim i përgjithshëm" nënkupton kuadrin ligjor të krijuar nga një Shtet anëtar, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me këtë direktivë.</p> <p>23. "Pika e aksesit pa tel në zonë të vogël" nënkupton një pajisje aksesi pa tel në rrjet, me fuqi të ulët dhe me përmasa të vogla, që operon brenda një zone të vogël duke përdorur spektrin radio të licencuar ose jo, ose një kombinim të tyre, dhe që mund të përdoret si pjesë e një rrjeti publik të komunikimeve elektronike, i cili mund të pajiset me një ose më shumë antena me ndikim të ulët vizual, për të lejuar aksesin me valë të përdoruesve, në rrjetet e komunikimeve elektronike, pavarësisht nga topologjia e rrjetit bazë, qoftë i lëvizshëm apo fikse;</p> <p>24. "Rrjet lokal i radios" ose 'RLAN' nënkupton një sistem aksesi pa tel me fuqi të ulët, që funksionon brenda një rrezeje të vogël dhe me rrezik të ulët ndërhyrjeje me sisteme të tilla të tjera, të vendosura në afërsi nga përdorues të tjerë dhe që përdorin spektrin e harmonizuar të frekuencave mbi baza joekskluzive;</p> <p>25. "Spektër i harmonizuar i radios" nënkupton spektrin radio për të cilin janë vendosur kushte të harmonizuara në lidhje me</p> | | <p>38. "Përdorues", është cilido që përdor ose kërkon të përdorë, shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.</p> <p>39. "Përdorues fundor", është një përdorues, i cili nuk ofron rrjete, ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun.</p> <p>40. "Përdorim i përbashkët i spektrit të radios", është aksesi për të përdorur të njëjtat breza të spektrit të frekuencave, nga dy ose më shumë përdorues, sipas një marrëveshjeje të caktuar bashkëpërdorimi të bazuar në autorizimin e përgjithshëm, të drejtat individuale të përdorimit të spektrit radio ose në kombinimin e të dyjave, duke përfshirë kuadrin rregullator për aksesin e përbashkët të spektrit të licencuar, që synon lehtësimin e përdorimit të përbashkët të një brezi të spektrit radio, subjekt i një marrëveshjeje detyruese për të gjitha palët e përfshira, në përputhje me rregullat e bashkëpërdorimit të përfshira në të drejtat e tyre të përdorimit për spektrin radio, me qëllim garantimin e një marrëveshjeje bashkëpërdorimi të parashikueshme dhe të besueshme, për të gjithë përdoruesit, duke respektuar ligjin e konkurrencës.</p> <p>41. "Pika e aksesit pa tel në zonë të vogël", është një pajisje aksesi në rrjet pa tel, me fuqi të ulët dhe me përmasa të vogla, që operon brenda një zone të vogël duke përdorur spektrin radio të licencuar ose jo, ose një kombinim të tyre dhe që mund të përdoret si pjesë e një rrjeti publik të komunikimeve elektronike, i cili mund të pajiset me një ose më shumë antena me ndikim të ulët pamor, për të lejuar aksesin me valë të përdoruesve në rrjetet e komunikimeve elektronike, pavarësisht nga topologjia e rrjetit bazë, qoftë ky i lëvizshëm apo fikse.</p> <p>42. "Pika fundore e rrjetit", është pika fizike, në të cilën një përdorues fundor ka akses në rrjetin e komunikimeve elektronike publike. Në rastin e rrjeteve që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin, pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një përdoruesi fundor.</p> <p>43. "Pika e përgjigjes për sigurinë publike" ose "PSAP", është vendndodhja fizike ku merret fillimisht një komunikim emergjence nën përgjegjësinë e autoritetit të përcaktuar në legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen civile dhe shërbimet e emergjencës.</p> <p>44. "Pika e përgjigjes për sigurinë publike më e përshtatshme", është një PSAP e përcaktuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen civile për të mbuluar komunikimet e emergjences nga një zonë e caktuar ose komunikimet e emergjencës të një lloji të caktuar.</p> <p>48. "Qarku lokal", është rrjeti fizik që lidh pikën fundore të rrjetit me kuadrin e shpërndarjes ose pajisjet e barasvlershme në rrjetin e komunikimeve elektronike fikse.</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të tij nëpërmjet masave teknike zbatuese në përputhje me nenin 4 të vendimit nr. 676/2002/KE;</p> <p>26. "Përdorim i përbashkët i spektrit të radios" nënkupton aksesin nga dy ose më shumë përdorues, për të përdorur të njëjtat breza të spektrit të frekuencave nën një marrëveshje të caktuar bashkëpërdorimi, të autorizuar nga autorizimi i përgjithshëm, nga të drejtat individuale të përdorimit të spektrit radio ose një kombinim i tyre, përfshirë kuadrin rregullator për aksesin e përbashkët të licencuar, duke synuar lehtësimin e përdorimit të përbashkët të një brezi spektri radio, subjekti i një marrëveshjeje detyruese për të gjitha palët e përfshira, në përputhje me rregullat e bashkëpërdorimit të përfshira në të drejtat e tyre të përdorimit për spektrin radio, me qëllim garantimin e një marrëveshjeje bashkëpërdorimi të parashikueshme dhe të besueshme për të gjithë përdoruesit, pa cënuar zbatimin e ligjit të konkurrencës</p> <p>27. "Akses" është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një sipërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë kur ato janë përdorur për shpërndarjen e shërbimeve të shoqërisë së informacionit ose shërbimeve të përmbajtjes së transmetimit; ai mbulon, ndër të tjera: akses në elementet e rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin akses të hapur në rrjetin lokal dhe akses në facilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); akses në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; akses në sistemet e software-ve përkatës, përfshirë sistemet mbështetëse operacionale; akses në sistemet e informacionit ose bazat e të dhënave për porositë paraprake, sigurimin, porositjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kërkesave dhe faturimin; akses në përkthimin e numrit (number translation) apo në sistemet që ofrojnë funksionalitet të njëvleftshëm; aksesin në rrjetet fikse apo të lëvizshme, në veçanti për roaming-un; akses në sistemet e aksesit të kushtëzuar për shërbimet televizive digjitale dhe aksesin në shërbimet e rrjeteve virtuale.</p> <p>28. "Interkoneksioni" është një lloj i veçantë aksesit, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit me anë të lidhjes fizike dhe logjike të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të përdorura nga e njëjta apo sipërmarrje e ndryshme, në mënyrë që t'i lejoj përdoruesit e të njëjtës apo të një sipërmarrësi tjetër të komunikojnë ose për të aksesuar shërbimet e ofruara nga një sipërmarrje tjetër kur këto shërbime ofrohen nga palët e përfshira ose palët e tjera që kanë akses në rrjet;</p> <p>29. "Operator" është një sipërmarrës, që ofron ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;</p> <p>30. "Qarku lokal" nënkupton rrugën fizike të përdorur nga sinjalet e komunikimit elektronik për të lidhur pikën fundore të rrjetit në</p> | | <p>50. Rrjet i komunikimeve elektronike", nënkupton sistemet e transmetimit, të bazuara ose jo mbi një infrastruktura të përhershme, ose mbi kapacitete administrimi të qëndëruar dhe kur është e aplikueshme, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore, me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin, rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit që përcjell.</p> <p>51. "Rrjet i komunikimeve publike", është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që mbështet transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.</p> <p>52. "Rrjet me kapacitet shumë të lartë", është një rrjet komunikimi elektronik, i cili përbëhet tërësisht nga elementet të fibrave optike të paktën deri në pikën e shpërndarjes në vendin e shërbimit, ose një rrjet komunikimi elektronik, i cili është në gjendje të ofrojë, në kushtet e zakonshme të kohës së pikut, një performancë rrjeti të ngjashme në termat e gjerësisë së disponueshme të brezit për shkarkim "downlink" dhe ngarkim "uplink", të qëndrueshmërisë, parametrave të lidhura me gabimet, vonesat dhe ndryshimet e saj. Performanca e rrjetit konsiderohet e ngjashme, pavarësisht nëse përvoja e përdoruesit fundor ndryshon, për shkak të karakteristikave të qenësishme të ndryshme të mjedisit, me të cilin ai lidhet përfundimisht me pikën fundore të rrjetit.</p> <p>53. "Rrjet lokal i radios" ose 'RLAN', është një sistem aksesit pa tel me fuqi të ulët, që funksionon brenda një rrezeje të vogël mbulimi dhe me rrezik të ulët ndërhyrjeje me sisteme të tilla të tjera, të vendosura në afërsi nga përdorues të tjerë dhe që përdorin spektrin e harmonizuar të frekuencave mbi baza joekskluzive.</p> <p>55. "Siguria e rrjeteve dhe shërbimeve", është aftësia e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike për t'i rezistuar, në një nivel të caktuar besimi, çdo veprimi që rrezikon disponueshmërinë, origjinalitetin, integritetin, keqpërdorimin, konfidencialitetin e këtyre rrjeteve dhe shërbimeve, çdo veprim ose mosveprim që rrezikon të dhënat e ruajtura, të transmetuara ose të përpunuara të shërbimeve përkatëse të ofruara, ose të aksesueshme nëpërmjet këtyre rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike.</p> <p>60. "Spekter i harmonizuar i frekuencave" nënkupton spektrin e frekuencave për të cilin përmes masave teknike të implementimit, janë krijuar kushtet e harmonizimit në lidhje</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>kuadrin e shpërndarjes ose pajisjet e barasvlershme në rrjetin publik telefonik fiks.</p> <p>31. "Thirrje" është lidhja ndërmjet dy pikave fundore, e realizuar nëpërmjet shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, e cila lejon komunikimin dydrejtimësh.</p> <p>32. "Shërbim komunikimi me zë" është një shërbim i disponueshëm komunikimi elektronik për publikun, për origjinimin dhe marrjen direkte ose indirekte të thirrjeve kombëtare, apo kombëtare e ndërkombëtare, nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik kombëtar ose ndërkombëtar."</p> <p>33. "Numër gjeografik" nënkupton një numër nga plani kombëtar i numeracionit, ku një pjesë e strukturës së tij shifrore përmban domethënie gjeografike të përdorur për vendndodhjen fizike të pikës fundore të rrjetit.</p> <p>34. "Numrat jo-gjeografik" janë numrat nga plani kombëtar i numeracionit, që nuk janë numra rajoni gjeografik të tilla si të lëvizshëm, pa pagesë, dhe numrat me tarifë premium;</p> <p>35. "Shërbimi total i bisedës" nënkupton një shërbim multimedial të bisedës në kohë reale, që ofron transferim simetrik dy drejtimësh në kohë reale të videove me lëvizje, tekstit dhe zërit ndërmjet përdoruesve në dy ose më shumë vendndodhje;</p> <p>36. "Pika e përgjigjes për sigurinë publike" ose "PSAP" nënkupton vendndodhjen fizike ku merret fillimisht një komunikim emergjence nën përgjegjësinë e autoritetit publik ose të një organizate private të njohur nga shteti anëtar.</p> <p>37. "PSAP më i përshatshëm" nënkupton një PSAP të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës për të mbuluar komunikimet emergjente nga një zonë e caktuar ose për komunikime emergjente të një lloji të caktuar;</p> <p>38. "Komunikim emergjence" do të thotë komunikim me anë të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal midis një përdoruesi fundor dhe PSAP-së, me qëllimin për të kërkuar dhe marrë ndihmë emergjente nga shërbimet e emergjencës;</p> <p>39. "Shërbim emergjence" nënkupton një shërbim i njohur si i tillë nga Shteti Anëtar, që ofron shërbime emergjente dhe asistencë të shpejtë në situatat ku ka nevecanti një rrezik direkt për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.</p> <p>40. "Informacion për vendndodhjen e telefonuesit" nënkupton, në një rrjet telefonik të lëvizshëm të dhënat e përpunuara, që gjenerohen nga infrastruktura e rrjetit ose nga pajisja fundore, duke treguar pozicionin gjeografik të pajisjes fundore të një përdoruesi dhe, në një rrjet publik fiks, të dhënat për adresën fizike të pikës fundore të rrjetit;</p> <p>41. "Pajisje fundore" nënkupton pajisjen sipas përcaktimeve në pikën (1) të nenit 1 të Direktivës së Komisionit 2008/63/EC;</p> | | <p>me disponueshmërinë dhe përdorimin eficient të tyre në përputhje me praktikën e BE-së.</p> <p>61. "Shërbim emergjence", është përgjigja sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, për ofrimin e shërbimeve emergjente dhe të asistencës, para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.</p> <p>62. "Shërbim i komunikimeve elektronike", është shërbimi i kryer kundrejt një pagese, i përfutur nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, i cili duke përjashtuar shërbimet që ofrojnë ose ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së transmetuar duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, përfshin llojet e mëposhtme të shërbimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) "shërbim aksesi në internet", është shërbimi i komunikimit elektronik i disponueshëm për publikun, që ofron akses në internet dhe në këtë mënyrë lidhje me pothuajse të gjitha pikat fundore virtuale të internetit, pavarësisht nga teknologjia e rrjetit dhe pajisjet fundore të përdorura; b) "shërbim i komunikimit ndërpersonal", është një shërbim i ofruar normalisht, kundrejt një pagese, që mundëson shkëmbimin e drejtpërdrejtë ndërpersonal dhe ndërveprues të informacionit, nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, ndërmjet një numri të kufizuar personash, ku personat që iniciojnë ose marrin pjesë në komunikim përcaktojnë marrësin/(t) e tij. Ky shërbim nuk përfshin shërbimet që mundësojnë komunikimin ndërpersonal dhe ndërveprues thjesht si një veçori ndihmëse e vogël, e lidhur në mënyrë të brendshme me një shërbim tjetër; c) shërbimet që konsistojnë tërësisht ose kryesisht në përcjelljen e sinjaleve të tilla si, shërbime transmetimi që përdoren për ofrimin e komunikimeve makinë – makinë dhe për transmetime radiotelevizive. <p>63. "Shërbim i komunikimit ndërpersonal i bazuar në numër", është një shërbim komunikimi ndërpersonal, i cili lidhet me burimet e numeracionit të caktuara publikisht, domethënë me një numër ose me numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit, që mundëson komunikimin me një numër tjetër, ose numra të planit kombëtar ose ndërkombëtar të numeracionit.</p> <p>64. "Shërbim i komunikimit ndërpersonal i pavarur nga numri", është një shërbim komunikimi ndërpersonal, i cili nuk lidhet me burimet e numeracionit të caktuara publikisht, domethënë me një numër ose numra të planit kombëtar ose</p> | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | | | |
|-------|---|--|------------------|--|---|--|
| | 42. "Incident sigurie" nënkupton çdo ngjarje që ka një efekt aktual negativ në sigurinë e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike. | | | <p>ndërkombëtar të numeracionit, ose që nuk mundëson komunikimin me një numër, ose numra të planit kombëtar, ose ndërkombëtar të numeracionit.</p> <p>65. "Shërbim komunikimi me zë", është një shërbim i komunikimit elektronik i disponueshëm për publikun, për origjinimin dhe marrjen direkte ose indirekte të thirrjeve kombëtare, ose kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni kombëtar ose ndërkombëtar.</p> <p>67. "Shërbime shoqëruese", janë ato shërbime, të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi, apo kanë potencial për ta bërë këtë dhe që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, përkthimin e numrave ose sistemet e ofrimit të funksionalitetit të barazvlefshëm, sistemet e aksesit të kushtëzuar dhe udhëzuesit e programit elektronik dhe shërbime të tjera të tilla, si shërbimet e identitetit, vendndodhjes dhe prezencës.</p> <p>71. "Shërbim i bisedës totale" nënkupton një shërbim bisedimi në kohë reale multimedial, që ofron transferimin simetrik dydrejtimësh në kohë reale të videos me lëvizje, tekstin dhe shërbimin zanor në kohë reale ndërmjet përdoruesve, në dy ose më shumë vendndodhje.</p> <p>77. "Thirrje", është lidhja ndërmjet dy pikave fundore, e realizuar nëpërmjet shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, e cila lejon komunikimin dydrejtimësh.</p> <p>78. "Tregjet ndërkombëtare" nënkupton tregjet e identifikuara në përputhje me nenin 186 të këtij ligji, i cili mbulon bashkimin ose një pjesë të rëndësishme të tij, të lokalizuar në më shumë se disa shtete anëtare.</p> | | |
| Neni3 | <p style="text-align: center;">KAPITULLI 2 Objektivat</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Objektivat e përgjithshme</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që gjatë kryerjes së detyrave rregulluese të përcaktuara në këtë Direktivë, autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, të marrin të gjitha masat e arsyeshme, të cilat janë të nevojshme dhe proporcionale për arritjen e objektivave të përcaktuara në paragrafin 2. Shtetet Anëtare, Komisioni, Grupi i Politikave të Spektrit të Radios ("RSPG") dhe BEREC, gjithashtu do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente do të kontribuojnë brenda kompetencësë tyre, për të siguruar zbatimin e politikave që synojnë promovimin e lirisë së shprehjes dhe informacionit, diversitetin kulturor dhe gjuhësor, si dhe pluralizmin e mediave.</p> | | Neni 5 Neni 6 | <p style="text-align: center;">Neni 5 Objektivat e përgjithshme</p> <p>1. Objektivat e përgjithshme politike për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike janë si më poshtë:</p> <p>a) Promovimi i aksesit dhe konektivitetit në rrjetet e komunikimeve elektronike të kapaciteteve shumë të larta si dhe përdorimi i tyre, nga rrjetet fikse, të lëvizshme dhe ato pa tel, nga të gjithë qytetarët dhe bizneset në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>b) Promovimi i konkurrencës efikente në ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, faciliteteve e shërbimeve shoqëruese të tyre, përfshirë konkurrencën efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike, përmes investimeve ekonomikisht efikente në infrastrukturën e re dhe atë ekzistuese.</p> | F | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| <p>2. Në kontekstin e kësaj direktive, autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, si dhe BEREC, Komisioni dhe shtetet anëtare, do të ndjekin secilën nga objektivat e mëposhtme të përgjithshme, të cilat nuk janë të renditura sipas përparësisë:</p> <p>(a) promovimi i konektivitetit dhe hyrjes në përvetësimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, përfshirë rrjetet fikse, mobile dhe wireless, nga të gjithë qytetarët dhe bizneset e Bashkimit Evropian.</p> <p>(b) promovimi i konkurrencës në sigurimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë konkurrencën efikase të bazuar në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të ofruara;</p> <p>(c) kontribumi në zhvillimin e tregut të brendshëm duke hequr pengesat e mbetura, dhe duke lehtësuar kushtet konvergjente për investimin dhe sigurimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, shërbimeve të komunikimit elektronik, facilitetet shoqëruese dhe shërbimeve të ofruara, në të gjithë Bashkimin Evropian, nga zhvillimi i rregullave të zakonshme dhe qasjeve rregullatore të parashikueshme, duke favorizuar përdorimin efektiv, efikas dhe të koordinuar të spektrit të radios, inovacionit të hapur, krijimin dhe zhvillimin e rrjeteve trans-evropiane, sigurimin, disponueshmërinë dhe ndërveprimin e shërbimeve pan-Evropiane.</p> <p>(d) Promovimi i interesave të qytetarëve të Bashkimit Evropian, duke siguruar lidhjen dhe disponueshmërinë e gjerë dhe përfitimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, përfshirë rrjetet fikse, mobile dhe wireless, dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, duke mundësuar përfitime maksimale në terma të zgjedhjes, çmimit dhe cilësisë në bazë të konkurrencës efektive, duke ruajtur sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, duke siguruar një nivel të lartë dhe të zakonshëm të mbrojtjes për përdoruesit fundorë përmes rregullave të duhura specifike për sektorin dhe duke adresuar nevojat, siç janë çmime të përballueshme, për grupe specifike sociale, në veçanti përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, përdoruesit fundorë të moshuar dhe përdoruesit fundorë me nevoja të veçanta sociale, zgjedhjen dhe aksesin ekuivalent për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.</p> <p>3. Kur Komisioni vendos standarde dhe raporte mbi efektivitetin e masave të Shteteve Anëtare për arritjen e objektiveve të përmendura në paragrafin 2, kur paraqitet e nevojshme, ai do të ndihmohet nga Shtetet Anëtare, autoritetet rregullatore kombëtare, BEREC dhe RSPG.</p> <p>4. Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, në ndjekje të objektivave të politikës të përmendura në paragrafin 2 dhe të specifikuar në këtë paragraf, ndër të tjera:</p> <p>(a) promovojnë parashikueshmërinë rregullatore, duke siguruar një qasje rregullatore të qëndrueshme për periudhat e</p> | | <p>c) Nxitja e zhvillimit të tregut shqiptar të komunikimeve elektronike me rregulla të zhvillimit dhe një kuadër rregullator të parashikueshëm, të harmonizuar me praktikat e Bashkimit Evropian, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. heqjes së pengesave të mbetura; ii. lehtësimit të investimeve në ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, faciliteteve dhe shërbimeve shoqëruese të tyre në kushtet e konvergjencës teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë; iii. promovimit të përdorimit efektiv dhe eficient të spektrit të radiofrekuencave dhe, iv. inovacionit të hapur. <p>Ç) Promovimi i interesave të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë duke siguruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. konektivitetin, disponueshmërinë e gjerë dhe përdorimin e rrjeteve të kapaciteteve shumë të larta si nga rrjetet fikse, të lëvizshme, ato pa tel dhe shërbimet e komunikimeve elektronike; ii. përfitim maksimal në termat e zgjedhjes, çmimit dhe cilësisë, bazuar në konkurrencën efektive; iii. mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, si dhe, iv. një nivel të lartë mbrojtjeje të përbashkët për përdoruesit fundorë, me rregulla specifike sektoriale, për përmbushje të nevojave për: çmime të përballueshme për grupe të veçanta sociale, në veçanti për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, të moshuarit, dhe ata me nevoja të veçanta sociale, si dhe në zgjedhjen e aksesit të barazvlefshëm për personat me aftësi të kufizuara. <p>d) Mbrojtja dhe promovimi i sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, nëpërmjet krijimit të rrjeteve të sigurta, të besuara e me integritet.</p> <p>2. Ministria, AKEP dhe autoritetet e tjera kompetente, në kryerjen e detyrave rregullatore të përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sigurojnë zbatimin e politikave për promovimin e lirisë së shprehjes dhe informimit, promovimin e larmisë kulturore, gjuhësore dhe shumëllojshmërisë së mediave, brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë dhe kompetencave sic përcaktohet në nenet 8, 9 dhe 10, të këtij ligji.</p> <p>3. Politika e përgjithshme e zhvillimit të sektorit të</p> | |
|---|--|--|--|

| | | | | | |
|--|---|--|--|--|--|
| | <p>duhura të rishikimit dhe përmes bashkëpunimit me njëri-tjetrin, me BEREC, me RSPG dhe me Komisionin;</p> <p>(b) sigurojnë që në rrethana të ngjashme të mos ketë diskriminim në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;</p> <p>(c) zbatojnë ligjin e Bashkimit Evropian në një mënyrë teknologjike asnjëse, në masën që kjo të jetë në përputhje me arritjen e objektivave të përcaktuara në paragrafin 2;</p> <p>(d) promovojnë investime dhe inovacione eficientë dhe zgjerojnë infrastrukturën e reja, duke siguruar që çdo detyrim për akses, të marrë parasysh përgjegjësinë e rrezikut të ndërmarrjeve investuese duke lejuar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi midis investitorëve dhe palëve që kërkojnë akses për të diversifikuar rrezikun e investimit, duke siguruar që të ruhet konkurrenca në treg dhe parimi i mosdiskriminimit;</p> <p>(e) marrin në konsideratë shumëllojshmërinë e kushteve në lidhje me infrastrukturën, konkurrencën, rrethanat e përdoruesve fundorë dhe veçanërisht, konsumatorët në zona të ndryshme gjeografike brenda një Shteti Anëtar, përfshirë infrastrukturën lokale të menaxhuar nga persona fizikë mbi një bazë jo-fitimprurëse;</p> <p>(f) imponojnë detyrime rregullatore të parashikuara, vetëm në masën e nevojshme për të siguruar një konkurrencë efektive dhe të qëndrueshme në interes të përdoruesve fundorë dhe për të hequr detyrime të tilla sa më shpejt që të përmbushet ky kusht.</p> <p>Shtetet Anëtare do të sigurojnë që rregullatori kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente të veprojnë në mënyrë të paanshme, objektive, transparente dhe në mënyrë jo-diskriminuese dhe proporcionale.</p> | | | <p>komunikimeve elektronike, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Përmbushja e objektivave</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, AKEP ndërmerr të gjitha masat e nevojshme proporcionale sipas përcaktimeve të këtij ligji, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse dhe autoritetet e tjera përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. 2. AKEP mbështet Ministrinë ose Këshillin e Ministrave, në krijimin e praktikave më të mira dhe raporteve, mbi efektivitetin e masave të ndërmarrja për arritjen e objektivave të përgjithshëm të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji. 3. Në zbatim të objektivave politike të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, AKEP midis të tjerash: <ol style="list-style-type: none"> a) Promovon parashikueshmërinë rregullatore, duke siguruar një qasje rregullatore të qëndrueshme gjatë rishikimeve periodike të vendimeve rregullatore, duke marrë në konsideratë opinionet, rekomandimet, udhëzimet, këshillimet apo praktikatat më të mira rregullatore të zhvilluara nga BEREC dhe RSPG. b) Siguron trajtim jo diskriminues të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në kushte të ngjashme. c) Zbaton për aq sa është e mundur, parimin e neutralitetit teknologjik, në përputhje me objektivat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji, dhe praktikën e BE-së. d) Promovon investimet efçente dhe inovacionin në infrastrukturën e reja dhe ato të përmirësuara, duke përfshirë sigurimin që çdo detyrim aksesi, merr në konsideratë rrezikun e shkaktuar nga sipërmarrësit investues dhe lejon marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi ndërmjet investitorëve dhe palëve që kërkojnë akses për të diversifikuar rrezikun e investimit dhe siguruar njëkohësisht ruajtjen e konkurrencës në treg dhe parimin e mosdiskriminimit. e) Merr në konsideratë kushtet e ndryshme në lidhje me infrastrukturën, konkurrencën, rrethanat e përdoruesve fundorë dhe në veçanti të përdoruesve në zona të ndryshme gjeografike në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë infrastrukturën lokale të administruar nga persona fizikë jo për qëllime fitimi. | |
|--|---|--|--|--|--|

| | | | | | |
|---------------|---|---------------|---|--|--|
| | | | | <p>f) Imponon detyrime rregullatore “<i>ex-ante</i>”, vetëm për atë që është e nevojshme për sigurimin e konkurrencës së qëndrueshme dhe efektive, në interes të përdoruesve fundorë dhe lehtëson ose heq këto detyrime sa më shpejt të jetë e mundur, kur plotësohen kushtet në treg.</p> <p>4. AKEP në përmbushje të objektivave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, vepron në mënyrë të pavarur, objektive, transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale.</p> | |
| Neni 4 | <p style="text-align: center;">Neni 4 Planifikimi strategjik dhe koordinimi i politikës së spektrit radio</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me Komisionin, në planifikimin strategjik, koordinimin dhe harmonizimin e përdorimit të spektrit të radios në Bashkimin Evropian, në përputhje me politikën e Bashkimit Evropian për krijimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm në komunikimet elektronike. Për këtë qëllim, ata do të marrin parasysh ndër të tjera ekonominë, sigurinë, shëndetin, interesin publik, lirinë e shprehjes, aspektet kulturore, shkencore, sociale dhe teknike të politikave të Bashkimit Evropian, si dhe interesat e ndryshme të bashkësive të përdoruesve të spektrit të radios, me qëllim të optimizimit të përdorimit të spektrit radio dhe shmangies së interferencave të dëmshme.</p> <p>2. Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe me Komisionin, Shtetet Anëtare promovojnë koordinimin e qasjes të politikave të spektrit të radios në Bashkimin Evropian dhe kur është e përshtatshme, promovojnë kushte të harmonizuara në lidhje me disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të spektrit të radios, të nevojshme për krijimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm në komunikimet elektronike.</p> <p>3. Shtetet Anëtare, përmes RSPG, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me Komisionin, në përputhje me paragrafin 1, dhe me kërkesën e tyre bashkëpunojnë edhe me Parlamentin Evropian dhe Këshillin, në mbështetje të planifikimit strategjik dhe koordinimit të qasjeve të politikës së spektrit radio në Bashkimin Evropian, duke mundësuar:</p> <p>(a) zhvillimin e praktikave më të mira në lidhje me çështjet e spektrit radio, me qëllim zbatimin e kësaj direktive;</p> <p>(b) lehtësimin e koordinimit midis Shteteve Anëtare me qëllim të zbatimit të kësaj direktive dhe ligjit tjetër të Bashkimit Evropian, si dhe kontribimin në zhvillimin e tregut të brendshëm;</p> <p>(c) koordinimin e qasjes së tyre, për caktimin dhe autorizimin e përdorimit të spektrit të radios dhe botimin e raporteve ose opinioneve për çështje që lidhen me të.</p> <p>BEREC, do të marrë pjesë në çështje brenda kompetencës së tij që kanë të bëjnë me rregullimin e tregut dhe konkurrencën në lidhje me spektrin e radios.</p> | Neni 7 | <p style="text-align: center;">Neni 7 Planifikimi strategjik dhe koordinimi i politikave për spektrin radio</p> <p>1. Spektri i radiofrekuencave është burim natyror i kufizuar dhe një pasuri kombëtare, e mirë publike. Dokumenti i politikave spektrale dhe i koordinimit e planifikimit strategjik të spektrit të radiofrekuencave, miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit.</p> <p>2. Autoritetet kompetente të përcaktuara në nenin 8, dhe pikën 1 të nenit 60, të këtij ligji, bashkëpunojnë me ministrin në hartimin e dokumentit të politikës spektrale dhe koordinimit e planifikimit strategjik në Republikën e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë midis të tjerash aspektet ekonomike, të sigurisë, shëndetit, interesit publik, lirisë së shprehjes, kulturës, shkencës, aspektet teknike dhe sociale të politikave kombëtare, si dhe interesat e komunitetit përdorues të spektrit radio, me qëllim optimizimin e përdorimit të spektrit radio, duke shmangur interferencat e dëmshme.</p> <p>3. Menaxhimi i spektrit, siguron përdorimin efektiv dhe të frytshëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, në përputhje me objektivat e përgjithshme të politikës të përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji dhe vendimet përkatëse të organizatave ndërkombëtare dhe detyrimeve që rrjedhin nga konventat apo marrëveshjet ku Republika e Shqipërisë aderon.</p> <p>4. Plani Kombëtar i Frekuencave, hartohet në përputhje me rregulloret përkatëse të ITU-së dhe me vendimet harmonizuese për spektrin e frekuencave në nivel evropian, duke marrë në konsideratë vendimet e BE-së dhe RSPG-së.</p> <p>5. Për sigurimin e përdorimit efektiv dhe pa interferenca të dëmshme të frekuencave, në veçanti në breza të caktuar, hartohen e miratohen marrëveshje të koordinimit ndërkufitar, bazuar në rregulloret ndërkombëtare të ITU-së dhe praktikën e evropiane.</p> | P | |

| | | | | | |
|--------|---|--------------------|---|---|--|
| | <p>4. Komisioni, duke marrë parasysh opinionin e RSPG, mund të paraqesë propozime legjislative në Parlamentin Evropian dhe Këshill, me qëllim të krijimit të programeve shumëvjeçare të politikave të spektrit të radios, duke përcaktuar orientimet e politikave dhe objektivat për planifikimin strategjik dhe harmonizimin e përdorimit të spektrit të radios, në përputhje me këtë Direktivë, si dhe me qëllim të lëshimit të spektrit të harmonizuar të radios për përdorim të përbashkët ose për përdorim që nuk i nënshtrohet të drejtave individuale.</p> | | | | |
| Neni 5 | <p style="text-align: center;">KAPITULLI II INSTITUTIONAL SET-UP AND GOVERNANCE</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Rregullatori kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që secila prej detyrave të përcaktuara në këtë Direktivë të ndërmerret nga një autoritet kompetent. Brenda qëllimit të kësaj direktive, autoritetet kombëtare rregullatore, do të jenë përgjegjëse për të paktën detyrat e mëposhtme:</p> <p>(a) zbatimin e rregullave të tregut, përfshirë imponimin e detyrimeve të aksesit dhe interkoneksionit;</p> <p>(b) sigurimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve;</p> <p>(c) realizimin e menaxhimit dhe vendimeve të spektrit të radios ose kur keto detyra u janë caktuar autoriteteve të tjera kompetente, dhenia e këshillimit në lidhje me formimin e tregut dhe elementet e konkurrencës së proceseve kombëtare, të lidhura me të drejtat e përdorimit të spektrit radio për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.</p> <p>(d) kontribimin, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente, në mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve fundorë në sektorin e komunikimeve elektronike;</p> <p>(e) vlerësimin dhe monitorimin nga afër të formës së tregut dhe çështjeve të konkurrencës në lidhje me aksesin e hapur në internet;</p> <p>(f) vlerësimin e barrës së padrejtë dhe llogaritjen e kostos neto të ofrimit të shërbimit universal;</p> <p>(g) sigurimin e transportueshmërisë së numrave (number portability) ndërmjet ofruesve;</p> <p>(h) kryerja e çdo detyre tjetër që kjo Direktivë i rezervon autoriteteve rregullatore kombëtare.</p> <p>Shtetet Anëtare mund të caktojnë detyra të tjera të parashikuara në këtë Direktivë dhe në ligjin tjetër të Bashkimit Evropian, tek autoritetet rregullatore kombëtare, në veçanti ato që lidhen me konkurrencën e tregut ose hyrjen në treg, siç është autorizimi i përgjithshëm, dhe ato që lidhen me ndonjë rol që i jepet BEREC. Kur ato detyra që lidhen me konkurrencën e tregut ose hyrjen në treg u janë caktuar autoriteteve të tjera kompetente, ata do të</p> | Neni 10 Neni 12 | KREU II ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE FUNKSIONIMI | F | |
| | | | <p style="text-align: center;">Neni 10 Roli i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare</p> <p>1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.</p> <p>2. AKEP-i është një person juridik, publik, jobuxhetor, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP-i në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij, është i pavarur. AKEP-i e ka selinë në Tiranë.</p> <p>3. AKEP-i kryen funksionet e tij në përputhje me këtë ligj, si dhe me aktet nënligjore, politikat kombëtare për zhvillimin e komunikimeve elektronike dhe marrëveshjet ndërkombëtare të sektorit të komunikimeve elektronike, në të cilat Republika e Shqipërisë aderon.</p> <p>4. AKEP-i përgjatë ushtrimit të kompetencave të tij, merr parasysh udhëzimet, opinionet, rekomandimet, pozicionet e përbashkëta, praktikatat më të mira e metodologjitë e BEREC dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Detyrat e AKEP</p> <p>1. AKEP-i kryen të gjitha detyrat e ngarkuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore, në veçanti për:</p> <p>a) rregullimin “<i>ex ante</i>” të tregut të komunikimeve elektronike, përfshirë vendosjen e detyrimeve të aksesit dhe interkoneksionit;</p> <p>b) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve;</p> | | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>kërkojnë të konsultohen me autoritetin rregullator kombëtar para se të marrin një vendim. Për të kontribuar në detyrat e BEREC, autoritetet rregullatore kombëtare kanë të drejtë të mbledhin të dhëna të nevojshme dhe informacione të tjera nga pjesëmarrësit e tregut.</p> <p>Shtetet Anëtare mund t'u caktojnë autoriteteve rregullatore kombëtare detyra të tjera në bazë të ligjit kombëtar, duke përfshirë ligjin kombëtar që zbaton ligjin e Bashkimit Evropian.</p> <p>Shtetet Anëtare, veçanërisht, promovojnë stabilitetin e kompetencave të autoriteteve rregullatore kombëtare kur transpozojnë këtë Direktivë në lidhje me caktimin e detyrave që rrjedhin nga kuadri rregullator i komunikimit elektronik të Bashkimit Evropian, ndryshuar në 2009.</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente të të njëjtit shtet anëtar ose të shteteve të ndryshme anëtare do të hyjnë kur është e nevojshme, në marrëveshje bashkëpunimi me njëri-tjetrin për të nxitur bashkëpunimin rregullator.</p> <p>3. Shtetet Anëtare do të publikojnë detyrat që duhen ndërmarrë nga rregullatori kombëtar dhe autoritete të tjera kompetente në një formë lehtësisht të arritshme, veçanërisht kur ato detyra u caktohen më shumë se një autoriteti. Shtetet Anëtare sigurojnë kur është e përshtatshme konsultime dhe bashkëpunim midis këtyre autoriteteve, dhe midis atyre autoriteteve dhe autoriteteve kombëtare, të cilëve u është besuar zbatimimi i ligjit të konkurrencës ose ligjit të konsumatorit, për çështje me interes të përbashkët. Kur më shumë se një autoritet ka kompetencë për të adresuar çështje të tilla, Shtetet Anëtare sigurojnë që detyrat përkatëse të secilit autoritet të publikohen në një formë lehtësisht të aksesueshme.</p> <p>4. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin për të gjithë rregullatorët kombëtarë dhe autoritetet e tjera kompetente, të cilëve u janë caktuar detyra sipas kësaj Direktive, dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, si dhe çdo ndryshim të tyre.</p> <p>Neni 6</p> <p>Pavarësia e autoriteteve rregullatore kombëtare dhe autoriteteve të tjera kompetente</p> <p>1. Shtetet Anëtare garantojnë pavarësinë e autoriteteve rregullatore kombëtare dhe të autoriteteve të tjera kompetente, duke siguruar që ata janë juridikisht të dallueshëm dhe të pavarur funksionalisht nga çdo person fizik ose juridik që siguron rrjete, pajisje ose shërbime të komunikimeve elektronike. Shtetet Anëtare që mbajnë pronësinë ose kontrollin e ndërmarrjeve, që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, duhet të sigurojnë ndarje efektive strukturore të funksionit rregullator nga aktivitetet që lidhen me pronësinë ose kontrollin.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që rregullatori kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente të ushtrijnë kompetencat e tyre në mënyrë të paanshme, transparente dhe në kohën e duhur. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që ato kanë burime të mjaftueshme</p> | | <p>c) kryen administrimin e spektrit të radiofrekuencave, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe merr vendimet përkatëse;</p> <ol style="list-style-type: none"> i. bashkëpunon me Ministrinë për përgatitjen e Planit Kombëtar të Frekuencave; ii. përgatit planin e përdorimit të radiofrekuencave dhe detajon përcaktimet për brezat e radiofrekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorime publike ose private, me përjashtim të brezit të frekuencave të caktuara për transmetimin radioteleviziv, të cilat administrohen nga Autoriteti i Medias Audiovizive; iii. monitoron përdorimin e spektrit të radiofrekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave; iv. lëshon autorizimet individuale për përdorimin e radio-frekuencave; v. ndjek procedurat e përcaktuara nga ky ligj, në lidhje me caktimin dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave; vi. kryen koordinimin ndërkuftar të përdorimit të radiofrekuencave me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera, në lidhje me spektrin që administrojnë AKEP; vii. bashkëpunon me AMA dhe institucionet e tjera, për administrimin e spektrit të frekuencave me qëllim përdorimin eficient të tij; viii. kontribuon në mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve fundorë në sektorin e komunikimeve elektronike, në koordinim sipas rastit, me ministrin dhe autoritetet e tjera kompetente për mbrojtjen e konsumatorit; ix. vlerëson dhe monitoron nga afër çështjet e formimit të tregut dhe konkurrencës, në lidhje me aksesin e hapur në internet; x. vlerëson barrën e padrejtë dhe llogarit koston neto të ofrimit të shërbimit universal; xi. siguron zbatimin e portabilitetit të numrave ndërmjet ofruesve. <p>2. AKEP është gjithashtu përgjegjës për:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve të tjera të nevojshme nga pjesëmarrësit e tregut, për të kontribuar në detyrat e BEREC; b) inkurajimin e përdorimit efikas të burimeve të kufizuara natyrore si radio-frekuencat dhe hapësirat numerike; c) mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare dhe garantimin e ruajtjes së integritetit dhe sigurisë së rrjeteve publike të komunikimeve elektronike; | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>teknike, financiare dhe njerëzore për të kryer detyrat që u janë caktuar.</p> | | <ul style="list-style-type: none"> d) përgatitjen, miratimin dhe administrimin e Planit Kombëtar të Numeracionit, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë; e) caktimin e numrave ose blloqeve të numrave, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe palëve të tjera të interesuara, siç përcaktohet nga Plani Kombëtar i Numeracionit. f) administron domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare; g) marrjen e masave administrative në përputhje me këtë ligj në rastet e shkeljes së këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij; h) menaxhimin dhe administrimin e Fondit të Shërbimit Universal, nëse është e aplikueshme; i) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve të rrjeteve të komunikimit elektronik dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimit elektronik, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve fundorë dhe operatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji; j) krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një baze të dhënash elektronike nga sektori i komunikimeve elektronike dhe sigurimin që të dhënat të jenë të disponueshme për publikun, në përputhje me rregullat për informacionin publik dhe respektimin e konfidencialitetit; k) mbledhjen e të dhënave dhe informacionit nga operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike; l) ndjek zbatimin e kërkesave thelbësore për pajisjet radio sipas rregullit teknik të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave; m) siguron që operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik, në rast lufte ose rrethanash të tjera të jashtëzakonshme, përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me mbrojtjen e vendit, sigurinë publike; n) kryerjen e procedurave për caktimin e ofruesit të shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 113 të këtij ligji; o) përcaktimin e rregullave për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes në vijën bregdetare | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|---|--|--|---|---|--|
| | | | | <p>pasi merr mendimin e ministrit;</p> <p>p) vendosjen e rregullave dhe kërkesave teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore në Republikën e Shqipërisë, bazuar në radiatorregulloret e ITU;</p> <p>q) sigurimin e disponueshmërisë së një baze qëndrore të dhënash për portabilitetin e numrave;</p> <p>r) përcaktimin e masave, për rregullimin e tarifave dhe çmimeve maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar të numrave të përdorur për shërbimet me vlerë të shtuar premium, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.</p> <p>3. AKEP bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për sektorin e komunikimeve elektronike dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre, në veçanti për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji.</p> <p>4. AKEP i paraqet Ministrinë, çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit dhe kompetencave të përcaktuara në këtë ligj dhe ato të ligjit për shërbimin postar.</p> <p>5. AKEP ka të drejtë të rregullojë shërbimet roaming mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe të tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.</p> | | |
| Neni 6 | <p align="center">Neni 6 Pavarësia e autoriteteve rregullatore kombëtare dhe autoriteteve të tjera kompetente</p> <p>1. Shtetet Anëtare garantojnë pavarësinë e autoriteteve rregullatore kombëtare dhe të autoriteteve të tjera kompetente, duke siguruar që ata janë juridikisht të dallueshëm dhe të pavarur funksionalisht nga çdo person fizik ose juridik që siguron rrjete, pajisje ose shërbime të komunikimeve elektronike. Shtetet Anëtare që mbajnë pronësinë ose kontrollin e ndërmarrjeve, që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, duhet të sigurojnë ndarje efektive strukturore të funksionit rregullator nga aktivitetet që lidhen me pronësinë ose kontrollin.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që rregullatori kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente të ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të paanshme, transparente dhe në kohën e duhur. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që ato kanë burime të mjaftueshme teknike, financiare dhe njerëzore për të kryer detyrat që u janë caktuar.</p> | | <p>Neni 13 Neni 14 Neni 15</p> | <p align="center">Neni 13 Pavarësia e AKEP</p> <p>1. AKEP ushtron kompetencat e tij në mënyrë të paanshme, objektive, transparente dhe të shpejtë. AKEP funksionon në mënyrë të pavarur, në ushtrimin e detyrave që i ngarkohen sipas këtij ligji. Ky parashikim nuk pengon mbikëqyrjen e veprimtarisë së AKEP, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>2. AKEP është i pavarur nga pronësia e sipërmarrjeve që ofrojnë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike dhe siguron ndarje strukturore efektive të funksionit rregullator, nga aktivitetet që lidhen me pronësinë e sipërmarrjeve ose kontrollin e saj.</p> <p>3. AKEP ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, me aftësi teknike të kërkuara për kryerjen e detyrave që i ngarkohen, përfshirë pjesëmarrjen në BEREC.</p> <p>4. Këshilli Drejtues i AKEP, propozon për miratim pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë strukturën dhe organikën e AKEP. Këshilli Drejtues miraton pagën,</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | <p>shpërblimet dhe trajtimet e tjera financiare dhe jofinanciare të punonjësve të AKEP.</p> <p>5. Këshilli Drejtues në përcaktimin e masës së pagës, shpërblimeve dhe trajtimeve të tjera financiare dhe jofinanciare të administratës, bazohet në një metodologji të qartë, që merr parasysh kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitetin e rregullatorit në Republikën e Shqipërisë dhe nevojat e vetë institucionit.</p> <p>6. Çdo vit, AKEP i paraqet Kuvendit Raportin Vjetor për veprimtarinë e tij, brenda pesë muajve të parë të vitit pasardhës. Një kopje e raportit i dorëzohet Ministrisë.</p> <p>7. Raporti Vjetor vihet në dispozicion të publikut dhe përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) raportin e veprimtarisë së AKEP të vitit paraardhës; b) programin vjetor për vitin në vazhdim; c) raportin mbi gjendjen e tregut të komunikimeve elektronike përfshirë Shërbimin Universal; d) raportin mbi burimet njerëzore dhe financiare të AKEP dhe mënyrën se si atribuohen këto burime. <p>8. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, mund të ankimohen në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>9. AKEP mbështet objektivat e BEREC dhe gjatë miratimit të vendimeve të tij, merr parasysh maksimalisht udhëzimet, opinionet, rekomandimet, qëndrimet e përbashkëta, praktikatat më të mira dhe metodologjitë e miratuara nga BEREC.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Këshilli Drejtues i AKEP</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AKEP drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë. 2. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në procedurë të hapur dhe transparente, mbi bazën e propozimit të Këshillit të Ministrave. Anëtarët e Këshillit Drejtues të AKEP, emërohen për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje jo më shumë se 1 herë. 3. Kuvendi emëron Kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit është edhe Drejtues Ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. 4. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë ekspertë të diplomuar dhe të kualifikuar, me përvojë minimale 10 vjet dhe janë përfaqësues të sektorit të komunikimeve elektronike, postare, ekonomike dhe juridike. 5. Anëtarët e Këshillit Drejtues, pasi emërohen, japin dorëheqjen nga çdo funksion zyrtar dhe politik, apo veprimtari fitimprurëse, si dhe heqin dorë nga çdo interes financiar që mund të ketë në shoqëri që ushtrojnë | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>veprimtari tregtare nën juridiksionin e AKEP. Për këto veprime, anëtari informon me shkrim Kuvendin.</p> <p>6. Personat që përjashtohen nga të qenit anëtarë të Këshillit Drejtues:</p> <ol style="list-style-type: none"> personi, bashkëshorti ose të afërmit deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Këshillit të Ministrave; personi që është dënuar nga gjykata për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë; personi, që është debitor, kreditor ose aksionar në një shoqëri, e cila i nënshtrohet kuadrit rregullator të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare; personi që përjashtohet me ligj për të mbajtur poste publike shtetërore. <p style="text-align: center;">Neni 15 Vendimmarrja dhe Struktura e Këshillit Drejtues</p> <ol style="list-style-type: none"> Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë. Çdo anëtar, duke përfshirë edhe Kryetarin, ka një votë. Asnjë mungesë apo vend vakant në Këshillin Drejtues, nuk çënon të drejtën e anëtarëve të mbetur, për të ushtruar të drejtat e tyre. Anëtarët e Këshillit Drejtues abstenojnë nga votimi, kur zbatohet një nga rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. | | |
| Neni 7 | Neni 7 Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të autoriteteve rregullatore kombëtare | | Neni 14 Neni 15 Neni 16 Pg. 2 Neni 25 | Neni 14 Këshilli Drejtues i AKEP | F | |
| | <ol style="list-style-type: none"> Kreu i një autoriteti rregullator kombëtar, ose kur është e aplikueshme, anëtarët e organit kolegjal që kryejnë atë funksion brenda një autoriteti rregullator kombëtar ose zëvendësit e tyre, emërohet për një mandat së paku tre vjeçar nga rradhët e personave me statusin e njohur dhe përvojë profesionale, në bazë të meritës, aftësive, njohurive dhe eksperiencave, duke ndjekur një procedurë të hapur dhe transparente të përzgjedhjes. Shtetet Anëtare do të sigurojnë vazhdimësinë e vendimmarrjes. Shtetet Anëtare sigurojnë që kreu i një autoriteti rregullator kombëtar, ose kur është e nevojshme anëtarët e organit kolegjal që kryejnë atë funksion brenda një autoriteti rregullator kombëtar, ose zëvendësit e tyre mund të shkarkohen gjatë mandatit të tyre vetëm nëse nuk plotësojnë më kushtet e kërkuara për kryerjen e detyrave të tyre të përcaktuara në ligjin kombëtar para emërimit të tyre. | | | <ol style="list-style-type: none"> AKEP drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në procedurë të hapur dhe transparente, mbi bazën e propozimit të Këshillit të Ministrave. Anëtarët e Këshillit Drejtues të AKEP, emërohen për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje jo më shumë se 1 herë. Kuvendi emëron Kryetarin, ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit është edhe Drejtues Ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë ekspertë të diplomuar dhe të kualifikuar, me përvojë minimale 10 vjet dhe janë përfaqësues të sektorit të komunikimeve elektronike, postare, ekonomike dhe juridike. | | |

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>3. Vendimi për të shkarkuar kreun e autoritetit rregullator kombëtar në fjalë, ose ku është e aplikueshme, anëtarët e organit kolegjal që kryejnë këtë funksion, do të bëhet publik në kohën e shkarkimit. Kreu i shkarkuar i autoritetit rregullator kombëtar ose, kur është e aplikueshme, anëtarët e organit kolegjal që kryejnë këtë funksion, do të marrin një deklaratë arsyesh. Në rast se deklarata e arsyeve nuk publikohet, ajo do të publikohet me kërkesë të këtij personi. Shtetet Anëtare sigurojnë që ky vendim t'i nënshtrohet rishikimit nga një gjykatë, në pikat faktike, si dhe në pikat e ligjit.</p> | | <p>11. Anëtarët e Këshillit Drejtues, pasi emërohen, japin dorëheqjen nga çdo funksion zyrtar dhe politik, apo veprimtari fitimprurëse, si dhe heqin dorë nga çdo interes financiar që mund të ketë në shoqëri që ushtrojnë veprimtari tregtare nën juridiksionin e AKEP. Për këto veprime, anëtari informon me shkrim Kuvendin.</p> <p>12. Personat që përjashtohen nga të qenit anëtarë të Këshillit Drejtues:</p> <ul style="list-style-type: none"> e) personi, bashkëshorti ose të afërmit deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Këshillit të Ministrave; f) personi që është dënuar nga gjykata për kryerjen e një veprë penale, me vendim të formës së prerë; g) personi, që është debitor, kreditor ose aksionar në një shoqëri, e cila i nënshtrohet kuadrit rregullator të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare; h) personi që përjashtohet me ligj për të mbajtur poste publike shtetërore. <p style="text-align: center;">Neni 15 Vendimmarrja dhe Struktura e Këshillit Drejtues</p> <p>3. Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë. Çdo anëtar, duke përfshirë edhe Kryetarin, ka një votë. Asnjë mungesë apo vend vakant në Këshillin Drejtues, nuk cënon të drejtën e anëtarëve të mbetur, për të ushtruar të drejtat e tyre.</p> <p>4. Anëtarët e Këshillit Drejtues abstenojnë nga votimi, kur zbatohet një nga rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues</p> <p>1. Anëtari i Këshillit Drejtues shkarkohet nga Kuvendi kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) gjatë periudhës të ushtrimit të detyrës si anëtar i Këshillit Drejtues i AKEP, shpallet fajtor për një krim me vendim gjyqësor të formës së prerë gjatë ushtrimit të detyrës; b) ka refuzuar ose nuk i ushtron pa shkak detyrat e caktuara, ose nuk ka qenë në gjendje t'i ushtrojë këto detyra për të paktën 6 muaj; c) përfshihet në ndonjë nga dispozitat e pikës 6 të nemit 14, të këtij ligji; d) vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. <p>2. Anëtari i Këshillit Drejtues lirohet nga Kuvendi kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) jep dorëheqjen; | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>b) zgjidhet ose kandidon si deputet i Kuvendit ose në organet e pushtetit vendor, me përjashtim të rastit kur është anëtar i shoqatave profesionale dhe mban funksione në to;</p> <p>c) është fizikisht ose mendërisht i paafitë për të kryer detyrat e përcaktuara.</p> <p>3. Kur shkarkohet një anëtar i Këshillit Drejtues, sipas pikës 1 të këtij neni, një anëtar zëvendësues emërohet nga Kuvendi, në përputhje me nenin 14, të këtij ligji, për një kohë të barabartë me kohën që i kishte mbetur pararendësit.</p> <p>4. Anëtari i shkarkuar i Këshillit Drejtues, nuk ka të drejtë të riemërohet në Këshillin Drejtues.</p> <p>5. Para se të lirohet ose shkarkohet, anëtari i Këshillit Drejtues ka mundësi të paraqesë ankimin e tij në Kuvend.</p> <p>6. Vendimi për të liruar dhe shkarkuar kryetarin, një anëtar ose më shumë se një anëtar, duhet të jetë i bazuar në ligj dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë në lirim ose shkarkimin e tij/tyre.</p> <p>7. Procedura e shkarkimit që kryhet nga Kuvendi, është transparente dhe vendimi i tij bëhet publik, në momentin e shkarkimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente</p> <p>1. AKEP, bashkëpunon me autoritetet e tjera kompetente për çështje të interesit të përbashkët, përmes shkëmbimit të informacionit për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore, si dhe të praktikave të lidhura me sektorin e komunikimeve elektronike. Autoritetet kompetente marrëse të informacionit, zbatojnë të njëjtin nivel konfidencialiteti.</p> <p>2. AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës, bashkëpunojnë në çështje të interesit të përbashkët, në zbatim të legjislacionit në fuqi për konkurrencën në sektorin e komunikimeve elektronike. Në veçanti në procesin e përcaktimit të tregjeve përkatës dhe analizat e tyre, AKEP konsultohet dhe bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës.</p> <p>3. AKEP dhe autoritetet e tjera kompetente, kur është e nevojshme për të nxitur bashkëpunimin rregullator, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me njeri tjetrin.</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|---------------|--|--------------------------------|---|---|--|
| | | | | | |
| Neni 8 | <p style="text-align: center;">Neni 8 Pavarësia politike dhe përgjegjësia e autoriteteve rregullatore kombëtare</p> <p>1. Pa paragjykuar nenin 10, autoritetet kombëtare rregullatore do të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe objektive, përfshirë zhvillimin e procedurave të brendshme dhe organizimin e stafit, do të veprojnë në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, dhe nuk do të kërkojnë ose marrin udhëzime nga çdo organ tjetër në lidhje me ushtrimin e detyrave që u janë caktuar atyre sipas ligjit kombëtar për zbatimin e ligjit të Bashkimit Evropian. Kjo nuk do të parandalojë mbikëqyrjen në përputhje me ligjin kombëtar kushtetues. Vetëm organet e apelit të krijuara në përputhje me Nenin 31 kanë fuqi të pezullojnë ose rrezojnë vendimet e autoriteteve rregullatore kombëtare.</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare raportojnë çdo vit, ndër të tjera, për gjendjen e tregut të komunikimeve elektronike, për vendimet që ata nxjerrin, për burimet e tyre njerëzore dhe financiare dhe se si atribuohen ato burime, si dhe për planet e ardhshme. Raportet e tyre duhet të bëhen publike.</p> | Pg.1-3, Neni 13 Neni 11 | <p style="text-align: center;">Neni 13 Pavarësia e AKEP</p> <p>1. AKEP ushtron kompetencat e tij në mënyrë të paanshme, objektive, transparente dhe të shpejtë. AKEP funksionon në mënyrë të pavarur, në ushtrimin e detyrave që i ngarkohen sipas këtij ligji. Ky parashikim nuk pengon mbikëqyrjen e veprimtarisë së AKEP, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>2. AKEP është i pavarur nga pronësia e sipërmarrjeve që ofrojnë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike dhe siguron ndarje strukturore efektive të funksionit rregullator, nga aktivitetet që lidhen me pronësinë e sipërmarrjeve ose kontrollin e saj.</p> <p>3. AKEP ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, me aftësi teknike të kërkuara për kryerjen e detyrave që i ngarkohen, përfshirë pjesëmarrjen në BEREC.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Vendimmarrja dhe Struktura e Këshillit Drejtues</p> <p>1. Këshilli Drejtues merr vendimet me shumicë votash, kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë. Çdo anëtar, duke përfshirë edhe Kryetarin, ka një votë. Asnjë mungesë apo vend vakant në Këshillin Drejtues, nuk cënon të drejtën e anëtarëve të mbetur, për të ushtruar të drejtat e tyre.</p> <p>2. Anëtarët e Këshillit Drejtues abstenojnë nga votimi, kur zbatohet një nga rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.</p> | F | |
| Neni 9 | <p style="text-align: center;">Neni 9 Kapaciteti rregullator i autoriteteve rregullatore kombëtare</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare të kenë buxhete të veçanta vjetore dhe të kenë autonomi në zbatimin e buxhetit të alokuar. Këto buxhete do duhet të bëhen publike.</p> <p>2. Pa cënuar detyrimin për të siguruar që autoritetet rregullatore kombëtare të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të kryer detyrën e caktuar për to, autonomia</p> | Neni 17 | <p style="text-align: center;">Neni 17 Financimi dhe buxheti i AKEP</p> <p>1. Burimet e financimit të AKEP, janë pagesat që bëhen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.</p> <p>2. Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore të AKEP, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave pas</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|--|---|---|--|
| | <p>financiare nuk do të parandalojë mbikëqyrjen ose kontrollin në përputhje me ligjin kombëtar kushtetues. Çdo kontroll mbi buxhetin e autoriteteve rregullatore kombëtare do të ushtrohet në mënyrë transparente dhe bëhet publik.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë gjithashtu që autoritetet kombëtare rregullatore të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për t'iu dhënë mundësi atyre që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në BEREC.</p> | | | <p>shqyrtimit në ministrinë përgjegjëse për financat. Këshilli Drejtues i AKEP detajon buxhetin e miratuar.</p> <p>3. AKEP mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin. AKEP-i gjithashtu publikon bilancin financiar vjetor që depoziton në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.</p> <p>4. Çdo tepriç që mbetet pa shpenzuar në përfundim të vitit financiar, transferohet për vitin pasardhës, dhe mbahet parasysh në rishikimin e pagesave përkatëse.</p> <p>5. Në rast të tepriçs së mbetur sipas pikës 4, të këtij neni, AKEP në vitin pasardhës, zvogëlon në mënyrë proporcionale, objektive, dhe jo diskriminuese për sipërmarrësit, pagesën e mbikëqyrjes së tregut, të parashikuar në nenin 20 të këtij ligji dhe publikon informacion mbi reflektimin e tepriçs së mbetur nga viti paraardhës, në pagesat e mbikëqyrjes së tregut për vitin në vijim.</p> | | |
| Neni10 | <p style="text-align: center;">Neni 10 Pjesëmarrja e autoriteteve rregullatore kombëtare në BEREC</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që qëllimet e BEREC, për të promovuar një koordinim dhe qëndrueshmëri më të madhe rregullatore, mbështeten në mënyrë aktive nga autoritetet e tyre përkatëse rregullatore.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kombëtare rregullatore të marrin parasysh maksimalisht udhëzimet, mendimet, rekomandimet, pozicionet e përbashkëta, praktikrat më të mira dhe metodologjitë e miratuara nga BEREC, teksa miratojnë vendimet e tyre për tregjet e tyre kombëtare.</p> | | <p>Pika 4, Neni 10 Pika 3, Neni 13</p> | <p style="text-align: center;">Neni 10 Roli i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare</p> <p>4. AKEP-i përgjatë ushtrimit të kompetencave të tij, merr parasysh udhëzimet, opinionet, rekomandimet, pozicionet e përbashkëta, praktikrat më të mira e metodologjitë e BEREC dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Pavarësia e AKEP</p> <p>3. AKEP ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, me aftësitë teknike të kërkuara, për kryerjen e detyrave që i ngarkohen, përfshirë pjesëmarrjen në BEREC.</p> | F | |
| Neni11 | <p style="text-align: center;">Neni 11 Bashkëpunimi me autoritetet kombëtare</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare, autoritetet e tjera kompetente sipas kësaj direktive dhe autoritetet kombëtare të konkurrencës, do t'i sigurojnë njëri-tjetrit informacionin e nevojshëm për zbatimin e kësaj direktive. Në lidhje me informacionin e shkëmbyer, do të zbatohen rregullat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave, dhe autoriteti pranues do të sigurojë të njëjtin nivel të konfidencialitetit me atë të autoritetit origjinal.</p> | | <p>Neni 25</p> | <p style="text-align: center;">Neni 25 Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente</p> <p>1. AKEP, bashkëpunon me autoritetet e tjera kompetente për çështje të interesit të përbashkët, përmes shkëmbimit të informacionit për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore, si dhe të praktikave të lidhura me sektorin e komunikimeve elektronike. Autoritetet kompetente marrëse të informacionit, zbatojnë të njëjtin nivel konfidencialiteti.</p> <p>2. AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës, bashkëpunojnë në çështje të interesit të përbashkët, në zbatim të legjislacionit në fuqi për konkurrencën në sektorin e komunikimeve elektronike. Në veçanti në procesin e përcaktimit të tregjeve përkatës dhe analizat e tyre, AKEP konsultohet dhe bashkëpunon me Autoritetin e</p> | F | |

| | | | | | |
|--------|--|--------------------|--|---|--|
| | | | | Konkurrencës. 3. AKEP dhe autoritetet e tjera kompetente, kur është e nevojshme për të nxitur bashkëpunimin rregullator, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me njeri tjetrin. | |
| Neni12 | <p style="text-align:center">KAPITULLI II AUTORRIZIMI I PËRGJITHSHËM SEKSIONI 1 Pjesa e përgjithshme</p> <p style="text-align:center">Neni 12 Autorizimi i përgjithshëm i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë lirinë e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këtë Direktivë. Për këtë qëllim Shtetet Anëtare nuk e pengojnë një ndërmarrje të sigurojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, përveç kur është e nevojshme për arsyet e përcaktuara në nenin 52 (1) TFEU. Çdo kufizim i tillë i lirisë për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike do të arsyetohet siç duhet dhe do t'i njoftohet Komisionit.</p> <p>2. Sigurimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të pavarura të komunikimit ndërnjerëzor, të pavarur nga numri, mund të mos cenonjë detyrimet specifike të përmendura në nenin 13 (2) ose të drejtat e përdorimit të përmendura në nenet 46 dhe 94, i nënshtrohet vetëm një autorizimi të përgjithshëm.</p> <p>3. Kur një Shtet Anëtar konsideron se një kërkesë e njoftimit për ndërmarrjet që i nënshtrohen një autorizimi të përgjithshëm është e justifikuar, ai Shtet Anëtar mund të kërkojë nga ndërmarrjet e tilla vetëm të paraqesin një njoftim pranë rregullatorit kombëtar ose autoritetit tjetër kompetent. Shteti Anëtar nuk kërkon që ndërmarrjet e tilla të marrin një vendim të caktuar ose ndonjë akt tjetër administrativ nga një autoritet i tillë ose nga ndonjë autoritet tjetër përpara se të ushtrojnë të drejtat e rrjedhura nga autorizimi i përgjithshëm.</p> <p>Në bazë të njoftimit, kur kërkohet, një ndërmarrje mund të fillojë veprimtarinë kur është e nevojshme, në varësi të dispozitave për të drejtat e përdorimit sipas kësaj direktive.</p> <p>4. Njoftimi i përmendur në paragrafin 3, nuk do të thotë më shumë se një deklaratë nga një person fizik ose juridik tek rregullatori kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent për qëllimin për të filluar sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe dorëzimin e informacionit minimal i cili kërkohet të lejojë BEREC dhe atë autoritet, të mbajnë një regjistër ose listë të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Ky informacion do të kufizohet në: (a) emrin e ofruesit;</p> | Neni 26 Neni 27 | <p style="text-align:center">KREU III AUTORIZIMI I PËRGJITHSHËM</p> <p style="text-align:center">SEKSIONI 1 PJESA E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align:center">Neni 26 Autorizimi i përgjithshëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike</p> <p>1. Çdo sipërmarrës, është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike nga një sipërmarrës, nuk pengohet nga AKEP, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për arsye të interesit publik, sigurisë publike ose shëndetit publik. Çdo kufizim për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, argumentohet bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi, i njoftohet Ministrisë, si dhe publikohet paraprakisht.</p> <p>2. Ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarura nga numrat, është subjekt vetëm i regjimit të autorizimit të përgjithshëm, pa paragjykuar respektimin e detyrimeve specifike të përcaktuara sipas pikës 6 të nenit 28 të këtij ligji, si dhe kërkesat për të drejtat e përdorimit sipas nenit 66 dhe 132 të këtij ligji, kur ofrimi i rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike bazohet në përdorimin e burimeve natyrore të fundme.</p> <p>3. Para fillimit të aktivitetit, çdo sipërmarrës njofton AKEP sipas një formulari të miratuar për mënyrat e njoftimit, bazuar në udhëzimet përkatëse të BEREC, që përmban elementët e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 27, të këtij ligji. Sipërmarrësit nuk i vendosen kërkesa shtesë ose të veçanta për njoftimin. Për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga autorizimi i përgjithshëm, sipërmarrësi i autorizuar nuk ka nevojë për marrjen e një vendimi apo akti administrativ të posaçëm nga AKEP. Me njoftimin dhe kur është e nevojshme përdorimi i burimeve të kufizuara, sipërmarrësi fillon aktivitetin, duke ju nënshtruar dispozitave për të drejtat e përdorimit, sipas këtij ligji për pajisjen me autorizim individual.</p> | F | |
| | | | | Neni 27 | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>(b)statusin juridik, formularin dhe numrin e regjistrimit të ofruesit, kur ofruesi është i regjistruar në një tregti ose regjistër tjetër të ngjashëm publik në Bashkimin Evropian;</p> <p>(c)adresën gjeografike të selisë kryesore të ofruesit në Bashkimin Europian, nëse ka dhe, kur është e përshtatshme, çdo degë dytësore në një Shtet Anëtar;</p> <p>(d)adresën e faqes së internetit të ofruesit, kur është e përshtatshme, e lidhur me sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;</p> <p>(e)kontaktet e një personi dhe detajet e kontaktit;</p> <p>(f)një përshkrim i shkurtër i rrjeteve ose shërbimeve që synojnë të ofrohen;</p> <p>(g)Shtetet Anëtare në fjalë;</p> <p>dhe</p> <p>(h)një datë të parashikuar për fillimin e veprimtarisë.</p> <p>Shtetet Anëtare nuk do të imponojnë ndonjë kërkesë shtesë ose kërkesë të veçantë njoftimi.</p> <p>Për të përafuar kërkesat e njoftimit, BEREC do të publikojë udhëzime për modelin e njoftimit dhe do të mbajë një bazë të dhënash të Bashkimit Evropian për njoftimet e transmetuara tek autoritetet kompetente. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente do të dërgojnë, me mjete elektronike çdo njoftim të marrë në BEREC pa vonesë të panevojshme. Njoftimet e bëra tek autoritetet kompetente para 21 dhjetorit 2020 do t'i përcillen BEREC deri më 21 dhjetor 2021.</p> | | <p style="text-align: center;">Njoftimi</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilido sipërmarrës, që për qëllime fitimi, parashikon të ofrojë një rrjet apo shërbim të komunikimit elektronik, njofton AKEP përpara fillimit të funksionimit, ndryshimit ose ndërprerjes së shërbimit. 2. Njoftimi i sipërmarrësit bëhet me shkrim, sipas rregullave të miratuara nga AKEP dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm: <ol style="list-style-type: none"> a) emrin, adresën gjeografike të degës kryesore të ofruesit dhe sipas rastit, të çdo dege dytësore; b) të dhënat e regjistrimit ligjor të sipërmarrësit, statusin ligjor, formën dhe numrin e regjistrimit, vendndodhjen e ofruesit; c) personin/at e kontaktit dhe të dhënat e kontaktit të sipërmarrësit; d) adresën e faqes web të ofruesit, që lidhet me ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, aty ku është e disponueshme, e shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të rrjeteve ose shërbimeve që do të ofrohen; e) kur është parashikuar fillimi i ofrimit, ndryshimi ose përfundimi i aktivitetit; f) shtrirjen gjeografike të rrjetit dhe shërbimeve që do të ofrohen dhe sipas rastit, së bashku me vendet që mbulojnë, përveç Republikës së Shqipërisë. g) një deklaratë mbi datën brenda të cilës sipërmarrësi kompletton ndërtimin e rrjetit ose ofrimin e shërbimeve të tij; 3. Njoftimi shoqërohet me: <ol style="list-style-type: none"> a) një deklaratë se informacioni është i saktë; b) një deklaratë se sipërmarrësi zotëron kapacitetet teknike, ligjore dhe financiare të nevojshme dhe do të zbatojë detyrimet ligjore. 4. Sipërmarrësi raporton tek AKEP çdo ndryshim në informacionin e paraqitur në njoftim, brenda 30 ditëve nga ndodhja e ndryshimit. 5. AKEP regjistron operatorët ose ofruesit e shërbimeve në bazën e të dhënave elektronike, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit dhe njofton regjistrimin e tyre me shkrim. 6. Kur njoftimi është jo i plotë, bazuar në kërkesat e pikave 2 dhe 3 të këtij neni, AKEP njofton sipërmarrësin brenda 7 ditësh pas marrjes së njoftimit, për plotësimin e mangësive në dokumentacion. Nëse sipërmarrësi nuk e plotëson informacionin që mungon brenda 15 ditëve, AKEP njofton sipërmarrësin se nuk do ta regjistrojë atë. Sipërmarrësi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP-it për këtë çështje. 7. Nëse AKEP nuk konfirmon me shkrim, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5, të këtij neni, ose nuk i | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|--------|--|--|---|--|--|--|
| | | | | <p>komunikon sipërmarrësit mungesën e informacionit sipas pikës 6, të këtij neni, njoftimi dhe regjistrimi konsiderohen të përfunduar.</p> <p>8. AKEP, miraton me një rregullore në zbatim të këtij ligji, formën dhe përmbajtjen e njoftimit, dokumentacionin mbështetës dhe konfirmimin e regjistrimit, duke marrë parasysh udhëzimet përkatëse të BEREC.</p> <p>9. AKEP administron një regjistër të përditësuar për personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë njoftuar dhe janë regjistruar sipas përcaktimeve të këtij neni, i cili përmban informacionin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni. Ky informacion bëhet i disponueshëm për publikun.</p> <p>10. AKEP bën çregjistrimin e sipërmarrësit me kërkesën e vetë sipërmarrësit, kur ai njofton ndërprerjen e aktivitetit sipas pikës 1, ose me nismën e vet, nëse rezulton se sipërmarrësi ka mbyllur apo pezulluar aktivitetin tregtar, ose në zbatim të një vendimi përfundimtar gjykatë apo administrativ, për shkaqe të bazuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p> | | |
| Neni13 | <p style="text-align: center;">Neni 13</p> <p>Kushtet e bashkangjitura me autorizimin e përgjithshëm dhe të drejtat e përdorimit për spektrin radio dhe përburimet e numeracionit, dhe detyrimet specifike</p> <p>1. Autorizimi i përgjithshëm për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe të drejtat e përdorimit për spektrin radio, si dhe të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit mund të jenë subjekt i kushteve të listuara në Shtojcën I. Kushtet e tilla do të jenë jodiskriminuese, proporcionale dhe transparente. Në rastin e të drejtave të përdorimit për spektrin radio, këto kushte sigurojnë përdorimin efektiv dhe efikas të tyre dhe duhet të jenë në përputhje me nenet 45 dhe 51, dhe në rast të të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit, duhet të jenë në përputhje me Nenin 94.</p> <p>2. Detyrimet specifike që mund të imponohen për ndërmarrjet që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas nenit 61 (1) dhe (5) dhe neneve 62, 68 dhe 83 ose për ato të përcaktuara për të ofruar shërbim universal, sipas kësaj direktive, do të jenë ligjërish të ndara nga të drejtat dhe detyrimet nën autorizimin e përgjithshëm. Për të arritur transparencën, kriteret dhe procedurat e imponimit të detyrimeve të tilla specifike ndaj ndërmarrjeve individuale do të përmenden në autorizimin e përgjithshëm.</p> <p>3. Autorizimi i përgjithshëm përmban vetëm kushte që janë specifike për atë sektor dhe janë dhënë në Pjesët A, B dhe C të Shtojcës I dhe nuk do të kopjojnë kushte që janë të zbatueshme për ndërmarrjet në bazë të ligjit tjetër kombëtar.</p> | | <p>Neni 28 Neni 29 Neni 30 Neni 31 Neni 32</p> <p>Neni 34</p> <p style="text-align: center;">Neni 28</p> <p>Kushtet e autorizimit të përgjithshëm dhe për të drejtat e përdorimit të spektrit të radiofrekuencave dhe numrave</p> <p>1. Autorizimi i përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe autorizimi për të drejtat e përdorimit të spektrit të radiofrekuencave dhe të të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit, mund të jetë subjekt i kushteve si më poshtë:</p> <p>a) kushteve të përgjithshme sipas nenit 29, të këtij ligji;</p> <p>b) kushteve specifike për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike sipas pikës 1 të nenit 30, të këtij ligji;</p> <p>c) kushteve specifike për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përjashtuar shërbimet e komunikimeve ndërpersonale të pavarura nga numri, sipas pikës 2 të nenit 30, të këtij ligji;</p> <p>d) kushteve për të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave, sipas nenit 31, të këtij ligji;</p> <p>e) kushteve për të drejtat e përdorimit të numeracionit, sipas nenit 32, të këtij ligji.</p> <p>2. Kushtet e vendosura nga AKEP-i, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë jodiskriminuese, proporcionale dhe transparente.</p> <p>3. Në rastin e përdorimit të frekuencave, sipërmarrësit duhet të përmbushin kushtet për përdorimin efektiv dhe eficient të frekuencave sipas përcaktimeve në Kreun X të këtij ligji dhe në rastin e përdorimit të numrave,</p> | F | | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>4.Shtetet Anëtare nuk do të kopjojnë kushtet e autorizimit të përgjithshëm, kur ata japin të drejtën e përdorimit për spektrin e radios ose për burimet e numeracionit.</p> | | <p>duhet të jenë në përputhje me nenin 132, të këtij ligji.</p> <p>4. Kushtet e autorizimit të përgjithshëm duhet të jenë specifike për sektorin dhe të justifikuar për rrjetin ose shërbimin në fjalë sipas përcaktimeve në këtë nen. Ato nuk duhet të dublojnë kushte që zbatohen ndaj sipërmarrësve nga akte të tjera ligjore në fuqi.</p> <p>5. Në dhënien e të drejtave të përdorimit për frekuencat dhe burimet e numeracionit, AKEP nuk dublikon kushtet e autorizimit të përgjithshëm.</p> <p>6. Detyrimet specifike që mund t'u imponohen nga AKEP, sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas pikës 1 të nenit 82, nenit 86, nenit 92 dhe nenit 109 të këtij ligji, si dhe detyrimet specifike që mund t'u imponohen sipërmarrësve që janë caktuar ofrues të shërbimeve universale sipas këtij ligji, duhet të jenë ligjërish të ndara nga të drejtat dhe detyrimet që lindin nga autorizimi i përgjithshëm.</p> <p>7. Në zbatim të parimit të transparencës, kriteret dhe procedurat për vendosjen e detyrimeve specifike sipas pikës 6, të këtij neni, mbi sipërmarrësit individualë, duhet të referohen në autorizimin e përgjithshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Kushtet e përgjithshme të autorizimit të përgjithshëm</p> <p>1. Në autorizimin e përgjithshëm AKEP vendos kushtet e përgjithshme si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) kryerjen e pagesave administrative në përputhje me nenin 18, të këtij ligji. Çdo sipërmarrës është i detyruar të paguajë pagesat administrative ose tarifën për të drejtat e përdorimit të burimeve të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi; b) mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen specifike të privatësisë në komunikimet elektronike, në përputhje me kreun XIX të këtij ligji; c) informacionin që paraqitet në procedurën e njoftimit sipas nenit 27, si dhe për qëllime të tjera, ashtu siç përcaktohet në nenin 42, të këtij ligji; d) lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përgjimin e telekomunikimeve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me kreun XIX të këtij ligji; e) kushtet e përdorimit nga autoritetet publike të komunikimeve për publikun e gjerë, për paralajmërimin e publikut nga rreziqe të afërta dhe për masat e shmangies së katastrofave të mëdha; | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>f) kushtet e përdorimit gjatë fatkeqësive të mëdha ose emergjencave kombëtare, për të siguruar komunikimin ndërmjet shërbimeve të emergjencave dhe autoriteteve;</p> <p>g) detyrimet e aksesit sipas këtij ligji që zbatohen për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike;</p> <p>h) masat e projektuara për të siguruar përputhjen me standardet ose specifikimet e përcaktuara në nenin 53, të këtij ligji;</p> <p>i) detyrimet për transparencë ndaj ofruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, për sigurimin e ndërlihdjes pikë fundore-pikë fundore, në përputhje me objektivat e nenit 5, të këtij ligji dhe kur është e nevojshme dhe proporcionale detyrimin për akses në informacionin që është i nevojshëm për verifikimin e saktësisë të këtij kushti.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Kushtet specifike të autorizimit të përgjithshëm</p> <p>1. Kushtet specifike që mund t'i bashkëlidhen një autorizimi të përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë si më poshtë:</p> <p>a) detyrimin për interkonektimin e rrjeteve sipas përcaktimeve në këtë ligj;</p> <p>b) parashikimet për detyrimin e mbartjes, që zbatohet në përputhje me ligjin për median audiovizive;</p> <p>c) masat për mbrojtjen e shëndetit publik kundrejt fushave elektromagnetike, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Udhëzimet e ICNIRP, për kufizimin e ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike, për mbrojtjen e njerëzve të ekspozuar në fushat elektromagnetike, kur këto kushte janë të ndryshme nga ato të përfshira në autorizimin e përgjithshëm.</p> <p>d) mirëmbajtjen dhe integritetin e rrjetit të komunikimeve elektronike në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, për parandalimin e interferencave elektromagnetike ndërmjet rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;</p> <p>e) siguria e rrjeteve publike kundrejt aksesit të paautorizuar, në përputhje me përcaktimet e Kreut XIX të këtij ligji;</p> <p>f) kushtet e përdorimit të frekuencave, sipas përcaktimeve në rregullin teknik për pajisjet radio të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, kur përdorimi i frekuencave nuk është subjekt i</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>autorizimit individual, sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p> <p>2. Kushtet specifike që mund t'i bashkëlidhen një autorizimi të përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> ndërveprueshmëria e shërbimeve në përputhje me këtë ligj; aksesimi nga përdoruesi fundor i numrave sipas Planit Kombëtar të Numeracionit, numrave nga Numrat Universal Ndërkombëtarë të Telefonave Falas (UIFN) dhe kur është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, nga planet e numeracionit, sipas kushteve në përputhje me këtë ligj. rregullat specifike të mbrojtjes së konsumatorit për sektorin e komunikimeve elektronike, duke përfshirë sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara; respektimin e kufizimeve në lidhje me transmetimet e përmbajtjeve të paligjshme ose përmbajtjes së dëmshme, bazuar në legjislacionin në fuqi. <p>3. Kushtet specifike të autorizimit të përgjithshëm sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, vendosen nga AKEP, për rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike dhe ato nuk duhet të publikojnë kushtet që zbatohen ndaj sipërmarrësve nga akte të tjera ligjore në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Kushtet për të drejtat e përdorimit për spektrin e frekuencave</p> <p>1. Përveç sa parashikohet në autorizimin e përgjithshëm, të drejtat e përdorimit të frekuencave janë subjekt i kushteve si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> detyrimi për të ofruar një shërbim ose për të përdorur një lloj teknologjie brenda kufizimeve të nenit 62 të këtij ligji, dhe kur është e nevojshme të kërkesave për mbulimin dhe cilësinë e shërbimit. kushtet teknike dhe operacionale për shmangien e interferencave të dëmshme dhe mbrojtjen e shëndetit nga rrezatimet elektromagnetike sipas legjislacionit në fuqi, kur këto janë të ndryshme nga sa përfshihet në kushtet e autorizimit të përgjithshëm për përdorimin efektiv dhe efikas të spektrit radio sipas këtij ligji. kohëzgjatjen maksimale të të drejtave të përdorimit të frekuencave, në përputhje me parashikimet e nenit 69, të këtij ligji dhe Planin Kombëtar të | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | | | <p>Frekuencave.</p> <p>d) e drejta e transferimit ose dhënies me qira të të drejtave, me iniciativë të mbajtësit të tyre dhe kushtet për transferim sipas këtij ligji.</p> <p>e) tarifat apo pagesat për të drejtat e përdorimit, në përputhje me nenin 19 dhe 21, të këtij ligji.</p> <p>ë) çdo angazhim që sipërmarrësi ka bërë në procesin e autorizimit për fitimin e të drejtës së përdorimit, apo gjatë rinovimit të autorizimit përpara dhënies së autorizimit ose sipas rastit, në përgjigje të ftesës për aplikim për të drejtat e përdorimit.</p> <p>f) detyrimet për të bashkuar për përdorim të përbashkët të spektrit të frekuencave ose për lejimin e aksesit në spektrin e frekuencave, për përdorues të tjerë në zona specifike ose në nivel kombëtar.</p> <p>g) detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse, në lidhje me përdorimin e brezave të spektrit të frekuencave.</p> <p>h) detyrimet specifike për një përdorim eksperimental të brezave të spektrit të frekuencave.</p> <p>i) kushtet për përdorimin e spektrit të frekuencave, kur një përdorim i tillë nuk i nënshtrohet dhënies së të drejtave individuale të përdorimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Kushte për përdorimin e numeracionit</p> <p>1. Përveç sa parashikohet në autorizimin e përgjithshëm, të drejtat e përdorimit të numeracionit mund të jenë subjekt i kushteve të mëposhtme:</p> <p>a) përcaktimin e shërbimit për të cilin përdoret numri, përfshirë çdo kërkesë që lidhet me ofrimin e atij shërbimi dhe, për shmangien e dyshimit, parimet tarifore dhe çmimet maksimale që mund të zbatohen në një seri specifike të numrave, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit në përputhje me parashikimet në shkronjën ç), të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji.</p> <p>b) përdorimi efektiv dhe efikas i burimeve të numeracionit, në përputhje me këtë ligj.</p> <p>c) kërkesat për zbatimin e portabilitetit të numrave, në përputhje me këtë ligj;</p> <p>d) detyrimi për ofrimin e informacionit në numërorin telefonik për përdoruesit fundorë, në lidhje me zbatimin e nenit 152 të këtij ligji;</p> <p>e) kohëzgjatjen maksimale në përputhje me përcaktimet në nenin 132, të këtij ligji dhe Planin Kombëtar të Numeracionit;</p> <p>f) transferimi i të drejtave të përdorimit të burimeve të numeracionit me iniciativën e mbajtësit të tyre</p> | | |
|--|--|--|--|---|--|--|

| | | | | | | |
|----------------|--|--|---------|--|---|--|
| | | | | <p>dhe kushtet për një transferim të tillë në përputhje me këtë ligj, duke përfshirë çdo kusht që e drejta e përdorimit për një numër, të jetë e detyrueshme për të gjithë sipërmarrësit të cilëve u janë transferuar të drejtat;</p> <p>g) pagesat për të drejtat e përdorimit në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;</p> <p>h) çdo angazhim, që sipërmarrësi që merr të drejtat e përdorimit, ka bërë gjatë një procedure përzgjedhjeje konkurruese ose krahasuese, për dhënien e të drejtës së përdorimit;</p> <p>i) detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse, në lidhje me përdorimin e numrave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Detyrimet e veçanta</p> <p>1. AKEP-i ka të drejtë, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, të vendosë detyrime të veçanta ndaj sipërmarrësit që ushtron veprimtari në sektorin e komunikimeve elektronike. Këto detyrime zbatohen, përveç kushteve të autorizimit të përgjithshëm dhe në përputhje me konsultimet dhe procedurat e përcaktuara në nenet 44, 67, 75 dhe 92, të këtij ligji.</p> <p>2. Detyrimet e veçanta të parashikuara në pikën 1 më sipër janë:</p> <p>a) detyrimet për ofrimin e shërbimit universal në përputhje me Kreun XVII të këtij ligji;</p> <p>b) detyrimet e veçanta të përcaktuara në këtë ligj për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg në tregjet përkatëse;</p> <p>c) detyrimet për aksesin në rrjete, në përputhje me Kreun XIII, të këtij ligji.</p> <p>3. AKEP publikon informacionin për vendosjen e detyrimeve të veçanta, sipas përcaktimeve në nenin 24, të këtij ligji.</p> | | |
| Neni 14 | <p style="text-align: center;">Neni 14</p> <p>Deklarata për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave për instalimin e pajisjeve dhe të drejtat e interkoneksionit</p> <p>Autoritetet kompetente, brenda një jave nga kërkesa e një sipërmarrjeje, do të lëshojnë deklaratat të standardizuara që konfirmojnë kur është e aplikueshme, se sipërmarrja ka paraqitur një njoftim sipas nenit 12 (3). Këto deklaratat do të detajojnë rrethanat në të cilat çdo ndërmarrje që ofron rrjete ose shërbime të komunikimit elektronik, nën autorizimin e përgjithshëm, ka të drejtë të kërkojë të drejta për të instaluar pajisje, të negociojë interkoneksionin dhe të sigurojë qasje ose interkoneksion, në mënyrë që të lehtësojë ushtrimin e atyre të drejtave, për shembull</p> | | Neni 33 | <p style="text-align: center;">Neni 33</p> <p>Çertifikata e konfirmimit për lehtësimin e ushtrimit të të drejtave për instalimin e faciliteteve dhe interkoneksionit</p> <p>1. Me kërkesë të një sipërmarrësi, AKEP brenda 7 ditësh kalendarike nga marrja e kërkesës, sipas rastit, lëshon një deklaratë të standardizuar, që konfirmom që sipërmarrësi ka paraqitur një njoftim sipas pikës 3, të nenit 26, të këtij ligji. Çertifikata e konfirmimit, detajon rrethanat në të cilat çdo sipërmarrës që ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, sipas autorizimit të përgjithshëm, ka të drejtë të instalojë facilitetet, të negociojë për interkoneksion ose të marrë akses e interkoneksion, me qëllim lehtësimin e ushtrimit</p> | F | |

| | | | | | |
|--------|---|--|---------|--|---|
| | në nivele të tjera të qeverisë ose në lidhje me ndërmarrjet e tjera. Kur është e përshatshme, deklarata të tilla mund të lëshohen gjithashtu si përgjigje automatike, në ndjekje të njoftimit të përmendur në nenin 12 (3). | | | te këtyre të drejtave, gjatë aplikimit pranë niveleve të tjera të qeverisjes ose tek sipërmarrësit e tjerë. 2. Kur është e mundur teknikisht, çertifikata e konfirmimit, mund të lëshohet si përgjigje automatike, pas njoftimit të përmendur në pikën 3, të nenit 26, të këtij ligji. | |
| Neni15 | <p style="text-align: center;">Seksioni 2 Të drejtat dhe detyrimet e autorizimit të përgjithshëm</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Lista minimale e të drejtave që rrjedhin nga autorizimi i përgjithshëm</p> <p>1. Ndërmarrjet që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm në zbatim të Nenit 12, kanë të drejtë: (a) të sigurojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike; (b) të kenë kërkesën e tyre për të drejtat e nevojshme për instalimin e pajisjeve të konsideruara në përputhje me Nenin 43; (c) të përdorin në varësi të Neneve 13, 46 dhe 55, spektrin eradios, në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike; (d) të krenë kërkesën e tyre për të drejtat e nevojshme të përdorimit për burimet e numeracionit, të konsideruara në përputhje me nenin 94.</p> <p>2. Kur ndërmarrjet e tilla, ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, autorizimi i përgjithshëm u jep atyre të drejtën: (a) të negociojnë interkoneksionin me dhe kur është e aplikueshme të përfitojnë akses, ose interkoneksion nga ofruesit e tjerë të rrjeteve publike të komunikimit elektronik ose shërbimet e komunikimit elektronik në dispozicion publik, të mbuluara nga një autorizim i përgjithshëm në Bashkimin Evropian në përputhje me këtë Direktivë; (b) t'u jepet një mundësi për të siguruar elementë të ndryshëm të shërbimit universal ose për të mbuluar pjesë të ndryshme të territorit kombëtar, në përputhje me nenin 86 ose 87.</p> | | Neni 35 | <p style="text-align: center;">SEKSIONI 2 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 Lista minimale e të drejtave që rrjedhin nga autorizimi i përgjithshëm</p> <p>1. Sipërmarrësit që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm sipas nenit 26, të këtij ligji, kanë të drejtë të: a) ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike; b) të aplikojnë për të drejtat e nevojshme për instalimin e faciliteteve në përputhje me nenin 57, të këtij ligji; c) të përdorin spektrin e radiofrekuencave në lidhje me shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike sipas përcaktimeve në nenet 28, 31, 66 dhe 75, të këtij ligji; d) të aplikojnë për të drejtat e përdorimit të nevojshme për burimet e numeracionit, në përputhje me nenin 131 dhe 132, të këtij ligji.</p> <p>2. Kur një sipërmarrës është autorizuar, sipas këtij ligji për të ofruar rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, atëherë autorizimi i përgjithshëm i jep të drejtë: a) të negociojë për interkoneksion dhe kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve të disponueshme për publikun, në përputhje me këtë ligj; b) të marrë pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta të shërbimit universal, ose për të mbuluar pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj.</p> | F |

| | | | | | | |
|----------------------|---|--|----------------|---|----------|--|
| <p>Neni16</p> | <p align="center">Neni 16 Tarifa Administrative</p> <p>1. Çdo tarifë administrative e vendosur ndaj ndërmarrjeve që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike nën autorizimin e përgjithshëm, ose të cilit i është dhënë një e drejtë e përdorimit do të:</p> <p>(a) Mbulojnë në total, vetëm kostot administrative të bëra në administrimin, kontrollin dhe zbatimin e sistemit të autorizimit të përgjithshëm, të të drejtave të përdorimit dhe detyrimeve specifike, siç përmenden në Nenin 13 (2), të cilat mund të përfshijnë shpenzime për bashkëpunimin ndërkombëtar, harmonizimin dhe standardizimin, analizimin e tregut, monitorimin e përputhshmërisë dhe kontrolli tjetër të tregut, si dhe puna rregullatore që përfshin përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit dytësor dhe vendimeve administrative, siç janë vendimet për qasje dhe interkoneksion; dhe</p> <p>(b) t'u imponohen ndërmarrjeve individuale në mënyrë objektive, transparente dhe proporcionale gjë që minimizon kostot shtesë administrative dhe tarifën e lidhura me to.</p> <p>Shtetet Anëtare mund të zgjedhin të mos zbatojnë tarifa administrative për sipërmarrjet, qarkullimi i të cilave është nën një prag të caktuar ose aktivitetet e të cilave nuk arrijnë një pjesë minimale të tregut ose mbulojnë një hapësirë territori shumë të kufizuar.</p> <p>Aty ku autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente vendosin tarifa administrative, ata duhet të publikojnë një përmbledhje vjetore të kostove të tyre administrative dhe të shumës totale të tarifave të mbledhura. Aty ku ekziston një ndryshim midis shumës totale të tarifave dhe kostove administrative, do të bëhen rregullime të përshtatshme.</p> | | <p>Neni 18</p> | <p align="center">Neni 18 Parimet për pagesat administrative</p> <p>1. Çdo pagesë administrative e bazuar në këtë ligj, e vendosur ndaj sipërmarrësve që ofrojnë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike sipas autorizimit të përgjithshëm, ose që u është dhënë e drejta e përdorimit:</p> <p>a) mbulon në total, vetëm kostot administrative të shkaktuara në menaxhimin, kontrollin dhe zbatimin e sistemit të autorizimit të përgjithshëm, të drejtave të përdorimit si dhe detyrimeve të veçanta siç referohen në nenin 34, të këtij ligji, të cilat mund të përfshijnë kostot për bashkëpunimin ndërkombëtar, harmonizimin dhe standardizimin, analizat e tregut, monitorimin e përputhshmërisë dhe kontrollin e tjera të tregut, si dhe punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit dytësor dhe vendimeve administrative, të tilla si vendimet për aksesin, interkoneksionin dhe,</p> <p>b) imponohet ndaj sipërmarrjeve individuale në mënyrë objektive, transparente dhe proporcionale, për të minimizuar kostot administrative shtesë ose tarifën shoqëruese, në lidhje me qëllimin e synuar të tyre, duke marrë parasysh objektivat e përgjithshme të këtij ligji.</p> <p>2. AKEP-i, publikon një pasqyrë vjetore të kostove administrative përkatëse, si dhe të shumës totale të pagesave të mbledhura. Kur ka një ndryshim midis shumës totale të pagesave dhe kostove administrative, bëhen rregullimet e duhura sipas pikës 5, të nenit 17, të këtij ligji.</p> | <p>F</p> | |
| <p>Neni17</p> | <p align="center">Neni 17 Ndarja e llogarive dhe raportet financiare</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të kërkojnë nga sipërmarrjet që ofrojnë për publikun rrjete publike të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike, dhe që kanë të drejta speciale ose ekskluzive për ofrimin e shërbimeve në sektorë të tjerë në të njëjtin ose një shtet tjetër anëtar:</p> <p>(a) Të mbajnë llogari të ndara për aktivitetet që lidhen me sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimit elektronik, në masën që do të kërkohej nëse ato aktivitetet do të kryheshin nga njësi juridike të pavarura, për të identifikuar të gjithë elementët e kostos dhe të ardhurave, me bazën e llogaritjes së tyre dhe metodat e detajuara të atribuimit të përdorura, të lidhura me aktivitetet të tilla, duke përfshirë një ndarje të parashikuar të aktiveve fikse dhe kostove strukturore; ose</p> | | <p>Neni 36</p> | <p align="center">Neni 36 Ndarja e llogarive dhe raportet financiare</p> <p>1. AKEP-i u kërkon sipërmarrësve që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, të cilët kanë të drejta të veçanta ose ekskluzive për ofrimin e shërbimeve në sektorë të tjerë, që:</p> <p>a) të mbajnë llogari të veçanta për aktivitetet që lidhen me ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në masën e kërkuar, nëse këto aktivitetet do të kryheshin nga subjekte ligjshme të pavarura, në mënyrë që të identifikohen të gjithë elementët e kostos dhe të të ardhurave, me bazën e llogaritjes së tyre dhe metodat e detajuara të atribuimit të përdorura, në lidhje me këto aktivitetet, duke përfshirë një ndarje</p> | <p>P</p> | |

| | | | | | | |
|---------|---|-------------------------------|--|---|--|--|
| | <p>(b) të ketë ndarje strukturore për aktivitetet që lidhen me sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike. Shtetet Anëtare mund të zgjedhin të mos zbatojnë kërkesat e përmendura në nënparagrafin e parë për sipërmarrjet që kanë një qarkullim vjetor prej më pak se 50 milion EUR në aktivitetet që lidhen me rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike në Bashkimin Evropian.</p> <p>2. Kur sipërmarrjet që ofrojnë rrjete publike të komunikimeve elektronike ose shërbime publike të komunikimit elektronik, nuk u nënshtrohen kërkesave të ligjit të shoqërive dhe nuk plotësojnë kriteret e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme të rregullave të llogarisë të ligjit të Bashkimit Evropian, raportet e tyre financiare hartohen dhe dorëzohen tek një auditim i pavarur dhe i publikuar. Auditimi kryhet në përputhje me rregullat përkatëse të Bashkimit Evropian dhe rregullave kombetare.</p> <p>Nënparagrafi i parë i këtij paragrafi do të zbatohet gjithashtu për llogaritë e veçanta që kërkohen në pikën (a) të nënparagrafit të parë të paragrafit 1.</p> | | | <p>të detajuar të aktiviteteve fikse dhe kostot strukturore; ose</p> <p>b) të ketë ndarje strukturore për aktivitetet që lidhen me ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.</p> <p>2. AKEP-i vendos të mos zbatojë kërkesat e përcaktuara në pikën e parë për sipërmarrësit që kanë një xhiro vjetore më të vogël se 0.5% të të ardhurave të tregut, në aktivitetet që lidhen me rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>3. Kur sipërmarrësi që ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, nuk i nënshtrohet legjislacionit për shoqëritë tregtare, raportet e tyre financiare hartohen dhe dorëzohen nga auditues të pavarur dhe publikohen. Auditimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin.</p> | | |
| Neni 18 | <p style="text-align: center;">Seksioni 3 Ndryshimi dhe tërheqja</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Ndryshimi i të drejtave dhe detyrimeve</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që të drejtat, kushtet dhe procedurat në lidhje me autorizimet e përgjithshme dhe të drejtat e përdorimit për spektrin e radios, për burimet e numeracionit e të drejtave për instalimin e pajisjeve, mund të ndryshohen vetëm në raste të justifikuara objektivist dhe në mënyrë proporcionale, duke marrë parasysh, kur është e përshtatshme, kushtet specifike të zbatueshme për të drejtat e transferueshme të përdorimit për spektrin e radios ose për burimet e numeracionit.</p> <p>2. Përveç kur ndryshimet e propozuara janë të vogla dhe është rënë dakord me mbajtësin e të drejtave ose autorizimin e përgjithshëm, njoftimi do të jepet në një mënyrë të përshtatshme me qëllimin për të bërë ndryshime të tilla. Palëve të interesuara, përfshirë përdoruesit dhe konsumatorët, do t'u lejohet një periudhë e mjaftueshme kohore për të shprehur pikëpamjet e tyre për ndryshimet e propozuara. Kjo periudhë do të jetë jo më pak se katër javë, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme. Ndryshimet do të publikohen, së bashku me arsyet e tyre.</p> | Neni 37 Neni 38 Neni 39 | <p style="text-align: center;">SEKSIONI 3 NDRYSHIMI DHE REVOKIMI I TË DREJTAVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Ndryshimi i të drejtave dhe detyrimeve</p> <p>3. AKEP-i ndryshon ose revokon të drejtat, kushtet dhe procedurat për autorizimin e përgjithshëm dhe të drejtat e përdorimit, në raste objektivist të justifikuara dhe në mënyrë proporcionale, pas kryerjes së një këshillimi publik, sipas përcaktimit në nenin 44, të këtij ligji.</p> <p>4. Me raste objektivist të justifikuara nënkuptohen:</p> <p>a) ndryshimi i fakteve, në bazë të të cilave janë përcaktuar të drejtat, kushtet dhe procedurat në autorizimin e përgjithshëm dhe të drejtat për përdorim;</p> <p>b) përmbushja e angazhimeve, që burojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;</p> <p>c) nevoja e mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit;</p> <p>ç) nevoja e mbrojtjes së interesit publik.</p> <p>5. Ndryshimi ose revokimi i të drejtave, kushteve dhe procedurave për autorizimin e përgjithshëm dhe për të drejtat e përdorimit, bëhet me vendim të AKEP-it.</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Ndryshimi i autorizimit individual</p> <p>1. AKEP-i ndryshon autorizimin individual me nismën e vet:</p> <p>a) kur ka ndryshuar Plani Kombëtar i Frekuencave, ose rregullat për kushtet e përdorimit të frekuencave;</p> | F | | |

| | | | | | | |
|----------------|---|--|---------|---|---|--|
| | | | | <p>b) për nevoja publike, që nuk mund të plotësohen në mënyrë tjetër;</p> <p>c) kur ndryshimi i kërkuar i shërben përdorimit eficient të frekuencave dhe është me interes publik;</p> <p>d) kur interferencat e dëmshme nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;</p> <p>e) kur ndryshimi buron nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i lëshon një autorizim individual të ri të përdorimit të frekuencave, i cili përfshin ndryshimet. Në këtë autorizim të ri përfshihet edhe një periudhë e arsyeshme kohe, brenda së cilës mbajtësi i autorizimit duhet të përshtasë përdorimin e frekuencave me autorizimin e ri.</p> <p>3. Mbajtësi i autorizimit individual, përballon me shpenzimet e veta kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme, që burojnë nga ndryshimet në autorizimin e ri individual të përdorimit të frekuencave.</p> <p>4. Përdoruesit e frekuencave të caktuara, autorizimi i përdorimit të të cilave është ndryshuar, gëzojnë të drejtën që t'u caktohet brez tjetër ekuivalent i frekuencave, brenda hapësirave të mundshme, sipas Planit të Përdorimit të Frekuencave, në rast se arsyet për ndryshimin ose revokimin e autorizimit nuk shkaktohen për fajin e tyre.</p> <p>5. Kur ndryshimet në autorizimin individual të frekuencave kërkohen nga mbajtësi i tij, autorizimi i ri mund të jepet sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe në një mënyrë që të mos shkelë të drejtat e përdoruesve të tjerë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Ndryshimi i vendimeve për caktimin e numrave dhe të serive numerike</p> <p>1. Për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, si dhe për të siguruar sasi të kënaqshme, përdorim eficient të burimeve të numeracionit, AKEP-i mund të ndryshojë strukturën dhe konfigurimin e hapësirës së numeracionit dhe caktimin e numrave. Ndryshimet miratohen pas këshillimit publik. Në këto raste, mbajtësi i numrave dhe serive numerike nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim.</p> <p>2. AKEP-i mund të ndryshojë vendimet për caktimin e numrave dhe të serive numerike edhe në bazë të kërkesës së mbajtësit të tyre, kur kjo është e mundur.</p> | | |
| Neni 19 | Neni 19 Kufizimi ose tërheqja e të drejtave | | Neni 40 | Neni 40 Kufizimi ose revokimi i të drejtave | F | |
| | 1. Pa cënuar nenin 30 (5) dhe (6), Shtetet Anëtare nuk do të kufizojnë ose tërheqin të drejtat për të instaluar pajisje ose të drejta të përdorimit për spektrin e radios ose për burimet e numeracionit para skadimit të periudhës për të cilën u është dhënë, | | | 1. Pa parajgykuar nenin 182, e vijues të këtij ligji, AKEP nuk kufizon ose revokon të drejtat për instalimin e pajisjeve, ose të drejtat e përdorimit të spektrit të radios ose burimeve numerike, përpara mbarimit të periudhës për | | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>përveç kur justifikohet në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, dhe, kur është e zbatueshme, në përputhje me Shtojcën I, dhe dispozitat përkatëse kombëtare në lidhje me kompensimin për tërheqjen e të drejtave.</p> <p>2. Në përputhje me nevojën për të siguruar përdorimin efektiv dhe efikas të spektrit të radios, ose zbatimin e masave teknike të zbatimit të miratuara në nenin 4 të Vendimit Nr. 676/2002 / EC, Shtetet Anëtare mund të lejojnë kufizimin ose tërheqjen e të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, përfshirë të drejtat e përmendura në nenin 49 të kësaj direktive, bazuar në procedura të paracaktuara dhe të përcaktuara qartë, në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Në raste të tilla, bartësit e të drejtave, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian dhe dispozitat përkatëse kombëtare, mund të kompensohen siç duhet.</p> <p>3. Një modifikim në përdorimin e spektrit të radios, si rezultat i zbatimit të nenit 45 (4) ose (5) nuk do të përbëjë vetëm arsye për të justifikuar tërheqjen e një të drejte të përdorimit për spektrin radio.</p> <p>4. Çdo qëllim për të kufizuar ose tërhequr të drejtat nën autorizimin e përgjithshëm ose të drejtat individuale të përdorimit për spektrin radio ose për burimet e numeracionit, pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave, i nënshtrohet konsultimit të palëve të interesuara në përputhje me nenin 23.</p> | | <p>të cilën ato janë dhënë, përveç rasteve kur justifikohet sipas pikës 2 të këtij neni dhe kur është e zbatueshme, në përputhje me nenin 28, të këtij ligji.</p> <p>2. Në përputhje me nevojën për të garantuar përdorimin efektiv dhe eficient të spektrit të radios, AKEP revokon një autorizim individual për frekuenca me nismën e vet, në rast se vërteton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) aplikimi i autorizimit për frekuenca përmban të dhëna të rreme; b) mbajtësi i të drejtës për përdorim nuk i ka përdorur frekuencat e dhëna brenda një viti nga data e dhënies në përdorim, ose i ka përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në autorizim; c) në rast se mbajtësi i autorizimit nuk ekziston më; d) janë shkelur dispozitat e këtij ligji ose kushtet e autorizimit individual të frekuencave; e) nuk janë eliminuar, brenda afatit të përcaktuar, mangësitë e evidentuara nga AKEP, të cilat i janë njoftuar sipërmarrësit; f) nuk janë kryer pagesat për përdorimin e frekuencave brenda 30 ditëve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit të AKEP-it; g) nuk ka mundësi tjetër për të shmangur interferencat e dëmshme të shkaktuara nga sinjalet e pajisjeve radio, të marrësve ose sistemeve elektrike e elektronike të tjera. <p>3. Pagesat e kryera për vitin në të cilin ndodh revokimi i autorizimit janë të parimbursueshme. Një modifikim në përdorimin e spektrit të radios si rezultat i zbatimit të nenit 59 pika 3 ose 4, nuk përbën arsyen e vetme për të justifikuar heqjen e të drejtës së përdorimit të spektrit të radios.</p> <p>4. Çdo synim për të kufizuar ose revokuar të drejtat, në bazë të autorizimit të përgjithshëm ose të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e frekuencave, ose për burimet e numeracionit pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave, duhet t'i nënshtrohet konsultimit të palëve të interesuara në përputhje me nenin 44, të këtij ligji. AKEP i jep mbajtësit të së drejtës së përdorimit, mundësinë të paraqesë pikëpamjet e tij si dhe propozime për masat.</p> <p>5. Kufizimi apo heqja e të drejtave të përdorimit të frekuencave, përfshirë të drejtat sipas nenit 69 të këtij ligji, bazohen në një procedurë të qartë dhe të miratuar paraprakisht nga AKEP në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe jo diskriminimit.</p> <p>6. Në rastet e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji ose kushtet e autorizimit individual të frekuencave, AKEP vepron sipas parashikimeve në nenin 182 dhe 183 të këtij ligji.</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|---------------|--|----------------|---|----------|--|
| <p>Neni20</p> | <p align="center">PJESA I – TITULLI II KAPITULLI III Sigurimi i informacionit, sondazheve dhe mekanizmit të konsultimit Neni 20</p> <p align="center">Kërkesë sipërmarrjeve për informacion</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që sipërmarrjet që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, facilitete shoqëruese ose shërbimet e ofruara, të japin të gjitha informacionet, përfshirë informacionin financiar, të nevojshëm për autoritetet rregullatore kombëtare, autoritetet e tjera kompetente dhe BEREC, për të siguruar konformitetin me dispozitat vendimet ose opinione të miratuara në përputhje me këtë Direktivë dhe Rregullore (BE) 2018/1971 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (1). Në veçanti, autoritetet rregullatore kombëtare dhe kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, autoritetet e tjera kompetente, kanë fuqinë të kërkojnë nga këto ndërmarrje të paraqesin informacione në lidhje me zhvillimet e ardhshme të rrjetit ose shërbimeve që mund të ndikojnë në shërbimet e shitjes me shumicë në dispozicion të konkurrentëve, si dhe informacione për rrjetet e komunikimeve elektronike efacilitetet shoqëruese që lidhen me të, që është i zbërthyer në nivelin lokal dhe i detajuar sa duhet për të mundësuar vëzhgimin gjeografik dhe përcaktimin e zonave në përputhje me nenin 22. Kur informacioni i mbledhur në përputhje me nënparagrafin e parë është i pamjaftueshëm për autoritetet kombëtare rregullatore, autoritetet e tjera kompetente dhe BEREC për të kryer detyrat e tyre rregullatore sipas ligjit të Bashkimit Evropian, informacioni i tillë mund të kërkohet nga sipërmarrjet e tjera përkatëse që janë aktive në komunikimet elektronike ose sektorët e lidhur ngushtë me këtë. Sipërmarrjet e përcaktuara si me fuqi të ndjeshme në treg ose në tregjet me shumicë, gjithashtu mund t'u kërkohet të paraqesin të dhëna kontabël në tregjet me pakicë që janë të lidhura me tregjet me shumicë. Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente mund të kërkojnë informacion nga pikat e vetme të informacionit të krijuara në bazë të Direktivës 2014/61 / BE. Çdo kërkesë për informacion do të jetë në propocion me performancën e detyrës dhe do të arsyetohet. Sipërmarrjet do të japin informacionin e kërkuar menjëherë dhe në përputhje me afatet kohore dhe nivelin e detajeve të kërkuara.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente t'i japin Komisionit informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat e tij në TFEU. Informacioni i kërkuar nga Komisioni është proporcional me kryerjen e atyre detyrave. Kur informacioni i ofruar, i referohet informacionit të dhënë më parë nga ndërmarrjet me kërkesë të</p> | <p>Neni 41</p> | <p align="center">KREU IV SIGURIMI I INFORMACIONIT, ANKETAVE DHE MEKANIZMI I KONSULTIMIT</p> <p align="center">Neni 41 Kërkesa për informacion nga sipërmarrësit</p> <p>1. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, facilitete ose shërbime shoqëruese, i paraqesin AKEP-it të gjithë informacionin e nevojshëm, për përmbushjen e detyrave të tij rregullatore dhe për bashkëpunimin me BEREC, përfshirë edhe informacionin financiar në përputhje me parashikimet e këtij ligji.</p> <p>2. AKEP-i ka të drejtë t'u kërkojë sipërmarrësve, informacion në lidhje me zhvillimet e ardhshme të rrjetit ose shërbimeve që kanë ndikim në shërbimet e shitjes me shumicë dhe që sipërmarrësit i vendosin në dispozicion të konkurrentëve, si dhe informacion mjaftueshmërisht të detajuar, mbi shtrirjen në nivel lokal të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe facilitetet e lidhura me to, me qëllim kryerjen e vrojtimit mbi shtrirjen gjeografike të rrjeteve të shpejtësisë së lartë dhe përcaktimin e zonave në përputhje me nenin 43, të këtij ligji.</p> <p>3. Kur informacioni i mbledhur është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave rregullatore sipas këtij ligji, AKEP-i mund të kërkojë informacion nga entitete të tjera që ushtrojnë aktivitet në sektorin e komunikimeve elektronike ose sektorë të lidhur ngushtë me të. AKEP-i kërkon gjithashtu informacion nga pika e vetme e informacionit, e krijuar në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.</p> <p>4. Sipërmarrësve, të përcaktuar si operatorë me fuqi të ndjeshme në treg në tregjet me shumicë, u kërkohet gjithashtu të paraqesin të dhëna kontabël për tregjet me pakicë, që janë të lidhura me tregjet me shumicë.</p> <p>5. Sipërmarrësit sigurojnë informacionin e kërkuar, në përputhje me afatet kohore dhe nivelin e detajimit të kërkuar.</p> <p>6. AKEP-i përcakton me një rregullore informacionin e kërkuar nga sipërmarrësit, si dhe afatin e paraqitjes së tij. Çdo kërkesë për informacion duhet të jetë e arsyetuar dhe proporcionale, me kryerjen e detyrave rregullatore.</p> <p>7. AKEP-i kërkon informacione, në veçanti, duke përfshirë informacionin financiar, me qëllim:</p> <p>a) verifikimin sistematik ose kohë pas kohe të pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji;</p> | <p>F</p> | |
|---------------|--|----------------|---|----------|--|

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>autoritetit, sipërmarrjet e tilla duhet të informohen për të. Në masën e nevojshme, dhe përveç nëse autoriteti që jep informacionin ka bërë një kërkesë të qartë dhe të arsyeshme në të kundërtën, Komisioni do t'i vëre në dispozicion informacionet e dhëna një autoriteti tjetër në një shtet tjetër anëtar.</p> <p>Në varësi të kërkesave të paragrafit 3, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që informacioni i dhënë një autoriteti, mund të vihet në dispozicion të një autoriteti tjetër, të tillë në të njëjtin shtet ose në shtete të ndryshme anëtare dhe për BEREC, pas një kërkesë të vërtetuar, kur është e nevojshme për të lejuar cilindo autoritet, ose BEREC për të përmbushur përgjegjësitë e tij sipas ligjit të Bashkimit Evropian.</p> <p>3. Kur informacioni i mbledhur në bazë të paragrafit 1, përfshirë informacionin e mbledhur në kontekstin e vëzhgimit gjeografik, konsiderohet të jetë konfidencial nga autoriteti rregullator kombëtar ose një autoritet tjetër kompetent, në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian dhe ligjet kombëtare për konfidencialitetin tregtar, Komisioni, BEREC dhe çdo autoritet tjetër kompetent i interesuar do të sigurojë ruajtjen e një konfidencialiteti të tillë. Një konfidencialitet i tillë nuk parandalon shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoritetit kompetent, Komisionit, BEREC dhe çdo autoriteti tjetër kompetent të interesuar në kohën e duhur për qëllime të rishikimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të kësaj direktive.</p> <p>4. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare në aksesin e informacionit publik dhe duke iu nënshtruar rregullave të Bashkimit Evropian dhe ligjeve Kombëtare për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, autoriteti rregullator kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente të publikojnë informacione që kontribuojnë për një treg të hapur dhe konkurrues.</p> <p>5. Autoriteti rregullator kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente, do të publikojnë termat e aksesimit të informacionit nga publiku, siç përmendet në paragrafin 4, përfshirë procedurat për marrjen e një aksesit të tillë.</p> | | <p>b) njohjen me procedurat dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie e të drejtave të përdorimit;</p> <p>c) publikimin e përmbledhjeve krahasuese të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve në dobi të përdoruesve;</p> <p>d) qëllime statistikore në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose që rrjedhin nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare;</p> <p>e) informacion në lidhje me zhvillimet e ardhshme të rrjeteve ose shërbimeve që mund të ndikojnë në shërbimet me shumicë që sipërmarrja u ofron konkurrentëve; dhe për</p> <p>f) analizimin e tregjeve në përputhje me Kreun XIV të këtij ligji.</p> <p>8. AKEP-i pas një kërkesë të arsyetuar, i siguron Komisionit informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat e tij sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Informacioni i kërkuar nga Komisioni, duhet të jetë proporcional me kryerjen e këtyre detyrave. Kur informacioni i dhënë, i referohet informacionit të dhënë më parë nga sipërmarrësit me kërkesë të AKEP, këta sipërmarrës informohen për këtë. Kur është e nevojshme, Komisioni duhet t'i vëre në dispozicion informacionin e dhënë një autoriteti tjetër kompetent, në një shtet tjetër anëtar, përveç rastit kur autoriteti që jep informacionin ka bërë një kërkesë të qartë dhe të arsyetuar për të kundërtën.</p> <p>Në varësi të kërkesave të kësaj pike, AKEP-i kur është e nevojshme, siguron që informacioni që i dërgohet Komisionit, t'i vihet në dispozicion një autoriteti tjetër dhe BEREC-ut, në të njëjtin ose në një tjetër Shtet Anëtar, pas një kërkesë të bazuar, për të lejuar AKEP-in ose BEREC që të përmbushë përgjegjësitë e tij sipas Ligjit të Bashkimit.</p> <p>9. Kur informacioni i mbledhur në zbatim të pikës 1 dhe 2, të këtij neni, përfshirë informacionin e mbledhur në kuadër të një vrojtimi gjeografik konsiderohet konfidencial nga AKEP-i, ai e mban konfidencial atë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi mbi sekretin tregtar të biznesit. Nëse informacioni nuk është konfidencial, kur është e nevojshme për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues, AKEP-i e publikon ose e vendos në dispozicion të publikut, mbi bazën e kërkesës. Në rast dyshimi për konfidencialitetin e informacionit, AKEP merr vendim për ruajtjen e konfidencialitetit, pasi të ketë dëgjuar dhe vlerësuar interesat e sipërmarrësit që zotëron informacionin.</p> <p>10. AKEP-i siguron që informacioni i publikuar kontribuon në një treg të hapur dhe konkurrues, duke vepruar në</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|--------|--|---------|---|--|--|
| | | | | <p>përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi për aksesin e publikut në informacion dhe si subjekt i konfidencialitetit tregtar dhe mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p>11. AKEP publikon kushtet e aksesit të publikut në informacion sipas pikës 8, të këtij neni, duke përfshirë procedurat për marrjen e një aksesi të tillë.</p> <p>12. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike, janë të detyruar t'i paraqesin ministrin, sipas kërkesës, të gjithë informacionin e kërkuar për përbushjen e detyrave funksionale të ministrin, sipas këtij ligji.</p> | |
| Neni21 | <p style="text-align: center;">Neni 21</p> <p style="text-align: center;">Informacioni i kërkuar në lidhje me autorizimin e përgjithshëm, të drejtat e përdorimit dhe detyrimet specifike</p> <p>1. Pa cënuar çdo informacion të kërkuar në përputhje me nenin 20, dhe informacionin dhe detyrimet e raportimit sipas ligjit kombëtar, përveç autorizimit të përgjithshëm, autoriteti rregullator kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente mund të kërkojnë nga ndërmarrjet që të japin informacione në lidhje me autorizimin e përgjithshëm, të drejtat e përdorimit ose detyrimet specifike të përmendura në nenin 13 (2), i cili është proporcional dhe objektivisht i justifikuar për qëllimet:</p> <p>(a) duke verifikuar, në mënyrë sistematike ose rast pas rasti, pajtueshmërinë me gjendjen 1 të Pjesës A, kushtet 2 dhe 6 të Pjesës D, dhe kushtet 2 dhe 7 të Pjesës E, të Shtojcës I dhe të përbushjes së detyrimeve siç përmendet në nenin 13 (2);</p> <p>(b) duke verifikuar rast pas rasti përputhjen e kushteve të përcaktuara në Shtojcën I, kur është pranuar një ankesë ose kur autoriteti kompetent ka arsye të tjera për të besuar se një kusht nuk është përbushur ose në rast të një hetimi nga autoriteti kompetent me iniciativën e tij;</p> <p>(c) kryerjen e procedurave dhe vlerësimin e kërkesave për dhënien e të drejtave të përdorimit;</p> <p>(d) publikimin e përmbledhjeve krahasuese të cilësisë dhe çmimit të shërbimeve në dobi të konsumatorëve;</p> <p>(e) mbledhjen e statistikave, raporteve ose studimeve të përcaktuara qartë;</p> <p>(f) kryerjen e analizave të tregut për qëllimet e kësaj direktive, përfshirë të dhënat për tregjet në rrjedhën e poshtme ose ato të shitjes me pakicë të lidhura ose që lidhen me tregjet që janë objekt i analizës së tregut;</p> <p>(g) sigurimin e përdorimit efikas dhe sigurimin e një administrimi efektiv të spektrit të radios dhe të burimeve të numeracionit;</p> <p>(h) vlerësimin e zhvillimeve të ardhshme të rrjetit ose shërbimeve që mund të kenë ndikim në shërbimet me shumicë të vëna në dispozicion të konkurrentëve, në mbulimin e territorit, në</p> | Neni 42 | <p style="text-align: center;">Neni 42</p> <p style="text-align: center;">Informacioni i kërkuar në lidhje me autorizimin e përgjithshëm, të drejtat e përdorimit dhe detyrimet specifike</p> <p>1. AKEP-i, pavarësisht nga informacioni i kërkuar sipas nenit 41, të këtij ligji, u kërkon sipërmarrësve të japin informacion në lidhje me autorizimin e përgjithshëm, të drejtat e përdorimit ose detyrimet specifike të përmendura në nenin 28, të këtij ligji, i cili duhet të jetë proporcional dhe objektivisht i justifikuar, në veçanti për:</p> <p>a) verifikimin sistematik ose rast pas rasti të respektimit të detyrimeve në lidhje me pagesat administrative, kushteve për përdorimin efektiv dhe eficient të spektrit të frekuencave dhe të burimeve të numeracionit, kryerjen e pagesave të përdorimit për frekuencat dhe numeracionin, si dhe kushtet specifike sipas pikës 6 të nenit 28 të këtij ligji;</p> <p>b) verifikimin rast pas rasti të respektimit të kushteve të përcaktuara në nenin 28, të këtij ligji, kur është marrë një ankesë ose kur AKEP-i ka arsye të tjera për të besuar se një kusht nuk është përbushur, ose në rastin e një hetimi të iniciuar nga vetë AKEP;</p> <p>c) procedurat për vlerësimin e kërkesave për dhënien e të drejtave të përdorimit;</p> <p>d) publikimin e pasqyrave krahasuese të cilësisë dhe çmimit të shërbimeve për të mirën e përdoruesve fundorë;</p> <p>e) qëllime statistikore, raporte ose studime të përcaktuara qartë;</p> <p>f) analiza tregu për qëllimet e këtij ligji, duke përfshirë të dhënat për tregjet e shitjes me pakicë, të njëjta ose të lidhura me tregjet që janë objekt i analizës së tregut;</p> <p>g) ruajtjen e përdorimit efikas dhe sigurimin e</p> | F | |

| | | | | | | |
|--------|---|--|---------|---|---|--|
| | <p>lidhjen në dispozicion të përdoruesve fundorë ose në përcaktimin e zonave në përputhje me nenin 22;</p> <p>(i) kryerjen e sondazheve gjeografike;</p> <p>(j) dhënia e përgjigjeve ndaj kërkesave të arsyeshme për informacion nga BEREC.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacioni i përmendur në pikat (a) dhe (b), dhe (d) deri (j) të nënparagrafit të parë nuk do të kërkohet si kusht për hyrjen në treg. • BEREC mund të zhvillojë modele për kërkesa të informacionit, kur është e nevojshme, për të lehtësuar prezantimin dhe analizën e konsoliduar të informacionit të marrë. <p>2. Sa i përket të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, informacioni i përmendur në paragrafin 1, do t'i referohet në mënyrë të veçantë përdorimit efektiv dhe efikas të spektrit të radios, si dhe pajtueshmërisë me cilindo mbulim dhe cilësi të detyrimeve të shërbimit, të bashkëngjitur me të drejtat e përdorimit për spektrin e radios dhe verifikimin e tyre.</p> <p>3. Kur autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente kërkojnë nga ndërmarrjet që të japin informacionin e përmendur në paragrafin 1, ata do duhet t'i informojnë ato për qëllimin specifik për të cilin do të përdoret ky informacion.</p> <p>4. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente nuk do të duplikojnë kërkesat e informacionit të bërë tashmë nga BEREC, në përputhje me nenin 40 të Rregullores (BE) 2018/1971, ku BEREC ka vënë informacionin e marrë në dispozicion të këtyre autoriteteve.</p> | | | <p>menaxhimit efektiv të spektrit të radios dhe të burimeve të numeracionit;</p> <p>h) vlerësimin e zhvillimeve të ardhshme të rrjetit ose shërbimeve që mund të kenë ndikim në shërbimet me shumicë të vëna në dispozicion të konkurrentëve, në mbulimin territorial, në lidhjen e disponueshme për përdoruesit fundorë ose në përcaktimin e zonave sipas nenit 43 të këtij ligji;</p> <p>i) kryerjen e vrojttimeve gjeografike;</p> <p>j) përgjigjen ndaj kërkesave të arsyetuara për informacion nga BEREC;</p> <p>k) për verifikimin e përputhshmërisë rast pas rasti, siç përmendet në gërmat a) dhe b), të paragrafit 1 të këtij neni, dhe informacionit lidhur me publikimin e pasqyrave krahasuese, raporteve statistikore të përcaktuara qartë ose për qëllime studimi, analizave të tregut, përdorimin efikas dhe sigurimin efektiv të menaxhimit të spektrit të frekuencave dhe burimeve të numeracionit, vlerësimin e zhvillimeve të ardhshme të rrjetit ose shërbimeve, kryerjen e vrojttimeve të shtrirjes gjeografike, u përgjigjet kërkesave për informacion nga BEREC, siç përcaktohet në gërmat d) deri i) të paragrafit 1 të këtij neni, dhe nuk kërkohet si parakusht për hyrjen në treg.</p> <p>l) qëllime statistikore që rrjedhin nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare.</p> <p>2. Për sa u përket të drejtave të përdorimit për spektrin radio, informacioni i përmendur në pikën 1, i referohet veçanërisht përdorimit efektiv dhe efikas të spektrit radio, si dhe respektimit të çdo detyrimi për mbulimin dhe cilësinë e shërbimit që i bashkëngjiten të drejtave të përdorimit për spektrin e frekuencave dhe verifikimit të tyre.</p> <p>3. AKEP-i u kërkon sipërmarrësve të japin informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, dhe i informon ata për qëllimin specifik, për të cilin përdoret ky informacion.</p> <p>4. AKEP-i dhe Ministria bashkëpunojnë, që të mos dublikojnë kërkesat e informacionit të vënë tashmë në dispozicion të tyre.</p> | | |
| Neni22 | <p style="text-align: center;">Neni 22</p> <p style="text-align: center;">Sondazhet gjeografike të shpërndarjes së rrjetit</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, duhet të kryejnë një vëzhgim gjeografik të shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të afta për të ofruar broadband (‘ rrjete broadband) deri më 21 dhjetor</p> | | Neni 43 | <p style="text-align: center;">Neni 43</p> <p style="text-align: center;">Vrojtimet për shtrirjen gjeografike të rrjetit</p> <p>1. Brenda tre vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKEP-i kryen një vrojtim mbi shtrirjen gjeografike të rrjeteve të komunikimeve elektronike broadband, i cili në vijim përditësohet rregullisht të paktën çdo tre vjet. Për përmbushjen e këtij detyrimi, AKEP-i bashkëpunon me</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>2023 dhe do ta përditësojnë atë të paktën çdo tre vjet pas kësaj.</p> <p>Vëzhgimi gjeografik do të përfshijë një vëzhgim të shtrirjes gjeografike aktuale të rrjeteve broadband brenda territorit të tyre, siç kërkohet për autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritete të tjera kompetente sipas kësaj direktive dhe për sondazhet e kërkuara për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.</p> <p>Vëzhgimi gjeografik mund të përfshijë gjithashtu një parashikim për një periudhë të përcaktuar nga autoriteti përkatës i arritjes së rrjeteve broadband, përfshirë rrjetet me kapacitet shumë të lartë, brenda territorit të tyre.</p> <p>Parashikimi i tillë do të përmbledhë të gjithë informacionin përkatës, përfshirë informacionin mbi vendosjet e planifikuara nga ndonjë ndërmarrje ose autoritet publik, të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë dhe përmirësime të konsiderueshme ose shtrirje të rrjeteve me të paktën 100 Mbps shpejtësi të shkarkimit. Për këtë qëllim, autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente do t'u kërkojnë sipërmarrjeve dhe autoriteteve publike që të sigurojnë një informacion të tillë në masën që është në dispozicion dhe që mund të sigurohen me një përpjekje të arsyeshme.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare do të vendosin, në lidhje me detyrat që u janë ngarkuar në mënyrë të veçantë në bazë të kësaj direktive, shtrirja në të cilën është e përshtatshme për tu mbështetur në të gjithë ose një pjesë të informacionit të mbledhur në kontekstin e një parashikimit të tillë.</p> <p>Informacioni i mbledhur në vëzhgimin gjeografik do të jetë në një nivel të duhur të detajeve lokale dhe do të përfshijë informacion të mjaftueshëm për cilësinë e shërbimit dhe parametrat e tyre dhe do të trajtohet në përputhje me nenin 20 (3).</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, mund të përcaktojnë një zonë me kufij të qartë, ku mbi bazën e informacionit të mbledhur dhe çdo parashikimi të përgatitur në bazë të paragrafit 1, përcaktohet që për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse të parashikimit, asnjë ndërmarrje ose autoritet publik nuk ka në plan të vendosë një rrjet me kapacitet shumë të lartë, të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme ose të zgjerojë rrjetin e tij, në një performancë prej të paktën 100 Mbps të shkarkimit. Rregullatori kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente publikojnë zonat e përcaktuara.</p> <p>3. Brenda një zone të caktuar, autoritetet përkatëse mund të ftojnë sipërmarrjet dhe autoritetet publike të deklarojnë qëllimin e tyre për të vendosur rrjete me kapacitet shumë të lartë gjatë kohëzgjatjes së periudhës përkatëse të parashikimit. Kur kjo ftesë rezulton në një deklaratë nga një sipërmarrje ose autoritet publik me qëllimin e saj për ta bërë</p> | | <p>ministrinë dhe autoritetet e tjera kompetente.</p> <p>2. Vrojtimi gjeografik mbi shtrirjen aktuale gjeografike të rrjeteve broadband në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshin informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave rregullatore të AKEP sipas këtij ligji, si dhe informacionin që kërkohet për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore. Informacioni i mbledhur për vrojtimin gjeografik është i detajuar në nivel lokal dhe përfshin informacion të mjaftueshëm mbi cilësinë e shërbimit. Ky informacion, trajtohet sipas parashikimeve të pikës 9, të nenit 41, të këtij ligji.</p> <p>3. Vrojtimi gjeografik sipas pikës 1, të këtij neni, përmban dhe një vlerësim për shtrirjen në të ardhmen të rrjeteve broadband, përfshirë parashikimet për rrjetet me kapacitet shumë të lartë, për një periudhë kohore të përcaktuar nga AKEP, e cila nuk është më shumë se tre vjet. Ky vlerësim, përfshin gjithë informacionin e duhur mbi planifikimet e bëra nga çdo sipërmarrës ose nga një autoritet publik, për shtrirjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë si dhe për përmirësimin ose zgjerime të rëndësishme të rrjetit që siguron shpejtësinë “download” të paktën me 100 Mbps.</p> <p>4. Sipërmarrësit dhe autoritetet publike duhet t'i ofrojnë AKEP-it dhe ministrit informacionin mbi parashikimet e shtrirjes së rrjeteve, në masën që ai është i disponueshëm dhe që mund të sigurohet me përpjekje objektive.</p> <p>5. Në bazë të vrojtimit gjeografik të kryer, përfshirë dhe informacionin e mbledhur për planifikimet e shtrirjes së rrjeteve, AKEP në bashkëpunim me ministrin, përcakton një zonë me kufij të qartë territorialë ku përgjatë periudhës përkatëse nuk parashikohet të ketë sipërmarrës ose ndonjë autoritet publik, që kanë shtrirë ose planifikojnë shtrirjen e rrjetit me kapacitet shumë të lartë ose planifikojnë kryerjen e përmirësimeve apo zgjerimeve të konsiderueshme të rrjetit që siguron një shpejtësi prej të paktën 100 Mbps. Informacioni për zonat e përcaktuara si më sipër, publikohet në faqen zyrtare të AKEP dhe ministrisë.</p> <p>6. Brenda një zone të caktuar, AKEP dhe/ose ministri, fton sipërmarrësit dhe autoritetet publike të deklarojnë synimin e tyre për shtrirjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, gjatë kohëzgjatjes së periudhës përkatëse të parashikimit. Pas deklarimit nga një sipërmarrës ose autoritet publik mbi synimin e tyre, autoriteti përkatës, me qëllim koordinimin e punimeve civile, u kërkon sipërmarrësve të tjerë dhe autoriteteve publike, të deklarojnë çdo synim për të vendosur rrjete me kapacitet shumë të lartë, për të përmirësuar ose zgjeruar ndjeshëm rrjetin e tyre, në një performancë me shpejtësi të paktën 100 Mbps në këtë zonë.</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>këtë, autoriteti përkatës mund të kërkojë nga ndërmarrjet e tjera dhe autoritetet publike të deklarojnë qëllimin për të vendosur rrjete me kapacitet shumë të lartë, të përmirësojnë ose zgjerojnë ndjeshëm rrjetin e tij në një performancë të paktën 100 Mbps të shkarkimit në këtë zonë. Autoriteti përkatës do të specifikojë informacionin që do të përfshihet në këto parashtresa (submissions), në mënyrë që të sigurojë të paktën një nivel të ngjashëm detajesh si ai i marrë në konsideratë në çdo parashikim në përputhje me paragrafin 1. Ai gjithashtu do të informojë çdo ndërmarrje ose autoritet publik që shpreh interesin e tij nëse zona e caktuar është e mbuluar ose ka të ngjarë të mbulohet nga një rrjet i gjeneratës së ardhshme që ofron shpejtësi të shkarkimit nën 100 Mbps në bazë të paragrafit 1.</p> <p>4. Masat sipas paragrafit 3, do të merren në përputhje me një procedurë efikase, objektive, transparente dhe jodiskriminuese, me anë të së cilës asnjë sipërmarrje nuk përjashtohet.</p> <p>5. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, autoritetet lokale rajonale dhe kombëtare me përgjegjësi për shpërndarjen e fondeve publike për vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, për hartimin e planeve kombëtare të broadband, për përcaktimin e detyrimeve të mbulimit të bashkangjitura me të drejtat e përdorimit për spektrin e radios dhe për verifikimin e disponueshmërisë së shërbimeve që janë brenda detyrimeve të shërbimit universal në territorin e tyre, marrin parasysht rezultatet e vëzhgimeve gjeografike dhe të çdo zone të caktuar, në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3.</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet që kryejnë vëzhgimin gjeografik t'i japin ato rezultate subjektivit të autoritetit pritës duke siguruar të njëjtin nivel konfidencialiteti dhe mbrojtje të sekreteve të biznesit si autoriteti origjinal dhe të informojnë palët që kanë dhënë informacionin. Këto rezultate do të vihen në dispozicion të BEREC dhe Komisionit me kërkesën e tyre dhe në të njëjtat kushte.</p> <p>6. Nëse informacioni përkatës nuk është i disponueshëm në treg, autoritetet kompetente duhet të nxjerrin të dhëna nga vëzhgimet gjeografike, të cilat nuk i nënshtrohen konfidencialitetit tregtar drejtpërdrejt në përputhje me Direktivën 2003/98 / EC, për të lejuar ripërdorimin e tij. Ato gjithashtu, kur mjete të tilla nuk janë të disponueshme në treg, do të vënë në dispozicion mjete të informacionit që mundësojnë përdoruesit fundorë të përcaktojnë disponueshmërinë e lidhjes në zona të ndryshme, me një nivel të detajeve të dobishme për të mbështetur zgjedhjen e tyre të operatorit ose ofruesit të shërbimit.</p> | | <p>7. AKEP-i në bashkëpunim me ministrin, specifikon informacionin që përfshihet në këto deklarata, për të siguruar të paktën një nivel të ngjashëm detajesh, si ajo e marrë në konsideratë në çdo parashikim sipas pikës 1 të këtij neni. AKEP-i, në bazë të informacionit të mbledhur në përputhje me pikën 1 e 3, të këtij neni, informon çdo sipërmarrës ose autoritet publik që shpreh interesin e tij, nëse zona e caktuar mbulohet ose ka të ngjarë të mbulohet nga një rrjet që ofron shpejtësi nën 100 Mbps.</p> <p>8. Në procedurat e kryera sipas këtij neni, AKEP-i dhe ministri, sigurojnë një procedurë efikase, objektive, transparente dhe jodiskriminuese, ku asnjë sipërmarrës nuk përjashtohet paraprakisht.</p> <p>9. Ministri, AKEP, si dhe autoritetet e tjera kompetente të qeverisjes vendore apo qendrore, përgjegjëse sipas fushës së tyre të kompetencës për shpërndarjen e fondeve publike për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, për hartimin e planit kombëtar broadband, për përcaktimin e detyrimeve të mbulimit që i bashkëngjiten të drejtave të përdorimit të spektrit të frekuencave dhe për verifikimin e disponueshmërisë së shërbimeve që përfshihen në detyrimin e shërbimit universal, marrin parasysht rezultatet e vrojtimit gjeografik dhe të çdo zone të caktuar, në përputhje me pikat 1 deri në 7, të këtij neni.</p> <p>10. AKEP dhe ministria, i japin këto rezultate autoritetit kërkues, duke siguruar të njëjtin nivel konfidencialiteti tregtar si autoriteti i origjinës dhe informojnë palët që kanë dhënë informacionin. Këto rezultate i vihen në dispozicion edhe Këshillit të Ministrave. Këto rezultate mund t'i vihen gjithashtu në dispozicion BEREC-ut dhe Komisionit, me kërkesën e tyre.</p> <p>11. Nëse informacioni përkatës nuk disponohet në treg, AKEP bazuar në ligjin në fuqi për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik, bën të aksesueshme të dhënat nga vrojtimit gjeografike që nuk i nënshtrohen konfidencialitetit tregtar, duke u mundësuar përdoruesve fundorë, të përcaktojnë disponueshmërinë e lidhjes në zona të ndryshme, me një nivel të detajuar, i cili është i dobishëm për të mbështetur zgjedhjen e tyre për operatorin ose ofruesin e shërbimit.</p> <p>12. AKEP-i vë në dispozicion informacionin sipas pikës 11, të këtij neni, edhe nëpërmjet Sistemit të Informacionit të Centralizuar për Rrjetet e Komunikimit Elektronik, siç përcaktohet në nenin 3, të ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".</p> <p>13. Në zbatim të këtij neni, AKEP-i pas konsultimit me grupet e interesit, në bashkëpunim me ministrin dhe</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|---------------|--|--|---------|--|---|
| | Deri më 21 qershor 2020, për të kontribuar në zbatimin e vazhdueshëm të vëzhgimeve dhe parashikimeve gjeografike, BEREC pas konsultimit me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin dhe autoritetet përkatëse kombëtare, nxjerr udhëzime për të ndihmuar autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet përkatëse kombëtare për zbatimin e vazhdueshëm të detyrimeve të tyre sipas këtij neni. | | | autoritetet e tjera kombëtare, nxjerr një udhëzim për zbatimin e detyrimeve të këtij neni, të harmonizuar me praktikën e BE-së, si dhe Udhëzimet përkatëse të BEREC-ut për vërtetimet gjeografike. | |
| Neni23 | <p style="text-align: center;">Neni 23 Mekanizmi i konsultimit dhe transparencës</p> <p>1. Me përjashtim të rasteve që përfshihen në nenin 26 ose 27 dhe nenin 32 (10), Shtetet Anëtare sigurojnë që kur autoritetet rregullatore ose autoritetet e tjera kompetente synojnë të marrin masa në përputhje me këtë Direktivë, ose kur ata synojnë të parashikojnë kufizime në përputhje me nenin 45 (4) dhe (5), të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun përkatës, ata u japin palëve të interesuara mundësinë që të komentojnë draft masën brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjes, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, në çdo rast jo më të shkurtër se 30 ditë.</p> <p>2. Për qëllimet e nenit 35, autoritetet kompetente informojnë RSPG në momentin e publikimit, në lidhje me çdo draft masë që është në fushën e procedurës së përzgjedhjes krahasuese ose konkurruese, në përputhje me nenin 55 (2) dhe ka të bëjë me përdorimin e spektrit të radios për të cilin janë vendosur kushte të harmonizuara me masa teknike zbatimi në përputhje me Vendimin Nr. 676/2002 / EC, në mënyrë që të mundësohet përdorimi i tij për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike ("wireless, broadband rrjetet dhe shërbimet").</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente publikojnë procedurat e tyre kombëtare të këshillimit.</p> <p>Shtetet Anëtare sigurojnë krijimin e një pike të vetme informacioni, përmes së cilës mund të arrihen të gjitha konsultimet aktuale.</p> <p>4. Rezultatet e procedurës së konsultimit do të vihen në dispozicion të publikut, përveç në rastin e informacionit konfidencial në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian dhe ligjet kombëtare për konfidencialitetin tregtar.</p> | | Neni 44 | <p style="text-align: center;">Neni 44 Mekanizmi i konsultimit dhe transparencës</p> <p>1. Me përjashtim të rasteve që përfshihen në nenet 47 dhe 48, të këtij ligji, kur AKEP-i synon të marrë masa në përputhje me këtë ligj, ose kur synon të parashikojë kufizime në përputhje me nenin 62 të këtij ligji, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun përkatës, AKEP-i përgjatë procesit të përgatitjes së dokumenteve rregullatorë për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, merr dhe vlerëson mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet procesit të këshillimit publik. Afati i zhvillimit të procesit të konsultimit publik nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.</p> <p>2. AKEP-i është pika e vetme e informacionit gjatë gjithë procesit të konsultimit të dokumentave rregullatore dhe publikon të gjitha procedurat kombëtare të konsultimit në faqen e tij të internetit. Konsultimet publike nga ministri, kryhen sipas ligjit për konsultimet publike në Regjistrin e Konsultimeve Publike.</p> <p>3. Rezultatet e procedurës së konsultimit, duhet të vihen në dispozicion të publikut, me përjashtim të rastit të informacionit konfidencial, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sekretin tregtar.</p> <p>4. Për të koordinuar dhe harmonizuar zbatimin e politikës së spektrit, AKEP-i informon RSPG-në në momentin e publikimit, për çdo draft masë që bie në fushën e procedurave të përzgjedhjes konkurruese, sipas këtij ligji të lidhur me përdorimin e harmonizuar të spektrit radio, që mundëson përdorimin e tij për rrjetet e komunikimeve elektronike pa tel, të afta për të ofruar rrjetet broadband.</p> | F |
| Neni24 | <p style="text-align: center;">Neni 24 Konsultimi i palëve të interesuara</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë kur është e përshtatshme, që autoritetet kompetente në koordinim me autoritetet rregullatore kombëtare, të marrin parasysh pikëpamjet e përdoruesve fundorë, në veçanti të konsumatorëve dhe përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara, prodhuesit dhe ndërmarrjet që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për çështje që lidhen me</p> | | Neni 45 | <p style="text-align: center;">Neni 45 Konsultimi me palët e interesuara</p> <p>1. AKEP-i, në bashkëpunim me autoritetet e tjera, merr në konsideratë mendimin e përdoruesve fundorë, në veçanti të konsumatorëve dhe të përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara, prodhuesve dhe sipërmarrësve që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime për çështje që lidhen me të gjitha të drejtat e përdoruesve</p> | F |

| | | | | | | |
|---------|---|--|---------|---|---|--|
| | <p>të gjitha të drejtat e përdoruesve fundorë dhe të konsumatorit, përfshirë hyrjen dhe zgjedhjen ekuivalente për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, në lidhje me shërbimet e komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, veçanërisht kur ato kanë një ndikim të rëndësishëm në treg.</p> <ul style="list-style-type: none"> Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente në koordinim me autoritetet rregullatore kombëtare, të krijojnë një mekanizëm konsultimi të arritshëm për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, duke siguruar që në vendimet e tyre për çështje që lidhen me përdoruesit fundorë dhe të drejtat e konsumatorit në lidhje me shërbimet e komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut vëmendja e duhur u kushtohet interesave të konsumatorit në komunikimet elektronike. <p>2. Palët e interesuara mund të zhvillojnë me drejtimin e autoriteteve kompetente në koordinim, nëse është e nevojshme me autoritetet rregullatore kombëtare, mekanizmat, duke përfshirë konsumatorët, grupet e përdoruesve dhe ofruesit e shërbimeve, për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të ofrimit të shërbimit, ndër të tjera, zhvillimin dhe kodet e monitorimit të sjelljes dhe standardet e funksionimit.</p> <p>3. Pa cënuar rregullat kombëtare në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian që promovojnë objektivat e politikës kulturore dhe mediatike, të tilla si diversiteti kulturor dhe gjuhësor dhe pluralizmi i mediave, autoritetet kompetente në koordinim kur është e nevojshme, me autoritetet rregullatore kombëtare, mund të promovojnë bashkëpunimin midis sipërmarrjeve që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime dhe sektorë të interesuar në promovimin e përmbajtjes së ligjshme në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Ky bashkëpunim mund të përfshijë gjithashtu koordinimin e informacionit për interesin publik që duhet të jepet në bazë të nenit 103 (4).</p> | | | <p>fundorë dhe të konsumatorëve, duke përfshirë garantimin e aksesit të njëjtë dhe të drejtën e zgjedhjes për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, në lidhje me shërbimet e komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, veçanërisht kur ato kanë një ndikim të rëndësishëm në treg.</p> <p>2. AKEP-i, në bashkëpunim me organin përgjegjës për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, krijon një mekanizëm konsultimi, të aksesueshëm për përdoruesit fundorë me aftësi ndryshe, duke siguruar që në vendimet e tyre për çështje që lidhen me të drejtat e përdoruesit fundor dhe të konsumatorit, në lidhje me shërbimet e komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, t'u kushtohet vëmendje e duhur interesave të konsumatorëve në komunikimet elektronike.</p> <p>3. Palët e interesuara, duke përfshirë konsumatorët, grupet e përdoruesve dhe ofruesit e shërbimeve, nën drejtimin e AKEP-it zhvillojnë mekanizma, për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të ofrimit të shërbimit, ndër të tjera, duke zhvilluar dhe monitoruar kodet e sjelljes dhe standardet e funksionimit.</p> <p>4. AKEP-i, dhe sipas rastit AKEP dhe AMA, nxisin bashkëpunimin ndërmjet sipërmarrjeve që ofrojnë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike dhe sektorëve të interesuar në promovimin e përmbajtjes që promovojnë objektivat e politikave kulturore dhe mediatike, të tilla si diversiteti kulturor dhe gjuhësor dhe pluralizmi mediatik. Ky bashkëpunim përfshin gjithashtu koordinimin e informacionit me interes publik, që duhet të sigurohet në përputhje me pikën 8 të nenit 142, të këtij ligji.</p> | | |
| Neni 25 | <p style="text-align: center;">Neni 25</p> <p style="text-align: center;">Zgjidhja e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoriteti rregullator kombëtar ose një autoritet tjetër kompetent përgjegjës për të, ose të paktën një organ i pavarur me ekspertizë të provuar, zbatimin e nenit 102 deri 107 dhe nenit 115 të kësaj direktive, listohen si një organ alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 20 (2) të Direktivës 2013/11/BE me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve dhe konsumatorëve që lindin nën këtë direktivë dhe në lidhje me kryerjen e kontratave. Shtetet Anëtare mund të zgjerojnë mundësinë e përdorimit të procedurave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të dhëna nga ai autoritet ose organ për përdoruesit fundorë përveç konsumatorëve, në veçanti mikro-ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla.</p> <p>2. Pa cënuar Direktivën 2013/11/BE, kur këto mosmarrëveshje përfshijnë palë në shtete të ndryshme anëtare,</p> | | Neni 46 | <p style="text-align: center;">Neni 46</p> <p style="text-align: center;">Zgjidhja e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës</p> <p>1. AKEP-i zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve dhe përdoruesve fundorë, përfshirë konsumatorët që lidhen me zbatimin e kontratave, bazuar në legjisllacionin për mbrojtjen e konsumatorit.</p> <p>2. Përdoruesi fundor, ka të drejtë të ankohet ose të kërkojë shpjegime nga ofruesi, në lidhje me kushtet e kontratës ose përmbushjen e këtyre kushteve nga ofruesi, përfshirë faturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.</p> <p>3. Pas marrjes së kërkesës, ofruesi i përgjigjet përdoruesit fundor me shkrim, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së kërkesës së përdoruesit fundor.</p> <p>4. Nëse përdoruesi fundor nuk pajtohet me përgjigjen me shkrim të ofruesit, ose nuk merr përgjigje nga ofruesi, ai ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pranë AKEP-it, ose të paraqesë kërkesë në gjykatën përkatëse, sipas Kodit të Procedurës</p> | F | |

| | | | | | | |
|--------|--|--|---------|---|---|--|
| | Shtetet Anëtare do të koordinojnë përpjekjet e tyre me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. | | | <p>Civile.</p> <p>5. Përdoruesi fundor paraqet në AKEP, një kërkesë me shkrim brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni. AKEP zgjidh mosmarrëveshjen në mënyrë transparente, të shpejtë, objektive dhe jodiskriminuese, brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës. Ky afat mund të shtyhet nga AKEP-i, për një periudhë kohore e cila nuk mund të kalojë 30 ditë shtesë.</p> <p>6. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, marrin pjesë në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe bashkëpunojnë me AKEP-in, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe i japin këtij të fundit të gjithë informacionin e kërkuar.</p> <p>7. AKEP-i, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e disponueshme, i jep përdoruesit fundor dhe sipërmarrësit një rekomandim me shkrim, për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Nëse të dyja palët, përdoruesi dhe sipërmarrësi e pranojnë me shkrim rekomandimin brenda 15 ditëve, ai bëhet përfundimtar dhe i detyrueshëm. Në të kundërt, secila palë mund t'ia drejtojë mosmarrëveshjen gjykatës përkatëse, sipas legjisllacionit në fuqi.</p> <p>8. AKEP-i përcakton procedurat dhe strukturën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me anë të një rregulloreje. Procedura e ndjekur nga AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, është pa pagesë.</p> <p>9. Kur AKEP-i konstaton se një çështje specifike, është objekt i shumë kërkesave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me një sipërmarrës të caktuar, shqyrton nëse procedura e trajtimit të ankesave zbatohet siç duhet nga sipërmarrësi. Nëse është e nevojshme, AKEP-i i kërkon sipërmarrësit të përmirësojë procedurat e ankimit.</p> <p>10. Me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, AKEP bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve të BE-së në koordinim me BEREC.</p> | | |
| Neni26 | <p style="text-align: center;">Neni 26</p> <p style="text-align: center;">Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrjeve</p> <p>1. Në rast të një mosmarrëveshje që lind në lidhje me detyrimet ekzistuese sipas kësaj directive, midis ofruesve të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në një Shtet Anëtar, ose midis sipërmarrjeve të tilla dhe sipërmarrjeve të tjera në Shtetin Anëtar, që përfitojnë nga detyrimet e hyrjes ose interkoneksionit midis ofruesit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në një Shtet Anëtar dhe ofruesit të faciliteteve shoqëruese, autoriteti rregullator kombëtar në fjalë, me kërkesë të secilës palë dhe pa çenuar paragrafin 2, do të nxjerrë përveçse në rrethana të jashtëzakonshme, një vendim detyrues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në një afat kohor sa më të shkurtër të mundshëm në bazë të procedurave të qarta dhe efikase, dhe në</p> | | Neni 47 | <p style="text-align: center;">Neni 47</p> <p style="text-align: center;">Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve</p> <p>1. AKEP zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.</p> <p>2. AKEP-i fillon një procedure për zgjidhje të mosmarrëveshjes me marrjen e kërkesës nga secila palë në mosmarrëveshje, dhe nxjerr një vendim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në një afat të shkurtër kohor, mbi bazën e procedurave të qarta dhe efikase dhe në çdo rast brenda katër muajve, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.</p> | F | |

| | | | | | | |
|--------|---|--|---------|--|---|--|
| | <p>çdo rast brenda katër muajve. Shteti Anëtar i interesuar kërkon që të gjitha palët të bashkëpunojnë plotësisht me autoritetin rregullator kombëtar.</p> <p>2. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kombëtare rregullatore të refuzojnë për të zgjidhur një mosmarrëveshje, kur ekzistojnë mekanizma të tjerë përfshirë ndërmjetësimin, që do të kontribuojnë më mirë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në kohën e duhur, në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 3. Autoriteti rregullator kombëtar do të informojë palët pa vonesë. Nëse pas katër muajsh mosmarrëveshja nuk zgjidhet dhe nëse mosmarrëveshja nuk është paraqitur para gjykatave nga pala që kërkon kompensim, autoriteti rregullator kombëtar do të nxjerrë me kërkesën e secilës palë një vendim detyrues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe në çdo rast brenda katër muajve.</p> <p>3. Në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, autoriteti rregullator kombëtar do të marrë vendime që synojnë arritjen e objektiveve të përcaktuara në nenin 3. Çdo detyrim i imponuar në një ndërmarrje nga autoriteti rregullator kombëtar për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje do të jetë në përputhje me këtë Direktivë.</p> <p>4. Vendimi i autoritetit rregullator kombëtar do të vihet në dispozicion të publikut, duke marrë parasysh kërkesat e konfidencialitetit tregtar. Autoriteti rregullator kombëtar u siguron palëve të interesuara një deklaratë të plotë për arsyet në të cilat bazohet vendimi.</p> <p>5. Procedura e përmendur në paragrafët 1, 3 dhe 4 nuk lejohet që asnjë palë të bëjë një veprim para gjykatave.</p> | | | <p>3. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve AKEP-i zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj. Të gjitha palët, duhet të bashkëpunojnë plotësisht me AKEP-in.</p> <p>4. AKEP-i gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve është i detyruar të marrë në konsideratë objektivat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji për garantimin e konkurrencës efektive dhe mbrojtjes së interesave të përdoruesve, të parashikuara në këtë ligj. Çdo detyrim i vendosur nga AKEP, ndaj sipërmarrësve në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të jetë objektiv, jodiskriminues dhe proporcional sipas parashikimeve të këtij ligji.</p> <p>5. AKEP-i u siguron palëve të interesuara një deklaratë të plotë të arsyeve mbi të cilat bazohet vendimi.</p> <p>6. AKEP-i publikon vendimet në lidhje me mosmarrëveshjet, duke mbajtur parasysh ruajtjen e sekretit tregtar të biznesit të palëve.</p> <p>7. Procedura e nisur para AKEP, nuk pengon asnjëherë nga palët t'i drejtohet gjykatës. Nëse pas katër muajsh, mosmarrëveshja nuk zgjidhet dhe nuk është objekt shqyrtimi gjyqësor, AKEP-i, me kërkesën e çdo njëres prej palëve, nxjerr një vendim detyrues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.</p> | | |
| Neni27 | <p style="text-align: center;">Neni 27</p> <p style="text-align: center;">Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkufitare</p> <p>1. Në rast të mosmarrëveshjeve që lindin nën këtë Direktivë midis ndërmarrjeve në shtete të ndryshme anëtare, zbatohen paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni. Këto dispozita nuk do të zbatohen për mosmarrëveshjet në lidhje me koordinimin e spektrit të radios të përfshira në nenin 28.</p> <p>2. Çdo palë mund t'ia referojë mosmarrëveshjen autoritetit rregullator kombëtar ose autoriteteve të interesuara. Kur mosmarrëveshja prek tregtinë midis Shteteve Anëtare, autoriteti rregullator kombëtar ose autoriteti kompetent i njoftojnë mosmarrëveshjen BEREC, në mënyrë që të sjellë një zgjidhje të qëndrueshme të mosmarrëveshjes, në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 3.</p> <p>3. Kur është bërë një njoftim i tillë, BEREC lëshon një mendim ku fton autoritetin kombëtar rregullator ose autoritetet e interesuara të ndërmarrin veprime specifike për të zgjidhur mosmarrëveshjen, ose të përmbahen nga veprimet në afatin më të shkurtër të mundshëm, dhe në çdo rast brenda katër muajve, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme.</p> <p>4. Autoriteti rregullator kombëtar ose autoritetet e interesuara, do të presin mendimin e BEREC, para se të</p> | | Neni 48 | <p style="text-align: center;">Neni 48</p> <p style="text-align: center;">Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkufitare</p> <p>1. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet një sipërmarrësi shqiptar që vepron në bazë të këtij ligji, me sipërmarrës të një vendi tjetër të BE-së, zbatohen pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni. Këto dispozita nuk zbatohen për mosmarrëveshjet që lidhen me koordinimin e spektrit radio që trajtohet sipas nenit 49, të këtij ligji.</p> <p>2. Çdo palë mund ta paraqesë mosmarrëveshjen tek AKEP-i ose autoritetet përkatëse rregullatore. Kur mosmarrëveshja prek tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të BE-së, AKEP ose autoritetet rregullatore kompetente, njoftojnë BEREC-un për mosmarrëveshjen, për arritur në një zgjidhje të qëndrueshme të mosmarrëveshjes, në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji.</p> <p>3. Kur është bërë një njoftim sipas pikës 2 të këtij neni, BEREC-u në afatin sa më të shkurtër kohor të mundshëm dhe në çdo rast brenda katër muajve, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, jep një opinion duke ftuar AKEP-in ose autoritetet e interesuara, të ndërmarrin veprime specifike për zgjidhjen e</p> | F | |

| | | | | | | |
|----------------|---|--|---------|--|---|--|
| | <p>ndërmarrin ndonjë veprim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur ekziston një nevojë urgjente për të vepruar, për të mbrojtur konkurrencën ose për të mbrojtur interesat e përdoruesve fundorë, cilido nga autoritetet kompetente rregullatore kombëtare me kërkesë të palëve ose me iniciativën e tij, mund të miratojë masat e përkohshme.</p> <p>5. Çdo detyrim i imponuar nga një sipërmarrje nga autoriteti rregullator kombëtar, si pjesë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duhet të përputhet me këtë Direktivë, të marrë parasysh maksimumin e mendimit të miratuar nga BEREC dhe të miratohet brenda një muaji të këtij mendimi.</p> <p>6. Procedura e përmendur në paragrafin 2 nuk lejon që asnjë palë të ndërmarrë një veprim para gjykatave.</p> | | | <p>mosmarrëveshjes, ose të frenojnë veprimet.</p> <p>4. AKEP-i ose autoritetet përkatëse, presin opinionin e BEREC, përpara se të ndërmarrin çdo veprim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur ka nevojë urgjente për të vepruar, për të mbrojtur konkurrencën ose për të mbrojtur interesat e përdoruesve fundorë, AKEP merr masa të përkohshme me iniciativën e tij, ose me kërkesë të palëve.</p> <p>5. Çdo detyrim që i vihet një sipërmarrësi nga AKEP-i, si pjesë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërkufitare, duhet të jetë në përputhje me këtë ligj, dhe merr parasysh maksimalisht opinionin e miratuar nga BEREC-u si dhe miratohet brenda një muaji nga marrja e tij.</p> <p>6. Procedura e përmendur në pikën 2, të këtij neni, nuk e pengon asnjërin nga palët që të ngrejë padi pranë gjykatës.</p> | | |
| Neni 28 | <p style="text-align: center;">Neni 28 Koordinimi i Spektrit të Radios midis Shteteve Anëtare</p> <p>1. Shtetet Anëtare dhe autoritetet e tyre kompetente sigurojnë që përdorimi i spektrit të radios të jetë i organizuar në territorin e tyre në atë mënyrë, që asnjë shtet tjetër anëtar të mos ndalohet të lejojë në territorin e tij përdorimin e spektrit të harmonizuar të radios në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, veçanërisht për shkak të ndërhyrjes së dëmshme ndërkufitare midis Shteteve Anëtare.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtetet Anëtare do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim, pa cënuar detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar dhe marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, siç janë Rregulloret e Radios ITU dhe Marrëveshjet Rajonale të Radio ITU. <p>2. Shtetet Anëtare bashkëpunojnë me njëri-tjetrin kur është e përshtatshme, përmes RSPG, në koordinimin ndërkufitar të përdorimit të spektrit të radios me qëllim që:</p> <p>(a) të sigurojnë pajtueshmërinë me paragrafin 1;</p> <p>(b) të zgjidhin çdo problem apo mosmarrëveshje në lidhje me koordinimin ndërkufitar ose ndërhyrjen e dëmshme ndërkufitare midis Shteteve Anëtare, si dhe me vendet e treta, të cilat i ndalojnë shtetet anëtare të përdorin spektrin e harmonizuar të radios në territorin e tyre.</p> <p>3. Për të siguruar përputhjen me paragrafin 1, çdo Shtet Anëtar i prekur, mund të kërkojë nga RSPG të përdorë zyrat e saj të mira për të adresuar çdo problem apo mosmarrëveshje në lidhje me koordinimin ndërkufitar ose ndërhyrjen e dëmshme ndërkufitare. Kur është e përshtatshme, RSPG mund të nxjerrë një mendim duke propozuar një zgjidhje të koordinuar në lidhje me një problem apo mosmarrëveshje të tillë.</p> <p>4. Kur veprimet e përmendura në paragrafin 2 ose 3 nuk e kanë zgjidhur problemin ose mosmarrëveshjen, dhe me kërkesën</p> | | Neni 49 | <p style="text-align: center;">Neni 49 Koordinimi i spektrit radio me vendet fqinje</p> <p>1. AKEP-i dhe AMA në bashkëpunim, sigurojnë që përdorimi i spektrit radio në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk shkakton ndërhyrje, në mënyrë që asnjë shtet fqinj të mos pengohet brenda territorit të tyre nga përdorimi i spektrit të harmonizuar të radio frekuencave, veçanërisht për shkak të interferencave të dëmshme ndërkufitare me vendet fqinje.</p> <p>2. Ministria në bashkëpunim me AKEP dhe AMA, marrin të gjitha masat e nevojshme për të respektuar detyrimet sipas ligjit ndërkombëtar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse, siç janë Rregulloret Radio të ITU dhe Marrëveshjet Rajonale Radio të ITU.</p> <p>3. AKEP-i dhe AMA bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe ministrinë dhe sipas rastit me autoritetet kompetente të vendeve të ITU, CEPT ose me RSPG, për marrëdhëniet ndërkufitare me fqinjët dhe vendet e tjera në lidhje me spektrin radio për të:</p> <p>a) siguruar përdorimin e spektrit në përputhje me pikën 1 të këtij neni;</p> <p>b) zgjidhur çdo problem ose mosmarrëveshje në lidhje me koordinimin ndërkufitar ose ndërhyrjen e dëmshme ndërkufitare me vendet e treta, të cilat i pengojnë ato të përdorin spektrin e harmonizuar radio në territorin e tyre.</p> <p>4. Për koordinimin ndërkufitar në lidhje me spektrin e harmonizuar radio me vendet e Bashkimit, AKEP koordinon me autoritetet kompetente të vendeve të Bashkimit dhe sipas nevojës me RSPG.</p> <p>5. Për të garantuar pajtueshmërinë me pikën 1, në rast vështirësish për koordinimin ndërkufitar me vendet e</p> | F | |

| | | | | | |
|---------------|---|--|---------------------------------|---|---|
| | <p>eçdo Shteti Anëtar të prekur, Komisioni mund të marrë parasysh maksimumin e çdo mendimi të RSPG-së, duke rekomanduar një zgjidhje të koordinuar në përputhje me paragrafin 3, të miratohet vendime drejtuar Shteteve Anëtare të interesuara nga çështja e pazgjidhur e ndërhyrjes së dëmshme me anë të zbatimit të akteve për të zgjidhur ndërhyrjen e dëmshme ndërkufitare midis dy ose më shumë shteteve anëtare që i parandalojnë ata të përdorin spektrin e harmonizuar të radios në territorin e tyre.</p> <p>Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> <p>5. Bashkimi Evropian, me kërkesën e çdo Shteti Anëtar të prekur, do të sigurojë mbështetje ligjore, politike dhe teknike për të zgjidhur çështjet e koordinimit të spektrit të radios me vendet fqinje të Bashkimit Evropian, përfshirë kandidatët dhe vendet fqinje, në atë mënyrë që Shtetet Anëtare të interesuara të mundën të respektojnë detyrimet e tyre sipas ligjit të Bashkimit Evropian. Në ofrimin e një ndihme të tillë, Bashkimi Evropian promovon zbatimin e politikave të Bashkimit Evropian.</p> | | | <p>Bashkimit, AKEP mund t'i kërkojë RSPG-së, mbështetje për të trajtuar problemin apo mosmarrëveshjen, në lidhje me koordinimin ndërkufitar ose ndërhyrjet e dëmshme ndërkufitare me vendet e Bashkimit. Kur është e përshtatshme, RSPG-ja mund të nxjerrë një opinion duke propozuar një zgjidhje të koordinuar në lidhje me një problem, apo mosmarrëveshje të tillë.</p> <p>6. Kur veprimet e përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe kur bashkëpunimi me RSPG sipas pikës 5 të këtij neni, nuk e kanë zgjidhur problemin ose mosmarrëveshjen e koordinimit ndërkufitar për spektrin radio me një ose disa Shtete Anëtare të BE-së, i kërkoet Komisionit të marrë një vendim për çështjen e pazgjidhur të cilat pengojnë përdorin e spektrit të harmonizuar radio në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>7. Aktet zbatuese sipas pikës 6 të këtij neni, miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit sipas pikës 4, të nenit 118, të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike.</p> <p>8. Ministria me kërkesë të AKEP, në rastin e vështirësive ose mosmarrëveshjeve në lidhje me koordinimin ndërkufitar të frekuencave me një ose disa shtete fqinje anëtare të Bashkimit, i kërkon Komisionit mbështetje ligjore, politike dhe teknike për të zgjidhur çështjet e koordinimit të spektrit radio me vendet fqinje me të, duke përfshirë vendet candidate, në mënyrë që Shtetet Anëtare të interesuara të respektojnë detyrimet e tyre sipas ligjit të Bashkimit dhe që të nxitet zbatimin e politikave të BE-së.</p> | |
| Neni29 | <p style="text-align: center;">TITULLI III</p> <p style="text-align: center;">ZBATIMI</p> <p style="text-align: center;">Neni 29</p> <p style="text-align: center;">Gjobat</p> <p>1. Shtetet Anëtare vendosin rregulla mbi dënimet kur është e nevojshme, përfshirë dënimet e paracaktuara ose periodike jo-penale, të zbatueshme për shkeljet e dispozitave kombëtare, të miratuara në bazë të kësaj direktive, ose të çdo vendimi detyruar të miratuar nga Komisioni, autoriteti rregullator kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent në përputhje me këtë Direktivë, dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e tyre. Brenda kufijve të ligjit kombëtar, autoriteti rregullator kombëtar dhe autoritetet e tjera kompetente kanë fuqinë për të imponuar dënime të tilla. Dënimet e parashikuara do të jenë të përshtatshme, efektive, proporcionale dhe shmangëse.</p> | | <p>Neni 183</p> <p>Neni 184</p> | <p style="text-align: center;">Neni 183</p> <p style="text-align: center;">Kundravajtjet administrative</p> <p>1. Kur nga procedura e inspektimit, konstatohet se një sipërmarrës që operon në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur përcaktimet ligjore, inspektorët e autorizuar të AKEP-it, marrin një nga masat administrative të mëposhtme:</p> <p>a) Në rast konstatimi të shkeljeve të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundravajtje administrative, por që rrethanat, rëndësia dhe pasojat, justifikojnë lehtësimin e dënimit, sipërmarrësit apo subjektit të inspektimit, i jepet masa administrative "Paralajmërim". Masa administrative e paralajmërimit përbën dënim kryesor.</p> <p>b) Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore sipas parashikimeve në paragrafët 1.III dhe 1.IV të nenit 184, të këtij ligji, inspektori merr masë administrative me gjobë.</p> | F |

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | <p>2. Shtetet Anëtare parashikojnë dënime në kontekstin e procedurës së përmendur në nenin 22 (3), vetëm kur një sipërmarrje ose autoritet publik me vetëdije ose nga pakujdesia siguron informacion mashtrues, të gabuar ose jo të plotë.</p> <p>Me rastin e përcaktimit të masës së gjobave ose dënimeve periodike të imponuara ndaj një ndërmarrjeje ose autoriteti publik për dhënien me vetëdije ose nga pakujdesia të informacionit mashtrues, të gabuar ose jo të plotë, në kontekstin e procedurës së përmendur në nenin 22 (3), do të merret parasysh nëse sjellja e sipërmarrjes ose autoritetit publik ka pasur një ndikim negativ në konkurrencë dhe veçanërisht nëse në kundërshtim me informacionin e dhënë fillimisht ose çdo përditësim, ndërmarrja ose autoriteti publik ose ka vendosur për të zgjeruar dhe përmirësuar një rrjet, ose nuk ka vendosur një rrjet dhe nuk ka arritur të sigurojë një arsytim objektiv për atë ndryshim të planit.</p> | | | <p>c) Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore sipas parashikimeve në paragrafët 1.I dhe 1.II të nenit 184, të këtij ligji, inspektori i propozon Këshillit Drejtues të AKEP-it, marrjen e masës administrative me gjobë.</p> <p>2. Në rast konstatimi të shkeljeve që parashikohen nga paragrafi 1.I, i neni 184 të këtij ligji, kur vlerësohet se dënimi me gjobë është i pamjaftueshëm pasi rrethanat, rëndësia apo pasojat e shkeljes/ve konsiderohen të tilla, sa të krijojnë pamundësinë për përmbushjen e objektivave të këtij ligji, inspektori i propozon Këshillit Drejtues të AKEP-it që ndaj sipërmarrësit, të vendoset edhe revokimi i:</p> <p>a) të drejtës së përdorimit të një ose më shumë frekuencave ose numeracioni; ose</p> <p>b) të drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.</p> <p>3. Këshilli Drejtues i AKEP-it shprehet me vendim mbi propozimet e inspektorëve, pasi të ketë garantuar të drejtën e sipërmarrësit për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime. Këshilli Drejtues i AKEP-it, përcakton me akt rregullator procedurën e detajuar mbi procesin e vendimmarrjes ndaj ankimit të masës administrative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 184 Masat e gjobave</p> <p>1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:</p> <p>I. Deri në vlerën e 3 për qind të të ardhurave vjetore të realizuara në vitin e fundit financiar të mbylltur, nëse sipërmarrësi:</p> <p>i) nuk njofton AKEP-in përpara fillimit të ndërtimit dhe përdorimit të rrjeteve apo shërbimeve publike të komunikimit, sipas nenit 27, të këtij ligji;</p> <p>ii) nuk krijon një person juridik të veçantë ose nuk mban llogari të veçanta financiare të të ardhurave, nëse përdor rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për përdorim vetjak, për ofrimin e shërbimeve të komunikimit publik, sipas nenit 36, të këtij ligji;</p> <p>iii) nuk ofron shërbim universal, sipas nenit 112, e vijues të këtij ligji;</p> <p>iv) nuk zbaton vendimet e AKEP-it lidhur me detyrimet e përcaktuara në nenet 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, të këtij ligji;</p> <p>v) përdor frekuenca pa marrë autorizim nga AKEP, sipas nenit 66 dhe 68 të këtij ligji;</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>vi) përdor numeracionin pa të drejtë përdorimi nga AKEP, sipas nenit 131 dhe 132 të këtij ligji;</p> <p>vii) nuk mban dokumentacion të plotë dhe të saktë për rrjetin sipas nenit 169, të këtij ligji;</p> <p>viii) nuk siguron konfidencialitetin sipas nenit 157, të këtij ligji;</p> <p>ix) nuk përmbush detyrimin ligjor për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllimin e ndjekjes penale sipas nenit 156, të këtij ligji;</p> <p>x) pengon hyrjen e inspektorëve të AKEP-it në ambientet ku janë instaluar pajisjet e komunikimit dhe pajisjet teknike ose nuk dorëzon të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët, sipas nenit 181, të këtij ligji;</p> <p>xi) nuk përmbush detyrimet për përgjimin e ligjshëm të komunikimeve sipas nenit 168, të këtij ligji;</p> <p>xii) nuk marrin masat e duhura teknike, organizative dhe proporcionale për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet që vijnë për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, sipas përcaktimeve të nenit 54, të këtij ligji;</p> <p>II. Deri në vlerën e 2 për qind të të ardhurave vjetore të realizuara në vitin e fundit financiar të mbyllur, nëse sipërmarrësi:</p> <p>i) dështon në ndërtimin dhe vendosjen e rrjeteve publike të komunikimit dhe objekteve shtesë, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre sipas nenit 58, të këtij ligji;</p> <p>ii) nuk zbaton rregullat e AKEP-it, për ndarjen e kostove të bashkëpërdorimit të faciliteteve të rrjetit ose pronës dhe të koordinimit të punëve civile sipas paragrafit 3, të nenit 58, të këtij ligji;</p> <p>iii) nuk respekton kërkesat sipas nenit 113, të këtij ligji;</p> <p>iv) nuk përmbushin detyrimin për financimin e shërbimit universal brenda intervalit dhe në masën e përcaktuar nga AKEP, sipas nenit 128, të këtij ligji;</p> <p>v) nuk paraqet në AKEP informacionin për të ardhurat vjetore sipas paragrafit 5, të nenit 128, të këtij ligji;</p> <p>vi) nuk përmbush detyrimet e përcaktuara sipas neneve 80, 81 dhe 82, 83, 84, 85, 86 të këtij ligji;</p> <p>vii) transferon ose jep me qira të drejtën e radio-frekuencave, pa pëlqimin paraprak të AKEP-it sipas nenit 71, të këtij ligji;</p> <p>viii) nuk përmbush detyrimet e vendosura për portabilitetin e numrave sipas nenit 145, të këtij ligji;</p> <p>ix) nuk publikon informacion transparent mbi tarifën e aplikueshme dhe mbi kushtet e përgjithshme të aksesit dhe përdorimit të shërbimeve publike të komunikimit;</p> <p>x) nuk informon përdoruesit dhe AKEP-in, për kufizimin ose përfundimin e aksesit në shërbimet e tyre;</p> <p>xi) kufizon aksesin në shërbimet e tij, shkëput përdoruesit fundorë ose përfundon një kontratë me përdoruesin fundor, në kundërshtim me dispozitat e kontratës së përdoruesit fundor dhe këtë ligj;</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>xii) prezanton masa diskriminuuese dhe disproporcionale;</p> <p>xiii) nuk informon me shkrim përdoruesin fundor për shkeljet e bëra dhe nuk cakton një afat kohor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;</p> <p>xiv) nuk miraton dhe nuk paraqet në AKEP një plan masash për situata të jashtëzakonshme;</p> <p>xv) nuk siguron akses të pandërprerë në numrat e thirrjeve të urgjencës, me masat e planit të masave;</p> <p>xvi) merr për vete ose për një palë tjetër informacion mbi përmbajtjen, faktet dhe rrethanat e mesazheve të transmetuara, në tejkallim të masës minimale të nevojshme thelbësore për ofrimin e shërbimeve elektronike specifike, ose nuk e përdor këtë informacion vetëm për ofrimin e këtyre shërbimeve dhe në përputhje me ndërmarrjen kontraktuale në lidhje me to;</p> <p>xvii) nuk i informon përdoruesit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qëllimin dhe përdorimin e të dhënave, ose nuk ofron një mundësi për të hedhur poshtë përpunimin e tillë të të dhënave, ose nuk arrin të marrë pëlqimin e një përdoruesi përpara përpunimit të të dhënave;</p> <p>xviii) dështon të fshijë të dhënat e trafikut ose t'i bëjë ato të paidentifikueshme, sipas nenit 163, të këtij Ligji;</p> <p>xix) përpunon të dhënat e trafikut pa pëlqimin paraprak të përdoruesit ose të përdoruesit përfundimtar;</p> <p>xx) lejon që të dhënat e trafikut të përpunohen nga persona që nuk janë të autorizuar për ta bërë këtë;</p> <p>xxi) dështon të përpunojë të dhënat e vendndodhjes;</p> <p>xxii) lejon që të dhënat e vendndodhjes të përpunohen nga persona që nuk janë të autorizuar për ta bërë këtë;</p> <p>xxiii) nuk vepron në përputhje me kërkesat e nenit 127, të këtij ligji, për komunikimet e pa kërkuara.</p> <p>III. Në masën 1 000 000 (një milion) lekë, nëse sipërmarrësi:</p> <p>i) nuk vepron në përputhje me kërkesat për miratimin dhe alokimin e radio-frekuencave;</p> <p>ii) nuk vepron në përputhje me vendimin për caktimin e numrave dhe serive të numrave;</p> <p>iii) nuk planifikon rrjetet publike të komunikimit, në një mënyrë të tillë që të krijojnë sa më pak rreziqe dhe shqetësime të pronës private;</p> <p>iv) nuk informon paraprakisht autoritetet përkatëse përpara fillimit të punimeve;</p> <p>v) kontrata e përdoruesit fundor nuk përmban të gjithë kërkesat e përcaktuara sipas nenit 141, të këtij ligji;</p> <p>vi) nuk informon përdoruesit e tij fundorë për ndryshimet në kushtet e kontratës së përdoruesit fundor sipas nenit 144, të këtij ligji;</p> <p>vii) nuk vë në dispozicion një nivel faturimi të detajuar, që mundëson kontrollin e shpenzimeve sipas nenit 117, të këtij ligji;</p> <p>viii) nuk ofron faturën e detajuar me të dhënat e kërkuara sipas nenit 161, të këtij ligji;</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|--------|---|--|---------|---|---|--|
| | | | | <p>ix) nuk siguron identifikimin e numrit të thirrur, si dhe parandalimin e tyre sipas nenit 162, të këtij ligji;</p> <p>x) në kushtet e përgjithshme të kontratës me përdoruesin fundor, nuk saktëson mundësinë e sigurimit të identifikimit të linjës së thirrur, si dhe parandalimin e saj sipas pikës 8 të nenit 162, të këtij ligji;</p> <p>xi) nuk u ofron përdoruesve fundorë ose përdoruesve, mundësinë e refuzimit të përpunimit të të dhënave të vendndodhjes sipas pikes 4 të nenit 163, të këtij ligji;</p> <p>xii) nuk paguan pagesën e plotë për mbikëqyrjen e tregut, brenda periudhës kohore të përcaktuar në nenin 20, të këtij Ligji;</p> <p>xiii) nuk paguan plotësisht pagesën për përdorimin e radio-frekuencave sipas nenit 21, të këtij ligji;</p> <p>xiv) nuk paguan plotësisht pagesën për përdorimin e numrave dhe serive të numrave të alokuar brenda afatit sipas nenit 22, të këtij ligji.</p> <p>xv) nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, për kryerjen e vrojtimit gjeografik;</p> <p>IV. Në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose dënim administrativ, paralajmërim për çdo shkelje tjetër të kryer nga sipërmarrësi që nuk përcaktohet në pikat e mësipërme.</p> <p>2. AKEP në përcaktimin e masës së gjobave merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:</p> <p>i) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;</p> <p>ii) rrethanat në të cilat është kryer shkelja;</p> <p>iii) nëse sipërmarrësi në shkelje ka një histori të shkeljeve të detyrimeve;</p> <p>iv) pasojat që kanë ardhur nga shkelja e konstatuar.</p> <p>3. Gjoha është titull ekzekutiv dhe derdhet në buxhetin e shtetit. Në rast se gjoha e vendosur paguhet nga subjekti përgjegjës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit përkatës të AKEP-it, masa e gjobës ulet automatikisht në 15% të shumës së vendosur.</p> <p>4. AKEP-i përcakton me akt rregullator kriteret dhe metodologjinë e përlllogaritjes së nivelit të gjobave, si dhe procedurën e veprimtarisë inspektuese në zbatim të këtij ligji dhe ligjit procedural kombëtar.</p> | | |
| Neni30 | <p style="text-align: center;">Neni 30</p> <p>Pajtueshmëria me kushtet e autorizimit të përgjithshëm ose të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, për burimet e numeracionit dhe pajtueshmëria me detyrimet specifike.</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet e tyre përkatëse kompetente të monitorojnë dhe mbikëqyrin respektimin e kushteve të autorizimit të përgjithshëm ose të të drejtave të përdorimit për spektrin radio dhe për burimet e numeracionit, me detyrimet specifike të përmendura në nenin 13 (2) dhe me</p> | | Neni 18 | <p style="text-align: center;">KREU XXIII</p> <p style="text-align: center;">INSPEKTIMI, MONITORIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE DHE KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 181</p> <p style="text-align: center;">Inspektimi</p> <p>1. Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon</p> | F | |

| | | | |
|--|--|---|--|
| <p>detyrimin për të përdorur spektrin e radios në mënyrë efektive dhe efikase në përputhje me nenin 4, nenin 45 (1) dhe nenin 47.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Autoritetet kompetente kanë fuqinë të kërkojnë sipërmarrje që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm ose përdorimit të të drejtave për të përdorur spektrin radio dhe për burimet e numeracionit për të siguruar të gjitha informacionet e nevojshme, për të verifikuar pajtueshmërinë me kushtet e autorizimit të përgjithshëm ose të drejtat e përdorimit të spektrit radio dhe për burimet e numeracionit, qoftë me detyrimet specifike të përmendura në nenin 13 (2) ose nenin 47, në përputhje me nenin 21. <p>2. Kur një autoritet kompetent konstaton se një sipërmarrje nuk i përmbahet një ose më shumë kushteve të autorizimit të përgjithshëm ose të të drejtave të përdorimit për spektrin radio dhe për burimet e numeracionit, ose me detyrimet specifike të përmendura në nenin 13 (2), ai njofton sipërmarrjen për ato gjetje dhe i jep mundësinë sipërmarrjes që të shprehë pikëpamjet e saj, brenda një afati të arsyeshëm kohor.</p> <p>3. Autoriteti kompetent ka fuqinë të kërkojë ndërprerjen e shkeljes së përmendur në paragrafin 2, menjëherë ose brenda një afati të arsyeshëm dhe do të marrë masa të përshtatshme dhe proporcionale me qëllim sigurimin e pajtueshmërisë.</p> <p>Në këtë drejtim, Shtetet Anëtare do t'u japin fuqi autoriteteve kompetente të imponojnë:</p> <p>(a) kur është e përshtatshme, ndëshkimet financiare shpërndarëse që mund të përfshijnë dënime periodike me efekt prapaveprues; dhe</p> <p>(b) urdhërat për të ndaluar ose vonuar ofrimin e një shërbimi ose një paketë shërbimesh, të cilat nëse vazhdojnë do të rezultojnë në një dëm të konsiderueshëm të konkurrencës, në pritje të respektimit të detyrimeve të hyrjes të vendosura pas një analize të tregut të kryer në përputhje me nenin 67.</p> <p>Autoritetet kompetente do të komunikojnë masat dhe arsyet mbi të cilat bazohen në ndërmarrjen në fjalë pa vonesë dhe do të përcaktojnë një periudhë të arsyeshme që ndërmarrja të zbatohet masat.</p> <p>4. Pavarësisht nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Shtetet Anëtare do të fuqizojnë autoritetin kompetent të vendosë kur është e përshtatshme, ndëshkime financiare për sipërmarrjet për mosdhënien e informacionit, në përputhje me detyrimet e vendosura në pikën (a) ose (b) të nënparagrafi i parë i nenit 21 (1) dhe nenit 69, brenda një periudhe të arsyeshme të caktuar nga autoriteti kompetent.</p> <p>5. Në rastin e një shkelje serioze ose shkelje të përsëritur të kushteve të autorizimit të përgjithshëm ose të të drejtave të përdorimit për spektrin radio dhe për burimet e numeracionit, ose të detyrimeve specifike të përmendura në nenin 13 (2) ose nenin 47 (1) ose (2), kur masat që synojnë garantimin e pajtueshmërisë siç përmenden në paragrafin 3 të këtij neni kanë dështuar, Shtetet Anëtare do të fuqizojnë autoritetet kompetente të parandalojnë një</p> | | <p>veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, kryhet nga inspektorët e AKEP-it.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Inspektorët e AKEP-it, pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset ku sipërmarrësi zhvillon veprimtarinë edhe pa e njoftuar atë paraprakisht, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave përkatëse të nxjerra në zbatim të tij. 3. Sipërmarrësi ose çdo person tjetër, fizik ose juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, është i detyruar t'i lejojë inspektorët të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t'u ofrojë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre. 4. Veprimtaria inspektuese e AKEP-it, ushtrohet në përputhje me Rregulloren përkatëse të miratuar nga Këshilli Drejtues. 5. Kur nevojitet ekspertizë e veçantë, inspektori mund të kërkojë ekspert. | |
|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|---------------|--|--|--|---|--|--|
| | <p>sipërmarrje të vazhdojë të sigurojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike ose të pezullojë dhe tërheqë ato të drejta të përdorimit. Shtetet Anëtare do të fuqizojnë autoritetin kompetent për të vendosur dënime të cilat janë efektive, proporcionale dhe dekuaruese. Dënime të tilla mund të zbatohen për të mbuluar periudhën e ndonjë shkeljeje, edhe nëse kjo shkelje më pas është korrigjuar.</p> <p>6. Pavarësisht nga paragrafët 2, 3 dhe 5 të këtij neni, autoriteti kompetent mund të marrë masa urgjente të përkohshme për të korrigjuar situatën përpara se të marrë një vendim të formës së prerë, kur ka prova për shkelje të kushteve të autorizimit të përgjithshëm, të drejtat e përdorimit për spektrin e radios dhe për burimet e numeracionit, ose të detyrimeve specifike të përmendura në nenin 13 (2) ose nenin 47 (1) ose (2), i cili paraqet një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz për sigurinë publike dhe shëndetin publik, rrezikon të krijojë probleme serioze ekonomike ose operacionale për ofruesit e tjerë dhe përdoruesit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe përdoruesve të tjerë të spektrit të radios. Autoriteti kompetent do t'i japë ndërmarrjes në fjalë një mundësi të arsyeshme të shprehë pikëpamjet e saj dhe të propozojë çdo mjet juridik. Kur është e përshtatshme, autoriteti kompetent mund të konfirmojë masat e përkohshme, të cilat do të jenë të vlefshme maksimumi për tre muaj, por në rrethana kur procedurat përmbartimore nuk kanë përfunduar, mund të zgjaten për një periudhë të mëtejshme deri në tre muaj.</p> <p>7. Ndërmarrjet kanë të drejtë të apelojnë kundër masave të marra në bazë të këtij neni në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 31.</p> | | | | | |
| Neni31 | <p style="text-align: center;">Neni 31 E drejta e apelit</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ekzistojnë mekanizma efektivë në nivelin kombëtar, nën të cilin çdo përdorues ose ndërmarrje që siguron rrjete ose shërbime të komunikimit elektronik ose facilitete shoqëruese, që preken nga një vendim i një autoriteti kompetent, ka të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi në një organ apelimi, kjo është e pavarur nga palët e përfshira dhe nga çdo ndërhyrje e jashtme ose presion politik që mund të rrezikojë vlerësimin e tij të pavarur për çështjet që vijnë përpara tij. Ky organ i cili mund të jetë gjykatë, do të ketë ekspertizën e duhur për t'i mundësuar që të kryejë funksionet e tij në mënyrë efektive. Shtetet Anëtare sigurojnë që meritat e çështjes të merren parasysh siç duhet.</p> <p>Në pritje të rezultatit të ankimit, vendimi i autoritetit kompetent qëndron, përveç nëse masat e përkohshme nuk janë dhënë në përputhje me ligjin kombëtar.</p> <p>2. Kur organi i ankimit nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk është me karakter gjyqësor, ai gjithmonë jep arsyet me shkrim për vendimin e tij. Për më tepër, në një rast të tillë, vendimi i tij do t'i nënshtrohet rishikimit nga një gjykatë në kuptimin e nenit 267</p> | <p>Pika 8, neni 13</p> <p>Neni 185</p> | <p style="text-align: center;">Neni 13 Pavaresia e AKEP</p> <p>8. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, mund të ankimohen në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 185 Ankimi</p> <p>1. Kundër gjobës së vendosur nga inspektorët sipas nenit 184, të këtij ligji, bëhet ankimi në Këshillin Drejtues të AKEP-it, brenda 30 ditëve nga data e dhënies së saj. Këshilli Drejtues merr vendim brenda 30 ditëve nga data e ankimit. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ nga Këshilli Drejtues, përcaktohet në Rregulloren përkatëse të AKEP.</p> <p>2. Kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP mund të bëhet ankimi, brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit, në gjykatën administrative të shkallës së parë.</p> | F | | |

| | | | | | | |
|--------|---|--|--|----------------|---|------------------------------------|
| | <p>TFEU.Shtetet Anëtare sigurojnë që mekanizmi i apelimit të jetë efektiv.</p> <p>3. Shtetet Anëtare mbledhin informacione mbi temën e përgjithshme të ankesave, numrin e kërkesave për ankesë, kohëzgjatjen e procedurave të ankimit dhe numrin e vendimeve për dhënien e masave të përkohshme. Shtetet Anëtare do t'i japin Komisionit dhe BEREC informacionin, si dhe vendimet ose gjykimet, me kërkesën e tyre të arsyeshme.</p> | | | | | |
| Neni32 | <p style="text-align: center;">TITLE IV</p> <p style="text-align: center;">PROCEDURAT E TREGUT TË BRENDSHËM</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI I</p> <p style="text-align: center;">Neni 32</p> <p style="text-align: center;">Konsolidimi i tregut të brendshëm të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj direktive, autoritetet kombëtare rregullatore marrin parasysh maksimumin e objektivave të përcaktuara në nenin 3.</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare kontribuojnë në zhvillimin e tregut të brendshëm duke punuar me njëri-tjetrin, me Komisionin dhe BEREC, në mënyrë transparente, dhe që të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm në të gjitha Shtetet Anëtare, të kësaj direktive. Për këtë qëllim ata do të punojnë, veçanërisht me Komisionin dhe BEREC për të identifikuar llojet e instrumenteve dhe mjeteve juridike më të përshtatshme për të adresuar lloje të veçanta të situatave në treg.</p> <p>3. Përveç kur parashikohet ndryshe në rekomandime ose udhëzime të miratuara në bazë të nenit 34 pas përfundimit të konsultimit publik, nëse kërkohet sipas nenit 23 ku autoriteti kombëtar rregullator synon të marrë një masë e cila:</p> <p>(a) bën pjesë në fushën e nenit 61, 64, 67, 68 ose 83; dhe</p> <p>(b) do të ndikonte tregtinë midis Shteteve Anëtare, Do të publikojë draft masën dhe do t'i komunikojë Komisionit, BEREC dhe autoriteteve rregullatore kombëtare në shtetet e tjera anëtare në të njëjtën kohë duke shprehur arsyet e masës, në përputhje me nenin 20 (3). Autoritetet rregullatore kombëtare, BEREC dhe Komisioni mund të komentojnë draft masënbrenda një muaji. Periudha një mujore nuk do të zgjatet.</p> <p>4. Drafti i masës nga paragrafi 3 i këtij neni nuk do të miratohet për dy muaj të tjerë, kur kjo masë synon:</p> <p>(a) të përcaktojë një treg përkatës që është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në rekomandimin e përmendur në nenin 64 (1); dhe</p> | | | E pazbatueshme | N | Ne adrese te vendeve anetare te BE |

| | | | | |
|---|--|--|--|--|
| <p>(b) të caktojë një sipërmarrje, që ka individualisht ose së bashku me të tjerët, fuqi të ndjeshme të tregut, sipas nenit 67 (3) ose (4);</p> <p>dhe kjo do të ndikonte në tregtinë midis Shteteve Anëtare, dhe Komisioni i ka treguar autoriteteve rregullatore kombëtare që konsideron se draft masa do të krijonte një pengesë për tregun e brendshëm ose nëse ka dyshime serioze në lidhje me pajtueshmërinë e tij me ligjin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti objektivat e përmendura në nenin 3. Kjo periudhë dy-mujore nuk do të zgjatet. Komisioni do të informojë BEREC dhe autoritetet rregullatore kombëtare për rezervat e tij në një rast të tillë dhe njëkohësisht t'i bëjë ato publike.</p> <p>5. BEREC publikon një mendim për rezervimet e Komisionit të përmendura në paragrafin 4, duke treguar nëse ai konsideron se draft masa duhet të ruhet, ndryshohet ose tërhiqet, dhe kur është e përshtatshme do të sigurojë propozime specifike për këtë qëllim.</p> <p>6. Brenda periudhës dy-mujore të përmendur në paragrafin 4, Komisioni mund të:</p> <p>(a) marrë një vendim që kërkon nga autoriteti kombëtar rregullator i interesuar të tërheqë draft masën;</p> <p>ose</p> <p>(b) të marrë një vendim për të hequr rezervat e saj të përmendura në paragrafin 4.</p> <p>Komisioni do të marrë parasysh maksimumin e mendimit të BEREC para se të marrë një vendim.</p> <p>Vendimet e përmendura në pikën (a) të nënparagrafit të parë, shoqërohen me një analizë të detajuar dhe objektive se pse Komisioni konsideron se draft masa nuk duhet të miratohet, së bashku me propozime specifike për ndryshimin e tij.</p> <p>7. Kur Komisioni ka miratuar një vendim në përputhje me pikën (a) të nënparagrafit të parë të paragrafit 6 të këtij neni, që kërkon nga autoriteti rregullator kombëtar të tërheqë draft masën, autoriteti rregullator kombëtar ndryshon ose tërheq draft masën brenda gjashtë muaj nga data e vendimit të Komisionit. Kur draft masa është ndryshuar, autoriteti rregullator kombëtar do të ndërmarrë një konsultë publike në përputhje me nenin 23, dhe do t'i njoftojë draft masën e ndryshuar Komisionit në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.</p> <p>8. Autoriteti rregullator kombëtar në fjalë do të marrë parasysh maksimumin e komenteve të autoriteteve të tjera rregullatore kombëtare, të BEREC dhe Komisionit, përveç në rastet e përfshira në paragrafin 4 dhe pikën (a) të paragrafit 6, të miratojë draft masën që rezulton dhe kur e bën këtë ia komunikon Komisionit.</p> <p>9. Autoriteti rregullator kombëtar do t'i komunikojë Komisionit dhe BEREC të gjitha masat e miratuara përfundimtare, të cilat përfshihen në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 3.</p> <p>10. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur një autoritet kombëtar rregullator konsideron se ka nevojë urgjente për të</p> | | | | |
|---|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|--|--|--|----------------|---|------------------------------------|
| | <p>vepruar në mënyrë që të mbrojë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e përdoruesve, me anë të shmangies nga procedura e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4, mund të miratojë menjëherë masa proporcionale dhe të përkohshme. Ai pa vonesë, do t'ia komunikojë ato masa, me arsye të plota Komisionit, autoriteteve të tjera rregullatore kombëtare dhe BEREC. Një vendim i autoritetit rregullator kombëtar për t'i dhënë këto masa të përhershme ose për të zgjatur periudhën për të cilën ato janë të zbatueshme do t'i nënshtrohen paragrafëve 3 dhe 4.</p> <p>11. Një autoritet kombëtar rregullator mund të tërheqidraft masën në çdo kohë.</p> | | | | | |
| Neni33 | <p style="text-align: center;">Neni 33</p> <p style="text-align: center;">Procedura për zbatimin e vazhdueshëm të mjeteve juridike</p> <p>1. Kur një masë e parashikuar e përfshirë nga neni 32 (3) synon të imponojë, ndryshojë ose tërheqë një detyrim ndaj një sipërmarrje në zbatim të nenit 61 ose 67 në lidhje me nenet 69 deri 76 dhe nenin 83, Komisioni brenda një periudhe një mujore të përmendur në nenin 32 (3), njofton autoritetin rregullator kombëtar në fjalë dhe BEREC për arsyet e tij, për të konsideruar se draft masa do të krijonte një pengesë për tregun e brendshëm ose për dyshimet e tij serioze në lidhje me pajtueshmërinë e tij me ligjin e Bashkimit Evropian. Në një rast të tillë, draft masa nuk do të miratohet për tre muaj të tjerë pas njoftimit të Komisionit. Në mungesë të një njoftimi të tillë, autoriteti rregullator kombëtar në fjalë mund të miratojë draft masën, duke marrë parasysh maksimumin e komenteve të bëra nga Komisioni, BEREC ose ndonjë autoritet tjetër rregullator kombëtar.</p> <p>2. Brenda periudhës tre-mujore të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Komisioni, BEREC dhe autoriteti rregullator kombëtar në fjalë, bashkëpunojnë ngushtë për të identifikuar masën më të përshtatshme dhe efektive në dritën e objektivave të përcaktuara në nenin 3, duke marrë parasysh pikëpamjet e pjesëmarrësve në treg dhe nevojën për të siguruar zhvillimin e praktikës rregullative të qëndrueshme.</p> <p>3. Brenda gjashtë javëve nga fillimi i periudhës tre-mujore të përmendur në paragrafin 1, BEREC lëshon një mendim mbi njoftimin e Komisionit të përmendur në paragrafin 1, duke treguar nëse ai konsideron se draft masa duhet të ndryshohet ose tërhiqet dhe aty ku është e përshtatshme të sigurojë propozime specifike për këtë qëllim. Ky mendim do të sigurojë arsyet dhe do të bëhet publik.</p> <p>4. Nëse sipas mendimit të tij, BEREC ndan dyshimet serioze të Komisionit, ai do të bashkëpunojë ngushtë me autoritetin rregullator kombëtar në fjalë, për të identifikuar masën më të përshtatshme dhe efektive. Para përfundimit të periudhës tre-mujore të përmendur në paragrafin 1, autoriteti rregullator kombëtar mund të:</p> | | | E pazbatueshme | N | Ne adrese te vendeve anetare te BE |

| | | | | | | |
|----------------------|--|--|--|-----------------------|----------|---|
| | <p>(a) ndryshojë ose tërheqë draft masëne tij duke marrë parasysh maksimumin e njoftimit të Komisionit të përmendur në paragrafin 1 dhe mendimit të BEREC; ose</p> <p>(b) mirëmbajë draft masën e tij.</p> <p>5. Komisioni mundet, brenda një muaji pas përfundimit të periudhës tre-mujore të përmendur në paragrafin 1 dhe duke marrë parasysh llogarinë maksimale të mendimit të BEREC, nëse ka:</p> <p>(a) të lëshojë një rekomandim që kërkon nga autoriteti kombëtar rregullator i interesuar të ndryshojë ose tërheqë draft masën, duke përfshirë propozime specifike për këtë qëllim dhe duke dhënë arsye për rekomandimin e tij, veçanërisht kur BEREC nuk ka dyshimet serioze të Komisionit;</p> <p>(b) të marrë një vendim për të hequr rezervat e tij të treguara në përputhje me paragrafin 1; ose</p> <p>(c) për draft masat që janë nën nënparagrafin e dytë të nenit 61 (3) ose nën nenin 76 (2), të marrë një vendim që kërkon nga autoriteti rregullator kombëtar i interesuar të tërheqë draft masat, ku BEREC ndan dyshimet serioze të Komisionit, shoqëruar nga një analizë e hollësishme dhe objektive se pse Komisioni konsideron se draft masa nuk duhet të miratohet së bashku me propozime specifike për ndryshimin e draft masës, në varësi të procedurës së përmendur në nenin 32 (7), e cila do të aplikohet pa prekur thelbin (mutatis mutandis).</p> <p>6. Brenda një muaji nga lëshimi i rekomandimit nga Komisioni, në përputhje me pikën (a) të paragrafit 5 ose heqjen e rezervave të tij në përputhje me pikën (b) të paragrafit 5, autoriteti rregullator kombëtar në fjalë i komunikon Komisionit dhe BEREC masën përfundimtare të miratuar.</p> <p>Kjo periudhë mund të zgjatet për të lejuar autoritetin rregullator kombëtar të ndërmarrë një konsultë publike në përputhje me nenin 23.</p> <p>7. Kur autoriteti rregullator kombëtar vendos të mos ndryshojë ose tërheqë draft masën në bazë të rekomandimit të lëshuar në pikën (a) të paragrafit 5, ai jep arsyet.</p> <p>8. Autoriteti rregullator kombëtar mund të tërheqë draft masën e propozuar në çdo fazë të procedurës.</p> | | | | | |
| <p>Neni34</p> | <p style="text-align: center;">Neni 34 Dispozitat zbatuese</p> <p>Pas konsultimit publik dhe pas konsultimit me autoritetet rregullatore kombëtare dhe duke marrë parasysh maksimumin e mendimit të BEREC, Komisioni mund të miratojë rekomandime ose udhëzime në lidhje me nenin 32 që përcaktojnë formën, përmbajtjen dhe nivelin e detajeve që duhen dhënë në njoftimet e kërkuara në përputhje me nenin 32 (3), rrethanat në të cilat njoftimet nuk do të kërkoreshin, dhe llogaritja e afateve.</p> | | | <p>E pazbatueshme</p> | <p>N</p> | <p>Ne adrese te vendeve anetare te BE</p> |

| | | | | | |
|--------|---|--------|--|---|------------------------------------|
| Neni35 | <p style="text-align: center;">PJESA I – TITULLI IV KAPITULLI II Detyrë konsistente e spektrit të radios</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 Procesi i peer review</p> <p>1. Kur autoriteti kombëtar rregullator ose një autoritet tjetër kompetent synon të ndërmarrë një procedurë të përzgjedhjes në përputhje me nenin 55 (2), në lidhje me spektrin e radios, për të cilin kushtet e harmonizuara janë caktuar nga masat teknike të zbatimit, në përputhje me vendimin nr. 676/2002/EC, në mënyrë që të mundësojë përdorimin e tij për rrjetet dhe shërbimet broadband wireless, ai në përputhje me nenin 23, do të informojë RSPG për masën e draftit që është brenda fushës së procedurës së përzgjedhjes krahasuese ose konkurruese, në përputhje me nenin 55 (2) dhe të tregojë kur do të kërkojë që RSPG të mbledhë një Forum peer review.</p> <p>Kur të kërkohet ta bëjë këtë, RSPG do të organizojë një Forum Shqyrtues për të diskutuar dhe shkëmbyer mendime mbi draft masat të transmetuara dhe do të lehtësojë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira për atodraft masa.</p> <p>Forumi i peer review do të përbëhet nga anëtarët e RSPG të organizuar dhe kryesuar nga një përfaqësues i RSPG.</p> <p>2. Më së voni gjatë konsultimit publik të kryer në bazë të nenit 23, RSPG mund të ndërmarrë në mënyrë të jashtëzakonshme iniciativën për të thirrur një Forum të peer review, në përputhje me rregullat e procedurës për organizimin e tij, në mënyrë që të shkëmbehen përvoja dhe praktikat më të mira në një draft masë në lidhje me një procedurë përzgjedhjeje kur konsideron se draft masa do të paragjykojë në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e rregullatorit kombëtar ose autoritetit tjetër kompetent për të arritur objektivat e përcaktuara në nenet 3, 45, 46 dhe 47.</p> <p>3. RSPG do të përcaktojë paraprakisht dhe do të bëjë publike kriteret objektive për mbledhjen e jashtëzakonshme të Forumit peer review.</p> <p>4. Gjatë Forumit peer review, autoriteti rregullator kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent duhet të sigurojë një shpjegim se si draft masa:</p> <p>(a) promovon zhvillimin e tregut të brendshëm, ofrimin e shërbimeve ndërkufitare, si dhe konkurrencën, dhe maksimizon përfitimet për konsumatorin, dhe në përgjithësi arrin objektivat e përcaktuara në nenet 3, 45, 46 dhe 47 të kësaj direktive. , si dhe në Vendimet Nr. 676/2002 / KE dhe Nr. 243/2012 / BE;</p> <p>(b) siguron përdorim efektiv dhe efikas të spektrit të radios;</p> <p>dhe</p> | Neni45 | <p style="text-align: center;">KREU V CAKTIMI I HARMONIZUAR I SPEKTRIT RADIO</p> <p style="text-align: center;">Neni 50 Njoftimi në RSPG</p> <p>1. Kur AKEP-i ndërmer një procedurë përzgjedhjeje në përputhje me nenin 75, të këtij ligji, në lidhje me spektrin e harmonizuar të radios, për të mundësuar përdorimin e tij për rrjetet dhe shërbimet wireless broadband, në zbatim të nenit 44, të këtij ligji, informon RSPG për çdo draft masë që lidhet me procedurën e përzgjedhjes krahasuese ose konkurruese sipas nenit 75, të këtij ligji.</p> <p>2. AKEP-i respekton detyrimet për të koordinuar dhe bashkëpunuar me CEPT, RSPG dhe ITU sipas parashikimeve të këtij ligji.</p> | P | Ne adrese te vendeve anetare te BE |
|--------|---|--------|--|---|------------------------------------|

| | | | | | |
|---------------|---|--|---------|--|---|
| | <p>(c) siguron kushte të qëndrueshme dhe të parashikueshme të investimit për përdoruesit ekzistues dhe të ardhshëm të spektrit të radios kur vendosni rrjete për ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik, të cilat mbështeten në spektrin e radios.</p> <p>5. Forumi peer review do të jetë i hapur për pjesëmarrje vullnetare nga ekspertë të autoriteteve të tjera kompetente dhe nga BEREK.</p> <p>6. Forumi peer review do të mblidhet vetëm një herë gjatë procesit të përgjithshëm kombëtar të përgatitjes dhe konsultimit të një procedure të vetme të përzgjedhjes në lidhje me një ose disa brezash të spektrit të radios, përveç nëse rregullatori kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent kërkon që ai të ri-rikthehet.</p> <p>7. Me kërkesën e rregullatorit kombëtar ose autoritetit tjetër kompetent që kërkoj takimin, RSPG mund të miratojë një raport mbi atë se si draft masa arrin objektivat e parashikuara në paragrafin 4, duke reflektuar pikëpamjet e shkëmbyera në Forumin e Rishikimit të kolegëve.</p> <p>8. RSPG do të publikojë në shkurt të çdo viti një raport në lidhje me draft masat e diskutuara në përputhje me paragrafët 1 dhe 2. Raporti tregon përvojat dhe praktikatat më të mira të shënuara.</p> <p>9. Pas Forumit peer review, me kërkesë të autoritetit rregullator kombëtar ose autoritetit tjetër kompetent që kërkoj mbledhjen, RSPG mund të miratojë një mendim për projekt-masën.</p> | | | | |
| Neni36 | <p style="text-align: center;">Neni 36 Caktimi i harmonizuar i spektrit të radios</p> <p>Kur përdorimi i spektrit të radios të jetë harmonizuar, kushtet dhe procedurat e aksesit të jenë dakortuesuar, dhe ndërmarrjet për të cilat do të caktohet spektri i radios janë zgjedhur në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe rregullat e Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare do të japin të drejtën e përdorimit për një spektër të tillë radio në përputhje me këto. Në rastin që të gjitha kushtet kombëtare, të bashkangjitura me të drejtën e përdorimit të spektrit të radios në fjalë, të jenë përmbushur në rastin e një procedure të zakonshme të përzgjedhjes, Shtetet Anëtare nuk do të imponojnë kushte të tjera, kritere ose procedura shtesë që mund të kufizojnë, ndryshojnë ose vonojnë zbatimin e saktë të caktimit të përbashkët të një spektri të tillë radio.</p> | | Neni 51 | <p style="text-align: center;">Neni 51 Caktimi i harmonizuar i spektrit të radios</p> <p>1. AKEP, jep të drejtën e përdorimit për spektrin e frekuencave, nëse përdorimi i spektrit të frekuencave është harmonizuar dhe kur është dakordësuar për kushtet e aksesit dhe procedurat, si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe rregullat e Bashkimit Evropian janë përzgjedhur operatorët të cilëve do t'u caktohet spektri i frekuencave.</p> <p>2. Në rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP nuk vendos asnjë kusht, kriter apo procedurë shtesë të mëtejshme që kufizon, ndryshon ose vonon zbatimin e saktë të caktimit të përbashkët të këtij spektri të radiofrekuencave, me kushtin që të gjitha kushtet kombëtare që i bashkëlidhen të drejtës së përdorimit të spektrit radio në fjalë, të jenë plotësuar.</p> | F |

| | | | | | | |
|--------|---|--|--|----------------|---|------------------------------------|
| Neni37 | <p style="text-align: center;">Neni 37 Procesi i përbashkët i autorizimit për të dhënë të drejtat individuale të përdorimit për spektrin radio</p> <p>Dy ose disa shtete anëtare mund të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me RSPG, duke marrë parasysh çdo interes të shprehur nga pjesëmarrësit në treg, duke vendosur bashkërisht për aspektet e përbashkëta të një procesi për autorizim dhe kur është e përshtatshme, gjithashtu duke zhvilluar bashkërisht procesin e përzgjedhjes për të dhënë të drejtat individuale e përdorimit për spektrin radio.</p> <p>Gjatë hartimit të procesit të përbashkët të autorizimit, Shtetet Anëtare mund të marrin parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <p>(a) proceset individuale të autorizimit kombëtar do të inicohen dhe zbatohen nga autoritetet kompetente në përputhje me një agjendë të dakortësuar bashkërisht;</p> <p>(b) do të sigurojë kur është e përshtatshme, për kushtet dhe procedurat e zakonshme për përzgjedhjen dhe dhënien e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e radios midis Shteteve Anëtare në fjalë;</p> <p>(c) do të sigurojë kur është e përshtatshme, për kushte të zakonshme ose të krahasueshme, të cilat do t'i bashkëngjiten të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e radios midis Shteteve Anëtare të interesuara, ndër të tjera, duke lejuar përdoruesit të caktojnë blloqe të ngjashme spektri radio;</p> <p>(d) do të jetë e hapur në çdo kohë për Shtetet e tjera Anëtare derisa të kryhet procesi i autorizimit të përbashkët.</p> <p>Kur përkundër interesit të shprehur nga pjesëmarrësit e tregut, Shtetet Anëtare nuk veprojnë bashkërisht, ata do t'i informojnë ata pjesëmarrës të tregut për arsyet e vendimit të tyre.</p> | | | E pazbatueshme | N | Ne adrese te vendeve anetare te BE |
| Neni38 | <p style="text-align: center;">PJESA I – TITULLI IV KAPITULLI –III Procedurat e harmonizimit</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Procedurat e harmonizimit</p> <p>1. Kur Komisioni konstaton se divergjencat në zbatimin nga ana e autoriteteve rregullatore kombëtare ose autoriteteve të tjera rregullatore kompetente të specifikuar në këtë Direktivë, mund të krijojnë një pengesë për tregun e brendshëm, Komisioni mund të marrë, mendimin e BEREC ose kur është e rëndësishme</p> | | | E pazbatueshme | N | Ne adrese te vendeve anetare te BE |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|
| | <p>RSPG miraton rekomandime ose në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, miraton vendime me anë të akteve zbatuese për të siguruar zbatimin e harmonizuar të kësaj direktive dhe në mënyrë që të çojnë më tej arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 3.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente për kryerjen e detyrave të tyre të marrin parasysh të gjitha rekomandimet e përmendura në paragrafin 1. Kur autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, zgjedhin të mos ndjekin një rekomandim, ai ose ato informojnë Komisionin, duke dhënë arsyet përkatëse për këtë.</p> <p>3. Vendimet e miratuara në bazë të paragrafit 1 përfshijnë vetëm identifikimin e një qasjeje të harmonizuar ose të koordinuar me qëllim të adresimit të çështjeve vijuese:</p> <p>(a) zbatimi në kundërshtim i qasjeve të përgjithshme rregullatore nga autoritetet rregullatore kombëtare, për rregullimin e tregjeve të komunikimeve elektronike në zbatimin e neneve 64 dhe 67, kur krijon një pengesë për tregun e brendshëm; vendime të tilla nuk do t'u referohen njoftimeve specifike të lëshuara nga autoritetet rregullatore kombëtare në përputhje me nenin 32; në të</p> <p>(b)</p> <p>(c) rast të tillë, Komisioni propozon vetëm një projektvendim:</p> <p>i. të paktën dy vjet pas miratimit të një rekomandimi të Komisionit që merret me të njëjtën çështje; dhe</p> <p>ii. duke marrë parasysh opinionin e BEREC, në rastin se një vendim i tillë është marrë nga BEREC brenda tre muajve nga kërkesa e Komisionit;</p> <p>(d) (Numbering) numeracioni, duke përfshirë kufijtë e numrave, Portabilitetin (transportueshmërinë) e numrave dhe identifikuesit, sistemet e përkthimit të numrave dhe adresave dhe aksesin në shërbimet e urgjencës përmes numrit të vetëm evropian të urgjencës '112'.</p> <p>4. Aktet zbatuese nga paragrafi 1 i këtij neni, miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> <p>5. BEREC me iniciativën e vet mund të këshillojë Komisionin nëse duhet të merret një masë në përputhje me paragrafin 1.</p> <p>6. Nëse Komisioni, nuk ka miratuar një rekomandim ose vendim, brenda një viti nga data e miratimit të një mendimi nga BEREC, që tregon se ka mosmarrveshje në zbatim nga ana e autoriteteve rregullatore kombëtare ose autoriteteve të tjera kompetente të detyrave rregullatore të specifikuara në këtë direktivë, gjë që mund të krijojë një pengesë për tregun e brendshëm, do të informojë Parlamentin Evropian dhe Këshillin për arsyet e tij për të mos e bërë këtë, dhe duhet t'i bëjë publike këto arsye.</p> <p>Kur Komisioni ka miratuar një rekomandim në përputhje me paragrafin 1, por zbatimi jo konsistent që krijon pengesa për</p> | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|--------|--|--------------------|---|---|--|
| | <p>tregun e brendshëm vazhdon për dy vjet pas kësaj, Komisioni në bazë të paragrafit 3, do të marrë një vendim me anë të zbatimit të akteve në përputhje me paragrafin 4.</p> <p>Kur Komisioni nuk ka miratuar një vendim brenda një viti tjetër nga çdo rekomandim i miratuar në bazë të nënparagrafit të dytë, ai do të informojë Parlamentin Evropian dhe Këshillin për arsye të tij për të mos e bërë këtë, dhe do t'i bëjë publike këto arsye.</p> | | | | |
| Neni39 | <p style="text-align: center;">Neni 39 Standartizimi</p> <p>1. Komisioni harton dhe boton në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, një listë të standardeve ose specifikimeve jo të detyrueshme, për të shërbyer si bazë për inkurajimin e sigurimit të harmonizuar të rrjeteve të komunikimeve elektronike, shërbimeve të komunikimit elektronik, facilitetet shoqëruese dhe shërbimeve të ofruara. Kur është e nevojshme, Komisioni mundet pas konsultimit me Komitetin e krijuar nga Direktiva (BE) 2015/1535, të kërkojë që standartet të hartohen nga organizatat evropiane të standardizimit (Komiteti Evropian për Standardizim (CEN), Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik (Cenelec), dhe Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI)).</p> <p>2. Shtetet Anëtare inkurajojnë përdorimin e standardeve ose specifikimeve të përmendura në paragrafin 1, për ofrimin e shërbimeve, ndërfaqeve teknike ose funksioneve të rrjetit, në masën që është rreptësisht e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve, lidhja fund në fund, end-to-end connectivity, lehtësimin e kalimit të ofruesit, transportueshmërinë e numrave dhe identifikuesve, dhe për të përmirësuar lirinë e zgjedhjes për përdoruesit.</p> <p>Në mungesë të publikimit të standardeve ose specifikimeve në përputhje me paragrafin 1, Shtetet Anëtare inkurajojnë zbatimin e standardeve ose specifikimeve të miratuara nga organizatat evropiane të standardizimit.</p> <p>Në mungesë të këtyre standardeve ose specifikimeve, Shtetet Anëtare inkurajojnë zbatimin e standardeve ndërkombëtare ose rekomandimeve të miratuara nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), Konferenca Evropiane e Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT), Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) dhe Komisioni Ndërkombëtar i Elektroteknikës (IEC).</p> <p>Kur ekzistojnë standarde ndërkombëtare, Shtetet Anëtare inkurajojnë organizatat evropiane të standardizimit që t'i përdorin ato, ose pjesë përkatëse të tyre, si një bazë për standartet që ata zhvillojnë, përveç rasteve kur standartet e tilla ndërkombëtare ose pjesët përkatëse do të ishin joefektive.</p> <p>Çdo standard ose specifikim i përmendur në paragrafin 1 ose në këtë paragraf, nuk do të parandalojë akasin siç mund të kërkohet sipas kësaj direktive, aty ku është e mundur.</p> | Neni 52 Neni 53 | <p>KREU VII PROCEDURAT E HARMONIZIMIT</p> <p>Neni 52 Rrjetet e Komunikimeve Elektronike Publike</p> <p>Rrjetet publike të komunikimeve elektronike, ndërtohen për të mbështetur shërbimet publike të komunikimeve elektronike dhe funksionojnë si rrjet mbarëkombëtar, në mënyrë të njëjtë për të gjithë përdoruesit, janë të hapura për të gjitha sipërmarrjet dhe të integruara në rrjetin ndërkombëtar, në përputhje me standartet ndërkombëtare.</p> <p>Neni 53 Standardizimi</p> <p>1. Në rrjetin e komunikimeve elektronike publike vendosen pajisje me karakteristika teknike në përputhje me standartet e harmonizuara dhe të miratuara nga organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë aderon.</p> <p>2. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, si organi kompetent kombëtar për standardizimin në Republikën e Shqipërisë, harton, adopton, miraton dhe publikon standartet e harmonizuara me standartet e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit në përputhje me ligjin për standardizimin.</p> <p>3. AKEP-i inkurajon përdorimin e standardeve ose specifikimeve të përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, për ofrimin e shërbimeve, ndërfaqeve teknike ose funksioneve të rrjetit, si dhe merr masat rigorozë të nevojshme për të garantuar ndërveprimin e shërbimeve, lidhjen pikë fundore-pikë fundore, lehtësitë në ndërrimin e ofruesit të shërbimit dhe portabilitetin e numrave dhe identifikuesve dhe për të përmirësuar lirinë e zgjedhjes për përdoruesit.</p> <p>4. Në mungesë të standardeve të publikuara sipas pikës 2 të këtij neni, inkurajohet zbatimi i standardeve ose rekomandimeve ndërkombëtare të miratuara nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), Konferenca Evropiane e Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT), Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) dhe Komisioni</p> | F | |

| | | | | | | |
|--------|--|--|---------|---|---|--|
| | <p>3. Nëse standardet ose specifikimet e përmendura në paragrafin 1, nuk janë zbatuar rigorozisht, në mënyrë që të sigurohet ndërveprimi i shërbimeve në një ose më shumë Shtete Anëtare, zbatimi i këtyre standardeve ose specifikimeve mund të bëhet i detyrueshëm sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 4, në masën që është rreptësisht e nevojshme për të siguruar një ndërveprim të tillë dhe për të përmirësuar lirinë e zgjedhjes për përdoruesit.</p> <p>4. Kur Komisioni synon të bëjë të detyrueshëm zbatimin e standardeve të caktuara ose specifikimeve, ai publikon një njoftim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe fton në konsultim publik, të gjitha palët e interesuara. Komisioni, përmes zbatimit të akteve, e bën të detyrueshëm zbatimin e standardeve përkatëse, duke iu referuar atyre si standarde të detyrueshme në listën e standardeve ose specifikimeve të botuara në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.</p> <p>5. Kur Komisioni konsideron se standardet ose specifikimet e përmendura në paragrafin 1, nuk kontribuojnë më në ofrimin e shërbimeve të harmonizuara të komunikimit elektronik, nuk plotësojnë më nevojat e konsumatorëve ose pengojnë zhvillimin teknologjik, ai i heq ato nga lista e standardeve ose specifikimeve referuara në paragrafin 1.</p> <p>6. Kur Komisioni konsideron se standardet ose specifikimet e përmendura në paragrafin 4, nuk kontribuojnë më në ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik të harmonizuar, nuk plotësojnë më nevojat e konsumatorëve, ose pengojnë zhvillimin teknologjik, ai me anë të akteve zbatuese do të heqë ato standarde ose specifikime nga lista e standardeve ose specifikimeve të përmendura në paragrafin 1.</p> <p>7. Aktet zbatuese të përmendura në paragrafët 4 dhe 6 të këtij neni, do të miratohen në përputhje me procedurën e provimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> <p>8. Ky nen nuk zbatohet në lidhje me ndonjë nga kërkesat thelbësore, specifikimet e ndërfaqes ose standardet e harmonizuara për të cilat zbatohet Direktiva 2014/53 / BE.</p> | | | <p>Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC) dhe ETSI. Çdo standard ose specifikim i përmendur në pikën 1 të këtij neni, ose sipas kësaj pike, nuk pengon sigurimin e aksesit sipas kërkesave të këtij ligji, kur kjo është e mundur.</p> <p>5. Nëse standardet ose specifikimet e përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe ndërveprueshmëria e shërbimeve nuk sigurohet, zbatimi i standardeve të harmonizuara ose specifikimeve teknike bëhet i detyrueshëm nga AKEP-i me masa të nevojshme rigoroze, për të siguruar ndërveprimin dhe përmirësuar lirinë e zgjedhjes për përdoruesit.</p> <p>6. Përcaktimet e këtij neni nuk zbatohen në lidhje me kërkesat thelbësore dhe specifikimet e ndërfaqes ose standardet e harmonizuara, të përcaktuara nga rregulli teknik për pajisjet radio të miraturara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore.</p> | | |
| Neni40 | <p align="center">PJESA I – TITULLI V SIGURIA</p> <p align="center">Neni40 Siguria e rrjeteve dhe shërbimeve</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, të marrin masa të duhura teknike dhe proporcionale teknike dhe organizative për të menaxhuar në mënyrë të duhur rreziqet e paraqitura për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të zhvillimeve, këto masa mundesojnë një nivel sigurie të</p> | | Neni 54 | <p align="center">KREU VIII SIGURIA</p> <p align="center">Neni 54 Siguria e rrjeteve dhe shërbimeve</p> <p>1. Ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, marrin masat e duhura teknike, organizative dhe proporcionale, për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet që vijnë për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve. Duke pasur parasysh gjendjen e teknologjisë, këto masa duhet të</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>përshtatshem për rrezikun e paraqitur. Në veçanti masat, përfshirë kodimin kur është e përshtatshme, do të merren për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e incidenteve të sigurisë tek përdoruesit dhe në rrjetet e shërbimet e tjera.</p> <p>Agjencia e Bashkimit Evropian për Rrjetin dhe Sigurinë e Informacionit ('ENISA') do të lehtësojë, në përputhje me me Rregulloren (BE) Nr 526/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (1), koordinimin e Shteteve Anëtare për të shmangur devijimin e kërkesave kombëtare që mund të krijojnë rreziqe të sigurisë dhe barriera për tregun e brendshëm.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e rrjeteve publike të komunikimit elektronik ose të shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, të njoftojnë pa vonesë autoritetin kompetent të një incidenti të sigurisë, që ka pasur një ndikim të rëndësishëm në funksionimin e rrjeteve ose shërbimeve. Për të përcaktuar rëndësinë e ndikimit të një incidenti të sigurisë, aty ku janë të disponueshëm, parametrat e mëposhtme duhet të merren parasysh:</p> <p>(a) numri i përdoruesve të prekur nga incidenti i sigurisë;</p> <p>(b) kohëzgjatja e incidentit të sigurisë;</p> <p>(c) përhapja gjeografike e zonës së prekur nga incidenti i sigurisë;</p> <p>(d) shkallën në të cilën ndikohet funksionimi i rrjetit ose shërbimit;</p> <p>(e) shkalla e ndikimit në aktivitetet ekonomike dhe shoqërore.</p> <p>Kur është e përshtatshme, autoriteti kompetent përkatës, informon autoritetet kompetente në shtetet e tjera anëtare dhe ENISA. Autoriteti kompetent përkatës, mund të informojë publikun ose të kërkojë nga ofruesit për ta bërë këtë, kur përcakton që zbulimi i incidentit të sigurisë është në interes të publikut.</p> <p>Një herë në vit, autoriteti kompetent përkatës i paraqet një raport përmbledhës Komisionit dhe ENISA, për njoftimet e marra dhe veprimet e ndërmarra në përputhje me këtë paragraf.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që në rast të një kërcënimi të veçantë dhe të rëndësishëm të një incidenti të sigurisë në rrjetet e komunikimeve elektronike publike ose shërbimet e komunikimit elektronik në dispozicion publik, ofruesit e këtyre rrjeteve ose shërbimeve do tu informojnë përdoruesve të tyre të prekur potencialisht nga një kërcënim i tillë, masat e mundshme mbrojtëse ose mjetet juridike që mund të ndermarrin. Kur është e përshtatshme, ofruesit informojnë përdoruesit e tyre për vetë kërcënimin.</p> <p>4. Ky artikull nuk cenon Rregulloren (BE) 2016/679 dhe Direktivën 2002/58 / EC.</p> <p>5. Komisioni, duke marrë parasysh opinionin e ENISA, mund të miratojë akte zbatuese, që detajojnë masat teknike dhe organizative të përmendura në paragrafin 1, si dhe rrethanat, format dhe procedurat e zbatueshme për kërkesat e njoftimit në përputhje me paragrafin 2. Ato do të bazohen mbi standardet</p> | | <p>sigurojnë një nivel të përshtatshëm sigurie për rrezikun e paraqitur. Në veçanti, masat, duke përfshirë enkriptimin aty ku është e përshtatshme, merren për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e incidenteve të sigurisë tek përdoruesit dhe në rrjetet dhe shërbimet e tjera.</p> <p>2. Ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, njoftojnë pa vonesë AKEP-in dhe Autoritetin Përgjegjës për Sigurinë Kibernetike në Republikën e Shqipërisë, për incidentin e sigurisë kibernetike që ka ndikuar në funksionimin e rrjeteve, sistemeve ose shërbimeve.</p> <p>3. Për të përcaktuar rëndësinë e ndikimit të një incidenti sigurie, kur është e mundur, duhet të merren parasysh në veçanti parametrat e mëposhtëm:</p> <p>a) numri i përdoruesve të prekur nga incidenti i sigurisë;</p> <p>b) kohëzgjatja e incidentit të sigurisë;</p> <p>c) shtrirjen gjeografike të zonës së prekur nga incidenti i sigurisë;</p> <p>d) shkallën në të cilën ndikohet funksionimi i rrjetit ose shërbimit;</p> <p>e) shtrirjen e ndikimit në aktivitetet ekonomike dhe shoqërore.</p> <p>4. AKEP-i informon Autoritetin Përgjegjës për Sigurinë Kibernetike në Republikën e Shqipërisë, për të gjithë incidentet e sigurisë kibernetike dhe sipas rastit informon Komisionin Evropian dhe ENISA-n, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave. AKEP-i informon publikun, ose u kërkon ofruesve ta bëjnë këtë, kur konstaton se zbulimi i incidentit të sigurisë është në interes të publikut. AKEP-i shkëmben informacion, në lidhje me shkeljen e sigurisë me Komisionin Evropian dhe Agjencinë Evropiane të Rrjeteve dhe Sigurisë së Informacionit, si dhe me autoritetet kompetente të vendeve të tjera, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave për transferimin ndërkombëtar.</p> <p>5. Dy herë në vit, AKEP-i u paraqet Këshillit të Ministrave dhe Ministrat përgjegjës dhe, për sa është e zbatueshme, paraqet tek ENISA, një raport përmbledhës për njoftimet e marra për incidentet, si dhe veprimet e ndërmarra në përputhje me këtë pikë.</p> <p>6. Ky nen zbatohet pa paragjykuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat e Kreut XIX, të këtij ligji.</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|----------------|---|---------|---|---|--|
| | <p>evropiane dhe ndërkombëtare në masën më të madhe të mundshme, dhe nuk do t'i ndalojë Shtetet Anëtare të miratojnë kërkesa shtesë për të ndjekur objektivat e përcaktuara në paragrafin 1.</p> <p>Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën e kontrollit të përmendur në nenin 118 (4).</p> | | | | |
| Neni 41 | <p style="text-align: center;">Neni 41 Implementimi dhe zbatimi (detyrimi)</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që për të zbatuar nenin 40, autoritetet kompetente kanë fuqinë për të nxjerrë udhëzime detyruese, përfshirë ato në lidhje me masat e kërkuara për të korrigjuar një incident të sigurisë ose për të parandaluar që të ndodhë, kur një kërcënim i rëndësishëm është identifikuar dhe afatet kohore për zbatim për ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshëm publikisht.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente kanë fuqinë të kërkojnë nga ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshëm publikisht për:</p> <p>(a) të siguroar informacionin e nevojshëm për vlerësimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të tyre, përfshirë politikat e dokumentuara të sigurisë; dhe</p> <p>(b) ushtrimin e nje auditi të sigurisë, të kryer nga një organ i pavarur i kualifikuar ose nga një autoritet kompetent dhe të vëre në dispozicion të autoriteteve kompetente rezultatet e tij; kostoja e auditimit paguhet nga ofruesi.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente, të kenë të gjitha fuqitë e nevojshme, për të hetuar rastet e mosrespektimit dhe efektet e tyre, në sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve.</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë që për të zbatuar nenin 40, autoritetet kompetente kanë fuqinë të marrin ndihmën e një Ekipi për Reagimin e Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike ('CSIRT') të përcaktuara në pajtim me nenin 9 të Direktivës (BE) 2016/1148, në lidhje me çështjet që janë brenda detyrave të CSIRT-it, në përputhje me pikën 2 të Shtojcës I të kësaj direktive.</p> <p>5. Autoritetet kompetente, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin kombëtar, këshillohen dhe bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse kombëtare të zbatimit të ligjit, autoritetet kompetente në kuptimin e nenit 8 (1) të Direktivës (BE) 2016/1148 dhe autoritetet kombëtare për mbrojtjen e të dhënave.</p> | Neni 56 | <p style="text-align: center;">Neni 56 Implementimi dhe detyrimi</p> <p>1. AKEP-i mbikëqyr zbatimin e nenit 54, të këtij ligji. AKEP-i bashkëpunon me Autoritetin Përgjegjës për Sigurinë Kibernetike në Republikën e Shqipërisë, për miratimin e udhëzimeve detyruese, përfshirë masat e nevojshme për korrigjimin e një incidenti sigurie ose parandalimin e tij nga ndonjë rrezik dhe nëse implementimi është në limitet e kohës tek ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të komunikimit elektronik të disponueshme publikisht.</p> <p>2. AKEP-i është i autorizuar të hetojë rastet e mospërputhjes dhe efekteve të saj në sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve.</p> <p>3. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike janë të detyruar të paraqesin tek AKEP:</p> <p>a) informacionin e nevojshëm për vlerësimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të tyre, përfshirë politikat e sigurisë së dokumentuara si dhe,</p> <p>b) të paraqesin auditimin e sigurisë të kryer nga një organ i kualifikuar i pavarur ose nga një autoritet kompetent dhe të bëjë të disponueshëm rezultatet e auditimit tek AKEP. Kosto e auditimit mbulohet nga sipërmarrësi.</p> <p>4. AKEP-i ka kompetencën për të marrë asistencë nga një ekip, për të reaguar ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike ('CSIRT'), bazuar në legjislacionin për sigurinë kibernetike.</p> <p>5. AKEP-i, bashkëpunon me Autoritetin Përgjegjës për Sigurinë Kibernetike në Republikën e Shqipërisë, bazuar në legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike dhe sipas rastit me autoritetet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera kompetente për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara sipas këtij kreu.</p> | F | |

| | | | | | |
|-----------------------|---|----------------|---|----------|--|
| <p>Neni42</p> | <p align="center">PJESA II – TITULLI I Hyrja ne Treg dhe Shtirja (shperndarja) KAPITULLI I Tarifat</p> <p align="center">Neni 42 Tarifat për të drejtat e përdorimit për spektrin radio dhe të drejtat për instalimin e pajisjeve</p> <p>1. Shtetet Anëtare mund të lejojnë autoritetin kompetent, të vendosë tarifa për të drejtat e përdorimit për spektrin e radios ose të drejta për të instaluar pajisje, mbi ose nën një pronë publike ose private, që përdoren për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe facilitete shoqëruese të cilat sigurojnë përdorimin optimal të këtyre burimeve. Shtetet Anëtare sigurojnë që tarifat e tilla janë të justifikuar në mënyrë objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale në lidhje me qëllimin e tyre të synuar dhe do të marrin parasysh objektivat e përgjithshëm të kësaj direktive.</p> <p>2. Në lidhje me të drejtat e përdorimit për spektrin e radios, Shtetet Anëtare do të kërkojnë të sigurojnë që tarifat e aplikueshme të vendosen në një nivel i cili siguron caktimin dhe përdorimin efikas të spektrit të radios, përfshirë nga:</p> <p>(a) përcaktimi i çmimeve të rezervës si tarifa minimale për të drejtat e përdorimit për spektrin radio duke marrë parasysh vlerën e këtyre të drejtave në përdorimet e tyre alternative të mundshme;</p> <p>(b) duke marrë parasysh kostot që rrjedhin nga kushtet e bashkangjitura me ato të drejta;</p> <p>dhe</p> <p>(c) duke zbatuar në masën e mundshme, marrëveshjet e pagesës të lidhura me disponueshmërinë aktuale për përdorimin e spektrit të radios.</p> | <p>Neni 21</p> | <p align="center">Neni 21 Pagesat për të drejtat e përdorimit të frekuencave</p> <p>1. AKEP, mund të vendosë tarifa për të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave, që përdoren për ofrimin e rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve të lidhura me to, të cilat sigurojnë përdorimin optimal të këtyre burimeve.</p> <p>2. Tarifat për të drejtat e përdorimit e spektrit të frekuencave duhet të jenë objektivist të justifikuar, jo diskriminuese dhe proporcionale në lidhje me qëllimin e synuar, bazuar në objektivat e përgjithshëm sipas nenit 5, të këtij ligji.</p> <p>3. Tarifat e aplikueshme në lidhje me të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave, vendosen në një nivel që siguron caktimin dhe përdorimin efikas të spektrit të radios, duke përfshirë:</p> <p>a) vendosjen e çmimeve rezervë, si tarifa minimale për dhënien e të drejtës së përdorimit të spektrit të frekuencave, duke pasur parasysh vlerën e këtyre të drejtave në përdorimet e tyre të mundshme alternative;</p> <p>b) kostot e shkaktuara nga kushtet e bashkëlidhura me këto të drejta; dhe</p> <p>c) aplikimin, për aq sa është e mundur, të modaliteteve të pagesave të lidhura me disponueshmërinë aktuale për përdorimin e spektrit të frekuencave;</p> <p>d) lëshimin e autorizimeve për përdorimin e frekuencave nga AKEP, të destinuar për qëllime të kërkimit, matjes dhe testimit të pajisjeve të radio komunikimit, për një zonë të kufizuar mbulimi dhe për jo më shumë se 120 ditë.</p> | <p>P</p> | |
| <p>Neni 43</p> | <p align="center">PJESA II – TITULLI I Kapitulli II</p> <p align="center">Neni43 E drejta e kalimit</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që kur një autoritet kompetent shqyrton një kërkesë për dhënien e të drejtave: -të instalojë pajisjet, mbi ose nën pronë publike ose private, në një ndërmarrje të autorizuar për të siguruar rrjete publike të komunikimeve elektronike, ose - të instalojë pajisjet, mbi ose nën një pronë publike një ndërmarrje të autorizuar për të siguruar rrjete të komunikimeve elektronike, përveç publikut,</p> <p>ai autoritet kompetent:</p> | <p>Neni 57</p> | <p align="center">KREU IX RREGULLIMI I TË DREJTËS SË KALIMIT</p> <p align="center">Neni 57 E drejta e kalimit</p> <p>1. E drejta e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike mbi pronën e të tretëve, u jepet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike bazuar në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjisacionit në fuqi për sigurimin e të drejtës së kalimit.</p> <p>2. Autoritetet kompetente kur shqyrtojnë një kërkesë për dhënien e të drejtave të kalimit:</p> <p>a) për të instaluar pajisje në, mbi ose nën pronën publike për një sipërmarrje të autorizuar për të ofruar rrjete publike të komunikimeve elektronike, ose,</p> | <p>F</p> | |

| | | | | | | |
|----------------------|---|--|----------------|---|----------|--|
| | <p>(a) vepron në bazë të procedurave të thjeshta, efikase, transparente dhe të disponueshme për publikun, të aplikuara pa diskriminim dhe pa vonesë, dhe në çdo rast merr vendimin e vet, brenda gjashtë muajve nga aplikimi, përveç në rastin e shpronësimit;</p> <p>dhe</p> <p>(b) ndjek parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit në bashkëlidhjen e kushteve për të drejtat e tilla.</p> <p>Procedurat e përmendura në pikat (a) dhe (b) mund të ndryshojnë, në varësi të faktit nëse aplikanti ofron rrjete publike të komunikimeve elektronike ose jo.</p> <p>Procedurat e përmendura në pikat (a) dhe (b) mund të ndryshojnë në varësi të faktit nëse aplikanti po ofron rrjete publike të komunikimit elektronik apo jo.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që, kur autoritetet publike ose lokale, të mbajnë pronësinë ose kontrollin e ndërmarrjeve që ofrojnë rrjete publike të komunikimeve elektronike ose shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, ekziston një ndarje efektive strukturore e funksionit përgjegjës për dhënien e të drejtave të përmendura në paragrafin 1, nga aktivitetet e lidhura me pronësinë ose kontrollin.</p> | | | <p>b) për të instaluar pajisje në, mbi, nën pronën publike për një sipërmarrje të autorizuar për të ofruar rrjete të komunikimeve elektronike të ndryshme nga publiku,</p> <p>veprojnë në bazë të procedurave të thjeshta, efikase, transparente, jodiskriminuese dhe të disponueshme për publikun, të zbatuara pa diskriminim dhe pa vonesë, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit.</p> | | |
| <p>Neni44</p> | <p style="text-align: center;">Neni 44</p> <p style="text-align: center;">Vendodhja e përbashkët dhe ndarja e elementeve të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Kur një operator ka ushtruar të drejtën sipas ligjit kombëtar për të instaluar pajisjet, mbi ose nën një pronë publike ose private, ose ka përfituar nga një procedurë për shpronësimin ose përdorimin e pronës, autoritetet kompetente mund të vendosin vendodhjen e përbashkët dhe ndarjen e elementeve të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese të instaluar në atë bazë, për të mbrojtur mjedisin, shëndetin publik, sigurinë publike ose për të përmbushur objektivat e planifikimit të qyteteve dhe të vendit.</p> <p>Vendodhja e përbashkët ose ndarja e elementeve të rrjetit dhe pajisjeve të instaluar dhe ndarja e pasurisë, mund të vendoset vetëm pas një periudhe të përshtatshme të konsultimit publik, gjatë së cilës të gjithë palëve të interesuarado t'u jepet një mundësi për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe vetëm në fushat specifike ku ndarja e tillë konsiderohet e nevojshme, për të ndjekur objektivat e parashikuara në nënparagrafin e parë. Autoritetet kompetente mund të imponojnë ndarjen e objekteve ose pasurive të tilla, përfshirë tokën, ndërtesat, hyrjet në ndërtesa, instalime elektrike, antenat, kullat dhe ndërtimet e tjera mbështetëse, kanalet, pusetat, dollapët ose masat që lehtësojnë koordinimin e punëve publike.</p> <p>Kur është e nevojshme, një Shtet Anëtar mund të caktojë një rregullator kombëtar ose një autoritet tjetër kompetent për një ose më shumë nga detyrat e mëposhtme:</p> <p>(a) koordinimin e procesit të parashikuar në këtë nen;</p> <p>(b) veprimin si një pikë e vetme informacioni;</p> | | <p>Neni 58</p> | <p style="text-align: center;">Neni 58</p> <p style="text-align: center;">Bashkëvendosja dhe përdorimi i përbashkët i elementeve të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Kur një sipërmarrës i komunikimeve elektronike ushtron të drejtën në bazë të këtij ligji, ose ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, për të instaluar facilitete në, mbi ose nën pronën publike ose private, ose ka përfituar nga një procedurë për shpronësimin ose shfrytëzimin e pronës, AKEP-i vetë ose sipas rastit, në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente siç specifikohen në nenin 3, të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, imponojnë bashkëvendosjen dhe bashkëpërdorimin e elementeve të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese të instaluar mbi këtë bazë, për të mbrojtur mjedisin, shëndetin publik, sigurinë publike, ose për të përmbushur objektivat e planifikimit urban.</p> <p>2. Bashkëvendosja ose bashkëpërdorimi i elementeve dhe pajisjeve të rrjetit të instaluar, ose bashkëpërdorimi i pronës, vendoset vetëm pas një procesi konsultimi publik, gjatë të cilit të gjitha palëve të interesuara, u jepet koha e përshtatshme dhe mundësia të shprehin pikëpamjet e tyre dhe vetëm për zonat specifike, ku një kërkesë për bashkëpërdorim konsiderohet e nevojshme,</p> | <p>F</p> | |

| | | | | | |
|----------------|--|--|--|--|---|
| | <p>(c) përcaktimine rregullave për ndarjen e kostove të objektit ose ndarjes së pronave dhe koordinimit të punëve civile.</p> <p>2. Masat e marra nga një autoritet kompetent në përputhje me këtë nen do të jenë objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale. Kur është e nevojshme këto masa do të kryhen në koordinim me autoritetet rregullatore kombëtare.</p> | | | <p>në funksion të përmbushjes së objektivave të parashikuara në nënpikën e parë. AKEP-i ose një autoritet tjetër kompetent, vendos bashkëpërdorimin e faciliteteve të rrjetit ose pronave, duke përfshirë tokën, ndërtesat, hyrjet në ndërtesa, instalimet elektrike të ndërtesave, shtyllat, antenat, kullat dhe ndërtimet e tjera mbështetëse, kanalet, pusetat, kabinetet ose masat që lehtësojnë koordinimin e punëve publike.</p> <p>3. Në zbatim të parashikimeve të këtij neni dhe bazuar në objektivat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, AKEP-i ka për detyrë:</p> <p>a) koordinimin e procesit të parashikuar në këtë nen;</p> <p>b) të veprojë si një pikë e vetme informacioni;</p> <p>c) përcaktimin e rregullave për ndarjen e kostove të bashkëpërdorimit të faciliteteve të rrjetit ose pronës dhe të koordinimit të punëve civile.</p> <p>4. Masat e marra nga AKEP-i, në përputhje me këtë nen, duhet të jenë objektive, transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale.</p> | |
| Neni 45 | <p align="center">PJESA II – TITULLI I Kapitulli III Të drejtat për Spektrin Radio Seksioni 1 Autorizimet</p> <p align="center">Neni 45 Menaxhimi i spektrit të radios</p> <p>1. Duke marrë parasysh faktin se spektri i radios është një e mirë publike që ka një vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike, Shtetet Anëtare sigurojnë menaxhimin efektiv të spektrit të radios për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në territorin e tyre në përputhje me nenet 3 dhe 4. Ata do të sigurojnë që shpërndarja, lëshimi i autorizimeve të përgjithshme, dhe dhënia e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin radio për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike nga autoritetet kompetente, bazohen në objektiva, transparente, pro-konkurruese, kritere jodiskriminuese dhe proporcionale.</p> <p>Në zbatimin e këtij neni, Shtetet Anëtare do të respektojnë marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë Rregulloret e Radios se ITU dhe marrëveshjet e tjera të miratuara në kuadrin e ITU, të zbatueshme për spektrin e radios, siç është marrëveshja e arritur në Konferencën Rajonale të Radiokomunikacionit të 2006, dhe mund të marrë në konsideratë konsideratat e politikave publike.</p> <p>2. Shtetet Anëtare promovojnë harmonizimin e përdorimit të spektrit të radios nga rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në të gjithë Bashkimin Evropian, në përputhje me nevojën për të siguruar përdorimin efektiv dhe efikas</p> | | <p>Neni 59 Neni 60 Neni 61 Neni 62</p> | <p align="center">KREU X QASJA NË SPEKTRIN E RADIO FREKUENCAVE</p> <p align="center">SEKSIONI 1 AUTORIZIMET</p> <p align="center">Neni 59 Alokimi i spektrit të frekuencave</p> <p>1. Spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar dhe një e mirë publike që ka një vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike. Menaxhimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e tij të frytshëm dhe efektiv për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, në përputhje me nenet 5 dhe 7, të këtij ligji, si dhe me vendimet përkatëse të organizatave ndërkombëtare dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ose marrëveshjet në të cilat Republika e Shqipërisë aderon.</p> <p>2. Alokimi i radiofrekuencave bazohet në Planin Kombëtar të Frekuencave dhe çdo ndryshim të tij, të miratuar nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit, mbi bazën e kritereve objektive, transparente, pro konkurrencës, jodiskriminuese dhe proporcionale.</p> <p>3. Plani Kombëtar i Frekuencave hartohet në përputhje me Rregulloret e Radios të ITU-së dhe Tabelën e Përbashkët Evropiane të Alokimit të miratuar nga CEPT. Plani Kombëtar i Frekuencave përfshin shërbimet e radio komunikimit për brezat përkatës. Për të siguruar përdorim të frytshëm dhe pa interferenca të radio-</p> | F |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>të tij dhe në ndjekje të përfitimeve për konsumatorin, siç janë konkurrenca, ekonomitë e shkallës dhe ndërveprimi i rrjeteve dhe shërbimeve. Duke vepruar kështu, ata do të veprojnë në përputhje me nenin 4 të kësaj direktive dhe me vendimin nr 676/2002 / EC, ndër të tjera:</p> <p>(a) ndjekjen e mbulimit wireless broadband të territorit të tyre kombëtar dhe popullsisë, me cilësi të lartë dhe shpejtësi, si dhe mbulimin e rrugëve kryesore të transportit kombëtar dhe evropian, përfshirë rrjetin e transportit trans-evropian, siç përmendet në Rregulloren (BE) Nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (1);</p> <p>(b) lehtësimin e zhvillimit të shpejtë në Bashkimin Evropian të teknologjive dhe aplikacioneve të reja të komunikimit me wireless, duke përfshirë, kur është e përshtatshme një qasje ndër-sektoriale;</p> <p>(c) sigurimin e parashikueshmërisë dhe konsistencës në dhënie, rinovimin, ndryshimin, kufizimin dhe tërheqjen e të drejtave të përdorimit të spektrit të radios me qëllim të promovimit të investimeve afatgjata;</p> <p>(d) sigurimin e parandalimit të ndërhyrjeve të dëmshme ndërkufitare ose kombëtare, në përputhje me nenin 28 dhe 46 përkatësisht, dhe marrjen e masave të duhura parandaluese dhe përmirësuese për këtë qëllim;</p> <p>(e) promovimin e përdorimit të përbashkët të spektrit të radios, përmes përdorimeve të ngjashme ose të ndryshme të tij, në përputhje me ligjin e konkurrencës;</p> <p>(f) aplikimin e sistemit të autorizimit më të përshtatshëm dhe më të lehtë, në përputhje me nenin 46 në atë masë që të maksimizohet fleksibiliteti, ndarja dhe efikasiteti në përdorimin e spektrit të radios;</p> <p>(g) aplikimin e rregullave për dhënie, transferimin, rinovimin, modifikimin dhe tërheqjen e të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, të përcaktuara qartë dhe në mënyrë transparente për të garantuar sigurinë, konsistencën dhe parashikueshmërinë rregullatore;</p> <p>(h) ndjekja e konsistencës dhe parashikueshmërisë në të gjithë Bashkimin Evropian, në lidhje me mënyrën e autorizimit të përdorimit të spektrit të radios për mbrojtjen e shëndetit publik, duke marrë parasysh Rekomandimin 1999/519 / EC.</p> <p>Për qëllimin e nënparagrafit të parë, dhe në kontekstin e zhvillimit të masave zbatuese teknike për një brez të spektrit radio nën Vendimin Nr. 676/2002 / EC, Komisioni mund të kërkojë nga RSPG, të lëshojë një mendim që rekomandon regjimet më të përshtatshme të autorizimit për përdorimin e spektrit radio në atë brez ose pjesë të tij. Kur është e përshtatshme dhe duke marrë parasysh një mendim të tillë, Komisioni mund të miratojë një rekomandim me qëllim të promovimit të një qasje të qëndrueshme në Bashkimin Evropian në lidhje me regjimet e autorizimit për përdorimin e këtij brezi.</p> | | <p>frekuencave, Plani Kombëtar i Frekuencave, përfshin udhëzime për përdorimin e frekuencave, si dhe përkufizime të detajuara.</p> <p>4. Hartimi i Planit Kombëtar të Frekuencave, bëhet nga ministria në bashkëpunim me institucionet e tjera kompetente të përcaktuara në nenin 60, të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 60 Administrimi i spektrit radio</p> <p>1. Spektri i radiofrekuencave administrohet nga:</p> <p>a) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare , për brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, me përjashtim të brezave të frekuencave të caktuara për transmetimet radiotelevizive;</p> <p>b) Autoriteti i Medias Audiovizive, për brezat e frekuencave të caktuara për transmetimet e radio televizionit, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave.</p> <p>c) Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, për brezat e frekuencave të përcaktuara për qëllime qeveritare, mbrojtjen kombëtare dhe rendit civil.</p> <p>2. Në zbatimin e këtij neni, AKEP-i, AMA dhe organet e tjera kompetente, respektojnë marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse, Rregulloret e Radios të ITU-së dhe marrëveshjet e tjera të miratuara të zbatueshme për spektrin e frekuencave dhe marrin parasysh konsideratat e politikave publike.</p> <p>3. AKEP-i promovon përdorimin e harmonizuar të spektrit të frekuencave nga rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, për të garantuar përdorimin efektiv dhe efikas të tij, rritjen e përfitimeve për përdoruesit nëpërmjet konkurrencës, ekonominë e shkallës dhe ndërveprueshmërinë e rrjeteve dhe shërbimeve. AKEP-i në përputhje me nenin 5 dhe 7, të këtij ligji, ndër të tjera:</p> <p>a) nxit mbulimin e rrjeteve pa tel me kapacitet shumë të lartë në të gjithë territorin dhe popullsinë e Republikës së Shqipërisë, përfshirë rrugët kryesore të transportit kombëtar dhe evropian dhe për sa është e zbatueshme rrjetet e transportit Trans-Evropian;</p> <p>b) lehtëson zhvillimin e shpejtë në Republikën e Shqipërisë të teknologjive dhe aplikacioneve të reja të komunikimit pa tel, duke përfshirë, sipas rastit, një qasje ndërsektoriale. AKEP-i siguron që të gjitha llojet e teknologjisë së përdorur për ofrimin e rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike, të përdoren në spektrin e frekuencave të disponueshëm për shërbimet e</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>Kur Komisioni shqyrton miratimin e masave në përputhje me nenin 39 (1), (4), (5) dhe (6), ai mund të kërkojë mendimin e RSPG në lidhje me implikimet e ndonjë standardi të tillë ose specifikim për koordinimin, harmonizimin dhe disponueshmërinë e spektrit radio. Komisioni do të marrë parasysh kryesisht mendimin e RSPG, për të ndërmarrë çdo hap pasues.</p> <p>Në rast se mungon kërkesa në tregun kombëtar ose rajonal për përdorimin e një brezi në spektrin e harmonizuar radio, shtetet anëtare mund të lejojnë një përdorim alternativ të të gjithë brezit ose vetëm pjesë të tij, duke përfshirë përdorimin aktual, në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni, me kusht që:</p> <p>3. Në rast se mungon kërkesa në tregun kombëtar ose rajonal për përdorimin e një brezi në spektrin e harmonizuar radio, shtetet anëtare mund të lejojnë një përdorim alternativ të të gjithë brezit ose vetëm pjesë të tij, duke përfshirë përdorimin aktual, në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni, me kusht që:</p> <p>(a) Zbulimi i mungesës së kërkesës së tregut për përdorimin e një grupi të tillë bazohet në një konsultim publik, në përputhje me nenin 23, duke përfshirë një vlerësim paraprak të kërkesës së tregut;</p> <p>(b) një përdorim i tillë alternativ nuk parandalon ose pengon disponueshmërinë ose përdorimin e një brezi të tillë në Shtetet e tjera Anëtare; dhe</p> <p>(c) Shteti Anëtar i interesuar merr në konsideratë disponueshmërinë afatgjatë ose përdorimin e një bande të tillë në Bashkimin Evropian dhe ekonominë e shkallës për pajisjet që vijnë nga përdorimi i spektrit të harmonizuar të radios në Bashkimin Evropian.</p> <p>Çdo vendim për të lejuar përdorimin alternativ mbi një bazë të jashtëzakonshme do t'i nënshtrohet një rishikimi të rregullt dhe në çdo rast do të rishikohet menjëherë me një kërkesë të arsyetuar siç duhet, nga një përdorues i ardhshëm te autoriteti kompetent për përdorimin e brezit në përputhje me masën teknike të zbatimit. Shteti Anëtar do të informojë Komisionin dhe Shtetet e tjera Anëtare për vendimin e marrë, së bashku me arsyet për marrjen e tij, si dhe për rezultatit e çdo rishikimi.</p> <p>4. Pa çënuar nënparagrafin e dytë, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjitha llojet e teknologjisë së përdorur për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimit elektronik, mund të përdoren në spektrin e disponueshëm të deklaruar të radios për shërbimet e komunikimeve elektronike në Planin e tyre Kombëtar të Alokimit të Frekuencës, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian.</p> <p>Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jo-diskriminuese, për llojet e rrjetit radio ose teknologjinë e aksesit me wireless, të përdorur për shërbimet e komunikimit elektronik, kur kjo është e nevojshme për:</p> <p>(a) shmangien e interferencave të dëmshme;</p> | | <p>komunikimeve elektronike, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave;</p> <p>c) siguron parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në dhënie, rinovimin, ndryshimin, kufizimin dhe heqjen e të drejtave të përdorimit të spektrit të frekuencave, me qëllim nxitjen e investimeve afatgjata;</p> <p>d) siguron parandalimin e interferencave të dëmshme ndërkufitare ose kombëtare në përputhje me nenin 49 dhe 66, të këtij ligji, duke marrë masat e duhura parandaluese dhe korrigjuese për këtë qëllim;</p> <p>e) promovon përdorimin e përbashkët të spektrit të frekuencave, ndërmjet përdorimeve të ngjashme ose të ndryshme të spektrit të frekuencave, në përputhje me parimet e konkurrencës;</p> <p>f) ndjek mbulimin me broadband pa tel, në të gjithë territorin dhe popullsinë e Republikës së Shqipërisë, me cilësi dhe shpejtësi të lartë, duke përfshirë mbulimin e rrugëve kryesore të transportit kombëtar dhe rrjetet e transportit trans-evropian;</p> <p>g) aplikon sistemin më të përshtatshëm dhe më pak të vështirë të autorizimit të mundshëm, në përputhje me nenin 66, të këtij ligji, në mënyrë të tillë që të maksimizojë fleksibilitetin, ndarjen dhe efikasitetin në përdorimin e spektrit të radios;</p> <p>h) zbaton rregullat për dhënie, transferimin, rinovimin, modifikimin dhe heqjen e të drejtave të përdorimit për spektrin e frekuencave, të cilat janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë transparente për të garantuar sigurinë rregullatore, qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë;</p> <p>i) ndjek parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në të gjithë Republikën e Shqipërisë, në lidhje me mënyrën e autorizimit të përdorimit të spektrit të radios në mbrojtjen e shëndetit publik, duke marrë parasysh ligjin shqiptar për rrezatimet elektro magnetike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 61 Kërkesa e tregut</p> <p>Në rastin e mungesës së kërkesës në tregun kombëtar ose rajonal, për përdorimin e një brezi të frekuencave, për të cilin janë miratuar masa teknike zbatuese në përputhje me politikën spektrale dhe praktikën e BE-së për përdorimin e harmonizuar të frekuencave, AKEP-i mund të lejojë një përdorim alternativ të të gjithë ose një pjese të atij brezi frekuencash, duke përfshirë përdorimin ekzistues, në përputhje me parashikimet në nenin 62, të këtij ligji, me kusht që:</p> <p>a) konstatimi i mungesës së kërkesës së tregut për</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>(b) mbrojtjen e shëndetit publik kundër fushave elektromagnetike, duke marrë parasysh Rekomandimn 1999/519 / EC;</p> <p>(c) të siguruar cilësinë teknike të shërbimit;</p> <p>(d) të siguruar maksimizimin e ndarjes së spektrit të radios;</p> <p>(e) mbrojtjen përdorimin efikas të spektrit të radios;dhe</p> <p>(f) përmbushjen e një objekti të interesit të përgjithshëm, në përputhje me paragrafin 5.</p> <p>Pa çënuar nënparagrafin e dytë, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që të gjitha llojet e shërbimeve të komunikimit elektronik, mund të sigurohen në spektrin e radios të deklaruar të disponueshëm për shërbimet e komunikimeve elektronike në Planin e tyre Kombëtar të Alokimit të Frekuencës, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jo-diskriminuese për llojet e shërbimeve të komunikimit elektronik që duhen ofruar, për të përmbushur një kërkesë sipas Rregullores së Radios ITU.</p> <p>Masat që kërkojnë të ofrohet një shërbim i komunikimit elektronik në një bandë specifike të disponueshme për shërbimet e komunikimeve elektronike, do të justifikohen për të siguruar përmbushjen e një objekti të interesit të përgjithshëm siç përcaktohet nga Shtetet Anëtare në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, por jo i kufizuar në:</p> <p>(a) sigurinë e jetës;</p> <p>(b) promovimin e kohezionit social, rajonal ose territorial;</p> <p>(c) shmangien e përdorimit joefikas të spektrit të radios; ose</p> <p>(d) promovimin e diversitetit kulturor dhe gjuhësor dhe pluralizmit të mediave, për shembull ofrimi i shërbimeve të transmetimit radio dhe televizion.</p> <p>Një masë e cila ndalon ofrimin e çdo shërbimi tjetër të komunikimit elektronik në një bandë specifike, mund të parashikohet vetëm kur justifikohet nga nevoja për të mbrojtur sigurinë e shërbimeve të jetës. Shtetet Anëtare mund të bëjnë, mbi një bazë eksepcionale, një masë të tillë për të përmbushur objektiva të tjerë të interesit të përgjithshëm, të përcaktuara nga Shtetet Anëtare, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian.</p> <p>5. Shtetet Anëtare do të rishikojnë rregullisht domosdoshmërinë e kufizimeve të përmendura në paragrafët 4 dhe 5, dhe do t'i bëjnë publike rezultatet e këtyre rishikimeve.</p> <p>6. Kufizimet e vendosura para datës 25 maj 2011 do të jenë në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 deri më 20 dhjetor 2018.</p> | | <p>përdorimin e këtij brezi, bazohet në rezultatet e një konsultimi publik në përputhje me nenin 44, të këtij ligji, duke përfshirë një vlerësim afatgjatë të kërkesës së tregut;</p> <p>b) një përdorim i tillë alternativ nuk parandalon ose pengon disponueshmërinë ose përdorimin e një brezi të tillë në vendet fqinje; dhe</p> <p>c) merret parasysh disponueshmëria afatgjatë ose përdorimi i një brezi të tillë dhe përfitimi nga ekonomia e shkallës për pajisjet që rezultojnë nga përdorimi i harmonizuar i spektrit të frekuencave në Republikën e Shqipërisë ose nëse zbatohet në Bashkimin Evropian.</p> <p>Çdo vendim për lejimin e përdorimit alternativ në baza të jashtëzakonshme, i nënshtrohet rishikimit të rregullt periodik. Në çdo rast, me marrjen e një kërkesë të mirëjustifikuar, drejtuar autoritetit kompetent, nga një përdorues i mundshëm për përdorimin e atij brezi në përputhje me masat teknike të zbatueshme, rishikimi do kryhet menjëherë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 62 Kufizimet</p> <p>1. Pa paragjykuar parashikimet e pikës 3, të nenit 60, të këtij ligji, AKEP-i parashikon kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese, për llojet e rrjetit radio ose të teknologjisë së aksesit pa tel që përdoret për shërbimet e komunikimeve elektronike, kur kjo është e nevojshme për:</p> <p>a) shmangien e interferencave të dëmshme;</p> <p>b) mbrojtjen e shëndetit publik kundër fushave elektromagnetike, duke marrë parasysh vlerësimin maksimal, si përcaktohet në legjislacionin kombëtar;</p> <p>c) sigurimin e cilësisë teknike të shërbimit;</p> <p>ç) të siguruar maksimizimin e përdorimit të spektrit të radios;</p> <p>d) mbrojtjen e përdorimit efikas të spektrit të radios; ose</p> <p>dh) sigurimin e përmbushjes së objekti të interesit të përgjithshëm, në përputhje me pikën 3, të nenit 66, të këtij ligji.</p> <p>2. Pa paragjykuar parashikimet e pikës 3, të nenit 60, të këtij ligji, Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani i Përdorimit të Frekuencave, parashikon kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për llojet e shërbimeve të komunikimit elektronik që ofrohen kur nevojitet, për të siguruar arritjen e qëllimeve të përgjithshme të tilla si:</p> <p>a) përmbushja e kërkesave të Rregullores të Radios të ITU-së;</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | | |
|----------------|---|--|---------|---|---|--|
| | | | | <ul style="list-style-type: none"> b) siguria e jetës; c) promovimi i ndërveprimit social, rajonal ose territorial; ç) parandalimi i përdorimit joefikas të radiofrekuencave; ose d) promovimi i diversitetit kulturor, gjuhësor dhe mediatik, si nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të transmetimit radioteleviz. <p>3. AKEP-i shqyrton rregullisht domosdoshmërinë e kufizimeve të përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni dhe bën publike rezultatet e këtyre rishikimeve. Një masë kufizuese për ofrimin e një shërbimi të komunikimit elektronik në një brez specifik frekuencash, mund të vendoset vetëm në rastet e justifikuara për mbrojtjen dhe sigurinë e jetës dhe shërbimeve. AKEP mund të propozojë rishikimin e kufizimeve me qëllim përmbushjen e objektivave të interesit të përgjithshëm sipas legjislacionit në fuqi.</p> | | |
| Neni 46 | <p style="text-align: center;">Neni 46 Autorizimi i përdorimit të spektrit radio</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të lehtësojnë përdorimin e spektrit të radios, përfshirë përdorimin e përbashkët, nën autorizime të përgjithshme dhe kufizojnë dhënien e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin radio në situata kur të drejtat e tilla janë të nevojshme për të maksimizuar përdorimin efikas nën dritën e kërkesës dhe duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nënparagrafin e dytë. Në të gjitha rastet e tjera, ata përcaktojnë kushtet për përdorimin e spektrit radio në një autorizim të përgjithshëm.</p> <p>Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare vendosin për regjimin më të përshtatshëm, për autorizimin e përdorimit të spektrit të radios, duke marrë parasysh:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) karakteristikat specifike të spektrit të radios në fjalë; (b) zhvillimin kushteve të besueshme për ndarjen e spektrit të radios, kur është e përshtatshme; (c) zhvillimin e kushteve të besueshme për ndarjen e spektrit të radios, kur është e përshtatshme; (d) nevojën për të siguruar cilësi teknike të komunikimeve ose shërbimeve; (e) objektivat e interesave të përgjithshme të përcaktuara nga Shtetet Anëtare, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian; (f) nevojën për të mbrojtur përdorimin efikas të spektrit të radios. <p>Kur shqyrtohet nëse do të lëshoni autorizime të përgjithshme ose do të jepni të drejta individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të radios, duke marrë parasysh masat teknike zbatuese të miratuara në përputhje me nenin 4 të Vendimit Nr. 676/2002 / EC, Shtetet Anëtare do të kërkojnë të minimizojnë problemet e interferencës së dëmshme, përfshirë në rastet e</p> | | Neni 66 | <p style="text-align: center;">Neni 66 Autorizimi i përdorimit të spektrit radio</p> <p>1. AKEP-i nxit përdorimin e spektrit të radios, duke përfshirë dhe bashkëpërdorimin, sipas autorizimit të përgjithshëm, siç përcaktohet në nenin 26, të këtij ligji dhe kufizon dhënien e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e frekuencave, në situatat kur kufizimi i këtyre të drejtave është i nevojshëm për të maksimizuar përdorimin efikas të spektrit dhe sipas kërkesës. Në të gjitha rastet e tjera, AKEP-i përcakton kushtet për përdorimin e spektrit të radios në një autorizim të përgjithshëm.</p> <p>2. Kur përdorimi i radiofrekuencave, nuk është subjekt vetëm i autorizimit të përgjithshëm, sipas pikës 8 të nenit 68, të këtij ligji, apo i nënshtrohet një konkurrimi publik, sipas këtij ligji, AKEP-i lëshon një autorizimin individual sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, duke përcaktuar kushtet për shfrytëzimin e radiofrekuencave. Nëse AKEP-i merr aplikime të ndryshme për autorizime individuale në të njëjtin brez frekuencash, ai i shqyrton ato sipas rradhës së paraqitjes.</p> <p>3. Përcaktimi i regjimit më të përshtatshëm të autorizimit për përdorimin e spektrit të frekuencave bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) karakteristikat specifike të spektrit radio të përfshirë; b) nevojën për shmangien e interferencave të dëmshme; c) zhvillimin e kushteve të besueshme për përdorimin e përbashkët të spektrit radio kur është e përshtatshme; d) nevojën për sigurimin e cilësisë teknike të | F | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>përdorimit të përbashkët të spektrit të radios në bazë të një kombinimi të autorizimit të përgjithshëm dhe të drejtave individuale të përdorimit.</p> <p>Kur është e përshtatshme, Shtetet Anëtare do të konsiderojnë mundësinë e autorizimit të përdorimit të spektrit të radios, bazuar në një kombinim të autorizimit të përgjithshëm dhe të drejtave individuale të përdorimit, duke marrë parasysh efektet e mundshme të kombinimeve të ndryshme të autorizimeve të përgjithshme dhe të drejtave individuale të përdorimit dhe të transferimeve graduale nga një kategori në tjetrën për konkurrencën, inovacionin dhe hyrjen në treg.</p> <p>Shtetet Anëtare do të kërkojnë të minimizojnë kufizimet në përdorimin e spektrit të radios duke marrë parasysh zgjidhjet teknologjike për administrimin e interferencave të dëmshme, në mënyrë që të imponohet regjimi më pak i rëndëi mundshëm i autorizimit.</p> <p>2. Kur marrin një vendim në bazë të paragrafit 1, me qëllim të lehtësimit të përdorimit të përbashkët të spektrit të radios, autoritetet kompetente sigurojnë që kushtet për përdorimin e përbashkët të spektrit të radios, janë përcaktuar qartë. Kushtet e tilla do të lehtësojnë përdorimin efikas të spektrit radio, konkurrencën dhe inovacionin.</p> | | <p>komunikimeve ose shërbimeve;</p> <p>e) objektivat e interesit të përgjithshëm sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>f) sigurimin e përdorimit eficient të spektrit radio.</p> <p>4. Lëshimi i autorizimeve të radiofrekuencave, bëhet në përputhje me përcaktimet në Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin për Përdorimin e Frekuencave, mbi baza jodiskriminuese, transparente dhe objektive.</p> <p>5. Autorizimet për përdorimin e radio-frekuencave lëshohen nga AKEP-i vetëm nëse:</p> <p>a) qëllimi i një përdorimi të tillë është parashikuar në Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe Planin për Përdorimin e Radio-Frekuencave;</p> <p>b) radio-frekuencat janë të disponueshme për përdorim;</p> <p>c) ato garantojnë pajtueshmërinë me përdorimin e frekuencave të tjera;</p> <p>ç) sigurohet përdorimi i frytshëm dhe pa interferenca nga aplikanti.</p> <p>6. Autorizimi individual për radiofrekuencën, lëshohet në bazë të një aplikimi të paraqitur në AKEP, i cili duhet të përfshijë si më poshtë:</p> <p>a) emrin dhe adresën e sipërmarrjes;</p> <p>b) të dhënat e regjistrimit;</p> <p>c) personin ose pikën e kontaktit të sipërmarrësit;</p> <p>ç) shpjegimet mbi nevojën e përdorimit të radio-frekuencave;</p> <p>d) zgjidhjet teknike, veçanërisht të dhënat për zonën gjeografike të përdorimit, metodën e përhapjes së radios, llogaritjen dhe përcaktimin e zonës së shërbimit, të dhënat gjeodezike për vendndodhjen e transmetuesit, fuqinë, modulimin dhe llojin e transmetimit, sistemin e antenës dhe pajisjet e radios.</p> <p>7. AKEP-i lëshon një autorizim individual brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së një kërkesë të plotësuar sipas pikave 4 dhe 5, të këtij neni.</p> <p>8. AKEP-i refuzon lëshimin e një autorizimi individual kur:</p> <p>a) aplikanti ka pasur një vendim për caktimin e radio-frekuencave, i cili është revokuar në 5 vitet e fundit për shkak të shkeljes së ligjit;</p> <p>b) caktimi i radio-frekuencave nuk garanton një përdorim efikas të spektrit të radio-frekuencave;</p> <p>c) sinjali i pajisjes radio do të shkaktoje ndërhyrje të dëmshme të pashmangshme në pajisje të tjera radio, ose sisteme elektrike ose elektronike;</p> <p>ç) dhënia e autorizimit rrezikon rendin publik ose sigurinë kombëtare.</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|--------|--|---------|--|--|--|--|
| | | | | <p>9. Kur është e përshtatshme, AKEP-i shqyrton mundësinë e dhënies së autorizimit të përdorimit të spektrit të radios, bazuar në një kombinim të autorizimit të përgjithshëm dhe të drejtave individuale të përdorimit, duke marrë parasysh efektet e mundshme të kombinimeve të ndryshme të të drejtave individuale të përdorimit dhe autorizimeve të përgjithshme dhe transferimeve graduale, nga një kategori në tjetrën, për konkurrencën, inovacionin dhe hyrjen në treg.</p> <p>10. AKEP-i dhe autoritetet e tjera kompetente, kur marrin një vendim sipas këtij neni, me qëllim lehtësimin e përdorimit të përbashkët të spektrit të radios, sigurojnë që kushtet për përdorimin e përbashkët të spektrit të radios të përcaktohen qartë. Kushtet e tilla lehtësojnë përdorimin efikas të spektrit të radios, konkurrencën dhe inovacionin.</p> <p>11. AKEP-i lëshon autorizime për përdorimin e radio frekuencave të destinuara për qëllime kërkimi, matjeje dhe vërtetimi të pajisjeve radiokomunikuese për një zonë të kufizuar mbulimi, por jo më shumë se 120 ditë.</p> | | |
| Neni47 | <p style="text-align: center;">Neni 47 Kushtet bashkëlidhur me të drejtat individuale të përdorimit për spektrin radio</p> <p>1. Autoritetet kompetente do të bashkëlidhin kushte me të drejtat individuale të përdorimit të spektrit të radios në përputhje me nenin 13 (1), në mënyrë të tillë që të sigurojnë përdorimin optimal dhe më të efektshëm dhe efikas të spektrit të radios. Ata, përpara caktimit ose rinovimit të këtyre të drejtave, përcaktojnë qartë çdo kusht të tillë, përfshirë nivelin e përdorimit të kërkuar dhe mundësinë e përbushjes së kësaj kërkesë përmes tregtimit ose dhënies me qira, në mënyrë që të sigurojnë zbatimin e atyre kushteve në përputhje me nenin 30. Kushtet e bashkëlidhura për rinovimin e së drejtës së përdorimit për spektrin radio, nuk do të ofrojnë përparësi të panevojshme për mbajtësit ekzistues të atyre të drejtave.</p> <p>Kushtet e tilla specifikojnë parametrat e zbatueshme, përfshirë çdo afat kohor, për ushtrimin e të drejtave të përdorimit, mos përbushja e të cilave do t'i jepte të drejtë autoriteteve kompetente të tërhiqnin të drejtën e përdorimit ose të impononin masa të tjera. Autoritetet kompetente, në kohën e duhur dhe në mënyrë transparente, do të konsultohen dhe informojnë palët e interesuara në lidhje me kushtet e bashkëlidhura me të drejtat individuale të përdorimit përpara shqiptimit të tyre. Ata përcaktojnë paraprakisht dhe informojnë palët e interesuara, në mënyrë transparente, për kriteret për vlerësimin e përbushjes së këtyre kushteve.</p> <p>2. Kur u bashkëlidhen kushtet të drejtave individuale të përdorimit për spektrin radio, autoritetet kompetente, me qëllim të sigurimit të përdorimit efektiv dhe efikas të spektrit të radios ose</p> | Neni 67 | <p style="text-align: center;">Neni 67 Kushtet që i bashkëngjiten të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e frekuencave</p> <p>1. AKEP-i vendos kushte të të drejtave individuale të përdorimit të spektrit të radios, në përputhje me nenin 28 dhe 31, të këtij ligji, në mënyrë që të sigurojë përdorimin optimal, efektiv dhe efikas të spektrit të radios. Kushtet që i bashkëngjiten rinovimit të së drejtës së përdorimit për spektrin e frekuencave, nuk ofrojnë avantazhe të panevojshme për mbajtësit ekzistues të këtyre të drejtave.</p> <p>2. AKEP-i përpara dhënies ose rinovimit të këtyre të drejtave, përcakton qartë kushtet e detajuara në këtë pikë, duke përfshirë kur është e nevojshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) kërkesat në lidhje me mbulimin dhe intensitetin e sinjalit, fuqinë e transmetimit; b) nivelin e përdorimit të kërkuar dhe mundësinë për të përbushur këtë kërkesë, nëpërmjet transferimit ose qiradhënies, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i kushteve të vendosura sipas nenit 28 e vijues, të këtij ligji; c) kushtet teknike dhe operacionale të nevojshme për shmangien e ndërhyrjeve të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike; ç) kohëzgjatjen e së drejtës për të përdorur radio-frekuencat; d) nëse lejohet transferimi i të drejtave të përdorimit të frekuencave për atë frekuencë si dhe kushtet për | F | | |

| | | | | | | |
|--------|---|--|---------|---|---|--|
| | <p>promovimit të mbulimit, do të parashikojnë mundësitë e mëposhtme:</p> <p>(a) ndarja e infrastrukturës pasive ose aktive që mbështetet në spektrin radio ose spektrin e radios;</p> <p>(b) marrëveshjet e hyrjes në roaming komercial;</p> <p>(c) Përdorimi i përbashkët i infrastrukturave të ndërtuara për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve që mbështeten në përdorimin e spektrit të radios.</p> <p>Autoritetet kompetente nuk parandalojnë ndarjen e spektrit të radios në kushtet e bashkëlidhura me të drejtat e përdorimit të spektrit radio. Zbatimi nga ndërmarrjet e kushteve të bashkëlidhura, në bazë të këtij paragrafi, mbetet subjekt i ligjit të konkurrencës.</p> | | | <p>një transferim të tillë;</p> <p>dh) pagesat përkatëse për caktimin dhe përdorimin e frekuencave;</p> <p>d) detyrimet shtesë të ndërmarra nga një ofertues i përzgjedhur nëpërmjet një procesi konkurrimi, tenderimi publik për ndërtimin e një rrjeti komunikimi elektronik;</p> <p>ë) detyrimet që lidhen me aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon.</p> <p>3. Kushtet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, specifikojnë të gjithë parametrat e zbatueshëm, duke përfshirë dhe kohëzgjatjen e të drejtave të përdorimit, mospërmbushja e të cilave i jep të drejtë AKEP-it, të revokojë të drejtën e përdorimit, ose të vendosë masa të tjera sipas këtij ligji.</p> <p>4. AKEP-i konsultohet dhe informon në kohën e duhur palët e interesuara në lidhje me kushtet që i bashkëlidhen të drejtave individuale të përdorimit, përpara vendosjes së tyre. AKEP-i informon palët e interesuara, në mënyrë transparente, për kriteret e vlerësimit mbi përmbushjen e këtyre kushteve.</p> <p>5. AKEP-i, kur vendos kushtet e të drejtave individuale të përdorimit të spektrit të radios, veçanërisht në funksion të garantimit të përdorimit efektiv dhe efikas të spektrit të radios ose për të nxitur mbulimin, parashikon mundësitë e mëposhtme:</p> <p>a) bashkëpërdorimin e infrastrukturës pasive ose aktive që lidhet me spektrin e frekuencave;</p> <p>b) marrëveshjet tregtare të aksesit në roaming;</p> <p>c) vendosjen e përbashkët të infrastrukturës për ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve që mbështeten në përdorimin e spektrit të radios.</p> <p>6. AKEP-i nuk pengon bashkëpërdorimin e spektrit të radios në kushtet që i bashkëlidhen të drejtave të përdorimit për spektrin e frekuencave. Zbatimi nga sipërmarrësit i kushteve të bashkangjitura në bazë të kësaj pike, është subjekt i ligjit të konkurrencës.</p> | | |
| Neni48 | <p style="text-align: center;">Seksioni 2 Të drejtat e përdorimit</p> <p style="text-align: center;">NENI 48 Dhënia e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin</p> <p>1. Kur është e nevojshme të jepen të drejta individuale të përdorimit për spektrin e radios, Shtetet Anëtare u japin të drejta të tilla, sipas kërkesës, çdo ndërmarrjeje për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nën autorizimin e përgjithshëm të përmendur në nenin 12, subjekt i Neni 13, në pikën (c) të nenit 21 (1) dhe nenit 55 dhe rregullat e tjera që</p> | | Neni 68 | <p style="text-align: center;">SEKSIONI 2 E DREJTA E PËRDORIMIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 68 Dhënia e të drejtave individuale të përdorimit të spektrit të radios</p> <p>1. Personat fizikë ose juridikë përdorin radiofrekuencat vetëm me autorizimin e AKEP-it, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Kur është e nevojshme të jepen të drejta individuale të përdorimit të spektrit të radios, AKEP-i i jep këto të drejta, me marrjen e kërkesës, për çdo sipërmarrjeje për ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas autorizimit të</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>sigurojnë përdorimin efikas të këtyre burimeve në përputhje me këtë Direktivë.</p> <p>2. Pa cënuar kriteret specifike dhe procedurat e miratuara nga Shtetet Anëtare, për të dhënë të drejta individuale të përdorimit për spektër radio për ofruesit e shërbimeve me përmbajtje transmetimi radio ose televizive, me qëllim ndjekjen e objektivave të interesit të përgjithshëm në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, të drejtat individuale të përdorimit për spektrin e radios do të jepen përmes procedurave të hapura, objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale, dhe në përputhje me nenin 45.</p> <p>3. Një përjashtim nga kërkesa e procedurave të hapura mund të zbatohet kur dhënia e të drejtave individuale të përdorimit të spektrit të radios për ofruesit e shërbimeve me përmbajtje transmetimi radio ose televizive, është e nevojshme për të arritur një objektiv të interesit të përgjithshëm, si përcaktohet nga Shtetet Anëtare, në përputhje me Ligjin e Bashkimit Evropian.</p> <p>4. Autoritetet kompetente, marrin në konsideratë aplikimet për të drejtat individuale të përdorimit për spektrin radio në kontekstin e procedurave të përzgjedhjes, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë objektive, transparente, proporcionale dhe jo-diskriminuese, të përcaktuara paraprakisht dhe pasqyrojnë kushtet që duhet t'i bashkohen këtyre të drejtave. Autoritetet kompetente do të jenë në gjendje të kërkojnë të gjithë informacionin e nevojshëm nga aplikantët në mënyrë që të vlerësojnë, në bazë të këtyre kriterëve, aftësinë e tyre për t'u përshtatur me këto kushte. Kur autoriteti kompetent konstaton se një aplikant nuk posedon aftësinë e kërkuar, ai duhet të sigurojë një vendim të arsyetuar siç duhet për këtë qëllim.</p> <p>5. Kur jepen të drejta individuale të përdorimit për spektrin e radios, Shtetet Anëtare do të specifikojnë nëse ato të drejta mund të transferohen ose jepen me qira nga mbajtësi i të drejtave, dhe në cilat kushte. Nenin 45 dhe 51 do të zbatohen.</p> <p>6. Autoriteti kompetent merr, komunikon dhe bën publike vendimet për dhënien e të drejtave individuale të përdorimit të spektrit të radios sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së aplikimit të plotë dhe brenda gjashtë javësh në rastin e spektrit të radios të deklaruar, në dispozicion për shërbimet e komunikimit elektronik në Planin e tyre Kombëtar të Alokimit të Frekuencave. Ky afat kohor nuk do të cenojë nenin 55 (7) dhe çdo marrëveshje ndërkombëtare të zbatueshme, në lidhje me përdorimin e spektrit të radios ose pozicioneve orbitale. Section 2</p> | | <p>përgjithshëm apo me autorizim individual, duke siguruar në çdo rast shfrytëzimin efikas të këtyre burimeve në përputhje me këtë ligj.</p> <p>2. Të drejtat individuale të përdorimit të spektrit të radios, jepen nëpërmjet procedurave të hapura, objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale dhe në përputhje me nenin 59, e në vijim të këtij ligji.</p> <p>3. Një përjashtim nga kërkesa e procedurave të hapura, zbatohet kur dhënia e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e frekuencave për ofruesit e shërbimeve të përmbajtjes së transmetimit radio ose televiziv, është e nevojshme për të arritur një objektiv të interesit të përgjithshëm në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>4. AKEP-i shqyrton aplikimet për të drejtat individuale të përdorimit të spektrit të radios në kuadër të procedurave të përzgjedhjes në zbatim të kriterëve objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese të pranueshmërisë, të përcaktuara paraprakisht dhe që pasqyrojnë kushtet që u duhen bashkëngjitur të drejtave të tilla. AKEP-i kërkon nga aplikuesit të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar, mbi bazën e këtyre kriterëve, aftësinë e tyre për të përmbushur këto kriterë. Në rastet kur AKEP-i konkludon se një aplikant nuk përmbush kriteret e vendosura, aplikimi refuzohet me vendim të arsyetuar.</p> <p>5. Gjatë procesit të dhënies së të drejtave të përdorimit, AKEP-i dhe organet e tjera kompetente, përcaktojnë nëse këto të drejta mund të transferohen ose të jepen me qira nga mbajtësi i të drejtave dhe në cilat kushte.</p> <p>6. AKEP-i merr të gjitha masat e nevojshme kur frekuencat përdoren në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloret përkatëse dhe pa autorizimin e dhënë sipas këtij ligji.</p> <p>7. Nuk kërkohet autorizim nga AKEP-i për radiofrekuencat e përdorura sipas Planit Kombëtar të Radio-Frekuencave, për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.</p> <p>8. Disa frekuenca mund të përdoren pa autorizim, sipas kushteve të autorizimit të përgjithshëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe në përputhje me rregullat dhe detyrimet ndërkombëtare të pranura nga Republika e Shqipërisë.</p> <p>9. Me marrjen e një aplikimi të plotësuar për dhënie të përdorimit të frekuencave, AKEP merr vendim për sa më shpejt pas marrjes së aplikimit të plotësuar dhe brenda gjashtë javësh nëse sipas Planit Kombëtar të Frekuencave, spektri i frekuencave është i disponueshëm për shërbimet e komunikimeve elektronike. Vendimi i AKEP komunikohet dhe bëhet publik në faqen e institucionit.</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|---------------|---|---------|---|--|--|
| | | | | 10. Afati kohor sipas pikës 9 të këtij neni, nuk paragjykon zbatimin e procedurave të parashikuara të nenit 75 dhe 76 të këtij ligji si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e spektrit radio apo për pozicionet orbitale. | |
| Neni49 | <p style="text-align: center;">Neni 49 Kohëzgjatja e të drejtave</p> <p>1. Kur Shtetet Anëtare autorizojnë përdorimin e spektrit të radios, përmes të drejtave individuale të përdorimit për një periudhë të kufizuar, ata sigurojnë që e drejta e përdorimit të jepet për një periudhë të përshtatshme, në dritën e objektivave të ndjekura në përputhje me nenin 55 (2), duke marrë parasysh nevojën për të siguruar konkurrencën, si dhe në veçanti përdorimin efektiv dhe efikas të spektrit radio, dhe për të promovuar inovacionin dhe investimet efikase, duke përfshirë dhe duke lejuar një periudhë të përshtatshme për amortizimin e investimeve.</p> <p>2. Kur Shtetet Anëtare japin të drejta individuale të përdorimit për spektrin e radios, për të cilat kushtet e harmonizuara janë caktuar me masa teknike, zbatimi në përputhje me Vendimin Nr. 676/2002/EC, në mënyrë që të mundësojnë përdorimin e tij për shërbimet e komunikimit elektronik me valë të gjerë ("shërbimetBroadband wireless") për një periudhë të kufizuar, ata sigurojnë parashikueshmëri rregullatore për mbajtësit e të drejtave, për një periudhë të paktën 20 vjet në lidhje me kushtet për investime në infrastrukturë, që mbështeten në përdorimin e një spektri të tillë radio, duke marrë parasysh kërkesat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. Ky Nen i nënshtrohet, kur është e nevojshme, çdo modifikimi të kushteve që i bashkëlidhen atyre të drejtave të përdorimit, në përputhje me nenin 18.</p> <p>Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare sigurojnë që këto të drejta të jenë të vlefshme për një kohëzgjatje të paktën 15 vjet dhe të përfshijnë, kur është e nevojshme në përputhje me nënparagrafin e parë, një shtrirje të përshtatshme të tij, nën kushtet e përcaktuara në këtë paragraf.</p> <p>Shtetet Anëtare do të mundësojnë kriteret e përgjithshme për një zgjatje të kohës së të drejtave të përdorimit, në mënyrë transparente, për të gjitha palët e interesuara, përpara se të japin të drejtat e përdorimit, si pjesë e kushteve të përcaktuara në nenin 55 (3) dhe (6). Kriteret të tilla të përgjithshme kanë të bëjnë me:</p> <p>(a) nevoja për të siguruar përdorimin efektiv dhe efikas të spektrit të radios në fjalë, objektivat e ndjekura në pikat (a) dhe (b) të nenit 45 (2), ose nevojën për të përmbushur objektivat e interesit të përgjithshëm që lidhen me sigurimin e jetës, rendin publik, siguria publike ose mbrojtja; dhe</p> | Neni 69 | <p style="text-align: center;">Neni 69 Kohëzgjatja e të drejtave</p> <p>1. AKEP përcakton kohëzgjatjen e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të dhëna në përputhje me këtë ligj, për një periudhë të kufizuar kohore, duke marrë parasysh sigurimin e konkurrencës në treg, përdorimin efektiv dhe eficient të spektrit të frekuencave, promovimin e inovacionit dhe investimet efikase, dhe një periudhë të përshtatshme për kthimin e investimeve në dritën e objektivave në përputhje me nenin 75, të këtij ligji.</p> <p>2. Në dhënien e autorizimeve individuale për përdorimin e spektrit të frekuencave, për të cilin janë vendosur kushtet e harmonizimit me masa teknike zbatimi sipas këtij ligji, me qëllim mundësimin e përdorimit të tij për shërbimet e komunikimeve elektronike broadband të lëvizshëm, pa tel, për një periudhë të kufizuar, AKEP siguron parashikueshmëri rregullatore për mbajtësit e të drejtave, për një periudhë të paktën 20 vjet, në lidhje me kushtet për investime në infrastrukturë që mbështeten në përdorimin e këtyre frekuencave, dhe duke marrë në konsideratë kërkesat sipas pikës 1 të këtij neni. Parashikimet e këtij neni i nënshtrohen, kur është e nevojshme, çdo modifikimi të kushteve që i bashkëlidhen këtyre të drejtave të përdorimit, në përputhje me nenin 37, të këtij ligji.</p> <p>3. Kohëzgjatja e autorizimeve individuale për të drejtat e përdorimit të përmendura në pikën 2, të këtij neni, është të paktën 15 vjet dhe përfshin, kur është e nevojshme në përputhje me pikën 1 të këtij neni, një zgjatje të afatit të drejtave të përdorimit për pesë vjet, sipas përcaktimeve në këtë nen.</p> <p>4. AKEP vë në dispozicion në mënyrë transparente, për të gjitha palët e interesuara, kriteret e përgjithshme për zgjatjen e afatit të të drejtave të përdorimit sipas kësaj pike, përpara se të jepen të drejtat e përdorimit, si pjesë e kushteve të përcaktuara në nenin 75, të këtij ligji.</p> <p>5. Kriteret e përgjithshme sipas pikës 4, të këtij neni, kanë të bëjnë me:</p> <p>a) nevojën për të siguruar përdorimin efektiv dhe efikas të spektrit radio në fjalë, objektivat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, ose nevojën</p> | F | |

| | | | | | |
|--|---|--|--|---|--|
| | <p>(b) nevoja për të siguruar një konkurrencë të drejtë.</p> <p>Në dy vitet e fundit, para skadimit të kohëzgjatjes fillestare të një të drejte individuale të përdorimit, autoriteti kompetent kryen një vlerësim objektiv dhe largpamës të kritereve të përgjithshme të përcaktuara, për afatin e kohëzgjatjes së asaj të drejte të përdorimit në pikën(c) të nenit 45 (2). Me kusht që autoriteti kompetent të mos ketë filluar veprime përmbartimore për mosrespektimin e kushteve të të drejtave të përdorimit në pajtim me nenin 30, ai do të japë afatin e kohëzgjatjes së të drejtës së përdorimit, përveç nëse konkludon se një afat i tillë nuk do të pajtohej me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën (a) ose (b) të nënparagrafit të tretë të këtij paragrafi.</p> <p>Në bazë të këtij vlerësimi, autoriteti kompetent njofton mbajtësin e së drejtës, nëse do të jepet afati i kohëzgjatjes së të drejtës të përdorimit.</p> <p>Nëse nuk do të jepet një afat i tillë, autoriteti kompetent do të zbatojë nenin 48 për dhënien e të drejtave të përdorimit për atë brez specifik të spektrit radio.</p> <p>Çdo masë sipas këtij paragrafi do të jetë proporcionale, jodiskriminuese, transparente dhe e arsyetuar.</p> <p>Nepërmjet derogimit të nenit 23, palët e interesuara do të kenë mundësinë të komentojnë çdo draft masë në përputhje me nënparagrafët e tretë dhe të katërt të këtij paragrafi për një periudhë të paktën tre mujore.</p> <p>Ky paragraf nuk cenon zbatimin e neneve 19 dhe 30.</p> <p>Kur vendosen tarifa për të drejtat e përdorimit, Shtetet Anëtare do të marrin parasysh mekanizmin e parashikuar në këtë paragraf.</p> <p>3. Kur justifikohet siç duhet, Shtetet Anëtare mund të derogojnë nga paragrafi 2 i këtij neni, në rastet e mëposhtme:</p> <p>(a) në zona të kufizuara gjeografike, kur hyrja në rrjetet me shpejtësi të lartë është jashtëzakonisht e pakët ose mungon dhe kjo është e nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave të nenit 45 (2);</p> <p>(b) për projekte specifike afatshkurtra;</p> <p>(c) për përdorim eksperimental;</p> <p>(d) për përdorime të spektrit të radios, të cilat, në përputhje me nenin 45 (4) dhe (5), mund të bashkëtojnë me shërbimet e broadband wireless;</p> <p>(e) për përdorim alternativ të spektrit të radios në përputhje me nenin 45 (3).</p> <p>4. Shtetet Anëtare mund të rregullojnë kohëzgjatjen e të drejtave të përdorimit të përcaktuara në këtë nen, për të siguruar skadimin e menjëhershëm të kohëzgjatjes së të drejtave në një ose disa breza.</p> | | | <p>për të përmbushur objektivat e interesit të përgjithshëm që lidhen me mbrojtjen e jetës njerëzore, me rendin publik, sigurinë publike ose mbrojtjen; dhe</p> <p>b) nevojën për të siguruar konkurrencë të drejtë.</p> <p>6. Dy vjet para përfundimit të kohëzgjatjes fillestare të një të drejte individuale të përdorimit, AKEP kryen një vlerësim objektiv dhe largpamës të kritereve të përgjithshme të përcaktuara për zgjatjen e kohëzgjatjes së të drejtës së përdorimit dhe parashikimet sipas shkronjës c) të pikës 3 të nenit 60, të këtij ligji.</p> <p>7. Me kushtin që AKEP, nuk ka filluar ndonjë procedim administrativ për mospërmbushje të kushteve të drejtave të përdorimit sipas këtij ligji, AKEP zgjat vlefshmërinë e kohëzgjatjes së të drejtës së përdorimit, nëse nuk arrin në përfundimin se zgjatja e afatit nuk përputhet me kriteret e përgjithshme të përcaktuara sipas pikës 5 të këtij neni. Në përfundim të vlerësimit AKEP njofton mbajtësin e së drejtës nëse kohëzgjatja e të drejtës do të jepet ose jo.</p> <p>8. Kur kohëzgjatja e të drejtës nuk miratohet, dhe mbajtësi i së drejtës së përdorimit nuk është shprehur për zgjatjen e vlefshmërisë pas kalimit të një periudhe prej të paktën tre muajsh, AKEP ricakton brezin e spektrit sipas parashikimeve të këtij ligji. Dispozita e mësipërme nuk paragjykojnë parashikimet e nenit 37 dhe nenit 181 e në vijim të këtij ligji.</p> <p>9. AKEP mund të shmangë pikat 2 deri në 9 të këtij neni, në rastet e justifikuara si më poshtë:</p> <p>a) në zona të kufizuara gjeografike, ku aksesimi në rrjetet me shpejtësi të lartë është shumë i mangët ose mungon dhe kjo është e nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave sipas pikës 3 të nenit 60 të këtij ligji;</p> <p>b) me kërkesë të mbajtësit të të drejtave për projekte afatshkurtra;</p> <p>c) për përdorim eksperimental;</p> <p>d) për përdorime të spektrit të radios që, në përputhje me nenin 62, të këtij ligji mund të bashkëtojnë me shërbimet broadband pa tel; ose</p> <p>e) për përdorim alternativ të spektrit të radios në përputhje me nenin 61, të këtij ligji.</p> <p>10. AKEP mund të rregullojë afatin e përdorimit të të drejtave sipas këtij neni, për të siguruar përfundimin e njëkohshëm të tyre, në një ose disa breza frekuencash, vetëm në rastet kur ricaktimi, rialokimi i të drejtave njëkohësisht rrit efikasitetin e përdorimit të spektrit.</p> | |
|--|---|--|--|---|--|

| | | | | | |
|---------------|--|----------------|--|----------|--|
| <p>Neni50</p> | <p style="text-align: center;">Neni 50</p> <p>Rinovimi i të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të radios</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente marrin një vendim për rinovimin e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të radios, në kohën e duhur, para se të skadojë kohëzgjatja e atyre të drejtave, përveçse kur në kohën e caktimit, mundësia e rinovimit ka qenë përjashtuar në mënyrë të qartë. Për këtë qëllim, këto autoritete do të vlerësojnë nevojën për një rinovim të tillë me iniciativën e tyre ose me kërkesë të mbajtësit të së drejtës, në rastin e fundit jo më vonë se pesë vjet para skadimit të kohëzgjatjes së të drejtave të interesuara. Kjo nuk do të cenojë klauzolat e rinovimit, të zbatueshme për të drejtat ekzistuese.</p> <p>2. Në marrjen e një vendimi, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet kompetente marrin parasysh:</p> <p>(a) përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 3, nenin 45 (2) dhe nenin 48 (2), si dhe objektivat e politikës publike sipas Bashkimit Evropian ose ligjit kombëtar;</p> <p>(b) zbatimin e një teknike të miratuar, në përputhje me nenin 4 të Vendimit Nr. 676/2002 / EC;</p> <p>(c) rishikimin e zbatimit të duhur të kushteve bashkëlidhur të së drejtës në fjalë;</p> <p>(d) nevojën për të promovuar, ose shmangur çdo shtrembërim të konkurrencës, në përputhje me nenin 52;</p> <p>(e) nevojën për ta bërë përdorimin e spektrit të radios më efikas në dritën e evolucionit teknologjik ose të tregut;</p> <p>(f) nevojën për të shmangur ndërprerjen e shërbimit.</p> <p>3. Kur shqyrtojnë rinovimin e mundshëm të të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të radios, për të cilin numri i të drejtave të përdorimit është i kufizuar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, autoritetet kompetente kryejnë një procedurë të hapur, transparente dhe jo-diskriminuese, dhe:</p> <p>(a) u japin të gjitha palëve të interesuara mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tyre përmes një konsultimi publik, në përputhje me nenin 23;</p> <p>dhe</p> <p>(b) theksojnë qartë arsyet e një rinovimi të mundshëm. Autoriteti rregullator kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent, do të marrë parasysh çdo provë që vjen nga konsultimi, në përputhje me nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, të kërkesës së tregut nga ndërmarrje të ndryshme nga ato që kanë të drejta të përdorimit për spektër radio në brezin përkatës, kur vendosin nëse do të rinovojnë të drejtat e përdorimit ose për të organizuar një procedurë të re të përzgjedhjes me qëllim të dhënies së të drejtave të përdorimit në pajtim me nenin 55.</p> <p>4. Një vendim për rinovimin e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e harmonizuar të radios mund të shoqërohet me një rishikim të tarifave, si dhe të termave dhe</p> | <p>Neni 70</p> | <p style="text-align: center;">Neni 70</p> <p>Rinovimi i autorizimeve të radiofrekuencave</p> <p>1. Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, vlefshmëria e autorizimit mund të zgjatet vetëm nëse në fund të afatit të tij, plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara për përdorimin e radiofrekuencave.</p> <p>2. Kërkesat për rinovimin e vlefshmërisë së autorizimit të radio-frekuencave, dorëzohen jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë para skadimit të tij. Gjithashtu, në rastet e spektrit të dhënë në përdorim me tender publik, aplikime të tilla do të bëhen jo më herët se 5 vjet, por jo më vonë se 2 vjet para skadimit të tij.</p> <p>3. Në rast rinovimi, AKEP lëshon një autorizim të ri për radiofrekuencat, për një kohëzgjatje në përputhje me nenin 69, të këtij ligji. Në rastet e autorizimeve individuale të dhëna me konkurim, për të cilat numri i të drejtave është i kufizuar, rregullat dhe procedurat e rinovimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Këto rregulla përcaktojnë një procedurë të hapur, transparente dhe jo diskriminuese duke siguruar midis të tjerash:</p> <p>a) dhënien e mundësisë për gjithë palët e interesuara të shprehin mendimet e tyre përmes një procesi konsultimi publik sipas nenit 44 të këtij ligji;</p> <p>b) një shprehje të qartë të arsyeve për këtë rinovim të mundshëm;</p> <p>4. Vlefshmëria e autorizimeve të radiofrekuencave të destinuara për qëllime të kërkimit, matjeve dhe vërtetimit të pajisjeve radiokomunikuese dhe atyre të destinuara për ngjarje të veçanta nuk mund të zgjatet.</p> <p>5. AKEP dhe organet e tjera kompetente të cilat administrojnë spektrin e frekuencave, vendosin në dispozicion të gjithë palëve të interesuara, në mënyrë transparente, kriteret e përgjithshme për rinovimin e të drejtave të përdorimit, përpara dhënies së të drejtave të përdorimit, si pjesë e kushteve të parashikuara në nenin 75, të këtij ligji. Këto kritere të përgjithshme kanë të bëjnë me:</p> <p>a) nevojën për të siguruar përdorim efektiv dhe efikas të spektrit radio në fjalë, sipas objektivave të përcaktuara në nenin 5 dhe pikën 3 të nenit 60, të këtij ligji ose nevojën për të përmbushur objektivat e interesit të përgjithshëm që lidhen me sigurimin e jetës, rendit publik, sigurisë publike ose tëmbrojtjes;</p> <p>b) zbatimin e masave teknike për qëllime të harmonizimit ndërkufitar të spektrit të frekuencave;</p> | <p>F</p> | |
|---------------|--|----------------|--|----------|--|

| | | | | | | |
|----------------|---|--|---------|--|---|--|
| | <p>kushteve të tjera të bashkangjitura ato. Kur është e përshtatshme, rregullatorët kombëtarë ose autoritetet e tjera kompetente mund të rregullojnë tarifatat për të drejtat e përdorimit në përputhje me nenin 42.</p> | | | <p>c) rishikimin e zbatimit të duhur të kushteve që janë bashkëlidhur të drejtave të përdorimit;</p> <p>d) nevojën për të siguruar konkurrencë të drejtë;</p> <p>e) nevojën për një përdorim me efikas të spektrit të frekuencave në dritën e zhvillimit teknologjik ose të tregut;</p> <p>f) nevojën për shmangien e ndërprerjeve të rënda të shërbimit.</p> <p>6. Para vendimit për rinovimin e një autorizimi të të drejtave të përdorimit, apo për kryerjen e një procesi të ri përzgjedhjeje për dhënien e të drejtave të përdorimit sipas nenit 75 të këtij ligji, AKEP merr në konsideratë çdo mendim të paraqitur gjatë procesit të konsultimit të kryer sipas parashikimeve në pikën 3 të këtij neni, në lidhje me kërkesën e tregut nga sipërmarrës të ndryshëm nga mbajtësi i të drejtës së përdorimit të frekuencave në brezin në fjalë.</p> <p>7. Vendimi për rinovimin e të drejtave të përdorimit të spektrit të harmonizuar të frekuencave mund të shoqërohet me rishikimin e pagesave si dhe termave dhe kushteve bashkëlidhur të drejtës së përdorimit. Kur është rasti, AKEP bën rregullimin e pagesave për të drejtat e përdorimit në përputhje me parashikimet e nenit 21 të këtij ligji.</p> | | |
| Neni 51 | <p style="text-align: center;">Neni 51</p> <p style="text-align: center;">Transferimi ose marrja me qira e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin radio</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që ndërmarrjet mund të transferojnë ose t'i marrin me qira ndërmarrjeve të tjera të drejtat individuale të përdorimit të spektrit radio. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë që ky paragraf nuk zbatohet kur e drejta individuale e ndërmarrjes për përdorimin e spektrit të radios fillimisht u dha falas ose ishte caktuar për transmetim.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që qëllimi i një ndërmarrjeje për të transferuar ose marrë me qira të drejtat e përdorimit për spektrin radio, si dhe transferimin efektiv të tyre, njoftohet në përputhje me procedurat kombëtare tek autoriteti kompetent dhe bëhet publik. Në rastin e spektrit të harmonizuar të radios, çdo transferim i tillë duhet të përputhet me një përdorim të tillë të harmonizuar.</p> <p>3. Shtetet Anëtare do të lejojnë transferimin ose marrjen me qira të të drejtave të përdorimit për spektrin radio, ku ruhen kushtet origjinale të bashkëlidhura të drejtat e përdorimit. Pa cënuar nevojën për të siguruar mungesën e shtrembërimit të konkurrencës, në përputhje me nenin 52 Shtetet Anëtare duhet:</p> <p>(a) të paraqesin transferime dhe dhënie me qira me sa më pak procedurë;</p> | | Neni 71 | <p style="text-align: center;">Neni 71</p> <p style="text-align: center;">Transferimi ose dhënia me qira e të drejtave individuale të përdorimit për spektrin e frekuencave</p> <p>1. Një sipërmarrës, mbajtës i autorizimit individual për përdorimin e spektrit të frekuencave mund të transferojnë ose t'i japë me qira një sipërmarrësi tjetër, të drejtat e përdorimit të frekuencave, pas miratimit nga AKEP sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p> <p>2. Nuk lejohet transferimi i të drejtave për përdorimin e spektrit të frekuencave, kur kjo e drejtë është dhënë fillimisht pa pagesë ose për transmetime televizive.</p> <p>3. Qëllimi i një sipërmarrësi për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave, si dhe transferimi efektiv të tij, i njoftohet AKEP dhe bëhet publik. Në rastin e spektrit të harmonizuar të frekuencave, çdo transferim i të drejtave të përdorimit bëhet në përputhje me kërkesat për përdorimin e harmonizuar të spektrit.</p> <p>4. Me Vendim të Këshillit të Ministrave miratohen rregulla specifike për transferimin apo dhënien me qira të drejtave të përdorimit të frekuencave.</p> <p>5. Transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit për spektrin e frekuencave lejohet nga AKEP kur respektohen kushtet fillestare që i bashkëlidhen të drejtave të përdorimit.</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>(b) të mos refuzojë dhënien me qira të të drejtave të përdorimit për spektrin radio, ku qiradhënësi merr përsipër të mbetet përgjegjës për përmbushjen e kushteve origjinale, të bashkëlidhura me të drejtat e përdorimit;</p> <p>(c) të mos refuzojë transferimin e të drejtave të përdorimit për spektrin radio, përveçse nëse ekziston një rrezik i qartë që mbajtësi i ri nuk është në gjendje t'i plotësojë kushtet origjinale për të drejtën e përdorimit.</p> <p>Çdo ngarkesë administrative që u është imponuar ndërmarrjeve, në lidhje me përpunimin e një kërkesë për transferimin ose marrjen me qira të të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, do të jetë në përputhje me nenin 16.</p> <p>Pikat (a), (b) dhe (c) të nënparagrafit të parë nuk cenojnë kompetencën e Shteteve Anëtare për të detyruar respektimin e kushteve të bashkëlidhura me të drejtat e përdorimit në çdo kohë, si në lidhje me qiradhënësin ashtu edhe qiramarrësin, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar.</p> <p>Autoritetet kompetente do të lehtësojnë transferimin ose marrjen me qira të të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, duke marrë parasysh çdo kërkesë që përshtatet me kushtet e bashkëlidhura të drejtat në kohën e duhur dhe duke siguruar që ato të drejta ose spektri përkatës radio mund të jetë në masën e duhur që të ndahet ose të zbërthehet.</p> <p>Në dritën e çdo transferimi ose dhënie me qira të të drejtave të përdorimit për spektrin e radios, autoritetet kompetente duhet të japin detaje përkatëse në lidhje me të drejtat individuale të tregtueshme, të disponueshme publikisht, në një format elektronik të standardizuar kur krijohen të drejtat dhe i mbajnë ato detaje për atë kohë sa ekzistojnë të drejtat.</p> <p>Komisioni mund të miratojë akte zbatuese duke specifikuar ato detaje përkatëse.</p> <p>Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> | | <ol style="list-style-type: none"> 6. Siper marrësi mbajtës i të drejtës dhe subjekti që kërkon transferimin apo marrjen me qira të drejtës, bashkarisht paraqesin një kërkesë tek AKEP. AKEP në shqyrtimin e kërkesës mban parasysh që transferimi të mos shtrembërojë konkurrencën si dhe verifikon nëse subjekti tek i cili transferohen të drejtat plotëson kushtet për përdorimin e spektrit të frekuencave. 7. AKEP mund të refuzojë miratimin e transferimit me vendim, nëse ka dyshime të arsyeshme se subjekti që kërkon transferimin apo marrjen me qira të drejtave të përdorimit nuk i përmbush kërkesat për përdorimin e tyre sipas këtij ligji. 8. Pa paragjykuar nevojën për sigurimin e konkurrencës së drejtë e efektive sipas nenit 72, të këtij ligji, transferimi ose dhënia me qira e të drejtave të përdorimit bazohet në: <ol style="list-style-type: none"> a) procedura të thjeshta; b) mos refuzim të dhënis me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave nëse subjekti mbajtës i të drejtës merr përsipër të mbetet përgjegjës për plotësimin e kushteve fillestare që i bashkëngjiten të drejtave të përdorimit; c) mos refuzim të transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave, përveçse kur ekziston një rrezik i qartë që mbajtësi i ri nuk është në gjendje të përmbushë kushtet fillestare për të drejtën e përdorimit. 9. Çdo tarifë administrative e vendosur ndaj sipërmarrjeve, në lidhje me shqyrtimin e një kërkesë për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave duhet të jetë në përputhje me parimet e nenit 18, të këtij ligji; 10. Parashikimet sipas pikës 8 të këtij neni, nuk e cenojnë kompetencën e AKEP për të kërkuar respektimin e kushteve që i bashkëngjiten të drejtave të përdorimit në çdo kohë, si për dhënësin, ashtu edhe për marrësin e këtyre të drejtave, në përputhje me këtë ligj. 11. AKEP vlerëson në kohën e duhur çdo kërkesë për të përshtatur kushtet e bashkëngjitura me të drejtat e përdorimit dhe duke siguruar që ato të drejta ose spektri përkatës i radios, mund të ndahet ose të zbërthehet në mënyrën më të mirë. 12. AKEP publikon detajet përkatëse në lidhje me të drejtat individuale që mund të transferohen ose jepen me qera, në një format elektronik të standardizuar. | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--------|--|---------|---|---|--|
| Neni52 | <p style="text-align: center;">Neni 52 Konkurrenca</p> <p>1. Autoritetet Rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente promovojnë konkurrencën efektive dhe shmangin shtrembërimet e konkurrencës në tregun e brendshëm kur vendosin të japin, ndryshojnë ose rinovojnë të drejtat e përdorimit për spektrin radio për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në përputhje me këtë Direktivë.</p> <p>2. Kur Shtetet Anëtare japin, ndryshojnë ose rinovojnë të drejtat e përdorimit për spektrin e radios, autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente me këshillat e dhëna nga autoriteti rregullator kombëtar mund të ndër marrin masa të përshtatshme si:</p> <p>(a) kufizimin e sasisë së brezave të spektrit të radios për të cilat të drejtat e përdorimit iu jepen çdo ndërmarrjeje, ose në rrethana të arsyeshme, duke i bashkëlidhur kushte për të drejtat e tilla të përdorimit, siç është sigurimi i aksesit të shumicës, roaming kombëtar ose rajonal, ne banda te caktuara ose në grupe të caktuara bandash me karakteristika të ngjashme;</p> <p>(b) rezervimin, nëse është e përshtatshme dhe e arsyeshme në lidhje me një situatë specifike në tregun kombëtar, një pjesë të caktuar të një grupi të spektrit të radios ose një grupi bandash për caktimin e hyrësve të rinj;</p> <p>(c) refuzimin për të dhënë të drejta të reja të përdorimit për spektrin radio, ose për të lejuar përdorime të reja të spektrit të radios në grupe të caktuara, ose duke bashkangjitur kushte për dhënien e të drejtave të reja të përdorimit për spektrin radio ose autorizimin e përdorimeve të reja për spektrin radio, në mënyrë për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës nga çdo detyrë, transferimin ose akumulimin e të drejtave të përdorimit;</p> <p>(d) përfshirë kushtet që ndalojnë ose imponojnë kushte mbi transferimin e të drejtave të përdorimit të spektrit të radios, që nuk i nënshtrohen kontrollit të Bashkimit Evropian ose kontrollit kombëtar të bashkimit, kur transferime të tilla ka të ngjarë të sjellin dëme të konsiderueshme për konkurrencën;</p> <p>(e) ndryshimin e të drejtave ekzistuese në përputhje me këtë Direktivë kur kjo është e nevojshme për të korrigjuar një shtrembërim të konkurrencës nga çdo transferim ose akumulim i të drejtave të përdorimit për spektrin radio.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente, duke marrë parasysh kushtet e tregut dhe standardet në dispozicion, bazojnë vendimet e tyre në një vlerësim të përparuar objektiv të kushteve të konkurrencës së tregut, nëse masat e tilla janë të nevojshme për të ruajtur ose arritur një konkurrencë efektive, dhe efektet e mundshme të masave të tilla në investimet ekzistuese dhe të ardhshme nga pjesëmarrësit e tregut në veçanti për shtrimin e rrjetit. Duke vepruar kështu, ata do të marrin parasysh qasjen ndaj analizës së tregut, siç përcaktohet në nenin 67 (2).</p> | Neni 72 | <p style="text-align: center;">Neni 72 Konkurrenca</p> <p>1. AKEP-i, në dhënien, ndryshimin ose rinovimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave, të spektrit të frekuencave për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, mban parasysh promovimin e konkurrencës efektive dhe shmangien e shtrembërimëve të konkurrencës në treg në përputhje me këtë ligj.</p> <p>2. Kur AKEP-i jep, ndryshon ose rinovon të drejtat e përdorimit për spektrin e frekuencave, merr masat e duhura në lidhje me:</p> <p>a) kufizimin e sasisë të spektrit të frekuencave, për të cilin e drejta e përdorimit i jepet një sipërmarrjeje, ose, në rrethana të justifikuar, vendosjen e kushteve për të drejtat e përdorimit në breza të caktuar ose në blloqe të caktuara brezash frekuence me karakteristika të ngjashme, si ofrimi i aksesit në tregun e shumicës, roamingun kombëtar ose rajonal;</p> <p>b) rezervimin, nëse është e përshtatshme dhe e justifikuar në lidhje me një situatë specifike të tregut, të një pjese të caktuar të brezit të spektrit të radios ose grupi të brezave të frekuencave për hyrës të rinj në treg;</p> <p>c) refuzimin e dhënies së të drejtave të reja të përdorimit për spektrin e frekuencave ose lejimin e përdorimeve të reja të spektrit në breza të caktuar, ose shoqërimin e të drejtave të reja të përdorimit ose autorizimin e përdorimeve të reja të spektrit të frekuencave, për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës nga çdo caktim, transferim ose akumulim i të drejtave të përdorimit;</p> <p>ç) përfshirjen e kushteve që ndalojnë ose imponimin e kushteve për transferimet e të drejtave të përdorimit për spektrin e frekuencave, që nuk i nënshtrohen kontrollit të bashkimit, kur transferime të tilla çojnë në dëm të konsiderueshëm për konkurrencën;</p> <p>d) ndryshimin e të drejtave ekzistuese në përputhje me këtë ligj, kur kjo është e nevojshme, për të korrigjuar një deformim të konkurrencës nga çdo transferim ose akumulim i të drejtave të përdorimit të spektrit radio.</p> <p>3. AKEP, merr parasysh kushtet e tregut dhe standardet e disponueshme, si dhe e bazon vendimin e tij në një vlerësim objektiv dhe largpamës të kushteve konkurruese të tregut, nëse këto masa janë të nevojshme për ruajtjen ose arritjen e konkurrencës efektive, si dhe për efektet e mundshme të këtyre masave në investimet</p> | F | |
|--------|--|---------|---|---|--|

| | | | | | |
|--------|--|---------|---|--|--|
| | <p>3. Kur zbatohet paragrafi 2 i këtij neni, autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente veprojnë në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 18, 19, 23 dhe 35.</p> | | | <p>ekzistuese apo të ardhshme nga operatorët e tregut, veçanërisht për shtrirjen e rrjetit, në përputhje me parashikimet e pikës 2 të 90, të këtij ligji. Gjatë zbatimit të pikës 2, të këtij neni, AKEP-i dhe autoritetet e tjera kompetente, veprojnë në përputhje me parashikimet në nenet 37, 40, 44 dhe 50, të këtij ligji.</p> <p>4. Në lidhje me vendimet sipas këtij neni, AKEP-i njofton paraprakisht Autoritetin e Konkurrencës, kur ato kanë impakt në konkurrencën e tregut të komunikimeve elektronike.</p> | |
| Neni53 | <p style="text-align: center;">Seksioni 3 Procedurat</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Koha e koordinuar e detyrave</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të bashkëpunojnë, në mënyrë që të koordinojnë përdorimin e spektrit të harmonizuar të radios për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Bashkimin Evropian, duke marrë parasysh situatat e ndryshme të tregut kombëtar. Kjo mund të përfshijë identifikimin e një ose disa datave të zakonshme me të cilat do të autorizohet përdorimi i spektrit specifik të harmonizuar të radios.</p> <p>2. Kur kushtet e harmonizuara janë caktuar nga masat teknike të zbatimit, në përputhje me vendimin nr. 676/2002 / EC, në mënyrë që të mundësojnë përdorimin e spektrit të radios për rrjetet broadband wireless dhe shërbimet, Shtetet Anëtare lejojnë përdorimin e këtij spektri radio, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në 30 muajt e fundit pas miratimit të asaj mase, ose sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së çdo vendimi për të lejuar përdorimin alternative mbi një bazë ekspecionale, në përputhje me nenin 45 (3) të kësaj direktive. Kjo nuk cenon vendimin e (BE) 2017/899 dhe të drejtën e iniciativës së Komisionit për të propozuar akte legjislativë.</p> <p>3. Një Shtet Anëtar mund të vonojë afatin e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni për një grup specifik në këto rrethana:</p> <p>(a) në masën që justifikohet me një kufizim në përdorimin e kësaj bande bazuar në objektivin e interesit të përgjithshëm të parashikuar në pikën (a) ose (d) të nenit 45 (5);</p> <p>(b) në rastin e çështjeve të pazgjidhura të koordinimit ndërkufitar që rezultojnë në ndërhyrje të dëmshme me vendet e treta, me kusht që Shteti Anëtar i prekur ka kërkuar, ndihmën e Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 28 (5);</p> <p>(c) ruajtjen e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare; ose</p> <p>(d) forcës madhore.</p> <p>• Shteti Anëtar në fjalë do të rishikojë një vonesë të tillë të paktën çdo dy vjet.</p> <p>4. Një Shtet Anëtar mund të vonojë afatin e parashikuar në paragrafin 2 për një bandë specifike në masën e nevojshme dhe deri në 30 muajt në rastin e:</p> | Neni 73 | <p style="text-align: center;">SEKSIONI 3 PROCEDURAT</p> <p style="text-align: center;">Neni 73 Koordinimi në kohë i caktimeve</p> <p>1. AKEP-i bashkëpunon me autoritetet kompetente të vendeve të Bashkimit, për të koordinuar përdorimin e harmonizuar të spektrit të frekuencave, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, duke marrë parasysh situatën e tregjeve përkatëse për identifikimin e një, ose, sipas rastit, afateve të njëjta, për dhënien e autorizimeve për përdorimin e spektrit specifik të harmonizuar të frekuencave.</p> <p>2. Kur kushtet për harmonizimin e spektrit të radios janë arritur sipas masave teknike dhe praktikës së BE-së, me qëllim mundësimi të përdorimit të spektrit të frekuencave për rrjetet dhe shërbimet broadband pa tel, AKEP-i autorizon përdorimin e tij, sa më shpejt të jetë e mundur. Afati maksimal është 30 muajt pas miratimit të kësaj mase, ose sa më shpejt të jetë e mundur pas heqjes së çdo vendimi për lejimin e përdorimit alternativ në baza të jashtëzakonshme, sipas nenit 61, të këtij ligji.</p> <p>3. Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, për një brez të caktuar mund të zgjatet në rrethanat e mëposhtme:</p> <p>a) në masën që justifikohet nga një kufizim në përdorimin e atij brezi bazuar në objektivin e interesit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 62, të këtij ligji;</p> <p>b) në rastin e çështjeve të pazgjidhura të koordinimit ndërkufitar, që rezultojnë në ndërhyrje të dëmshme me vendet e treta;</p> <p>c) për ruajtjen e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare; ose</p> <p>ç) në rastin e forcave madhore.</p> <p>AKEP-i shqyrton këtë vonesë, të paktën çdo dy vjet.</p> <p>4. AKEP-i zgjat afatin e parashikuar në pikën 2, për një brez të caktuar në masën e nevojshme dhe deri në 30 muajt në rastet e:</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------------|---|--|--------------------|---|---|--|
| | <p>(a) çështjeve të koordinimit ndërkufitar të pazgjidhura që rezultojnë në ndërhyrje të dëmshme ndërmjet Shteteve Anëtare, me kusht që Shteti Anëtar i prekur të marrë të gjitha masat e nevojshme në kohën e duhur, në përputhje me nenin 28 (3) dhe (4);</p> <p>(b) nevojës për të siguruar kompleksitetin e sigurimit të migracionit teknik të përdoruesve ekzistues të asaj bande.</p> <p>5. Në rast të vonesës në paragrafin 3 ose 4, Shteti Anëtar i interesuar do të informojë Shtetet e tjera Anëtare dhe Komisionin në kohën e duhur, duke shprehur arsyet.</p> | | | <p>a) çështjeve të pazgjidhura të koordinimit ndërkufitar, që rezultojnë në ndërhyrje të dëmshme, me kusht që AKEP-i të marrë të gjitha masat e nevojshme në kohën e duhur, sipas nenit 49, të këtij ligji;</p> <p>b) nevojës për të siguruar, dhe kompleksitetin e sigurimit, të migrimit teknik të përdoruesve ekzistues të atij brezi.</p> <p>5. Në rastin e vonesave në procesin e parashikuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, AKEP informon organet rregullatore të vendeve të tjera ndërkufitare si dhe Komisionin Evropian duke dhënë arsyet për vonesat.</p> | | |
| Neni54 | <p style="text-align: center;">Neni 54</p> <p style="text-align: center;">Koha e koordinuar e detyrave për bandat specifike 5G</p> <p>1. Deri më 31 dhjetor 2020, për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime broadband wireless, Shtetet Anëtare për të lehtësuar përfshirjen e 5G, do të ndërmarrin të gjitha masat e duhura:</p> <p>(a) do të riorganizojnë dhe lejojnë përdorimin e blloqeve mjaft të mëdha të brezit 3.4-3.8 GHz;</p> <p>(b) do të lejojnë përdorimin e të paktën 1 GHz të bandës 24,25-27,5 GHz, me kusht që të ketë dëshmi të qartë të kërkesës së tregut dhe të mungesës së kufizimeve të rëndësishme për shpërnguljen e përdoruesve ekzistues ose pastrimin e heqjen e bandës.</p> <p>2. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të zgjasin afatin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, kur justifikohet, në përputhje me nenin 45 (3) ose nenin 53 (2), (3) ose (4).</p> <p>3. Masat e marra në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me kushtet e harmonizuara të përcaktuara nga masat teknike të zbatimit, në përputhje me nenin 4 të vendimit nr. 676/2002 / EC.</p> | | Neni 74 | <p style="text-align: center;">Neni 74</p> <p style="text-align: center;">Koordinimi kohor për brezat specifike 5G</p> <p>1. Për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime broadband të lëvizshme, pa tel, AKEP-i brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe kur është e nevojshme për të lehtësuar përhapjen e 5G, merr të gjitha masat e duhura për:</p> <p>a) riorganizimin dhe lejimin e përdorimit të blloqeve të mjaftueshme të brezit 3,4-3,8 GHz;</p> <p>b) lejimin e përdorimit e të paktën 1 GHz të brezit 24,25-27,5 GHz, me kusht që të ketë një evidencë të qartë të kërkesave të tregut dhe në mungesë të kufizimeve të rëndësishme për migrimin e përdoruesve ekzistues ose lirimin e brezit.</p> <p>2. AKEP-i zgjat afatin e parashtruar në pikën 1, kur kjo justifikohet, në përputhje me nenin 61 ose nenin 73, të këtij ligji, subjekt i harmonizimit në alokim me shtetet e tjera.</p> | P | |
| Neni55 | <p style="text-align: center;">Neni 55</p> <p style="text-align: center;">Procedura për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit që duhen dhënë për spektrin radio</p> <p>1. Pa cënuar nenin 53, kur një Shtet Anëtar konstaton se e drejta për të përdorur spektër radio nuk mund t'i nënshtrohet një autorizimi të përgjithshëm dhe kur ai merr në konsideratë nëse do të kufizojë numrin e të drejtave të përdorimit që do të jepen për spektrin e radios, do të:</p> <p>(a) thonë qartë arsyet e kufizimit të të drejtave të përdorimit, veçanërisht duke i dhënë peshë të duhur nevojës për të maksimizuar përfitimet për përdoruesit dhe për të lehtësuar zhvillimin e konkurrencës, dhe rishikuar kufizimin në interval të rregullt ose në kërkesën e arsyeshme e ndërmarrjeve të prekura;</p> <p>(b) japin të gjitha palëve të interesuara, përfshirë përdoruesit dhe konsumatorët, mundësinë për të shprehur</p> | | Neni 75 Neni 76 | <p style="text-align: center;">Neni 75</p> <p style="text-align: center;">Procedura për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit për spektrin e frekuencave</p> <p>1. Bazuar në vlerësimin e tregut, kur AKEP-i vlerëson se interesi për një brez të caktuar frekuencash, mund të tejkalojë disponueshmërinë e frekuencave në këtë brez dhe për të siguruar përdorimin efikas të tyre, kryen një proces konsultimi publik me palët e interesuara për kushtet e përdorimit të këtij brezi frekuencash dhe procedurën që do të zbatohet për alokimin e tyre.</p> <p>2. AKEP-i është i detyruar të zhvillojë procesin e konsultimit publik dhe me paraqitjen e një kërkesë nga çdo palë e interesuar për frekuenca specifike, jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e kërkesës. AKEP-i fillon procesin e konsultimit publik për frekuencat specifike që</p> | P | |

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>pikëpamjet e tyre për çdo kufizim përmes një konsultimi publik, në përputhje me nenin 23.</p> <p>2. Kur një Shtet Anëtar konstaton se numri i të drejtave të përdorimit duhet të jetë i kufizuar, ai përcakton qartë dhe jep arsyet për objektivat e ndjekura me anë të një procedure përzgjedhjeje konkurruese ose krahasuese, sipas këtij neni, dhe ku është e mundur të përcaktojë sasinë duke i dhënë peshë të duhur nevojës për të përmbushur objektivat e tregut kombëtar dhe të brendshëm. Objektivat që Shteti Anëtar mund të përcaktojë me qëllim të përcaktimit të procedurës specifike të përzgjedhjes, përveç promovimit të konkurrencës, do të kufizohet në një ose më shumë nga sa vijon:</p> <p>(a) promovimi i mbulimit;</p> <p>(b) sigurimi i cilësisë së kërkuar të shërbimit;</p> <p>(c) promovimi i përdorimit efikas të spektrit të radios, duke marrë parasysh kushtet e bashkëlidhura me të drejtat e përdorimit dhe nivelin e tarifave;</p> <p>(d) promovimi i inovacionit dhe zhvillimit të biznesit.</p> <p>Autoriteti rregullator kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent përcakton qartë dhe justifikon zgjedhjen e procedurës së përzgjedhjes, përfshirë çdo fazë paraprake për të hyrë në procedurën e përzgjedhjes. Ai gjithashtu përcakton qartë rezultatin e çdo vlerësimi të lidhur me situatën konkurruese, teknike dhe ekonomike të tregut dhe jep arsye për përdorimin e mundshëm dhe zgjedhjen e masave në përputhje me nenin 35.</p> <p>3. Shtetet Anëtare publikojnë çdo vendim mbi procedurën e përzgjedhjes së zgjedhur dhe rregullat përkatëse, duke shprehur qartë arsyet e tyre. Do të publikojë gjithashtu kushtet që i bashkëlidhen të drejtave të përdorimit.</p> <p>4. Pasi të përcaktojë procedurën e përzgjedhjes, Shteti Anëtar do të ftojë aplikime për të drejtat e përdorimit.</p> <p>5. Kur një Shtet Anëtar konstaton se mund të jepen të drejta shtesë të përdorimit për spektrin radio ose një kombinim i autorizimit të përgjithshëm dhe të drejtave individuale të përdorimit, do ta publikojë atë konkluzion dhe do të fillojë procesin e dhënies së të drejtave.</p> <p>6. Kur dhënia e të drejtave të përdorimit për spektrin e radios duhet të jetë e kufizuar, Shtetet Anëtare i japin këto të drejta në bazë të kriterëve të përzgjedhjes dhe një procedure përzgjedhjeje të cilat janë objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale. Çdo kriter i i përzgjedhjes do t'i japë peshë të duhur arritjes së objektivave dhe kërkesave të neneve 3, 4, 28 dhe 45.</p> <p>7. Kur do të përdoren procedurat e përzgjedhjes konkurruese ose krahasuese, Shtetet Anëtare mund të zgjasin periudhën maksimale prej gjashtë javësh, të përmendur në nenin 48 (6), për atë kohë sa është e nevojshme për të siguruar që procedurat e tilla janë të drejta, të arsyeshme, të hapura dhe transparente për të gjitha palët e interesuara, por jo më gjatë se të</p> | | <p>mund t'i nënshtrohen të drejtave të kufizuara edhe me kërkesë të ministrit.</p> <p>3. Njoftimi publik për konsultim, përfshin informacionin e frekuencave që do të ndahen, numrin e pritsëm të të drejtave për përdorimin e frekuencave, kushtet që mendohet se zbatohen për dhënie e së drejtës të përdorimit të frekuencave. Gjithashtu do të kërkojë që palët e interesuara të shprehin mendimin e tyre për vlerën e tregut të frekuencave dhe për të gjitha çështjet për të cilat AKEP-i është i interesuar të marrë mendimin e palëve të interesuara. Afati për paraqitjen e mendimeve në asnjë rast nuk duhet të jetë më i shkurtër se 30 ditë.</p> <p>4. AKEP-i ruan konfidencialitetin e propozimeve të mundshme të bëra nga palët e interesuara, në lidhje me vlerën e tregut të këtyre frekuencave.</p> <p>5. AKEP-i publikon opinionet dhe qëndrimin e tij, lidhur me çështjet e ngritura brenda 30 ditëve pas përfundimit të afatit për paraqitjen e opinionit të palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik.</p> <p>6. AKEP-i, bazuar në konkluzionet sipas pikës 5 të këtij neni, si dhe duke mbajtur parasysh objektivat për promovimin e konkurrencës, të mbulimit, sigurimin e cilësisë së shërbimit, përdorimin eficient të spektrit të frekuencave përfshirë kushtet e autorizimit dhe nivelin e pagesave, si dhe promovimin e inovacionit dhe zhvillimin e biznesit, i propozon ministrit:</p> <p>a) kufizimin ose moskufizimin e të drejtave për përdorimin e frekuencave;</p> <p>b) datën e fillimit të procedurës së tenderit publik, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i konsultimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore për këtë qëllim;</p> <p>c) numrin e autorizimeve individuale;</p> <p>d) kriteret e vlerësimit dhe,</p> <p>e) çmimin minimal për shpërndarjen e tyre, duke marrë parasysh zhvillimin e konkurrencës, interesin publik, mbrojtjen e konsumatorit, rrethanat e tregut dhe përdorimin efektiv të frekuencave.</p> <p>7. Ministri jo më vonë se 30 ditë nga marrja e propozimit të AKEP-it, sipas pikës 6 të këtij neni, miraton numrin e autorizimeve individuale, vlerën minimale për ndarjen e tyre dhe nxjerr urdhrin për fillimin e tenderit publik sipas nenit 76, të këtij ligji. Në çdo rast vendimi për kufizimin e të drejtave të përdorimit duhet të jetë i motivuar.</p> <p>8. Kur në përfundim të procesit të konsultimit, nuk është i nevojshëm kufizimi i numrit të autorizimit individual sipas këtij neni dhe nëse nuk është në kundërshtim me interesin e përdoruesve ose me interesin e zhvillimit të konkurrencës ekonomike, AKEP-i pasi të ketë marrë</p> | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>muaj, duke iu nënshtruar çdoorari specifik të përcaktuar në bazë të nenit 53.</p> <p>Këto afate nuk do të cenon marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e spektrit të radios dhe koordinimin satelitor.</p> <p>8. Ky nen nuk cenon transferimin e të drejtave të përdorimit për spektrin e radios në përputhje me nenin 51.</p> | | <p>miratimin e ministrit për vazhdimin e procedurës dhe për vlerën minimale për ndarjen e frekuencave vazhdon procedurën për dhënien e autorizimeve individuale sipas nenit 68, të këtij ligji.</p> <p>9. Sipërmarrësi i përzgjedhur nga procesi i konkurrimit publik, sipas nenit 76, të këtij ligji, kryen pagesën për frekuencat e alokuara sipas vlerës së përcaktuar në procedurën e tenderit, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 76 Procedura e konkurrimit publik</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AKEP-i, sipas rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, zhvillon procedurën e konkurrimit publik për dhënien e autorizimeve individuale, për një numër të kufizuar të drejtash të përdorimit të frekuencave, jo më vonë se 15 ditë pasi miratohet nga ministri sipas pikës 7 të nenit 75, të këtij ligji. 2. Koha e fillimit të shërbimit, afati i vlefshmërisë së autorizimit dhe numri i sipërmarrësve, përcaktohen nga ministri, ndërsa kushtet e tjera përcaktohen nga AKEP-i. 3. Rregullat e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave garantojnë një procedurë përzgjedhëse të hapur, objektive, jo diskriminuese dhe proporcionale dhe përfshijnë të paktën kërkesat si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> a) dhënien e arsyeve të qarta për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit; b) fazën paraprake të pjesëmarrjes në një procedurë përzgjedhëse; c) një vlerësim të qartë mbi situatën ekonomike, teknike në një proces konkurrese si dhe të arsyeve për përdorimin e mundshëm të frekuencave si dhe të masave të zgjedhura; d) publikimin e vendimit për përzgjedhjen e bërë dhe argumentat përkatëse si dhe kushtet bashkëlidhur të drejtave të përdorimit; e) përcaktimin e procedurës për aplikimet përfshirë afatet si dhe nëse e drejta e përdorimit do të jepet e kombinuar me autorizimin e përgjithshëm; f) vendosja e kriterëve duhet të mbajë parasysh shkallën e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në nenet 5, 7, 49, 60, 61 dhe 62 të këtij ligji. g) parashikimin e afateve kohore të përshtatshme për të siguruar një procedurë të ndershme, të hapur dhe transparente për të gjithë palët e interesuara. Afati maksimal nuk duhet të jetë më shumë se tetë muaj, pa paragjykuar afatet e aplikueshme sipas | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | | |
|---------|---|---------|---|--|--|
| | | | | marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e spektrit të frekuencave dhe koordinimin satelitor. | |
| Neni 56 | <p align="center">PJESA II – TITULLI I Kapitulli IV Shtirirja dhe përdorimi i pajisjeve të rrjetit me wireless</p> <p align="center">Neni 56 Aksesi në rrjetet lokale të radios</p> <p>1. Autoritetet kompetente do të lejojnë sigurimin e aksesit përmes RLAN-ve në një rrjet publik të komunikimeve elektronike, si dhe përdorimin e spektrit të harmonizuar të radios për atë dispozitë, duke iu nënshtruar vetëm kushteve të autorizimit të përgjithshëm të zbatueshëm në lidhje me përdorimin e spektrit të radios, siç përmendet në nenin 46 (1). Kur kjo dispozitë nuk është pjesë e një aktiviteti ekonomik ose është ndihmëse e një aktiviteti ekonomik ose një shërbimi publik i cili nuk varet nga përcjellja e sinjaleve në ato rrjete, çdo ndërmarrje, autoriteti publik ose përdoruesit fundorë që ofrojnë akses të tillë nuk do të nënshtrohen për çdo autorizim të përgjithshëm për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me nenin 12, ndaj detyrimeve në lidhje me përdoruesit fundorë.</p> <p>2. Do të zbatohet neni 12 i Direktivës 2000/31/EC.</p> <p>3. Autoritetet kompetente nuk do të parandalojnë ofruesit e rrjeteve publike të komunikimit elektronik ose shërbimet e komunikimit elektronik në dispozicion të publikut që të lejojnë aksesin në rrjetet e tyre për publikun, përmes RLAN-ve, të cilat mund të jenë të vendosura në ambientet e përdoruesve fundorë, në varësi të kushteve të autorizimit të përgjithshëm të zbatueshëm dhe marrëveshjes së informuar paraprake të përdoruesve fundorë.</p> <p>4. Në përputhje me nenin 3 (1) të Rregullores (BE) 2015/2120, autoritetet kompetente sigurojnë që ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose shërbimet e komunikimit elektronik të disponueshëm publikisht nuk kufizojnë në mënyrë të njëanshme ose parandalojnë përdoruesit fundorë nga:</p> <p>(a) Aksesi në RLAN sipas dëshirës së tyre i siguruar nga palët e treta; ose</p> <p>(b) Aksesi në rrjetet e ofruesve të tillë nga përdoruesit e tjerë fundorë përmes RLAN-ve, duke përfshirë në bazë të nismave të palëve të treta që grumbullojnë dhe e bëjnë publikisht të aksesueshëm RLAN-et e përdoruesve të ndryshëm fundorë.</p> | Neni 77 | <p align="center">KREU XI VENDOSJA DHE PËRDORIMI I PAJISJEVE TË RRJETEVE PA TEL</p> <p align="center">Neni 77 Aksesi në rrjetet lokale të radios</p> <p>1. Ofrimi i aksesit në një rrjet publik të komunikimeve elektronike, nëpërmjet rrjeteve lokale të radios (RLAN), si dhe përdorimi i spektrit të harmonizuar të frekuencave për ofrimin e ketij aksesit, i nënshtrohet vetëm kushteve të autorizimit të përgjithshëm të zbatueshme në lidhje me përdorimin e spektrit të frekuencave, sipas nenit 66, të këtij ligji.</p> <p>2. Kur ofrimi i aksesit nëpërmjet RLAN, nuk është pjesë e një aktiviteti ekonomik, ose nuk është ndihmëse e një aktiviteti ekonomik, ose një shërbimi publik që nuk varet nga përcjellja e sinjaleve në këto rrjete, çdo sipërmarrje, autoritet publik ose përdorues fundor që ofron këtë akses, nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike në bazë të nenit 26, si dhe i detyrimeve në lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë të përcaktuara në nenin 151, të këtij ligji, ose ndaj detyrimeve për interkoneksion të rrjetit në bazë të Kreut XIII, të këtij ligji.</p> <p>3. Parashikimet e nenit 12, të ligjit për tregtinë elektronike për transmetimin e thjeshtë “<i>mere conduit</i>”, janë të zbatueshme në ofrimin e aksesit në rrjet sipas këtij neni.</p> <p>4. Ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, lejojnë aksesin në rrjetet e tyre, nëpërmjet RLAN-ve, që mund të ndodhen në ambientet e një përdoruesi fundor, kur respektohen kushtet e autorizimit të përgjithshëm në fuqi dhe në marrëveshje paraprake në dëgjim të përdoruesit fundor.</p> <p>5. AKEP-i siguron që ofruesit e rrjeteve ose të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, nuk i kufizojnë ose parandalojnë në mënyrë të njëanshme, nëpërmjet mjeteve të menaxhimit të trafikut, përdoruesit fundorë nga:</p> <p>a) aksesi sipas zgjedhjes së tyre, në RLAN të ofruar nga palët e treta; ose</p> | F | |

| | | | | | | |
|--------|--|---------|---|---|--|--|
| | <p>5. Autoritetet kompetente nuk do të kufizojnë ose parandalojnë përdoruesit fundorë që të lejojnë aksesin në RLAN nga përdoruesit e tjerë fundorë, duke përfshirë në bazë të nismave të palëve të treta që agregojnë dhe bëjnë publike RLAN-etepërdoruesve të ndryshëm.</p> <p>6. Autoritetet kompetente nuk e kufizojnë padrejtësisht ofrimin e aksesit në RLAN për publikun:</p> <p>(a) nga organet e sektorit publik ose në hapësira publike afër hapësirave të zena nga organe të tilla të sektorit publik, kur kjo dispozitë është ndihmëse për shërbimet publike të ofruara në ato vende;</p> <p>(b) me iniciativat e organizatave joqeveritare ose organeve të sektorit publik për të grumbulluar dhe për të bërë reciprokisht të arritshëm RLAN-et e përdoruesve të ndryshëm fundorë përfshirë aty ku është e zbatueshme, RLAN-et në të cilat sigurohet qasja e publikut në përputhje me pikën (a) .</p> | | | <p>b) lejimi reciprok ose, në përgjithësi, nga aksesimi i përdoruesve të tjerë fundorë nëpërmjet RLAN-ve, në rrjetet e këtyre ofruesve, duke përfshirë aksesimin publik të RLAN-ve të përdoruesve të ndryshëm fundorë, të integruara në bazë të iniciativave të palëve të treta;</p> <p>6. Përdoruesit fundorë lejohen të kenë akses, reciprokisht ose jo, në RLAN-et e tyre nga përdorues të tjerë fundorë, duke përfshirë aksesimin e RLAN-ve të përdoruesve të ndryshëm fundorë, të aksesueshme publikisht, të integruara me iniciativë të palëve të treta.</p> <p>7. Sigurimi i aksesit në RLAN për publikun nuk duhet të kufizohet në mënyrë të padrejtë:</p> <p>a) nga organet e sektorit publik ose në hapësirat publike pranë ambienteve të shfrytëzuara nga këto organe, kur ofrimi i aksesit është ndihmëse për shërbimet publike të ofruara në këto ambiente;</p> <p>b) nga iniciativa të organizatave joqeveritare ose organeve të sektorit publik për integrimin dhe për t'i bërë në mënyrë reciproke ose më të përgjithshme të aksesueshme RLAN e përdoruesve të ndryshëm fundorë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, RLAN në të cilat ofrohet akses publik në përputhje me germën a), të kësaj pike.</p> | | |
| Neni57 | <p style="text-align: center;">Neni 57 Vendosja dhe funksionimi i pikave të aksesit me wireless në zona të vogla</p> <p>1. Autoritetet kompetente nuk e kufizojnë padrejtësisht vendosjen e pikave të aksesit me wireless në zona të vogla. Shtetet Anëtare do të përpiqen të sigurojnë që çdo rregull që rregullon vendosjen e pikave të aksesit me wireless në zona të vogla të jetë në përputhje me rregullat kombëtare. Këto rregulla do të publikohen përpara zbatimit të tyre.</p> <p>Në veçanti, autoritetet kompetente nuk do t'i nënshtrohen vendosjes së pikave aksesit me wireless të zonave të vogla, në përputhje me karakteristikat e përcaktuara në bazë të paragrafit 2, të ndonjë leje të planifikimit të qytetit ose lejeve të tjera të mëparshme individuale.</p> <p>Sipas mënyrës së derogimit nga nënparagrafi i dytë i këtij paragrafi, autoritetet kompetente mund të kërkojnë leje për vendosjen e pikave të aksesit me wireless në zona të vogla në ndërtesa ose vende me vlera arkitektonike, historike ose natyrore të mbrojtura në përputhje me ligjin kombëtar ose kur është e nevojshme për arsye të sigurisë publike . Neni 7 i Direktivës 2014/61 / BE do të zbatohet për dhënien e atyre lejeve.</p> <p>2. Komisioni, përmes zbatimit të akteve, specifikon karakteristikat fizike dhe teknike, të tilla si madhësia, pesha maksimale dhe fuqia e emetimit të pikave të aksesit me wireless në zona të vogla.</p> | Neni 78 | <p style="text-align: center;">Neni 78 Vendosja dhe funksionimi i pikave të aksesit pa tel në zona të vogla</p> <p>1. Autoritetet e planifikimit të territorit në nivel qendror dhe vendor nuk kufizojnë në mënyrë të panevojshme, vendosjen e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla.</p> <p>2. Ministria dhe AKEP në koordinim me autoritetet kompetente sipas pikës 1 të këtij neni, sigurojnë që çdo normë që rregullon vendosjen e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla, të jetë në përputhje me standardet kombëtare si dhe kërkojnë publikimin e tyre.</p> <p>3. Autoritetet kompetente, në veçanti nuk kushtëzojnë vendosjen e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla, që përputhen me karakteristikat e miratuara sipas pikës 5, të këtij neni, subjekt i çdo leje planifikimi urbanistik individual ose lejeve të tjera individuale të dhëna më parë.</p> <p>4. Pavarësisht nga pika 3 e këtij neni, vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla, në ndërtesa ose zona me vlerë arkitekturore, historike ose natyrore të mbrojtura, ose kur kjo është e nevojshme për arsye të sigurisë publike, bëhet me leje nga autoriteti përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>5. Karakteristikat teknike si madhësia, pesha maksimale dhe nese eshte e nevojshme per fuqine e emetimit të</p> | F | | |

| | | | | | | |
|--------|---|--|---------|---|---|--|
| | <p>Këto akte plotësuese do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4). Akti i parë i tillë plotësues do të miratohet deri më 30 qershor 2020.</p> <p>3. Ky artikull nuk cenon kërkesat thelbësore të përcaktuara në Direktivën 2014/53/BE dhe për regjimin e autorizimit të zbatueshëm për përdorimin e spektrit përkatës radio.</p> <p>4. Shtetet Anëtare, dot ë zbatojnë kur është e nevojshme, procedurat e miratuara në përputhje me Direktivën 2014/61 / BE, dhe sigurojnë që operatorët të kenë të drejtë të hyjnë në çdo infrastrukturë fizike të kontrolluar nga autoritetet publike kombëtare, rajonale ose lokale, e cila është teknikisht e përshtatshme për të pritur pikat e aksesit me wireless në zona të vogla ose që është e nevojshme për të lidhur pikat e tilla të aksesit në një rrjet backbone, duke përfshirë street furniture, siç janë shtyllat e ndricimit, shenjat e rrugës, semaforët, tabelat, stacionet e autobusit dhe tramvajit dhe stacionet e metrosë. Autoritetet publike do të plotësojnë të gjitha kërkesat e arsyeshme për akses në kushte të drejta, të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese, të cilat do të bëhen publike në një pikë të vetme informacioni.</p> <p>5. Pa çenuar marrëveshjet tregtare, vendosja e pikave të aksesit me wireless në zona të vogla nuk do t'i nënshtrohet tarifave që tejkalojnë tarifat administrative, në përputhje me nenin 16.</p> | | | <p>rrezatimeve për pikat e aksesit pa tel në zona të vogla, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>6. AKEP-i në bashkëpunim me ministrin, siguron që operatorët të kenë të drejtën e aksesit në çdo infrastrukturë fizike të kontrolluar nga autoritetet publike, e cila është teknikisht e përshtatshme për vendosjen e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla, ose që është e nevojshme për të lidhur pika të tilla aksesit me një rrjet bazë, duke përfshirë pajisjet e rrugës, si shtyllat e ndricimit, sinjalistikës rrugore, semaforët, tabelat, stacionet e autobusëve dhe sipas rastit tramvajit, stacionet e metrosë, në zbatim të këtij ligji dhe parashikimeve të ligjit “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.</p> <p>7. Autoritetet publike plotësojnë të gjitha kërkesat e arsyeshme për akses me terma dhe kushte të drejta, të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese, të cilat duhet të bëhen publike në një pikë të vetme informacioni.</p> <p>8. Pa paragjykuar ndonjë marrëveshje tregtare, vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla, nuk i nënshtrohet ndonjë pagese ose tarife përtej tarifave administrative në përputhje me nenin 18, të këtij ligji.</p> | | |
| Neni58 | <p>Neni 58 Rregulloret teknike për fushat elektromagnetike</p> <p>Procedurat e përcaktuara në Direktivën (BE) 2015/1535 do të zbatohen në lidhje me çdo draft masë nga një Shtet Anëtar, që do të impononte vendosjen e pikave të aksesit me wireless në zonat e vogla me kërkesa të ndryshme në lidhje me fushat elektromagnetike të parashikuara në Rekomandimin 1999/519 / EC.</p> | | Neni 79 | <p>Neni 79 Rregulloret teknike për fushat elektromagnetike</p> <p>Vendosja e pikave të aksesit pa tel në zona të vogla, respekton kërkesat në lidhje me kufizimet për fushat elektromagnetike të parashikuara në legjisllacionin kombëtar për mbrojtjen nga rrezatimet. AKEP bashkëpunon me autoritetin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet për zbatimin e standardeve apo kufizimeve për fushat elektromagnetike nga rrjetet e komunikimeve elektronike.</p> | F | |
| Neni59 | <p>TITLE II AKSESI Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme, parimet e aksesit Neni 59 Kuadri i përgjithshëm për akses dhe interkoneksion</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që të mos ketë kufizime që parandalojnë ndërmarrjet në të njëjtin shtet anëtar ose në shtete të ndryshme anëtare të negociojnë ndërmjet tyre marrëveshje për aranzhime teknike dhe tregtare për akses ose interkoneksion, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian. Ndërmarrja që kërkon akses ose interkoneksion nuk ka nevojë të autorizohet të operojë</p> | | Neni 80 | <p>KREU XII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, PARIMET E AKSESIT Neni 80 Kuadri i përgjithshëm për aksesin dhe interkoneksionin</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, janë të lirë të negociojnë ndërmjet tyre marrëveshjet teknike dhe komerciale për akses ose interkoneksion, në përputhje me këtë ligj.</p> <p>2. Një sipërmarrës që kërkon akses ose interkoneksion, nuk ka nevojë të autorizohet sipas nenit 26 të këtij ligji, kur ai nuk ofron shërbime dhe nuk zotëron rrjet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|---------|---|---|--|
| | <p>në Shtetin Anëtar, ku kërkohet akses ose interkoneksion, nëse nuk ofron shërbime dhe nuk operon një rrjet në atë Shtet Anëtar.</p> <p>2. Pa cenuar nenin 114, Shtetet Anëtare nuk do të mbajnë masa ligjore ose administrative të cilat kërkojnë nga ndërmarrjet, kur lejojnë akses ose interkoneksion, të ofrojnë terma dhe kushte të ndryshme për ndërmarrjet e ndryshme për shërbime ekuivalente ose masa që imponojnë obligime që nuk kanë lidhje me shërbimet aktuale të aksesit dhe ndërinterkoneksionit pa cenuar kushtet e përcaktuara në Shtojcën I.</p> | | | | | |
| Neni60 | <p style="text-align: center;">Neni 60 Të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjeve</p> <p>1. Operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike kanë një të drejtë dhe kur kërkohet nga ndërmarrje të tjera të autorizuar në përputhje me nenin 15, një detyrim për të negociuar me njëri-tjetrin interkoneksionin me qëllim të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, në mënyrë që të sigurohet provizioni dhe ndërveprimi i shërbimeve në të gjithë Bashkimin Evropian. Operatorët do të ofrojnë akses dhe ndërlidhje me ndërmarrjet e tjera në terma dhe kushte në përputhje me detyrimet e vendosura nga autoriteti rregullator kombëtar në përputhje me nenet 61, 62 dhe 68.</p> <p>2. Pa cenuar Nenin 21, Shtetet Anëtare do të kërkojnë që ndërmarrjet që marrin informacion nga një ndërmarrje tjetër përpara, ose pas procesit të negociimit të marrëveshjeve të interkoneksionit, ta përdorin atë informacion vetëm për qëllimin për të cilin është krijuar dhe duke respektuar në çdo kohë konfidencialitetin e informacionit të transmetuar ose të ruajtur. Ndërmarrjet e tilla nuk do t'ia kalojnë informacionin e marrë asnjë pale tjetër, veçanërisht departamenteve të tjera, filialet ose partnerët, për të cilët një informacion i tillë mund të sigurojë një avantazh konkurrues.</p> <p>3. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që negociatat të bëhen përmes ndërmjetësve asnjans kur kështu e kërkojnë kushtet e konkurrencës.Neni60</p> | | Neni 81 | <p style="text-align: center;">Neni 81 Të drejtat dhe detyrimet për sipërmarrësit</p> <p>1. Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë të drejtë dhe, kur kërkohet nga një sipërmarrës tjetër të autorizuar në përputhje me këtë ligj, detyrimin për të negociuar me njëri-tjetrin për interkoneksionin, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, në mënyrë që të sigurohet ofrimi dhe ndërveprueshmëria e shërbimeve.</p> <p>2. Sipërmarrësit duhet të ofrojnë akses dhe interkoneksion për sipërmarrësit e tjerë, me terma dhe kushte në përputhje me detyrimet e vendosura nga AKEP, në bazë të Kreut XIII, dhe nenit 92, të këtij ligji.</p> <p>3. Pa paragjykuar nenin 42 të këtij ligji, një sipërmarrës që merr informacion nga një sipërmarrës tjetër përpara, gjatë, ose pas procesit të negociimit të marrëveshjeve të aksesit ose të interkoneksionit, duhet ta përdorë atë vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë dhe respekton në çdo kohë konfidencialitetin e informacionit të marrë ose të ruajtur. Sipërmarrësi nuk duhet t'ia kalojë informacionin e marrë asnjë pale tjetër, veçanërisht departamenteve, filialeve ose partnerëve të tjerë, për të cilët ky informacion mund të sigurojë një avantazh konkurrues në treg.</p> <p>3. Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë, ofron një ofertë interkoneksioni për sipërmarrjet e tjera të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, për të siguruar komunikimin e përdoruesve, ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe ndërveprueshmërinë e shërbimeve.</p> <p>4. Pavarësisht nga e drejta e sipërmarrjeve për të negociuar lirisht ndërmjet tyre, kur e kërkojnë kushtet e konkurrencës negociatat zhvillohen përmes një ndërmjetësi neutral, me miratimin e AKEP-it. Palët e interesuara dorëzojnë në AKEP informacionin përkatës, për t'u dokumentuar.</p> | F | |

| | | | | | |
|--------|--|---|---|---|--|
| Neni61 | <p align="center">PJESA II – TITULLI II Aksesi Kapitulli II Akses dhe ndërlihdje</p> <p align="center">Neni 61 Kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve rregullatore kombëtare dhe autoriteteve të tjera kompetente në lidhje me aksesin dhe ndërlihdjen</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente në rastin e pikave (b) dhe (c) të nënparagrafit të parë të paragrafit 2 të këtij neni, duke vepruar në zbatim të objektivave të përcaktuara në nenin 3, inkurajojnë dhe kur është e përshtatshme, sigurojnë, në përputhje me këtë Direktivë, akses dhe ndërlihdje të përshtatshme, dhe ndërveprim të shërbimeve, duke ushtruar përgjegjësinë e tyre në një mënyrë që promovon efikasitetin, konkurrencën e qëndrueshme, vendosjen e rrjeteve me kapacitete shumë të larta, investime efikase dhe inovacione, dhe jep maksimumin e përfitimit për përdoruesit fundorë. Ata do të japin udhëzime dhe do të vënë në dispozicion të publikut procedurat e zbatueshme për të fituar akses dhe interkoneksion për të siguruar që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe operatorët me një shtrirje të kufizuar gjeografike, të mund të përfitojnë nga detyrimet e vendosura.</p> <p>2. Pa cënuar masat që mund të merren në lidhje me ndërmarrjet e përcaktuara që kanë fuqi të konsiderueshme të tregut, në përputhje me nenin 68, autoritetet rregullatore kombëtare, ose autoritete të tjera kompetente në rastin e pikave (b) dhe (c) të këtij nënparagrafi, do të jenë në gjendje të ngarkojnë:</p> <p>(a) në masën e nevojshme për të siguruar lidhjen deri në fund, detyrimet ndaj ndërmarrjeve që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm që kontrollojnë aksesin tek përdoruesit fundorë, përfshirë në raste të justifikuar detyrimin për të ndërlihdhur rrjetet e tyre, ku ky nuk është rasti i tanishëm.</p> <p>(b) në raste të justifikuar dhe në masën e nevojshme, detyrimet ndaj ndërmarrjeve që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm që kontrollojnë aksesin të përdoruesit fundorë për t'i bërë shërbimet e tyre ndërvepruese;</p> <p>(c) në raste të justifikuar, kur lidhja nga fundi në fund midis përdoruesve fundorë rrezikohet për shkak të mungesës së ndërveprimit midis shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, dhe në masën e nevojshme për të siguruar lidhjen nga fundi në fund midis përdoruesve fundorë, detyrimet mbi ofruesit përkatës të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, të cilët arrijnë një nivel të konsiderueshëm të mbulimit dhe marrjes së përdoruesve, për t'i bërë shërbimet e tyre ndërvepruese;</p> <p>(d) në masën e nevojshme për të siguruar mundësinë e përdorimit të përdoruesve fundorë në shërbimet digjitale të transmetimit të radios dhe televizionit dhe shërbimeve shtesë</p> | Neni 82 Neni 83 Neni 84 Neni 85 Neni 86 | <p align="center">KREU XIII AKSESI DHE INTERKONEKSIONI</p> <p align="center">Neni 82 Kompetencat dhe përgjegjësitë e AKEP-it në lidhje me aksesin dhe interkoneksionin</p> <p>1. Në zbatim të objektivave të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, AKEP-i inkurajon dhe, sipas rasti, siguron në përputhje me këtë ligj, aksesin dhe interkoneksionin e duhur si dhe ndërveprimin e shërbimeve. AKEP-i në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, promovon konkurrencën e ndershme e të qëndrueshme në ndërtimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, kryerjen e investimeve efikente dhe inovacionin, për përfitimin maksimal të përdoruesve fundorë.</p> <p>2. AKEP-i harton udhëzime dhe vë në dispozicion të publikut procedurat e zbatueshme për marrjen e aksesit dhe interkoneksionit, për të garantuar që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe operatorët me shtrirje të kufizuar gjeografike, të mund të përfitojnë nga detyrimet e vendosura.</p> <p>3. AKEP-i vendos:</p> <p>a) për sa është e nevojshme, detyrimet për sigurimin e lidhjes pikë fundore – pikë fundore, ndaj sipërmarrësve që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm dhe që kontrollojnë aksesin tek përdoruesit fundorë, duke përfshirë në rastet e justifikuar, detyrimin për interkonëktimin e rrjeteve të tyre;</p> <p>b) në raste të justifikuar dhe në masën e nevojshme, detyrimet ndaj sipërmarrësve që i nënshtrohen autorizimit të përgjithshëm dhe që kontrollojnë aksesin e përdoruesve fundorë, për t'i bërë shërbimet e tyre të ndërveprueshme;</p> <p>c) në raste të justifikuar, kur lidhja pikë fundore – pikë fundore ndërmjet përdoruesve fundorë, rrezikohet për shkak të mungesës së ndërveprimit ndërmjet shërbimeve të komunikimit ndërpersonal dhe në masën e nevojshme për të siguruar lidhjen pikë fundore – pikë fundore ndërmjet përdoruesve fundorë, detyrimet mbi ofruesit përkatës të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, të cilët arrijnë një nivel të konsiderueshëm mbulimi dhe pranimit nga përdoruesit, për t'i bërë shërbimet e tyre të ndërveprueshme.</p> <p>d) në masën e nevojshme sigurimin e aksesit të përdoruesve fundorë në shërbimet radio digjitale dhe shërbimet plotësuese përkatëse, të specifikuar</p> | F | |
|--------|--|---|---|---|--|

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>plotësuese të specifikuara nga Shteti Anëtar, detyrimet ndaj operatorëve për të siguruar akses në lehtësitë e tjera të përmendura në Pjesën II të Shtojcës II në terma të drejtë, të arsyeshëm dhe jo diskriminues.</p> <p>Detyrimet e përmendura në pikën (c) të nënparagrafit të parë do të vendosen vetëm:</p> <p>i. në masën e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal dhe mund të përfshijnë detyrimproporcionale për ofruesit e këtyre shërbimeve për të publikuar dhe lejuar përdorimin, modifikimin dhe rishpërndarjen e informacionit përkatës nga autoritetet dhe ofruesit e tjerë, ose të përdorin dhe zbatojnë standardet ose specifikimet e listuara në nenin 39 (1) ose të çdo standardi tjetër evropian ose ndërkombëtar përkatës;</p> <p>ii. kur Komisioni, pasi u këshillua me BEREC dhe duke marrë në konsideratë opinionin e tij, ka gjetur një kërcënim të konsiderueshëm për lidhjen nga fundi në fund midis përdoruesve fundorë në të gjithë Bashkimin Evropian ose të paktën në tre Shtete Anëtare dhe ka miratuar masa zbatuese që specifikojnë natyrën dhe qëllimin e çdo detyrimi që mund të imponohet.</p> <p>Masat zbatuese të përmendura në pikën (ii) të nënparagrafit të dytë do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> <p>3. Pa çenuar paragrafët 1 dhe 2, autoritetet rregullatore kombëtare mund të imponojnë detyrime, me kërkesë të arsyeshme, për të lejuar akses në instalime elektrike dhe kablllo dhe facilitetet shoqëruese brenda ndërtesave ose deri në pikën e parë të përqendrimit ose shpërndarjes, siç përcaktohet nga autoriteti rregullator kombëtar, ku ajo pikë ndodhet jashtë ndërtesës. Kur justifikohet me arsyetimin se përsëritja e elementëve të tillë të rrjetit do të ishte ekonomikisht joefikase ose fizikisht e pa praktikueshme, detyrime të tilla mund të imponohen për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike ose pronarëve të këtyre instalimeve elektrike dhe kablllove dhe faciliteteve të shoqëruara, kur ata pronarë nuk janë ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kushtet e aksesit të imponuara mund të përfshijnë rregulla specifike për akses në elementë të tillë të rrjetit dhe faciliteteve të shoqëruara dhe shërbimeve të ofruara, mbi transparencën dhe mosdiskriminimin dhe ndarjen e kostove të aksesit, të cilat, janë rregulluar për të marrë parasysh faktorët e rrezikut.</p> <p>Kur një autoritet kombëtar rregullator arrin në përfundimin duke pasur parasysh aty ku është e zbatueshme, detyrimet që rezultojnë nga analizapërkatëse e tregut, që detyrimet e vendosura në përputhje me nënparagrafin e parë nuk adresojnë sa duhet, barrierat e larta ekonomike dhe fizike jo-tranzitore për replikimin e të cilave mbështesin një situatë ekzistuese ose në zhvillim të tregut që kufizon ndjeshëm rezultatet konkurruese për përdoruesit fundorë, mund të zgjasë imponimin e detyrimeve të aksesit, me terma dhe kushte të drejta dhe të arsyeshme, përtej pikës së parë</p> | | <p>në legjislacionin në fuqi, detyrimet e operatorëve për të siguruar akses në objektet e tjera me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.</p> <p>Neni 83</p> <p>Vendosja e detyrimeve kur rrezikohet ndërlidhja pikë fundore-pikë fundore</p> <ol style="list-style-type: none"> Detyrimet e përcaktuara në gjermën c) të pikës 3, të nenit 82 të këtij ligji, vendosen vetëm: <ol style="list-style-type: none"> kur janë të nevojshme për sigurimin e ndërveprueshmërisë të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal dhe mund të përfshijë detyrime proporcionale ndaj ofruesve të këtyre shërbimeve për publikimin dhe lejimin e përdorimit, modifikimit dhe rishpërndarjes së informacionit përkatës, nga autoritetet dhe ofruesit e tjerë, ose për përdorimin dhe zbatimin e standardeve apo specifikimeve të përcaktuara sipas nenit 53, të këtij ligji. kur autoritetet kompetente pas konsultimit me AKEP, kanë gjetur një kërcënim të qenësishëm në ndërlidhjen pikë fundore - pikë fundore në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose kur të paktën tre vende Evropiane kanë marrë masa duke specifikuar natyrën dhe fushën e detyrimeve që mund të vendosen. Në veçanti, dhe pa paragjykuar përcaktimet e nenit 82 të këtij ligji, AKEP-i me marrjen e një kërkesë që vlerësohet e arsyeshme, vendos detyrime për dhënie aksesit në rrjetet, kabllot dhe facilitetet shoqëruese brenda ndërtesave, ose deri në pikën e parë të shpërndarjes në ndërtesa, kur kjo pikë ndodhet jashtë ndërtesës. Në rastet kur instalimi rishfaqet i elementëve të tillë të rrjetit është ekonomikisht joefikas ose fizikisht i pamundur, detyrimi për akses vendoset mbi ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ose mbi pronarët e instalimeve kabllore dhe faciliteteve shoqëruese, që nuk janë ofrues të rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kushtet e vendosura për dhënie të aksesit, përfshijnë rregulla specifike për aksesin në elementë të tillë të rrjetit dhe në infrastrukturën dhe facilitetet shoqëruese mbi baza transparence, mosdiskriminimi dhe ndarjen proporcionale të kostove të aksesit, të cilat rregullohen sipas rastit, duke marrë parasysh faktorët e rrezikut. <p>Neni 84</p> <p>Rastet e vecanta të shtrirjes dhe kufizimit të detyrimeve për akses</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>të përqendrimit ose shpërndarjes, në një pikë që përcakton të jetë më e afërt me përdoruesit fundorë, të aftë për të pritur një numër të mjaftueshëm të lidhjeve të përdoruesve fundorë që të jenëkomercialisht të vlefshme për kërkuesit e aksesit efikas. Në përcaktimin e shkallës së shtrirjespërtej pikës së parë të përqendrimit ose shpërndarjes, autoriteti rregullator kombëtar do të marrë parasysh te gjitha udhëzimet përkatëse të BEREC. Nëse justifikohet në baza teknike ose ekonomike, autoritetet rregullatore kombëtare mund të vendosin detyrime aktive ose virtuale të aksesit.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare nuk vendosin detyrime në përputhje me nënparagrafin e dytë për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, kur ata përcaktojnë se:</p> <p>(a) ofruesi ka karakteristikat e listuara në nenin 80 (1) dhe vë në dispozicion një mënyrë alternative të zbatueshme dhe të ngjashme për arritjen e përdoruesve fundorë duke siguruar akses në një rrjet me kapacitet shumë të lartë për çdo ndërmarrje, me terma dhe kushte, jo-diskriminuese dhe të arsyeshme; autoritetet rregullatore kombëtare mund të zgjerojnë atë përjashtim tek ofruesit e tjerë që ofrojnë terma dhe kushte të drejta, jo-diskriminuese dhe të arsyeshme, akses në një rrjet me kapacitete shumë të larta;</p> <p>ose</p> <p>(b) imponimi i detyrimeve do të rrezikojë qëndrueshmërinë ekonomike ose financiare të një vendosjeje të re të rrjetit, veçanërisht nga projektet e vogla lokale.</p> <p>Nëpërmjet derogimit nga pika (a) e nënparagrafit të tretë, autoritetet kombëtare rregullatore mund të imponojnëdetyrime për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike që plotësojnë kriteret e përcaktuara në atë pikë ku rrjeti në fjalë është financuar publikisht.</p> <p>Deri më 21 dhjetor 2020, BEREC do të publikojë udhëzime për të nxitur një zbatim të qëndrueshëm të këtij paragrafi, duke përcaktuar kriteret përkatëse:</p> <p>(a) pika e parë e përqendrimit ose e shpërndarjes;</p> <p>(b) pika, përtej pikës së parë të përqendrimit ose shpërndarjes, e aftë për të pritur një numër të mjaftueshëm të lidhjeve të përdoruesit fundorë për të mundësuar një ndërmarrje efikase për të kapërcyer pengesat e rëndësishme të përsëritshme të identifikuar;</p> <p>(c) cilat vendosje të rrjetit mund të konsiderohen të reja;</p> <p>(d) cilat projekte mund të konsiderohen të vogla;</p> <p>dhe</p> <p>(e) cilat barriera ekonomike ose fizike për replikimin janë të larta dhe jo-tranzitore.</p> <p>4. Pa çenuar paragrafët 1 dhe 2, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që autoritetet kompetente kanë fuqinë t'i imponojnë ndërmarrjeve që sigurojnë ose autorizojnë, të ofrojnë detyrimetë rrjeteve të komunikimeve elektronike në lidhje me ndarjen e infrastrukturës pasive ose detyrimet për të arritur në përfundimin</p> | | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kur AKEP-i, arrin në përfundimin, duke marrë parasysh kur janë të zbatueshme dhe detyrimet për tregun përkatës mbi bazën e analizës së tregut, se detyrimet e vendosura në përputhje me gërmën a) të paragrafit 3, të nenit 82 të këtij ligji, nuk mjaftojnë për adresimin e pengesave të larta ekonomike ose fizike për replikimin e një tregu ekzistues apo në zhvillim, që kufizon ndjeshëm rezultatet konkurruese për përdoruesit fundorë, mund të shtrijë vendosjen e detyrimeve të tilla të aksesit, me terma dhe kushte të drejta dhe të arsyeshme, përtej pikës së parë të shpërndarjes, deri në një pikë që është më afër përdoruesit fundor, e aftë për mbajtjen e një numri të kënaqshëm lidhesh të përdoruesve fundorë, për të mundësuar një akses të qëndrueshëm dhe komercialisht eficient për kërkuesit e tij. 2. AKEP-i në përcaktimin e shtrirjes së detyrimit për akses përtej pikës së parë të shpërndarjes, merr parasysh udhëzimet përkatëse të BEREC-ut. Kur justifikohet për arsye teknike ose ekonomike, AKEP-i vendos detyrime për aksesin aktiv ose virtual. 3. AKEP-i, në përputhje me gërmën b) të paragrafit 3, të të nenit 82 të këtij ligji, nuk vendos detyrime për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, kur arrin në përfundimin se: <ol style="list-style-type: none"> a) ofruesi ka karakteristikat e parashikuara në pikën 1 të nenit 106, të këtij ligji, dhe vë në dispozicion një mjet alternativ të ngjashëm për të arritur tek përdoruesit fundorë, duke ofruar akses në një rrjet me kapacitet shumë të lartë për çdo sipërmarrje, në mënyrë të drejtë, me terma dhe kushte jodiskriminuese dhe të arsyeshme. AKEP-i e shtrin këtë përjashtim për ofruesit e tjerë që ofrojnë akses në një rrjet me kapacitet shumë të lartë, me terma dhe kushte të drejta, jodiskriminuese dhe të arsyeshme; ose b) vendosja e detyrimeve rrezikon qëndrueshmërinë ekonomike ose financiare të ndërtimit të një rrjeti të ri, veçanërisht nga projektet e vogla lokale. 4. Pavarësisht nga përcaktimi i gërmës a) të pikës 3 të këtij neni, AKEP-i vendos detyrime për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në atë pikë, ku rrjeti në fjalë financohet me fonde publike. 5. AKEP-i merr parasysh udhëzimet përkatëse të BEREC-ut dhe përcakton kriteret përkatëse për përcaktimin: <ol style="list-style-type: none"> a) e pikës së parë të përqendrimit ose shpërndarjes; b) e pikës, përtej pikës së origjinës, e aftë për të pritur një numër të mjaftueshëm lidhesh të përdoruesit fundor, për të mundësuar një sipërmarrje efikase | |
|--|---|--|---|--|

| | | | |
|--|--|--|--|
| <p>e marrëveshjeve të lokalizuara të aksesit në roaming, në të dyja rastet nëse është e nevojshme drejtpërdrejt për ofrimin lokal të shërbimeve që mbështeten në përdorimin e spektrit të radios, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian dhe me kusht që asnjë mjet i zbatueshëm dhe i ngjashëm i aksesit për përdoruesit fundorë të mos vihet në dispozicion për çdo ndërmarrje me termat dhe kushtet e drejta dhe të arsyeshme. Autoritetet kompetente mund të imponojnë detyrime të tilla vetëm kur kjo mundësi parashikohet qartë kur jepen të drejtat e përdorimit për spektrin radio dhe kur justifikohet me arsyetimin se në zonën e detyrimeve të subjektivit, vendosja e infrastrukturës së drejtuar nga tregu për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve që mbështeten në përdorimin e spektrit të radios është subjekt i pengesave të pakapërcyeshme ekonomike ose fizike dhe për këtë arsye aksesit në rrjete ose shërbime nga përdoruesit fundorë është jashtëzakonisht i mangët ose mungon. Në ato rrethana kur aksesit dhe ndarja vetëm e infrastrukturës pasive nuk mjafton për të adresuar situatën, autoritetet rregullatore kombëtare mund të imponojnë detyrime për ndarjen e infrastrukturës aktive.</p> <p>Autoritetet kompetente do të kenë parasysh:</p> <p>(a) nevojën për të maksimizuar lidhjen në të gjithë Bashkimin Evropian, përgjatë shtigjeve kryesore të transportit dhe veçanërisht zonave territoriale, dhe mundësinë e rritjes së ndjeshme të zgjedhjes dhe cilësisë më të lartë të shërbimit për përdoruesit fundorë;</p> <p>(b) përdorimi efikas i spektrit të radios;</p> <p>(c) fizibilitetin teknik të ndarjes dhe kushtet e shoqëruara;</p> <p>(d) gjendjen e konkurrencës së bazuar në infrastrukturë, si dhe të shërbimit;</p> <p>(e) risite teknologjike;</p> <p>(f) nevojën mbizotëruese për të suportuar nxitjen e pritësit për të shfrytëzuar infrastrukturën i pari.</p> <p>Në rast të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, autoritetet kompetente mund t'i imponojnë përfituesve, detyrimin për të ndarë spektrin radio me pritësin e infrastrukturës në zonën përkatëse.</p> <p>5. Detyrimet dhe kushtet e vendosura në përputhje me paragrafët 1 deri 4 të këtij neni do të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe jo-diskriminuese, ato do të zbatohen në përputhje me procedurat e përmendura në nenet 23, 32 dhe 33. Autoritetet Rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente që kanë imponuar detyrimet dhe kushtet të tilla duhet të vlerësojnë rezultatet e tyre brenda pesë vjetësh pas miratimit të masës së mëparshme të miratuar në lidhje me të njëjtat ndërmarrje dhe të vlerësojnë nëse do të ishte e përshtatshme t'i tërhiqnin ose t'i ndryshonin ato në dritën e kushteve në zhvillim. Këto autoritete do të njoftojnë rezultatet e vlerësimit të tyre në përputhje me procedurat e përmendura në nenet 23, 32 dhe 33.</p> <p>6. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoriteti rregullator kombëtar është i autorizuar të ndërhyjë në iniciativën e tij, kur është e arsyeshme,</p> | | <p>për të kapërcyer pengesat e përsëritshme, të identifikuar si të rëndësishme;</p> <p>c) se cilat shtrirje rrjeti mund të konsiderohen të reja;</p> <p>d) se cilat projekte mund të konsiderohen të vogla; dhe</p> <p>e) cilat pengesa ekonomike ose fizike ndaj dublikimit janë të larta dhe jo kalimtare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 85</p> <p>Rastet për ofrimin lokal të shërbimeve që varen nga përdorimi i spektrit radio</p> <ol style="list-style-type: none"> Pa paragjykuar paragrafët 1 dhe 2, të nenit 82 të këtij ligji, AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve që ofrojnë ose janë autorizuar të ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike, detyrimin për bashkëpërdorimin e infrastrukturës pasive, ose detyrimin për të lidhur marrëveshje të lokalizuara të aksesit për roaming, nëse kjo, në të dyja rastet është drejtpërdrejt e nevojshme për ofrimin lokal të shërbimeve që varen nga përdorimi i spektrit radio, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kushtin që asnjë mjet alternativ i mundshëm dhe i ngjashëm i aksesit për përdoruesit fundorë, nuk vihet në dispozicion të çdo sipërmarrësi me terma dhe kushte të drejta dhe të arsyeshme. AKEP-i vendos detyrimet e përmendura në nenin 82 të këtij ligji, vetëm kur kjo mundësi parashikohet qartë në dhënie të drejtave të përdorimit të spektrit radio dhe kur justifikohet bazuar në zonën që i nënshtrohet këtyre detyrimeve, shtrirja e infrastrukturës për ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve që mbështeten në përdorimin e spektrit radio, u nënshtrohen pengesave ekonomike ose fizike të pakapërcyeshme dhe për këtë arsye aksesit në rrjete ose shërbime nga përdoruesit fundorë është shumë i mangët ose mungon. Në rrethanat kur vetëm aksesit dhe bashkëpërdorimi i infrastrukturës pasive nuk mjaftojnë AKEP-i vendos detyrime për bashkëpërdorimin e infrastrukturës aktive. AKEP-i, sipas rastit në bashkëpunim me ministrinë, mbajnë parasysh: <ol style="list-style-type: none"> nevojën për të maksimizuar ndërlidhjen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përgjatë korridoreve kryesore të transportit dhe në zona të veçanta territoriale si dhe rritjen e mundësisë për të zgjedhur dhe cilësinë më të lartë të shërbimit për përdoruesit fundorë; përdorimin efikas të spektrit radio; fizibilitetin teknik të bashkëpërdorimit dhe kushtet shoqëruese; | |
|--|--|--|--|

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>në mënyrë që të sigurojë objektivat e politikës së nenit 3, në përputhje me këtë Direktivë dhe me procedurat e përmendura në nenet 23 dhe 32.</p> <p>7. Deri më 21 qershor 2020 për të kontribuar në një përcaktim të qëndrueshëm të vendndodhjes së pikave të ndërprerjes së rrjetit nga autoritetet rregullatore kombëtare, BEREC do të marrë konsultimin me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, për udhëzimet për qasjet e përbashkëta të identifikimit të pikave fundore në topologji të ndryshme të rrjetit. Autoritetet rregullatore kombëtare marrin parasysh maksimalisht udhëzimet kur përcaktojnë vendndodhjen e pikave të përfundimit të rrjetit.</p> | | <p>d) gjendjen e konkurrencës bazuar në infrastrukturë dhe në shërbime;</p> <p>e) rritjen teknologjike;</p> <p>f) nevojën kryesore për të forcuar nxitjen e operatorit pritës për të shtrirë së pari infrastrukturën.</p> <p>Në rast të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, AKEP-i, i vendos sipërmarrësit detyrimin për të bashkëpërdorur spektrin radio me operatorin pritës të infrastrukturës në zonën përkatëse.</p> <p style="text-align: center;">Neni 86</p> <p>Procedura e AKEP për vendosjen e detyrimeve për akses dhe vlerësimin e tyre</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Detyrimet dhe kushtet e vendosura në përputhje me nenet 82, 83, 84, dhe 85 të këtij ligji, duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese. Këto detyrime zbatohen në përputhje me procedurat e konsultimit të parashikuara në nenin 44, të këtij ligji. 2. AKEP-i vlerëson rezultatet e këtyre detyrimeve dhe kushteve, pesë vjet pas miratimit të masës së mëparshme, të miratuar në lidhje me të njëjtët operatorë dhe bazuar në kushtet në zhvillim, vlerëson nëse është e përshtatshme për t'i tërhequr ose ndryshuar ato. AKEP-i njofton rezultatit e vlerësimit të tij në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 44, të këtij ligji. 2. Për qëllimet e neneve 82, 83, 84, dhe 85 të këtij ligji, AKEP-i është i autorizuar të ndërhyjë me iniciativën e tij aty ku justifikohet, për të siguruar objektivat e politikës së përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, në përputhje me këtë ligj dhe në veçanti me procedurat e referuara në nenet 44 dhe 45, të këtij ligji. 3. Kur, si rezultat i një analize tregu të kryer në përputhje me nenin 90, të këtij ligji, AKEP-i konstaton se një ose më shumë sipërmarrës nuk kanë fuqi të ndjeshme tregu në tregun përkatës, ndryshon ose tërheq kushtet në lidhje me këta sipërmarrës, në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 44, të këtij ligji vetëm në masën që: <ol style="list-style-type: none"> a) aksesin për përdoruesit fundorë në transmetimet radiotelevizive e kanalet e transmetimit dhe shërbimet të specifikuar në përputhje me detyrimet e mbartjes, siç përcaktohet në nenin 87, të ligjit nr. 97/2013, "Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, nuk do të ndikohet negativisht nga një ndryshim ose tërheqje e tillë; b) perspektivat për konkurrencë efektive në tregjet e rrjedhës së poshtme, downstream, nuk do të | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|--|--|---|--|---|--|
| | | | | <p>ndikoheshin negativisht nga një ndryshim ose tërheqje e tillë:</p> <p>i) shërbimet e transmetimit televiziv digjital dhe radios me pakicë; dhe</p> <p>ii) sistemet e aksesit të kushtëzuar dhe lehtësira të tjera shoqëruese.</p> <p>Palët që preken nga ky ndryshim ose tërheqje e kushteve, njoftohen paraprakisht duke ju dhënë një periudhë e përshtatshme njoftimi.</p> <p>4. AKEP-i merr parasysh maksimalisht në konsideratë udhëzimet e BEREC të miratuara sipas Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike, gjatë përcaktimit të vendndodhjes së pikave fundore të rrjetit.</p> | | |
| Neni62 | <p align="center">Neni 62 Sistemet e aksesit me kusht dhe faciliteteve të tjera</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që kushtet e përcaktuara në Pjesën I të Shtojcës II të zbatohen në lidhje me aksesin e kushtëzuar në televizionet dixhitale dhe shërbimet radio që transmetohen për shikuesit dhe dëgjuesit në Bashkimin Evropian, pavarësisht nga mjetet e transmetimit.</p> <p>2. Kur, si rezultat i një analize të tregut të kryer në përputhje me nenin 67 (1), autoriteti kombëtar rregullator konstaton se një ose më shumë ndërmarrje nuk kanë fuqi të konsiderueshme të tregut në tregun përkatës, ai mund të ndryshojë ose tërheqë kushtet në lidhje me ato ndërmarrje, në përputhje me procedurat e përmendura në nenet 23 dhe 32, vetëm në masën që:</p> <p>(a) aksesit i përdoruesve fundorë në transmetimet radio dhe televizive dhe kanalet transmetuese dhe shërbimet e specifikuar në përputhje me nenin 114 nuk do të ndikohet negativisht nga një ndryshim ose tërheqje e tillë;</p> <p>dhe</p> <p>(b) perspektivat për një konkurrencë efektive në tregjet në vijim nuk do të ndikohen negativisht nga një ndryshim ose tërheqje e tillë:</p> <p>i. shërbime të shitjes me pakicë të televizionit dixhital dhe radiotelevizionit;</p> <p>dhe</p> <p>ii. sistemet e aksesit me kusht dhe facilitetet e tjera shoqëruese.</p> <p>Një periudhë e përshtatshme njoftimi do t'u jepet palëve të prekura nga një ndryshim i tillë ose tërheqja e kushteve.</p> <p>3. Kushtet e zbatuara në përputhje me këtë nen nuk paragjykojnë aftësinë e Shteteve Anëtare për të imponuar detyrime në lidhje me aspektin prezantues të EPGs dhe objekteve të ngjashme të listimit dhe të navigimit.</p> <p>4. Pavarësisht nga paragrafi I i këtij neni, Shtetet Anëtare mund të lejojnë autoritetin e tyre kombëtar rregullator, sa më shpejt të jetë e mundur pas 20 dhjetorit 2018 dhe në mënyrë periodike pas kësaj, të rishikojnë kushtet e zbatuara në përputhje</p> | | <p>Neni 82 dhe 83 Ligji nr. 97/2013</p> | <p align="center">KREU XI SHËRBIMET E MBROJTURA Neni 82 Ofrimi i shërbimeve me akses të kushtëzuar</p> <p>1. Ofrimi i shërbimeve me akses të kushtëzuar dhe shërbimet shoqëruese/mbështetëse të tyre realizohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AMA. Me anë të rregullave të nxjerra në zbatim të këtij ligji, AMA siguron që shërbimet e mbrojtura ofrohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.</p> <p>2. AMA ka të drejtë të imponojë detyrime për ofruesit e shërbimeve me akses të kushtëzuar në masën e nevojshme për të siguruar marrjen nga përdoruesit të shërbimeve audio dhe audiovizive, sipas specifikimeve të këtij ligji.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimit me akses të kushtëzuar sigurojnë akses në ndërfaqet/përshtatësit e programeve të aplikimit ose në udhëzuesit elektronikë të programeve në kushte të ndershme, jodiskriminuese dhe të përshtatshme.</p> <p>4. AMA përcakton kushtet e funksionimit të pajisjeve të televizionit numerik për përdoruesit.</p> <p align="center">Neni 83 Sistemet e aksesit të kushtëzuar</p> <p>1. Sistemet e aksesit të kushtëzuar për shërbimet radiotelevizive numerike duhet të kenë kapacitetet e nevojshme teknike për të mundësuar që operatorët e rrjeteve të kenë kontrollin e plotë mbi shërbimet që përdorin këto sisteme.</p> <p>2. Ofruesit e shërbimeve të aksesit të kushtëzuar, që sigurojnë aksesin në shërbimet radio dhe televizive numerike, janë të detyruar t'u ofrojnë të gjithë OSHMA-ve, në kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jo diskriminuese, asistencë teknike, që mundëson abonentët e tyre të kenë akses në shërbimet e ofruara me anë të dekodërëve.</p> | F | <p>Perfafruar me Ligjin nr. 97/2013 per median audiovizive te ndryshuar;</p> |

| | | | | | |
|----------------|---|--------------------|---|---|--|
| | me këtë nen, duke ndërmarrë një analizë të tregut në përputhje me nenin 67 (1) për të përcaktuar nëse duhet të ruhen, ndryshohen ose tërhiqen kushtet e aplikuar. | | | 3. Për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar, operatorët që ofrojnë këtë shërbim mbajnë llogari të ndara nga pjesa tjetër e aktivitetit. | |
| Neni 63 | <p style="text-align: center;">PJESA II – TITULLI II Aksesi Kapitulli III</p> <p style="text-align: center;">Neni 63 Analiza e tregut dhe fuqia e ndjeshme e tij</p> <p>1. Kur kjo Direktivë kërkon nga autoritetet kombëtare rregullatore të përcaktojnë nëse sipërmarrjet kanë fuqi të ndjeshme në tregu, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 67, do të zbatohet paragrafi 2 i këtij neni.</p> <p>2. Një sipërmarrje do të konsiderohet se ka fuqi të ndjeshme të tregut, nëse individualisht ose së bashku me të tjerët gëzon një pozicion të barabartë me mbizotërimin, përkatësisht një pozicion të forcës ekonomike duke i dhënë asaj fuqi të sjellë një masë të konsiderueshme në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët dhe së fundite konsumatorët. Autoritetet rregullatore kombëtare, kur vlerësojnë nëse dy ose më shumë ndërmarrje janë në një pozicion të përbashkët mbizotërues në një treg, veprojnë në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian dhe marrin në konsideratë opinionin e tij për analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme të tregut të publikuar nga Komisioni në përputhje me nenin 64.</p> <p>3. Kur një sipërmarrje ka fuqi të ndjeshme të tregut në një treg specifik, ajo gjithashtu mund të përcaktohet si një fuqi e ndjeshme e tregut në një treg të lidhur ngushtë, kur lidhjet midis dy tregjeve lejojnë që fuqia e tregut të mbajtur në treg specifik të nxitet në tregun e lidhur ngushtë, duke forcuar kështu fuqinë e tregut të sipërmarrjes. Rjedhimisht mjetet juridike që synojnë të parandalojnë një levë të tillë mund të zbatohen në tregun e afërt të lidhur me nenet 69, 70, 71 dhe 74.</p> | Neni 87 Neni 88 | <p style="text-align: center;">KREU XIV ANALIZA E TREGUT DHE FUQIA E NDJESHME NË TREG</p> <p style="text-align: center;">Neni 87 Dispozita të përgjithshme</p> <p>1. Tregjet, që justifikojnë rregullimin dhe janë subjekt i rregullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, janë tregjet me pengesa të larta dhe të qëndrueshme, me natyrë ligjore ose strukturore për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuara drejt konkurrencës efektive brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi vetëm i ligjit të konkurrencës nuk mund të zgjidhë në mënyrë të duhur dështimet e tregut.</p> <p>2. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP në përputhje me nenin 90, të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 88 Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg</p> <p>1. AKEP-i, përcakton nëse sipërmarrësit kanë fuqi të ndjeshme në treg, sipas procedurës së parashikuar në nenin 90, të këtij ligji dhe bazuar në përcaktimet e këtij neni.</p> <p>2. Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm ose së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson sipërmarrësit një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit fundorë të tij.</p> <p>3. Në vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet në kriteret e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut; në pengesat e larta për hyrje në treg dhe zgjerimi i pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme; në fuqinë kundërvepruese të blerësve; në zhvillimin e elasticitetit ndërmjet kërkesës dhe ofertës; fazat e zhvillimit të tregut përkatës; | F | |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>f) përparësitë teknologjike;</p> <p>g) çdo zhvillim i rrjeteve të shitjes dhe shpërndarjes;</p> <p>h) ekonomitë e shkallës ose ekonomitë e sektorit dhe dendësisë;</p> <p>i) shkallën e integritimit vertikal;</p> <p>l) shkallën e produkteve të diferencuara;</p> <p>m) aksesin në burimet financiare;</p> <p>n) kontrollin mbi infrastrukturën që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;</p> <p>o) sjelljet e përgjithshme në treg, si tarifat, politikat e marketingut, shërbimet dhe produktet e kufizuara ose vendosja e pengesave.</p> <p>4. Dy ose më shumë sipërmarrës, vlerësohen se kanë një pozitë dominuese të përbashkët, nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore ose të lidhjeve të tjera ndërmjet tyre, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cila të çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit fundorë.</p> <p>5. Për të bërë përcaktimin e dominancës së bashkuar të dy ose më shumë sipërmarrësve, AKEP-i bazohet, ndër të tjera, në kriteret e mëposhtme:</p> <p>a) zhvillimin e përqëndrimit të tregut, shpërndarjen e pjesëve të tregut dhe ndryshimin në kohë të tyre;</p> <p>b) pengesat për të hyrë në treg dhe efekti i tyre në konkurrencën e mundshme;</p> <p>c) efektin e kundërveprimit të fuqisë blerëse;</p> <p>ç) transparencën aktuale të tregut;</p> <p>d) fazën e zhvillimit të tregut përkatës;</p> <p>e) produktet homogjene;</p> <p>f) strukturën e kostos;</p> <p>g) zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;</p> <p>h) zhvillimin e inovacioneve teknologjike dhe shkallën e maturisë teknologjike;</p> <p>i) mungesën e kapaciteteve të tepërta;</p> <p>l) lidhjet informale dhe të tjera ndërmjet lojtarëve të tregut;</p> <p>m) mekanizmat ndëshkues;</p> <p>n) zhvillimi i nxitësve për konkurrencën e tarifave.</p> <p>o) fuqinë ekonomike dhe financiare të sipërmarrësit.</p> <p>6. Kur një sipërmarrës ka fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës ai vlerësohet se mund të ketë fuqi të ndjeshme në treg edhe në një treg përkatës tjetër, të lidhur horizontalisht, vertikalisht ose gjeografikisht me tregun e analizuar, nëse lidhjet midis dy tregjeve janë të tilla që mundësojnë shtrirjen e fuqisë së ndjeshme nga tregu i parë në tjetrin, duke fuqizuar kështu fuqinë e sipërmarrësit në treg.</p> | | |
|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|----------------------|--|--|-----------------|--|----------|---|
| <p>Neni64</p> | <p style="text-align: center;">Neni 64</p> <p style="text-align: center;">Procedura për identifikimin dhe përcaktimin e tregjeve</p> <p>1. Pas konsultimit publik përfshirë atë me autoritetet rregullatore kombëtare dhe duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, Komisioni do të miratojë një Rekomandim për Tregjet përkatëse të Produkteve dhe Shërbimeve ('Rekomandimi'). Rekomandimi do të identifikojë ato tregje të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike, karakteristikat e të cilave mund të jenë të tilla që të justifikojnë imponimin e detyrimeve rregullatore të përcaktuara në këtë Direktivë, pa paragjykuar tregjet që mund të përcaktohen në raste specifike sipas ligjit të konkurrencës. Komisioni përcakton tregjet në përputhje me parimet e ligjit të konkurrencës. Komisioni do të përfshijë tregjet e produkteve dhe shërbimeve në Rekomandimin ku pasi të vëzhgojë tendencat e përgjithshme në Bashkimin Evropian, do të konstantoje se secili prej tre kriterëve të listuara në nenin 67 (1) është përmbushur. Komisioni do të rishikojë Rekomandimin deri më 21 dhjetor 2020 dhe rregullisht pas kësaj.</p> <p>2. Pas konsultimit me BEREC, Komisioni publikon udhëzime për analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme të tregut (udhëzimet e SMP-së), të cilat duhet të jenë në përputhje me parimet përkatëse të ligjit të konkurrencës. Udhëzimet e SMP-së përfshijnë udhëzime për autoritetet rregullatore kombëtare për zbatimin e konceptit të fuqisë së rëndësishme të tregut në kontekstin specifik të rregullimit të tregjeve të komunikimeve elektronike, duke marrë parasysh tre kriteret e listuara në nenin 67 (1).</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare, duke marrë parasysh opinionin e BEREC, të Rekomandimit dhe udhëzimeve të SMP, përcaktojnë tregjet përkatëse të përshtatshme për rrethanat kombëtare, veçanërisht tregjet gjeografike përkatëse brenda territorit të tyre duke marrë parasysh, shkallën e konkurrencës në infrastrukturë në ato zona, në përputhje me parimet e ligjit të konkurrencës. Autoritetet rregullatore kombëtare, marrin parasysh edhe rezultatet e vëzhgimit gjeografik të kryer në përputhje me nenin 22 (1). Ata do të ndjekin procedurat e përmendura në nenet 23 dhe 32 përpara se të përcaktojnë tregjet që ndryshojnë nga ato të identifikuar në Rekomandim.</p> | | <p>Neni 89</p> | <p style="text-align: center;">Neni 89</p> <p style="text-align: center;">Procedura për identifikimin dhe përcaktimin e tregjeve</p> <p>1. AKEP përcakton me rregullore tregjet përkatëse të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar dhe duke mbajtur në konsideratë kërkesat e rregullimit të veçantë të sektorit, si dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve, pas kryerjes së një konsultimi publik në përputhje me nenin 45, të këtij ligji.</p> <p>2. Përveç tregjeve të identifikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, AKEP-i mund të marrë vendim duke identifikuar tregje të tjera, subjekt ndaj rregullimit <i>ex ante</i>, nëse përmbushen njëherazi tre kushtet e mëposhtme në këto tregje:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) verifikimi i prezencës së barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes; b) verifikimi nëse një strukturë tregu nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrencë efektive brenda një afati kohor përkatës; c) vlerësimi nëse aplikimi vetëm i ligjit në fuqi që rregullon fushën e konkurrencës është, ose jo, i mjaftueshëm për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim. <p>3. AKEP-i, duke iu përmbajtur maksimalisht parashikimeve të këtij ligji, përcakton tregjet përkatëse të përshtatshme për rrethanat kombëtare, veçanërisht tregjet përkatëse me shtrirje gjeografike lokale, rajonale ose kombëtare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke marrë parasysh, ndër të tjera, shkallën e konkurrencës në infrastrukturë në ato zona, në përputhje me parimet e ligjit të konkurrencës. AKEP-i, sipas rastit, merr parasysh edhe rezultatet e vrojtimit gjeografik të kryer në përputhje me nenin 43, të këtij ligji. AKEP-i kryen procesin e konsultimit sipas këtij ligji, përpara se të përcaktojnë tregjet që ndryshojnë nga ato të identifikuar në Rregullore.</p> | <p>F</p> | |
| <p>Neni65</p> | <p style="text-align: center;">Neni 65</p> <p style="text-align: center;">Procedura për identifikimin e tregjeve transnacionale</p> <p>1. Nëse Komisioni, ose të paktën dy autoritete rregullatore kombëtare, paraqesin një kërkesë të arsyeshme duke përfshirë provat mbështetëse, BEREC do të kryejë një analizë të një tregu të mundshëm transnacional. Pas konsultimit me palët e interesuara dhe duke marrë parasysh opinionin e analizatë bërë nga BEREC, Komisioni mund të marrë vendime që identifikojnë</p> | | <p>Neni 186</p> | <p style="text-align: center;">KREU XXIV</p> <p style="text-align: center;">DISPOZITA SHITESË</p> <p style="text-align: center;">Neni 186</p> <p style="text-align: center;">Procedura e identifikimit të tregjeve ndërkombëtare</p> <p>1. Nëse Komisioni Evropian, ose të paktën dy autoritete rregullatore kombëtare, paraqesin një kërkesë të arsyetuar, bazuar në prova mbështetëse, BEREC kryen</p> | <p>F</p> | <p>Per t'u zbatuar nga momenti i anetaresimit ne BE</p> |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|----------|--|---|--|
| | <p>tregjet transnacionale, në përputhje me parimet e ligjit të konkurrencës dhe duke marrë parasysh maksimalisht Rekomandimet dhe udhëzimeve e SMP-së, të miratuara në përputhje me nenin 64.</p> <p>2. Në rastin e tregjeve transnacionale të identifikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet kombëtare rregullatore të interesuara, kryejnë së bashku analizën e tregut duke marrë parasysh udhëzimeve SMP dhe në një mënyrë të bashkërenduar vendosin për çdo imponim, mirëmbajtje, ndryshim ose tërheqje të detyrimeve rregullatore të përmendura në nenin 67 (4). Autoritetet rregullatore kombëtare në fjalë, bashkarisht njoftojnë Komisionin për draft masat e tyre në lidhje me analizën e tregut dhe çdo detyrim rregullator, në përputhje me nenin 32 dhe 33.</p> <p>Dy ose më shumë autoritete rregullatore kombëtare gjithashtu mund të njoftojnë bashkërisht draft masat e tyre në lidhje me analizën e tregut dhe çdo detyrim rregullator në mungesë të tregjeve transnacionale, kur ata konsiderojnë se kushtet e tregut në juridiksionet e tyre përkatëse janë mjaft homogjene.</p> | | | <p>një analizë për tregun e mundshëm ndërkombëtar. Pas konsultimit me palët e interesuara dhe marrjes parasysh të analizës së BEREC, Komisioni mund të miratojë me vendim, identifikimin e tregut ndërkombëtar në përputhje me parimet e ligjit për konkurrencën dhe duke u mbështetur në rekomandimin dhe udhëzimet për fuqinë e ndjeshme në treg të miratuar në përputhje me nenin 89, të këtij ligji.</p> <p>2. Në rastin e identifikimit të tregjeve ndërkombëtare sipas pikës 1, të këtij neni, autoritetet rregullatore kombëtare, kryejnë bashkarisht analizën e tregut duke u mbështetur në udhëzimet për operatorët me fuqi të ndjeshme dhe bashkërisht vendosin për çdo detyrim, mbajtje, ndryshim apo heqje të detyrimeve rregullatore të përmendura në nenin 90, të këtij ligji. Autoritetet rregullatore kombëtare njoftojnë së bashku Komisionin, mbi projekt masat e tyre në lidhje me analizën e tregut, si dhe çdo detyrim rregullator sipas neneve 80 dhe 81, të këtij ligji. Dy ose më shumë autoritete rregullatore kombëtare gjithashtu njoftojnë së bashku projekt-masat e tyre, në lidhje me analizën e tregut dhe çdo detyrim rregullator në mungesë të tregjeve ndërkombëtare, kur ata konsiderojnë se kushtet e tregut dhe kuadri ligjor përkatës i tyre është mjaftueshëm i ngjashëm.</p> | | |
| Neni66 | <p style="text-align: center;">Neni 66 Procedura për identifikimin e kërkesës transnacionale</p> <p>1. BEREC do të kryejë një analizë të kërkesës transnacionale të përdoruesit fundor për produkte dhe shërbime që ofrohen brenda Bashkimit Evropian, në një ose më shumë tregje të listuara në Rekomandim, nëse merr një kërkesë të arsyeshme duke siguruar dëshmi mbështetëse nga Komisioni, ose të paktën dy nga autoritetet rregullatore kombëtare e përfshira, tregojnë se ekziston një problem serioz i kërkesës për t'u adresuar. BEREC gjithashtu mund të kryejë një analizë të tillë, nëse merr një kërkesë të arsyeshme nga pjesëmarrësit e tregut, duke siguruar prova të mjaftueshme mbështetëse dhe konsideron se ekziston një problem serioz i kërkesës për t'u adresuar. Analiza e BEREC-ut nuk cenon gjetjet e tregjeve transnacionale, në përputhje me nenin 65 (1) dhe çdo gjetje të tregjeve gjeografike kombëtare ose nën-kombëtare nga autoritetet rregullatore kombëtare në përputhje me nenin 64 (3).</p> <p>Kjo analizë e kërkesës transnacionale të përdoruesit fundor mund të përfshijë produkte dhe shërbime që furnizohen brenda tregut të produkteve ose shërbimeve që janë përcaktuar në mënyra të ndryshme nga një ose më shumë autoritete rregullatore kombëtare, kur merren parasysh rrethanat kombëtare, me kusht që ato produkte dhe shërbime të jenë të zëvendësueshme për ato që furnizohen në një nga tregjet e listuara në rekomandim.</p> | | Neni 187 | <p style="text-align: center;">Neni 187 Procedura për identifikimin e kërkesës ndërkombëtare</p> <p>1. BEREC kryen një analizë të kërkesës së përdoruesve ndërkombëtarë për produkte dhe shërbime që sigurohen brenda Bashkimit, në një ose më shumë nga tregjet e listuara në Rekomandim, nëse merr një kërkesë të arsyetuar që ofron prova mbështetëse nga Komisioni, ose të paktën nga dy nga autoritetet rregullatore kombëtare në fjalë, duke treguar se ka një problem serioz të kërkesës për t'u trajtuar. BEREC kryen gjithashtu një analizë të tillë, nëse merr një kërkesë të arsyetuar nga pjesëmarrësit e tregut, duke ofruar dëshmi të mjaftueshme mbështetëse dhe konsideron se ka një problem serioz të kërkesës për t'u adresuar. Analiza e BEREC, nuk cenon çdo gjetje të tregjeve ndërkombëtare në përputhje me nenin 179, të këtij ligji dhe çdo gjetje, nga AKEP, të tregjeve gjeografike kombëtare ose lokale, në përputhje me nenin 91, të këtij ligji.</p> <p>Kjo analizë e kërkesës së përdoruesve ndërkombëtare, përfshin produkte dhe shërbime që ofrohen brenda tregjeve të produkteve ose shërbimeve që janë përcaktuar në mënyra të ndryshme nga AKEP, kur merren parasysh rrethanat kombëtare, me kusht që ato produkte dhe shërbime të jenë të zëvendësueshme, me</p> | F | Per t'u zbatuar nga momenti i anetaresimit ne BE |

| | | | | | |
|--------|---|--|---------|--|---|
| | <p>2. Nëse BEREC, arrin në përfundimin se ekziston një kërkesë transnacionale e përdoruesve fundorë, ajo është e rëndësishme dhe nuk përmbushet sa duhet nga furnizimi i siguruar në bazë tregtare ose të rregulluar, pasi të këshillohet me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, nxjerr udhëzime për qasjet e përbashkëta që autoritetet rregullatore kombëtare të plotësojnë kërkesën e identifikuar transnacionale, duke e përfshirë kur është e pershtatshme dhe kur ato vendosin mjete juridike në përputhje me nenin 68. Autoritetet rregullatore kombëtare do të marrin parasysht maksimalisht ato udhëzime kur kryejnë detyrat e tyre rregullatore në juridiksionin e tyre. Këto udhëzime mund të ofrojnë bazën për bashkëveprimin e produkteve me shumicë të aksesit në të gjithë Bashkimin Evropian dhe mund të përfshijnë udhëzime për harmonizimin e specifikimeve teknike të produkteve me shumicë të aksesit, të afta për të përmbushur kërkesat e tilla të identikuara transnacionale.</p> | | | <p>ato të furnizuara në një nga tregjet e listuara në Rekomandim.</p> <p>2. Nëse BEREC arrin në përfundimin se ekziston një kërkesë e përdoruesve ndërkombëtare, e cila është e rëndësishme dhe nuk plotësohet mjaftueshëm nga oferta e ofruar mbi baza tregtare ose të rregulluara, ai, pas konsultimit me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, nxjerr udhëzime mbi qasjet e përbashkëta, në mënyrë që AKEP të përmbushë kërkesat e identifikuar ndërkombëtare, duke përfshirë sipas rastit, vendosjen e mjeteve juridike në përputhje me nenin 92, të këtij ligji. AKEP merr parasysht këto udhëzime, kur kryen detyrat e tij rregullatore brenda juridiksionit të tij. Këto udhëzime ofrojnë bazën për ndërveprimin e produkteve të aksesit me shumicë në të gjithë Bashkimin dhe përfshijnë udhëzime për harmonizimin e specifikimeve teknike të produkteve të aksesit me shumicë, të aftë për të përmbushur një kërkesë ndërkombëtare të identifikuar.</p> | |
| Neni67 | <p style="text-align: center;">Neni 67 Procedura e analizës së tregut</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare përcaktojnë nëse një treg përkatës, i përcaktuar në përputhje me nenin 64 (3), është i tillë që të justifikojë imponimin e detyrimeverregullatore të përcaktuara në këtë Direktivë. Shtetet Anëtare sigurojnë që të bëhet një analizë në bashkëpunim me autoritetet kombëtare të konkurrencës. Autoritetet rregullatore kombëtare, kur bëjnë një analizë të tillë, marrin parasysht maksimalisht udhëzimet për SMP dhe ndjekin procedurat e përmendura në nenet 23 dhe 32. Një treg mund të konsiderohet se justifikon imponimin e detyrimeve rregullatore të përcaktuara në këtë Direktivë, nëse përmbushen të gjitha kriteret e mëposhtme:</p> <p>(a) Kur janë të pranishme pengesat strukturore, ligjore ose rregullatore të larta dhe jo-tranzitore për hyrjen;</p> <p>(b) Kur ekziston një strukturë e tregut e cila nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda kufirit përkatës kohor, duke marrë parasysht gjendjen e konkurrencës së bazuar në infrastrukturë dhe burimeve të tjera të konkurrencës pas barrierave të hyrjes;</p> <p>(c) Nëse vetëm ligji i konkurrencës është i pamjaftueshëm për të adresuar në mënyrë adekuate dështimet e identikuara të tregut.</p> <p>Kur një autoritet kombëtar rregullator bën një analizë të një tregu që është i përfshirë në Rekomandim, do të marrë parasysht që pikat (a), (b) dhe (c) të nënparagrafit të dytë janë përmbushur, vetëm nëse autoriteti rregullator kombëtar përcakton, që një ose më shumë kritere të tilla nuk përmbushen në rrethanat specifike kombëtare.</p> | | Neni 90 | <p style="text-align: center;">Neni 90 Procedura e analizës së tregut</p> <p>1. Kur AKEP-i, kryen analizën e një tregu që përfshihet në listën e tregjeve përkatëse sipas parashikimeve në pikën 1, të nenit 89 të këtij ligji, AKEP merr parasysht plotësimin e kushteve sipas gërmeve a), b) dhe c), të paragrafit të dytë të nenit 89, të këtij ligji, përveç rasteve kur AKEP përcakton se një ose më shumë nga këto kritere nuk plotësohen në rrethanat specifike kombëtare.</p> <p>2. Gjatë procesit të analizës sipas parashikimeve në paragrafin 1 të nenit 89 të këtij ligji, AKEP-i, në mungesë të parashikimeve rregullatore, merr në konsideratë zhvillimet e pritshme në të ardhmen si më poshtë vijon:</p> <p>a) zhvillimet e tregut që ndikojnë në prirjen e tregut përkatës drejt konkurrencës efektive;</p> <p>b) të gjitha shqetësimet e mundshme për konkurrencën, në nivelet e shitjes me shumicë dhe pakicë, pavarësisht nëse burimi i këtyre shqetësimeve lidhet me rrjetet e komunikimeve elektronike, shërbimet e komunikimeve elektronike, apo lloje të tjera shërbimesh ose aplikacionesh që janë të krahasueshme nga këndvështrimi i përdoruesit fundor, dhe pavarësisht nëse këto kufizime janë pjesë e tregut përkatës;</p> <p>c) lloje të tjera rregullimesh ose masash të vendosura dhe që prekin tregun përkatës ose tregjet e shitjes me pakicë, gjatë gjithë periudhës përkatëse, duke</p> | F |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>2. Kur një autoritet kombëtar rregullator bën analizën e kërkuar nga paragrafi 1, ai do të marrë në konsideratë zhvillimet nga një perspektivë progresive, në mungesë të rregullave të vendosura në bazë të këtij neni në atë treg përkatës, dhe duke marrë parasysh të gjitha këto që vijnë :</p> <p>(a) zhvillimet e tregut që ndikojnë në gjasat e tregut përkatës që kanë tendencë për konkurrencë efektive;</p> <p>(b) të gjitha kufizimet përkatëse konkurruese, në nivelin me shumicë dhe pakicë, pavarësisht nëse burimet e këtyre kufizimeve konsiderohen si rrjete të komunikimeve elektronike, shërbime të komunikimeve elektronike, ose llojet e tjera të shërbimeve ose aplikacioneve që janë të krahasueshme nga këndvështrimi i përdoruesve fundorë dhe pavarësisht nëse kufizime të tilla janë pjesë e tregut përkatës;</p> <p>(c) llojet e tjera të rregullimit ose masave të imponuara dhe që prekin tregun përkatës ose tregun me pakicë ose tregjet gjatë gjithë periudhës përkatëse, duke përfshirë pa kufizime detyrimet e vendosura në përputhje me nenet 44, 60 dhe 61;</p> <p>(d) Rregulloren e vendosur në tregjet e tjera të rëndësishme në bazë të këtij neni.</p> <p>3. Kur një autoritet kombëtar rregullator konstaton se një treg përkatës nuk justifikon vendosjen e detyrimeverregullatore në përputhje me procedurën në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, ose kur kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni nuk janë përmbushur, ai nuk do të imponojë ose ruajë ndonjë detyrim specifik rregullator në përputhje me nenin 68. Kur tashmë ekzistojnë detyrime rregullatore specifike të sektorit të vendosura në përputhje me nenin 68, ai tërheq detyrimet e tilla të vendosura mbi ndërmarrjet në atë treg përkatës.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që palët e prekura nga një tërheqje e tillë e detyrimeve të njoftohen brenda një periudhe të përshtatshme, të përcaktuar duke balancuar nevojën për të siguruar një tranzicion të qëndrueshëm për përfituesit e atyre detyrimeve dhe përdoruesve fundorë, zgjedhjen e përdoruesve fundorë dhe atë rregullore të mos e vazhdojë më gjatë seç duhet. Kur vendoset një periudhë e tillë njoftimi, autoritetet kombëtare rregullatore mund të përcaktojnë kushte specifike dhe periudha njoftimesh në lidhje me marrëveshjet ekzistuese të aksesit.</p> <p>4. Kur një autoritet kombëtar rregullator përcakton që në një treg përkatës imponimi i detyrimeve rregullatore, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, është i justifikuar, ai identifikon çdo ndërmarrje që individualisht ose bashkërisht ka një fuqi të konsiderueshme të tregut në atë treg përkatës në përputhje me nenin 63. Autoriteti rregullator kombëtar, do t'u imponojë ndërmarrjeve të tilla detyrime rregullatore të duhura specifike në përputhje me nenin 68 ose do t'i ruajë ose ndryshojë këto detyrime, kur ato ekzistojnë tashmë, nëse konsideron se rezultati për përdoruesit fundorë nuk do të ishte efektivisht konkurrues në mungesë të atyre detyrimeve.</p> | | <p>përfshirë, pa kufizim, detyrimet e vendosura në përputhje me nenet 58, 81 dhe Kreut XIII, të këtij ligji;</p> <p>d) rregullat e vendosura në tregjet e tjera përkatëse në bazë të këtij neni.</p> <p>3. Kur AKEP arrin në përfundimin se një treg përkatës nuk e justifikon vendosjen e detyrimeve rregullatore në përputhje me procedurën e pikës 1 dhe 2 të këtij neni, ose kur kushtet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni nuk përmbushen, AKEP nuk vendos ose nuk mban ndonjë detyrim specifik rregullator në përputhje me nenin 92 të këtij ligji. AKEP heq detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrësit në tregun përkatës, duke siguruar që palët e ndikuara nga ky vendim, të njoftohen në një periudhë të përshtatshme kohore.</p> <p>4. Periudha e përshtatshme kohore sipas pikës 3 të këtij neni, përcaktohet nga AKEP duke balancuar nevojën për një tranzicion të qëndrueshëm për përfituesit e këtyre detyrimeve dhe përdoruesit fundor, zgjedhjen e përdoruesit fundor, dhe nevojën që rregullimi të mos vazhdojë përtej kohës së nevojshme. AKEP mund të përcaktojë kushte të posaçme si dhe periudhat e njoftimit në lidhje me marrëveshjet ekzistuese të aksesit.</p> <p>5. Kur AKEP përcakton që vendosja e detyrimeve rregullatore në një treg përkatës, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, janë të justifikuar, AKEP identifikon sipërmarrësit që vetëm ose së bashku me të tjerë, kanë fuqi të ndjeshme në tregun përkatës sipas nenit 92 të këtij ligji. AKEP vendos ndaj këtyre sipërmarrësve detyrimet e veçanta rregullatore në përputhje me nenin 92 të këtij ligji, ose mban apo ndryshon këto detyrime nëse ato ekzistojnë aktualisht, kur vlerëson se mungesa e këtyre detyrimeve nuk sjell rezultatet e konkurrencës efektive për përdoruesit fundor.</p> <p>6. AKEP-i kryen analizën e tregjeve përkatëse të identifikuar sipas përcaktimeve të këtij ligji, në mënyrë periodike sipas afateve më poshtë:</p> <p>a) brenda pesë vjetësh nga data e vendimit të mëparshëm të AKEP për përcaktimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në një treg përkatës të përcaktuar në rregulloren e AKEP;</p> <p>b) brenda tre vjetësh nga data e ndryshimit të rregullores për përcaktimin e tregjeve përkatës në përputhje me rekomandimet e BE-së, për tregjet e pa njoftuar më parë;</p> <p>c) brenda tre vjetësh nga data e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|-----------------------|---|--|----------------|---|----------|--|
| | <p>5. Masat e marra në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni do t'i nënshtrohen procedurave të përmendura në nenet 23 dhe 32. Autoritetet rregullatore Kombëtare kryejnë një analizë të tregut përkatës dhe njoftojnë për draft masën përkatëse në përputhje me nenin 32:</p> <p>(a) brenda pesë vjetësh nga miratimi i një mase të mëparshme kur autoriteti rregullator kombëtar ka përcaktuar tregun përkatës dhe ka përcaktuar se cilat ndërmarrje kanë fuqi të ndjeshme në treg; që periudha pesë-vjeçare, te mund të zgjatet deri në një vit, mundet kur autoriteti rregullator kombëtar ka njoftuar një propozim të arsyeshëm për një zgjatje në Komision jo më vonë se katër muaj para skadimit të periudhës pesë-vjeçare, dhe Komisioni nuk ka kundërshtuar brenda një muaji nga zgjatja e njoftuar;</p> <p>(b) brenda tre vjetësh nga miratimi i një Rekomandimi të rishikuar për tregjet përkatëse, për tregjet që nuk i janë njoftuar më parë Komisionit;</p> <p>ose</p> <p>(c) brenda tre vjetëve nga pranimi i tyre, për Shtetet Anëtare që janë anëtarësuar kohët e fundit në Bashkimin Evropian.</p> <p>6. Kur një autoritet kombëtar rregullator, mendon se nuk mund të përfundojë ose nuk ka përfunduar analizën e tij për një treg përkatës të identifikuar në rekomandim, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, sipas kërkesës BEREC do t'i ofrojë ndihmë autoritetit rregullator kombëtar të interesuar në përfundimin e analizës së tregut specifik dhe detyrimeve specifike që do të imponohen. Me këtë ndihmë, autoriteti rregullator kombëtar, brenda gjashtë muajve nga kufiri i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, do t'i njoftojë Komisionit draft masën në përputhje me nenin 32.</p> | | | <p>7. Në raste përjashtimore e të justifikuara, afati i përcaktuar në gërmën a, të pikës 6, të këtij neni, mund të shtyhet jo më shumë se një vit. AKEP njofton ministrin për arsyet e shtyrjes së afatit për analizën e tregut të paktën katër muaj para përfundimit të afatit.</p> <p>8. Nëse një ose më shumë sipërmarrës janë shpallur FNT në tregun përkatës dhe në përfundim të procesit të analizës së tregut, vlerësohet se në këtë treg ka konkurrencë efektive, atëherë AKEP vendosë të mbajë, të ndryshojë ose të heqë detyrimet e veçanta.</p> <p>9. Kur AKEP konsideron që nuk mund të përfundojë analizën e tregut përkatës të identifikuar sipas këtij ligji brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, AKEP mund të kërkojë këshillim nga BEREC për përfundimin e analizës së tregut përkatës dhe vendosjen e detyrimeve të veçanta.</p> | | |
| <p>Neni 68</p> | <p align="center">PJESA II – TITULLI II</p> <p align="center">Aksesi</p> <p align="center">Kapitulli IV</p> <p align="center">Mjetet juridike të aksesit të imponuara për sipërmarrjet me fuqi të ndjeshme në tregu</p> <p align="center">Neni 68</p> <p align="center">Vendosja, ndryshimi ose tërheqja e detyrimeve</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare janë autorizuar të imponojnë detyrimet e përcaktuara në nenet 69 deri 74 dhe nenet 76 deri 81.</p> <p>2. Kur një sipërmarrje është caktuar të ketë fuqi të ndjeshme të tregut në një treg specifik si rezultat i një analize të tregut të kryer në përputhje me nenin 67, autoritetet rregullatore kombëtare vendosin sipas rastit, cilindo nga detyrimet e përcaktuara në nenet 69 deri në 74 dhe nenet 76 dhe 80. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, një autoritet rregullator</p> | | <p>Neni 92</p> | <p align="center">KREU XV</p> <p align="center">DETYRIMET PËR AKSESE NDAJ SIPËRMARRËSVE ME FUQI TË TË NDJESHME NË TREG</p> <p align="center">Neni 92</p> <p align="center">Vendosja, ndryshimi ose heqja e detyrimeve</p> <p>1. Vendosja e detyrimeve ndaj sipërmarrësve të shpallur fuqi të ndjeshme në treg, ndryshimi, mbajtja ose heqja e detyrimeve sipas përcaktimeve në nenet 93 deri 99 dhe nenet 101, deri në 104, të këtij ligji, bëhet me vendim të AKEP-it, pas përfundimit të procedurës për analizën e tregut dhe përcaktimit të sipërmarrësit/ve me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës. Vendimet e AKEP-it, merren pas procesit të konsultimit publik të përcaktuar në nenet 44 dhe 45, të këtij ligji.</p> <p>2. Kur një sipërmarrës, përcaktohet se ka fuqi të ndjeshme në një treg përkatës, mbi bazën e një analize tregu të kryer në përputhje me këtë ligj, AKEP-i, sipas rastit,</p> | <p>F</p> | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>kombëtar zgjedh mënyrën më pak ndërhyrëse për adresimin e problemeve të identifikuar në analizën e tregut.</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare vendosin detyrime të përcaktuara në nenet 69 deri 74 dhe nenet 76 dhe 80 vetëm për sipërmarrjet që janë caktuar të kenë fuqi të ndjeshme të tregut, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, pa cënuar:</p> <p>(a) Nenet 61 dhe 62;</p> <p>(b) Nenet 44 dhe 17 të kësaj Direktive, Kushti 7 në Pjesën D të Shtojcës I, siç zbatohet në bazë të nenit 13 (1) të kësaj direktive, nenet 97 dhe 106 të kësaj direktive dhe dispozitave përkatëse të Direktivës 2002/58/KE që përmbajnë detyrime ndaj sipërmarrjeve të ndryshme nga ato të përcaktuara si fuqi të ndjeshme në treg;</p> <p>ose</p> <p>(c) nevojën për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare.</p> <p>Në rrethana të jashtëzakonshme, kur një autoritet kombëtar rregullator, synon të imponojë sipërmarrjet e përcaktuara që kanë detyrime të konsiderueshme të fuqisë së tregut akses ose interkoneksion, përveç atyre të përcaktuara në nenet 69 deri 74 dhe nenet 76 dhe 80, ai i paraqet një kërkesë Komisionit. Komisioni, do të marrë parasysh opinionin e BEREK, do të miratojë vendime me anë të zbatimit të akteve, duke autorizuar ose parandaluar autoritetin rregullator kombëtar të marrë masa të tilla.</p> <p>Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën këshilluese të përmendur në nenin 118 (3).</p> <p>4. Detyrimet e vendosura në përputhje me këtë nen do të jenë:</p> <p>(a) të bazuara në natyrën e problemit të identifikuar nga një autoritet kombëtar rregullator në analizën e tij të tregut, duke marrë parasysh identifikimin e kërkesës transnacionale, në përputhje me nenin 66;</p> <p>(b) proporcionale, duke pasur parasysh, kostot dhe përfitimet;</p> <p>(c) të arsyetuara në dritën e objektivave të përcaktuara në nenin 3; dhe</p> <p>(d) vendosjen pas konsultimit në përputhje me nenet 23 dhe 32.</p> <p>5. Në lidhje me nevojën për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, autoritetet rregullatore kombëtare njoftojnë vendimet për vendosjen, ndryshimin ose tërheqjen e detyrimeve ndaj sipërmarrjeve pranë Komisionit, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 32.</p> <p>6. Autoritetet rregullatore kombëtare do të marrin parasysh ndikimin e zhvillimeve të reja të tregut, në lidhje me marrëveshjet tregtare, përfshirë marrëveshjet e bashkë-investimit, duke ndikuar në dinamikën e konkurrencës.</p> | | <p>vendos detyrimet e përcaktuara në nenet 93 deri në 99 dhe nenet 101 dhe 106, të këtij ligji. Në përputhje me objektivat e nenit 5, të këtij ligji dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, AKEP-i zgjedh mënyrën më efektive dhe me sa më pak ndërhyrje për adresimin e problemeve të evidentuara në analizën e tregut.</p> <p>3. AKEP-i vendos detyrimet e përcaktuara në nenet 93 deri 99, 101 dhe 106, të këtij ligji, vetëm për sipërmarrësit që janë përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg në përputhje me pikën 2 të këtij neni, pa paragjykuar:</p> <p>a) parashikimet për aksesin sipas Kreut XIII , të këtij ligji;</p> <p>b) nenet 58 dhe 36, të këtij ligji, si dhe çdo angazhim që sipërmarrësi që merr të drejtat e përdorimit, ka bërë në kuadrin e një procesi të rinovimit të autorizimit ose përpara dhënies së autorizimit, ose, sipas rastit, ndaj ftesës për aplikim për të drejtat e përdorimit, nenet 135 dhe 145, të këtij ligji dhe dispozitat përkatëse të Kreut XIX, të këtij ligji që përmbajnë detyrime ndaj sipërmarrësve, të ndryshme nga ato të përcaktuara si me fuqi të ndjeshme në treg, ose;</p> <p>c) nevojën për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare.</p> <p>4. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur AKEP-i synon t'u vendosë sipërmarrësve të përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg, detyrime për aksesin ose interkoneksionin, përveç atyre të parashikuara në nenet 93 deri në 99 dhe neneve 101 e 106, të këtij ligji, ai duhet t'i paraqesë një kërkesë ministrit. Në rast se ministri miraton këtë kërkesë, propozimi i dërgohet Këshillit të Ministrave për një vendim që autorizon ose ndalon AKEP-in në marrjen e masave të tilla.</p> <p>5. Vendosja e detyrimeve sipas këtij neni bazohet në:</p> <p>a) natyrën e problemit të identifikuar nga AKEP gjatë analizës së tregut dhe kur është e përshtatshme merr në konsideratë kërkesat ndërkombëtare sipas nenit 186, të këtij ligji;</p> <p>b) proporcionalitetin duke mbajtur parasysh kur është e mundur përfitimet dhe kostot;</p> <p>c) justifikimin sipas objektivave të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji; dhe,</p> <p>d) vendosjen e tyre pas një procesi konsultimi të kryer sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p> <p>6. Në lidhje me nevojën për të respektuar angazhimet ndërkombëtare të përmendura në pikën 3 të këtij neni, AKEP-i, i njofton Komisionit Evropian vendimet për vendosjen, ndryshimin ose tërheqjen e detyrimeve të sipërmarrjeve, në përputhje me procedurën e</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|---------------|---|--|---------|--|---|
| | <p>Nëse këto zhvillime nuk janë mjaft të rëndësishme për të kërkuar një analizë të re të tregut, në përputhje me nenin 67, autoriteti rregullator kombëtar vlerëson pa vonesë nëse është e nevojshme të rishikohendetyrimet e vendosura për sipërmarrjet e përcaktuara si fuqi të ndjeshme në treg dhe të ndryshojnë çdo vendim të mëparshëm, përfshirë tërheqjen e detyrimeve ose vendosjen e detyrimeve të reja, me qëllim që të sigurohen që detyrime të tilla vazhdojnë të plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni. Ndryshimet e tilla do të vendosen vetëm pas konsultimeve në përputhje me nenet 23 dhe 32.</p> | | | <p>parashikuar në nenin 32, të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike.</p> <p>7. AKEP merr në konsideratë ndikimin e zhvillimeve të reja të tregut, në lidhje me marrëveshjet tregtare, përfshirë marrëveshjet e bashkëinvestimit, që ndikojnë në dinamikën konkurruese. Nëse këto zhvillime nuk janë mjaftueshëm të rëndësishme për të kërkuar një analizë të re tregu në përputhje me nenin 90, të këtij ligji, AKEP vlerëson pa vonesë, nëse është i nevojshëm rishikimi i detyrimeve të vendosura ndaj sipërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg dhe ndryshimi i çdo vendimi të mëparshëm, duke përfshirë heqjen e detyrimeve ose vendosjen e detyrimeve të reja, për të siguruar që këto detyrime të vazhdojnë të plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 5, të këtij neni. Këto ndryshime vendosen vetëm pas proceseve konsultuese në përputhje me nenin 44, të këtij ligji.</p> | |
| Neni69 | <p style="text-align: center;">Neni 69 Detyrimi i transparencës</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare, në përputhje me nenin 68, mund të vendosin detyrime të transparencës në lidhje me interkoneksionin ose aksesin, duke kërkuar nga sipërmarrjet që të bëjnë informacion specifik publik, siç janë informacioni i kontabilitetit, çmimet, specifikimet teknike, karakteristikat e rrjetit dhe zhvillimet e pritshme të tyre, si dhe termat dhe kushtet për furnizim, përfshirë çdo kusht që ndryshon aksesin ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve, veçanërisht në lidhje me migracionin nga infrastruktura ligjore, kur këto kushte lejohen nga Shtetet Anëtare në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian.</p> <p>2. Në veçanti, kur një sipërmarrje ka detyrime të mosdiskriminimit, autoritetet rregullatore kombëtare mund të kërkojnë që ndërmarrja të botojë një ofertë referimi, e cila do të jetë mjaft e shpërndarë për të siguruar që ndërmarrjet nuk kërkohen të paguajnë për lehtësira që nuk janë të nevojshme për shërbimin e kërkuar. Kjo ofertë do të përmbajë një përshkrim të ofertave përkatëse të ndara në komponentë sipas nevojave të tregut, termave dhe kushteve të lidhura, përfshirë çmimet. Autoriteti rregullator kombëtar mund të vendosë ndryshime në ofertat e referencës për të dhënë efekt të detyrimeve të vendosura sipas kësaj direktive.</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të specifikojnë informacionin e saktë që duhet të vihet në dispozicion, nivelin e detajeve të kërkuara dhe mënyrën e publikimit.</p> <p>4. Deri më 21 dhjetor 2019, për të kontribuar në zbatimin e vazhdueshëm të detyrimeve të transparencës, BEREC, pasi të keshillojë palët e interesuara dhe në bashkëpunim me Komisionin, do të nxjerrë udhëzime për kriteret minimale për një ofertë reference dhe do t'i rishikojë ato kur është e nevojshme për t'i</p> | | Neni 93 | <p style="text-align: center;">Neni 93 Detyrimi i transparencës</p> <p>1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, detyrime për transparencë, në lidhje me aksesin dhe interkoneksionin.</p> <p>2. AKEP, pavarësisht parashikimeve të nenit 41, të këtij ligji, vendos ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrimet për të publikuar këtë informacion:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) informacion mbi të dhënat financiare; b) specifikimet teknike; c) karakteristikat e rrjetit; d) termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin; e) tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme. <p>3. AKEP-i përcakton edhe shkallën e hollësive dhe mënyrën e publikimit të informacionit të mësipërm, nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg.</p> | F |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|---------|--|---|--|
| | <p>përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe të tregut. Në sigurimin e kriterëve të tilla minimale, BEREC do të ndjekë objektivat në nenin 3 dhe do të ketë parasysh nevojat e përfituesve të detyrimeve të aksesit dhe të përdoruesve fundorë që janë aktivë në më shumë se një Shtet Anëtar, si dhe çdo udhëzim të BEREC për identifikimin e kërkesës transnacionale në përputhje me nenin 66 dhe çdo vendim të lidhur me Komisionin.</p> <p>Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij neni, kur një ndërmarrje ka detyrime sipas nenit 72 ose 73 në lidhje me aksesin me shumicë në infrastrukturën e rrjetit, autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë publikimin e një oferte referimi për të marrë parasysh opinionin e BEREC mbi kriteret minimale për një ofertë referimi, kjo do të sigurojë që treguesit kryesorë të performancës janë specifikuar si edhe nivelet përkatëse të shërbimit, dhe monitorojnë nga afër dhe sigurojnë respektimin e tyre. Për më tepër, autoritetet kombëtare rregullatore, mund të paracaktojnë ndëshkimet e shoqëruara financiare në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian dhe ligjin kombëtar.</p> | | | | | |
| Neni70 | <p style="text-align: center;">Neni 70 Detyrimi i mosdiskriminimit</p> <p>1. Një autoritet kombëtar rregullator, në përputhje me nenin 68, mund të imponojë detyrimin e mosdiskriminimit, në lidhje me interkoneksionin ose aksesin.</p> <p>2. Detyrimet e mosdiskriminimit do të sigurojnë, që sipërmarrja të zbatojë kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ofruesit e tjerë të shërbimeve ekuivalente, dhe siguron shërbime dhe informacion për të tjerët në të njëjtat kushte dhe me të njëjtën cilësi siç siguron shërbimet e veta, ose ato të filialeve ose partnerëve të saj. Autoritetet rregullatore kombëtare mund t'i imponojnë asaj sipërmarrje detyrime për të furnizuar produkte dhe shërbime të aksesit për të gjitha sipërmarrjet, përfshirë vetë atë, në të njëjtat periudha kohore, terma dhe kushte, përfshirë ato që lidhen me çmimet dhe nivelet e shërbimit, dhe me anë të të njëjtave sisteme dhe procese, me qëllim të sigurimit të ekuivalencës së aksesit.</p> | | Neni 95 | <p style="text-align: center;">Neni 95 Detyrimi i mosdiskriminimit</p> <p>1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrime për mosdiskriminim për aksesin dhe interkoneksionin.</p> <p>2. Detyrimet për mosdiskriminim, sigurojnë në veçanti, që një sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg, të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij.</p> <p>3. AKEP-i u kërkon sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, të publikojnë një ofertë reference për aksesin dhe interkoneksionin. Sipërmarrësi duhet të ofrojë në këtë ofertë reference shërbime të detajuara, zërthimin e ofertave përkatëse në elementët përbërës, në përputhje me nevojat e tregut dhe deklarimin e termave e të kushteve shoqëruese, përfshirë tarifën.</p> <p>4. AKEP-i kërkon dhe detyron ndryshime në ofertën referencë të aksesit, me qëllim që të realizohen detyrimet e vendosura sipas këtij ligji dhe akteve në zbatim të tij.</p> | | |
| Neni71 | <p style="text-align: center;">Neni 71 Detyrimi i ndarjes së llogarisë</p> <p>1. Një autoritet kombëtar rregullator, në përputhje me nenin 68, mund të imponojë detyrime për ndarjen e llogarisë në lidhje me aktivitetet e specifikuar që lidhen me ndërlidhjen ose aksesin.</p> <p>Autoriteti kombëtar rregullator mund të kërkojë nga një sipërmarrje e integruar vertikalisht që të bëjë transparente çmimet</p> | | Neni 96 | <p style="text-align: center;">Neni 96 Detyrimi për ndarjen e llogarive</p> <p>1. AKEP-i u kërkon sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, të paraqesin në mënyrë të detajuar koston për aktivitete të veçanta, që lidhen me aksesin dhe interkoneksionin, me qëllim parandalimin e subvencionimit e ndërsjelltë të pandershëm.</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|------------------|---|---|--|
| | <p>e saj me shumicë dhe çmimet e saj të brendshme të transferimit, për të siguruar pajtueshmërinë kur ekziston një detyrim i mosdiskriminimit sipas nenit 70, ose kur është e nevojshme, për të parandaluar subvencionin e padrejtë. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të specifikojnë format dhe metodologjinë e llogarisë që do të përdoret.</p> <p>2. Pa çenuar nenin 20, për të lehtësuar verifikimin e respektimit të detyrimeve të transparencës dhe mosdiskriminimit, autoritetet rregullatore kombëtare do të kenë fuqinë të kërkojnë që regjistrimet e llogarisë, përfshirë të dhënat për të ardhurat e marra nga palët e treta, të sigurohen sipas kërkesës. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të publikojnë informacione që do të kontribuojnë në një treg të hapur dhe konkurrues, ndërsa respektojnë rregullat e Bashkimit Evropian dhe ligjet kombëtare për konfidencialitetin tregtar.</p> | | | <p>2. Për këtë qëllim, në vecanti, sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg të integruar vertikalisht, i kërkohet të bëjë transparente tarifat e shumicës dhe tarifat e transferimeve të brendshme. AKEP-i përcakton formatin dhe metodologjinë e llogaritjes që përdoret, duke përfshirë shkallën e hollësishtme dhe mënyrën me të cilën ato do të paraqiten dhe bëhen të disponueshme.</p> <p>3. Nëse AKEP ka vendosur një detyrim specifik sipas neneve 93 dhe 95 të këtij ligji, atëherë kërkon që, pavarësisht nga dispozitat e nenit 41, të këtij Ligji, që të dhënat për llogaritë, përfshirë të gjitha informacionet dhe dokumentet mbështetëse, t'i paraqiten kundrejt kërkesës në mënyrën dhe formën e përcaktuar. AKEP-i e publikon këtë informacion, nëse kjo vlerësohet e nevojshme për nxitjen e konkurrencës në treg, duke marrë parasysh kërkesat ligjore për ruajtjen e sekreteve tregtare dhe funksionale apo operacionale të biznesit.</p> | | |
| Neni72 | <p style="text-align: center;">Neni 72 Aksesi në inxhinierinë civile</p> <p>1. Një autoritet kombëtar rregullator, në përputhje me nenin 68, mund të imponojë detyrime ndaj sipërmarrjeve për të përmbushur kërkesa të arsyeshme për akses dhe përdorimin e inxhinierisë civile, por pa u kufizuar në ndërtesa ose akses në ndërtesa, kablllo ndërtimi, përfshirë instalime elektrike, antenat, kullat dhe ndërtimet e tjera mbështetëse, shufrat, kanalet, përçuesit, dhomat e inspektimit, pusetat dhe kabinetet, në situatat kur ka marrë në konsideratë analizën e tregut, autoriteti rregullator kombëtar nxjerr në konkluzion se mohimi i hyrjes ose aksesit të dhënë nën kushte të paarsyeshme dhe kushtet që kanë një efekt të ngjashëm do të pengonin shfaqjen e një tregu të qëndrueshëm konkurrues dhe nuk do të ishin në interesin e përdoruesve fundorë.</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të vendosin detyrime për një ndërmarrje për të siguruar akses në përputhje me këtë nen, pavarësisht nëse asetet që preken nga detyrimet janë pjesë e tregut përkatës në përputhje me analizën e tregut, me kusht që detyrimet të jenë të nevojshme dhe proporcionale për të përmbushur objektivat e nenit 3.</p> | | Neni 97 | <p style="text-align: center;">Neni 97 Aksesi në punime, inxhinierinë civile</p> <p>1. AKEP-i, vendos ndaj sipërmarrësit detyrime për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për akses dhe përdorim të punimeve të inxhinierisë civile, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, ndërtesat ose pikat e aksesit në ndërtesa, kabllot në ndërtesa, përfshirë antenat, kullat dhe ndërtimet e tjera mbështetëse, shtylla, kanale, përçjellsa, dhoma inspektimi, puseta dhe kabinetet, në situatat kur, bazuar në analizën e tregut, arrin në përfundimin se refuzimi i aksesit, ose aksesit i dhënë me terma dhe kushte të paarsyeshme, ka një efekt të ngjashëm që pengon konkurrencën në treg dhe nuk është në interesin e përdoruesit fundor.</p> <p>2. AKEP-i, i imponon një operatori detyrimin për të ofruar akses në përputhje me këtë nen, pavarësisht nëse aktivitet që preken nga ky detyrim, janë pjesë e tregut përkatës në përputhje me analizën e tregut, me kusht që detyrimi të jetë i nevojshëm dhe proporcional për përmbushjen e objektiveve të nenit 5, të këtij ligji.</p> | F | |
| Neni73 | <p style="text-align: center;">Neni 73 Detyrimet e aksesit dhe përdorimit të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve të shoqëruara</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare, në përputhje me nenin 68, mund të imponojnë detyrime ndaj sipërmarrjeve për të përmbushur kërkesa të arsyeshme për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në</p> | | Neni85 Neni89 | <p style="text-align: center;">Neni 94 Marrëveshjet e Aksesit</p> <p>1. Një sipërmarrës i rrjetit të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, ndaj të cilit është vendosur detyrimi për akses sipas nenit 98 të këtij ligji, duhet t'u japë sipërmarrësve të tjerë, që kërkojnë akses në rrjetin e tij, një ofertë që ata të ofrojnë shërbime të</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>situata kur autoritetet rregullatore kombëtare konsiderojnë se mohimi i aksesit ose termat dhe kushtet e paarsyeshme që kanë një efekt të ngjashëm do të pengonin shfaqjen e një tregu të qëndrueshëm konkurrues në nivelin me pakicë, dhe nuk do të ishin në interesin e përdoruesve fundorë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Autoritetet rregullatore kombëtare mund tu kërkojnë ndërmarrjeve ndër të tjera: <ol style="list-style-type: none"> (a) për t'u dhënë palëve të treta mundësinë e përdorimit të elementeve specifike të rrjetit fizik dhe lehtësitë e shoqëruara, duke përfshirë hyrjen e pakufizuar në lakun lokal (local loop)dhe nën-lak (sub loop); (b) t'u japë palëve të treta akses në elemente dhe shërbime specifike të rrjetit aktiv ose virtual; (c) të negociojë në mirëbesim me ndërmarrjet që kërkojnë akses; (d) të mos tërheqë aksesin në pajisjet e dhëna; (e) të ofrojë shërbime specifike mbi baza shumice për shitje nga palët e treta; (f) të lejojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera kryesore që janë të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose shërbimeve virtuale të rrjetit; (g) të sigurojë vendndodhjen e përbashkët ose format e tjera të ndarjes së lehtësivepërkatese; (h) të ofrojë shërbime specifike të nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve të mbarimit për përdoruesit, ose roaming në rrjetet e lëvizshme; (i) të sigurojë akses në sistemet e ndihmës operative ose sisteme të ngjashme softuerike, të nevojshme për të siguruar një konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve; (j) për të ndërlidhur rrjetet ose pajisjet e rrjetit; (k) të sigurojë akses në shërbimet e ofruara siç janë identiteti, vendndodhja dhe shërbimi i pranisë. • Autoritetet rregullatore kombëtare mund t'i nënshtrohen këtyre detyrimeve ndaj kushteve që mbulojnë ndershmërinë, arsyeshmërinë dhe afatin kohor. <p>2. Kur autoritetet rregullatore kombëtare konsiderojnë përshtatshmërinë e imponimit të detyrimeve të mundshme specifike të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe veçanërisht kur ata vlerësojnë, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, nëse dhe si detyrimet e tilla do të imponohen, ata do të analizojnë nëse format e tjera të aksesit në inputet e shumicë,në të njëjtin treg ose me një treg të lidhur me shumicë, do të jenë të mjaftueshme për të adresuar problemin e identifikuar në interesat e përdoruesve fundorë. Ky vlerësim do të përfshijë oferta komerciale për akses, akses të rregulluar në pajtim me nenin 61, ose akses të rregulluar ekzistues ose të planifikuar në inputet e tjera me shumicë në përputhje me këtë nen. Autoritetet rregullatore kombëtare marrin parasysh faktorët e mëposhtëm:</p> | | <p>komunikimeve elektronike. Oferta e aksesit duhet të paraqitet pa vonesë, por në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë nga dita e marrjes së kërkesës.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Marrëveshjet e aksesit të lidhura nga një operator publik i rrjeteve të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, me sipërmarrësit e tjerë, përgatitet me shkrim. 3. Një sipërmarrës i rrjetit të komunikimeve elektronike me fuqi të ndjeshme në treg, duhet të paraqesë në AKEP marrëveshjen e aksesit, ku ai është palë, brenda 15 ditëve nga data e lidhjes së saj. AKEP-i publikon vendin dhe kohën kur marrëveshjet e mësipërme të jenë të vlefshme për inspektim nga subjektet që kërkojnë shërbime dhe facilitate të aksesit. 4. Pavarësisht pikës 3 të këtij neni, kur një operator ka detyrime sipas nenit 97 ose 98, të këtij ligji, në lidhje me aksesin me shumicë në infrastrukturën e rrjetit, AKEP siguron publikimin e një oferte referencë, duke marrë parasysh maksimalisht udhëzimet e BEREC, për kriteret minimale për një ofertë referencë dhe siguron që treguesit kryesorë të performancës janë specifikuar, aty ku është e përshtatshme, si dhe nivelet përkatëse të shërbimit, dhe monitoron nga afër dhe sigurohet për përputhjen me to. <p style="text-align: center;">Neni 89 Detyrimet e aksesit dhe përdorimit të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AKEP vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë. 2. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg i kërkohej njëra, disa, apo të gjitha prej masave të mëposhtme, në mënyrë të veçantë: <ol style="list-style-type: none"> a) t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal, duke lejuar, ndërmjet të tjerash, zgjedhjen dhe/ose parazgjedhjen e bartësit dhe/ose ofertat e rishitjes së linjës së pajtimtarit; b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta; | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>(a) qëndrueshmërinë teknike dhe ekonomike të përdorimit ose instalimit të pajisjeve konkurruese, sipas shkallës së zhvillimit të tregut, duke marrë parasysh natyrën dhe llojin e ndërlidhjes ose aksesin e përfshirë, duke përfshirë qëndrueshmërinë e produkteve të tjera të aksesit upstream, të tilla si aksesin në ducts;</p> <p>(b) evolucionin e prishëm teknologjik që ndikon në hartimin dhe menaxhimin e rrjetit;</p> <p>(c) nevojën për të siguruar neutralitetin e teknologjisë që mundëson palët të hartojnë dhe menaxhojnë rrjetet e tyre;</p> <p>(d) mundësinë e sigurimit të aksesit të ofruar, në lidhje me kapacitetin e mundshëm;</p> <p>(e) investimin fillestar nga pronari i objektit, duke marrë parasysh çdo investim publik të bërë dhe rreziqet e bëra për të investuar, kryesisht me investimet, dhe nivelet e rrezikut të lidhura me rrjetet me kapacitet shumë të lartë;</p> <p>(f) nevojën për të mbrojtur konkurrencën në një afat të gjatë, me vëmendje të veçantë konkurrencës ekonomikisht të efektshme të bazuar në infrastrukturë dhe modele biznesi të reja që mbështesin konkurrencën e qëndrueshme, siç janë ato të bazuara në bashkë-investime në rrjete;</p> <p>(g) kur është e përshtatshme, çdo të drejtë përkatëse e pronësisë intelektuale;</p> <p>(h) ofrimin e shërbimeve pan-Evropiane.</p> <p>Kur një autoritet kombëtar rregullator konsideron, në përputhje me nenin 68, detyrimin e obligimeve në bazë të neneve 72 ose të këtij neni, ai do të shqyrtojë nëse vendosja e obligimeve në përputhje me nenin 72 do të ishte një mjet proporcional, me të cilin mund të promovohet konkurrenca dhe interesat e përdoruesve të fundit.</p> <p>3. Kur vendosin detyrime ndaj një sipërmarrjeje për të siguruar akses në përputhje me këtë nen, autoritetet rregullatore kombëtare mund të përcaktojnë kushte teknike ose operationale që duhet të përmbushen nga ofruesi ose përfituesit e një aksesit të tillë, për të siguruar funksionimin normal të rrjetit. Detyrime për të ndjekur standarde specifike teknike ose specifitime duhet të jenë në përputhje me standardet dhe specifimet e përcaktuara në përputhje me nenin 39.</p> | | <p>c) të mos anulohet aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;</p> <p>ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;</p> <p>d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollat ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;</p> <p>dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllorë ose shtyllat, kullat;</p> <p>e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore - pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut në rrjetet mobile;</p> <p>ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;</p> <p>f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.</p> <p>g) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese.</p> <p>3. Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni dhe për të vlerësuar nëse detyrimi për akses dhe interkoneksion është i justifikuar dhe proporcional, për rregullimet e parashtruara në këtë ligj, AKEP duhet të ketë parasysh, veçanërisht, faktorët e mëposhtëm:</p> <p>a) aftësitë teknike dhe ekonomike për përdorimin ose instalimin e faciliteteve konkurruese, në pikëpamje të shkallës së zhvillimit të tregut, duke pasur parasysh natyrën dhe tipin e interkoneksionit e të aksesit, që është në diskutim, përfshirë mundësinë e aksesit në produkte të tjera të një niveli më të lartë, si aksesin në tubacione;</p> <p>b) mundësinë e ofrimit të aksesit të propozuar, në relacion me kapacitetet e disponueshme;</p> <p>c) investimin fillestar nga pronari i faciliteteve, duke mbajtur parasysh riskun e përfshirë në kryerjen e investimit;</p> <p>ç) nevojën për të garantuar konkurrencën në terma afatgjatë në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe, veçanërisht, duke krijuar stimuj për investime efikente në facilitete, të cilat, në terma afatgjatë, sigurojnë më shumë konkurrencë;</p> <p>d) të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale.</p> <p>4. Kur një sipërmarrës dëshmon se përdorimi i facilitetit mund të rrezikojë mirëmbajtjen e tërësisë së rrjetit ose funksionet e rrjetit, AKEP nuk vendos detyrim për këtë facilitet, ose vendos detyrimin në një formë tjetër.</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>Mirëmbajtja e tërësisë së rrjetit dhe siguria e funksioneve të rrjetit duhet të justifikohen nga sipërmarrësi, bazuar në standardet objektive..</p> <p>Neni 98 Detyrimet e aksesit dhe përdorimit të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, detyrimin për të plotësuar kërkesat për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë. 2. Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg i kërkohet njëra, disa, apo të gjitha prej masave të mëposhtme, në mënyrë të veçantë: <ol style="list-style-type: none"> a) t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal dhe nënqarkun lokal, “<i>sub local loop</i>”; b) të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta; c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë; ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses; d) të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollat ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual; dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat; e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore - pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent ose roaming-ut në rrjetet e lëvizshme; ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike software, të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve; f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit. g) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese. 3. Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 2, të këtij neni, AKEP vlerëson nëse detyrimi për akses dhe | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|---|--|---------|---|---|--|
| | | | | <p>interkoneksion është i justifikuar dhe proporcional për rregullimet e parashikuara në këtë ligj, duke mbajtur parasysh veçanërisht, faktorët e mëposhtëm:</p> <p>a) aftësitë teknike dhe ekonomike për përdorimin ose instalimin e faciliteteve konkurruese, në pikëpamje të shkallës së zhvillimit të tregut, duke pasur parasysh natyrën dhe tipin e interkoneksionit e të aksesit, që është në diskutim, përfshirë mundësinë e aksesit në produkte të tjera të një niveli më të lartë, si aksesin në tubacione;</p> <p>b) zhvillimet e pritshme teknologjike që ndikojnë në projektimin dhe menaxhimin e rrjetit;</p> <p>c) nevojën për të siguruar neutralitetin teknologjik duke u mundësuar palëve projektimin dhe menaxhimin e rrjeteve të tyre;</p> <p>ç) mundësinë e ofrimit të aksesit të propozuar, në relacion me kapacitetet e disponueshme;</p> <p>d) investimin fillestar nga pronari i faciliteteve, duke mbajtur parasysh riskun e përfshirë në kryerjen e investimit;</p> <p>e) nevojën për të garantuar konkurrencën në terma afatgjatë në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe veçanërisht, duke krijuar stimuj për investime efikente në facilitete, të cilat, në terma afatgjatë që sigurojnë më shumë konkurrencë;</p> <p>ë) kur është e përshtatshme të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale;</p> <p>f) sigurimin e shërbimeve pan-Evropiane.</p> <p>4. Kur një sipërmarrës dëshmon se përdorimi i facilitetit mund të rrezikojë mirëmbajtjen e tërësisë së rrjetit ose funksionet e rrjetit, AKEP-i nuk vendos detyrim për këtë facilitet, ose vendos detyrimin në një formë tjetër. Mirëmbajtja e tërësisë së rrjetit dhe siguria e funksioneve të rrjetit duhet të justifikohen nga sipërmarrësi, bazuar në standardet objektive.</p> | | |
| Neni74 | <p style="text-align: center;">Neni 74</p> <p>Kontrolli i çmimeve dhe detyrimet e kontabilitetit të kostos</p> <p>1. Një autoritet kombëtar rregullator, në përputhje me nenin 68, mund të imponojë detyrime në lidhje me rikuperimin e kostos dhe kontrollin e çmimeve, përfshirë detyrimet për orientimin e çmimeve drejt kostos dhe detyrimet në lidhje me sistemet e llogaritjes së kostos, për sigurimin e llojeve specifike të interkoneksionit ose aksesit, në situata kur një analizë e tregut tregon se mungesa e një konkurrence efektive do të thotë që ndërmarja në fjalë mund të mbajë çmimet në një nivel tepër të lartë, ose mund të aplikojë një shtrengim çmimesh në dëm të përdoruesve fundorë.</p> | | Neni 99 | <p style="text-align: center;">Neni 99</p> <p>Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive</p> <p>1. Në përputhje me nenin 92, të këtij ligji, kur pas kryerjes së analizës së tregut AKEP evidenton se në treg mungon konkurrenca efektive, që nënkupton se sipërmarrësi i shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, ka aplikuar tarifa të larta të paarsyeshme, ose tarifa të ulëta të paarsyeshme, në dëm të përdoruesve fundorë, AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin në lidhje me mbulimin e kostove dhe kontrollin e çmimeve, duke përfshirë detyrimet për orientimin e çmimeve drejt kostos si dhe në lidhje me</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>Në përcaktimin, nëse detyrimet për kontrollin e çmimeve do të ishin të përshtatshme, autoritetet rregullatore kombëtare do të marrin parasysh nevojën për të promovuar konkurrencën dhe interesat afatgjata të përdoruesve fundorë në lidhje me vendosjen dhe marrjen e rrjeteve të gjeneratës së ardhshme, dhe veçanërisht rrjetet me kapacitet shumë të lartë. Në veçanti, për të inkurajuar investimet nga ndërmarrja, përfshirë rrjetet e gjeneratës së ardhshme, autoritetet rregullatore kombëtare do të marrin parasysh investimin e bërë nga ndërmarrja. Kur autoritetet kombëtare rregullatore konsiderojnë se janë të përshtatshme detyrimet për kontrollin e çmimeve, ato lejojnë ndërmarrjen të kthejnë kapitalin adekuat të punësuar në një nivel të arsyeshëm, duke marrë parasysh rreziqet specifike për një projekt të veçantë të rrjetit të investimeve.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare do të konsiderojnë mos imponimin ose ruajtjen e detyrimeve në përputhje me këtë nen, kur ata përcaktojnë se një kufizim i çmueshëm i çmimit me pakicë është i pranishëm dhe që çdo detyrim i imponuar në përputhje me nenet 69 deri 73, duke përfshirë çdo provë të përsëritshme ekonomike të imponuar në në përputhje me nenin 70, siguron akses efektiv dhe jo-diskriminues.</p> <p>Kur autoritetet kombëtare rregullatore e konsiderojnë të përshtatshme për të imponuar detyrime për kontrollin e çmimeve, për aksesin në elementët ekzistues të rrjetit, ata gjithashtu marrin parasysh përfitimet e çmimeve me shumicë të parashikueshme dhe të qëndrueshme për të siguruar hyrje të efektshme në treg dhe incentiva të mjaftueshme për të gjitha ndërmarrjet për të vendosur rrjete të reja dhe të zgjeruara .</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që çdo mekanizëm i rikuperimit të kostos ose metodologjisë së çmimeve që është e mandatuar shërben për të promovuar vendosjen e rrjeteve të reja dhe të zgjeruara, efikasitetin dhe konkurrencën e qëndrueshme dhe të maksimizojë përfitimet e qëndrueshme të përdoruesve fundorë. Në këtë drejtim, autoritetet rregullatore kombëtare gjithashtu mund të marrin parasysh çmimet e disponueshme në tregjet konkurruese të krahasueshme.</p> <p>3. Kur një ndërmarrje ka një detyrim në lidhje me orientimin e kostos së çmimeve të saj, barra e provës se tarifat rrjedhin nga kostot, përfshirë një shkallë të arsyeshme të kthimit të investimit, i takon ndërmarrjes në fjalë. Për të llogaritur koston e ofrimit të shërbimeve efektive, autoritetet rregullatore kombëtare mund të përdorin metoda të llogaritjes së kostos, të pavarura nga ato të përdorura nga ndërmarrja. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të kërkojnë nga një ndërmarrje, të sigurojë arsyetimin e plotë për çmimet e saj, dhe, kur është e përshtatshme, mund të kërkojë që çmimet të rregullohen.</p> <p>4. Autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që, kur implementimi i një sistemi të llogaritjes së kostos është mandatuar për të mbështetur kontrollin e çmimeve, një përshkrim i sistemit të llogaritjes së kostos është vënë në dispozicion të publikut, duke</p> | | <p>sistemin e mbajtjes së llogarive, për ofrimin e llojeve të veçanta të aksesit ose interkoneksionit.</p> <p>2. Në përcaktimin nëse detyrimet e kontrollit të çmimeve janë të përshtatshme, AKEP-i konsideron interesat afatgjata të përdoruesve fundorë dhe nxitjen e konkurrencës, duke vlerësuar nevojën për krijimin e rrjeteve të gjeneratës së ardhshme dhe në veçanti të rrjeteve me shpejtësi dhe kapacitet shumë të lartë. Për të nxitur investimet nga sipërmarrësi, përfshirë rrjetet e gjeneratës së ardhshme, AKEP-i merr parasysh investimin e bërë nga sipërmarrësi.</p> <p>3. Kur AKEP-i konsideron të përshtatshme detyrimet për kontrollin e çmimeve, AKEP do t'i lejojë sipërmarrësit një normë të arsyeshme fitimi mbi kapitalin e punësuar, duke marrë parasysh çdo rrezik specifik për një projekt të caktuar të rrjetit të ri të investimeve.</p> <p>4. AKEP-i konsideron të mos vendosë apo të mbajë detyrimet e përcaktuara në këtë nen, kur demonstrohet se ekzistojnë rrethana shtrënguese për përcaktimin e çmimit të pakicës dhe se vendosja e detyrimeve në përputhje me nenet 93 deri 98, të këtij ligji, përfshirë në veçanti detyrimi sipas nenit 95, të këtij ligji garanton ofrimin e aksesit efektiv dhe jo diskriminues.</p> <p>5. Kur AKEP-i e vlerëson të përshtatshme vendosjen e detyrimit të kontrollit të çmimit për akses, në elementët ekzistues të rrjetit, ai merr në konsideratë përfitimet nga vendosja e çmimeve me shumicë, të qëndrueshme dhe të parashikueshme, për të garantuar hyrje efikase në treg dhe se ekzistojnë stimuj të mjaftueshëm për të gjithë operatorët për të ndërtuar dhe përmirësuar rrjetet e komunikimeve elektronike.</p> <p>6. AKEP-i siguron që çdo mekanizëm për mbulimin e kostove ose metodologji e zgjedhur për përcaktimin e çmimit, shërben për të promovuar shtrirjen e rrjeteve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistues, efikasitetin dhe konkurrencën e qëndrueshme, si edhe qëndrueshmëri në maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve fundor. Në këtë proces, AKEP-i merr parasysh edhe çmimet e disponueshme në tregje me konkurrencë të ngjashme.</p> <p>7. Kur një sipërmarrës ka detyrimin për orientimin e çmimeve drejt kostove, barra e provës se tarifat janë të bazuar në kostot, duke përfshirë një normë të arsyeshme kthimi të investimit, është e sipërmarrësit në fjalë. Me qëllim llogaritjen e kostos së ofrimit të shërbimeve efikase, AKEP-i përdor metoda të llogaritjes së kostove të pavarura nga ato të përdorura nga sipërmarrësi. AKEP-i, i kërkon operatorit të japë argumentim të plotë për çmimet e tij dhe, sipas rastit kur e shikon të arsyeshme kërkon rregullim të çmimeve.</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|--------|---|----------|--|---|--|
| | <p>treguar kategoritë kryesore nën të cilat grupohen kostot dhe rregullat e përdorura për shpërndarjen e kostove. Një organ i pavarur i kualifikuar do të verifikojë pajtueshmërinë me sistemin e llogaritjes së kostos dhe do të publikojë çdo vit një deklaratë në lidhje me pajtueshmërinë.</p> | | | <p>8. AKEP-i siguron që, kur vendos të aplikojë një model të llogaritjes së kostove për të mundësuar kontrollin e çmimeve, një përshkrim i këtij modeli bëhet i disponueshëm për publikun, në të cilin të tregohen të paktën kategoritë kryesore në të cilat grupohen kostot dhe rregullat e përdorura për shpërndarjen e kostove. Një organ i kualifikuar e pavarur, ka të drejtë të kryejë verifikimin e përputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së kostos dhe publikon çdo vit një deklaratë në lidhje me përputhshmërinë.</p> | |
| Neni75 | <p style="text-align: center;">Neni 75 Tarifa e perfundimit te terminimit</p> <p>1. Deri më 31 dhjetor 2020, Komisioni, duke marrë parasysh opinionin e BEREC, do të miratojë një akt të deleguar në përputhje me nenin 117 që plotëson këtë Direktivë, duke vendosur një tarifë maksimale të vetme të përfundimit të thirrjeve zanore në mbarë Bashkimin Evropian dhe një tarifë të vetme maksimale të përfundimit të thirrjeve zanore fikse në mbarë Bashkimin Evropian (së bashku referuar si 'Tarifa e përfundimit të thirrjeve zanore në Bashkimin Evropian'), të cilat i imponohen çdo ofruesi të përfundimit të thirrjeve zanore celular ose shërbimeve të fiksimit të përfundimit të thirrjeve zanore, përkatësisht, në çdo shtet anëtar.</p> <p>Për këtë qëllim, Komisioni do të:</p> <p>(a) respektojë parimet, kriteret dhe parametrat e parashikuara në Shtojcën III;</p> <p>(b) kur vendosen për herë të parë tarifën e terminimit të thirrjeve zanore në mbarë Bashkimin Evropian, duhet të merren parasysh mesatarja e ponderuar e kostove efikase në rrjetet fikse dhe mobile, të vendosura në përputhje me parimet e parashikuara në Shtojcën III, të aplikuar në të gjithë Bashkimin Evropian; tarifën e terminimit të thirrjeve zanore në mbarë Bashkimin Evropian në aktin e parë të deleguar nuk duhet të jenë më të larta se niveli më i lartë midis tarifave që ishin në fuqi gjashtë muaj para miratimit të këtij akti të deleguar në të gjitha Shtetet Anëtare, pas çdo rregullimi të nevojshëm për rrethana të jashtëzakonshme kombëtare;</p> <p>(c) të marrë parasysh numrin e përgjithshëm të përdoruesve fundorë në secilin Shtet Anëtar, për të siguruar një kompesim të duhur të tarifave maksimale të terminimit, si dhe rrethanat kombëtare që rezultojnë në ndryshime të konsiderueshme midis Shteteve Anëtare gjatë përcaktimit të tarifave maksimale të terminimit në Bashkimin Evropian;</p> <p>(d) të marrë parasysh informacionin e tregut të siguruar nga BEREC, autoritetet rregullatore kombëtare ose direkt nga ndërmarrjet që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike;</p> <p>dhe</p> | Neni 100 | <p style="text-align: center;">Neni 100 Tarifat e terminimit</p> <p>1. Pa paragjykuar procedurën e përcaktuar në nenin 89, dhe 90 të këtij ligji, nëse në bazë të analizës së tregut për terminimin e thirrjeve, arrihet në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive, atëherë në këto tregje aplikohet rregullimi i tarifave nëpërmjet metodës së kontrollit të çmimit.</p> <p>2. Tarifën e terminimit të orientuar drejt kostos, duhet të demonstrojnë se tarifën e shërbimeve të ofruara, rrjedhin nga kosto efektive dhe mbajnë në konsideratë parashikimet rregullatore të këtij ligji, si edhe praktikatat dhe rekomandimet e BE-së.</p> <p>3. AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:</p> <p>a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;</p> <p>b) korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:</p> <p>i) kufirin maksimal të normës së ndryshimit, e rritjes ose e uljes të mundshme të tarifës, brenda një periudhe të caktuar kohe;</p> <p>ii) raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse inputeve, brenda një periudhe kohe të caktuar;</p> <p>iii) procedurën që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efektive, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;</p> <p>c) përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.</p> <p>4. Me qëllim llogaritjen e kostos së ofrimit të shërbimit efektiv, AKEP-i përdor metoda të llogaritjes së kostos të pavarura nga ato të përdorura nga sipërmarrësit.</p> | P | |

| | | | | | | |
|---------|--|--|----------------------|--|---|--|
| | <p>(e) të marrë në konsideratë nevojën për të lejuar një periudhë kalimtare jo më të gjatë se 12 muaj, në mënyrë që të lejojnë rregullime në Shtetet Anëtare kur kjo është e nevojshme në bazë të tarifave të vendosura më parë.</p> <p>2. Duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, Komisioni do të rishikojë aktin e deleguar të miratuar në bazë të këtij neni çdo pesë vjet dhe do të marrë në konsideratë secilin rast të tillë, duke zbatuar kriteret e listuara në nenin 67 (1), nëse tarifa e terminimit të thirrjeve zanore e përcaktuara nga Bashkimi Evropian, vazhdon të jetë e nevojshme. Kur Komisioni vendos, pas rishikimit të tij në përputhje me këtë paragraf, të mos vendosë një tarifë maksimale të terminimit të thirrjeve zanore celular ose një tarifë maksimale fikse të terminimit të thirrjeve zanore, autoritetet rregullatore kombëtare mund të kryejnë analiza të tregut të terminimit të thirrjeve zanore në përputhje me nenin 67, për të vlerësuar nëse imponimi i detyrimeve rregullatore është i nevojshëm. Nëse një autoritet kombëtar rregullator imponon, si rezultat i një analize të tillë, nivelet e terminimit të drejtimit të kostos në një treg përkatës, ai do të ndjekë parimet, kriteret dhe parametrat e përcaktuara në Aneksin III dhe draft masa e tij do t'i nënshtrohet procedurave të referuara në nenet 23, 32 dhe 33.</p> <p>3. Autoritetet kombëtare rregullatore monitorojnë nga afër dhe sigurojnë pajtueshmërinë me zbatimin e niveleve të terminimit të thirrjeve zanore në mbarë Bashkimin Evropian nga ofruesit e shërbimeve të terminimit të thirrjeve zanore. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të kërkojnë, në çdo kohë, një ofruesi të shërbimeve të terminimit të thirrjeve zanore, të ndryshojë normën që u ngarkon ndërmarrjeve të tjera nëse nuk është në pajtim me aktin e deleguar të përmendur në paragrafin 1. Autoritetet rregullatore Kombëtare raportojnë çdo vit në Komision dhe te BEREC në lidhje me zbatimin e këtij neni.</p> | | | <p>5. Me kërkesë të AKEP-it, sipërmarrësi brenda një periudhe 45-ditore, duhet të provojë se tarifat e tij janë të orientuara drejt kostos. Nëse sipërmarrësi, brenda periudhës kohore të përcaktuar, nuk e justifikon tarifën si më sipër, AKEP-i provon se tarifat nuk janë të orientuara nga kostoja.</p> <p>6. AKEP-i siguron që sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg, i cili i nënshtrohet detyrimit të llogaritjes së kostos, të bëjë të disponueshme publikisht, përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos, duke treguar të paktën kategoritë kryesore, ku shfaqen të grupuara kostot dhe rregullat e përdorura për përcaktimin e tyre.</p> <p>7. AKEP-i ose një ekspert i pavarur kontabël i përzgjedhur nga AKEP-i, ka të drejtë të kryejë auditimin vjetor të përputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së kostos.</p> <p>8. Në rregullimin e tarifave sipas paragrafit 1, AKEP-i vlerëson të dhënat më të fundit për sa vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> tarifat mesatare të vendeve të BE-së; praktikat dhe rekomandimet më të mira në vendet e BE-së; tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë; raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës; normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë. <p>4. Metodat e rregullimit të tarifave, mund të jenë të kombinuara dhe marrin parasysh kushtet specifike të tregut të komunikimeve elektronike në vend.</p> | | |
| Neni 76 | <p style="text-align: center;">Neni 76</p> <p style="text-align: center;">Trajtimi rregullator i elementeve të rinj të rrjetit me kapacitet shumë të lartë</p> <p>1. Sipërmarrjet të cilat janë përcaktuar se kanë fuqi të ndjeshme të tregut në një ose disa tregje përkatëse, në përputhje me nenin 67, mund të ofrojnë angazhime, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 79 dhe që i nënshtrohen nënparagrafit të dytë të këtij paragrafi, për të hapur shtrirjen e një rrjeti të ri me kapacitet shumë të lartë që përbëhet nga elementë të fibrave optike deri në ambientet e përdoruesve fundorë ose stacionin bazë për bashkë-investimin, për shembull duke ofruar bashkëpronësi ose ndarjen afatgjatë të rrezikut përmes bashkëfinancimit ose përmes marrëveshjeve të blerjes, duke dhënë të drejta specifike me karakter strukturor nga ofruesit e tjerë të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike. Kur autoriteti rregullator kombëtar i vlerëson ato angazhime, ai përcakton nëse oferta për bashkë investime përputhet me të gjitha kushtet e mëposhtme:</p> | | Neni 101 Neni 102 | <p style="text-align: center;">Neni 101</p> <p style="text-align: center;">Trajtimi rregullator për rrjetet e reja me kapacitet shumë të lartë transmetimi</p> <p>1. Sipërmarrësit e përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg, në një ose disa tregje përkatëse, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 105 të këtij ligji, mund të paraqesin angazhime për të bashkëinvestuar në shtrimin e një rrjeti të ri me kapacitet shumë të lartë, që konsiston në ofrimin e elementëve të fibrave optike deri në ambientet e përdoruesit fundor ose të stacionit bazë, subjekt i kërkesave të nënpikës b) të pikës 2, të këtij neni në format si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> duke ofruar bashkëpronësi ose, ndarje të rrezikut afatgjatë nëpërmjet bashkëfinancimit ose, përmes blerjes së marrëveshjeve duke krijuar të drejta specifike me karakter strukturor nga | F | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>(a) është i hapur në çdo moment gjatë ekzistencës së rrjetit për çdo ofrues të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;</p> <p>(b) do të lejonte bashkë-investitorët e tjerë që janë ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimit elektronik, të konkurrojnë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në një afat të gjatë në tregjet në rrjedhën e sipërme, në të cilat ndërmarrja e caktuar si fuqi e konsiderueshme e tregut është aktive, me kushte që përfshijnë:</p> <p>i. terma të drejtë, të arsyeshëm dhe jo-diskriminues që lejojnë akses në kapacitetin e plotë të rrjetit në masën që ai i nënshtrohet bashkë-investimit;</p> <p>ii. fleksibilitet për sa i përket vlerës dhe kohës së pjesëmarrjes së secilit bashkë-investitor;</p> <p>iii. mundësinë për të rritur një pjesëmarrje të tillë në të ardhmen;</p> <p>dhe</p> <p>iv. të drejtat reciproke të dhëna nga bashkë-investitorët pas vendosjes së infrastrukturës së bashkë-investuar;</p> <p>(c) ai bëhet publik nga sipërmarrja në kohën e duhur dhe nëse sipërmarrja nuk ka karakteristikat e listuara në nenin 80 (1), të paktën gjashtë muaj para fillimit të vendosjes së rrjetit të ri; ajo periudhë mund të zgjatet bazuar në rrethanat kombëtare;</p> <p>(d) Kërkesit e aksesit që nuk marrin pjesë në bashkë-investim mund të përfitojnë që në fillim nga e njëjta cilësi, shpejtësi, kushte dhe mundësia e përdoruesve fundorë, siç ishin në dispozicion para vendosjes, të shoqëruar nga një mekanizëm adaptimi i konfirmuar nga autoriteti rregullator kombëtar në dritën e zhvillimeve në tregjet e lidhura me pakicë, i cili mban stimujt për të marrë pjesë në bashkë-investim; një mekanizëm i tillë siguron që kërkesit e aksesit të kenë akses në elementët me kapacitet shumë të lartë të rrjetit, dhe në bazë të kushteve transparente dhe jo-diskriminuese, të cilat pasqyrojnë në mënyrë të duhur shkallët e rrezikut të shkaktuara nga bashkë-investitorët përkatës në faza të ndryshme të vendosjes dhe të marrë parasysh situatën konkurruese në tregjetme pakicë;</p> <p>(e) është në përputhje me minimumin e kriterëve të përcaktuara në Shtojcën IV dhe është bërë me mirëbesim.</p> <p>2. Nëse autoriteti rregullator kombëtar konstaton, duke marrë parasysh rezultatet e testit të tregut të kryer në përputhje me nenin 79 (2), se angazhimi për investime të ofruara në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, do ta bëjë atë angazhim të detyrueshëm në përputhje me nenin 79 (3) dhe nuk do të imponojë asnjë detyrim shtesë, në përputhje me nenin 68, në lidhje me elementët e rrjetit të ri me kapacitet shumë të lartë që janë subjekt i angazhimeve, nëse të paktën një bashkë-investitor i mundshëm ka hyrë në një marrëveshje bashkë-investimi me ndërmarrjen e caktuar pasi ka fuqi të konsiderueshme në treg.</p> | | <p>ofruesit e tjerë të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.</p> <p>2. AKEP-i gjatë vlerësimit të këtyre angazhimeve, përcakton veçanërisht, nëse oferta për bashkëinvestim, është në përputhje me të gjitha kushtet e mëposhtme:</p> <p>a) është e hapur në çdo moment për çdo ofrues të rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike;</p> <p>b) do të lejonte bashkë-investitorët e tjerë, të cilët janë ofrues të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, të konkurrojnë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në terma afatgjatë, në tregjet e rrjedhës së poshtme, <i>downstream</i>, në të cilat është aktive sipërmarrja e përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg, me terma që përfshijnë:</p> <p>i) kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese që lejojnë aksesin në kapacitetin e plotë të rrjetit në masën që ai është subjekt i bashkëinvestimit;</p> <p>ii) fleksibilitet për sa i përket vlerës dhe kohës së pjesëmarrjes së çdo bashkëinvestitori;</p> <p>iii) mundësinë për të rritur një pjesëmarrje të tillë në të ardhmen; dhe</p> <p>iv) të drejtat reciproke të dhëna nga bashkëinvestitorët, pas përcaktimit të infrastrukturës së bashkëinvestuar;</p> <p>c) bërjen publike nga sipërmarrja në kohën e duhur dhe, të paktën gjashtë muaj përpara fillimit të shtrirjes së rrjetit të ri, nëse sipërmarrja nuk ka karakteristikat e përcaktuara në nenin 106, të këtij ligji, periudhë e cila mund të zgjatet në bazë të rrethanave kombëtare;</p> <p>d) përmbushjen minimalisht të kriterëve të përcaktuara në nenin 102 të këtij ligji, dhe se ajo është bërë me mirëbesim;</p> <p>3. Kur AKEP-i, bazuar në rezultatet e testit të tregut të kryer në përputhje me pikën 3, të nenit 105 të këtij ligji, arrin në përfundimin se angazhimi i propozuar i bashkëinvestimit, është në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ai e bën atë angazhim të detyrueshëm në përputhje me pikën 8, të nenit 105 të këtij ligji dhe nuk vendos asnjë detyrim shtesë në bazë të nenit 92, të këtij ligji, në lidhje me elementët e rrjetit të ri me kapacitet shumë të lartë, që u nënshtrohen angazhimeve, kjo nëse të paktën një bashkëinvestitor i mundshëm ka hyrë në një marrëveshje me sipërmarrësin e përcaktuar si me fuqi të ndjeshme në treg.</p> <p>4. Pika 3, e këtij neni, nuk çënon trajtimin rregullator të rrethanave që nuk përputhen me kushtet e përcaktuara në</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>Nënparagrafi i parë nuk do të cenojë trajtimin rregullator të rrethanave që nuk përputhen me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duke marrë parasysh rezultatet e çdo testi të tregut të kryer në përputhje me nenin 79 (2), por që kanë ndikim në konkurrencë dhe merren parasysh për qëllimet e neneve 67 dhe 68.</p> <p>Sipas mënyrës së derogimit nga nënparagrafi i parë i këtij paragrafi, autoriteti kombëtar rregullator mund të imponojë, mirëmbajë ose adaptojë mjete juridike, në përputhje me nenet 68 deri në 74, në lidhje me rrjetet e reja me kapacitete shumë të larta, për të adresuar problemet e rëndësishme të konkurrencës në tregjet specifike, kur autoriteti rregullator kombëtar përcakton që duke pasur parasysh karakteristikat specifike të këtyre tregjeve, ato probleme të konkurrencës nuk do të adresoheshin ndryshe.</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare do të monitorojnë, mbi baza të vazhdueshme, pajtueshmërinë me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe mund të kërkojnë nga ndërmarrja e caktuar si fuqi e konsiderueshme e tregut për t'i siguruar asaj deklaratat vjetore të përputhshmërisë.</p> <p>Ky nen nuk do të cenojë fuqinë e autoritetit rregullator kombëtar për të marrë vendime në përputhje me nenin 26 (1) në rast të mosmarrëveshjes që lindin midis ndërmarrjeve në lidhje me një marrëveshje bashkë-investimi të konsideruar prej tij për të përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>4. BEREC, pasi të këshillohet me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, do të publikojë udhëzime për të nxitur zbatimin e vazhdueshëm nga autoritetet rregullatore kombëtare të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1, dhe kriteret e përcaktuara në Shtojcën IV.</p> | | <p>pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh rezultatet e çdo testi tregu të kryer në përputhje me neni 105, të këtij ligji, por që kanë një ndikim në konkurrencë dhe merren parasysh për qëllimet e neneve 90 dhe 92, të këtij ligji.</p> <p>5. Duke përjashtuar pikën 3 të këtij neni, AKEP-i, në rrethana të mirëjustifikuara, vendos, të mbajë ose të përshtasë masat rregullatore në përputhje me nenet 92 deri në 99, të këtij ligji, për rrjetet e reja me kapacitet shumë të lartë, për të adresuar shtrembërimet e konkurrencës në tregje specifike, ku evidenton se problematikat e konkurrencës nuk mund të adresohen ndryshe, për shkak të karakteristikave specifike të këtyre tregjeve.</p> <p>6. AKEP-i monitoron në mënyrë të vazhdueshme respektimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe mund t'i kërkojë sipërmarrësit të shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, të paraqesë pranë AKEP-it, deklaratat vjetore të përmbushjes së angazhimeve. Ky nen nuk cënon kompetencën e AKEP-it, për të marrë vendime në zbatim të nenit 47, të këtij ligji në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet sipërmarrjeve, që kanë të bëjnë me përmbushjen e kushteve të marrëveshjes së bashkëinvestimit, të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të këtij neni.</p> <p>7. Në zbatimin e rregullimeve sipas këtij neni AKEP-i merr në konsideratë udhëzimet përkatëse të BEREC.</p> <p style="text-align: center;">Neni 102 Kriteret e vlerësimit të propozimeve për bashkëinvestim</p> <p>1. Në shqyrtimin e angazhimeve për bashkëinvestim sipas nenit 101 të këtij ligji, AKEP vlerëson nëse janë përmbushur minimalisht kriteret si më poshtë:</p> <p>a) oferta e bashkëinvestimit të jetë e hapur për çdo sipërmarrje, gjatë gjithë ekzistencës së rrjetit të ndërtuar sipas një oferte bashkëinvestimi mbi baza jodiskriminuese. Sipërmarrja e përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg përfshin në ofertë kushte të arsyeshme në lidhje me kapacitetin financiar të çdo sipërmarrjeje, në mënyrë që, bashkëinvestitorët e mundshëm të demonstrojnë aftësinë e tyre për të kryer pagesa me faza, mbi bazën e të cilave është planifikuar shtrimi i rrjetit, të përfshijnë pranimin e një plani strategjik mbi bazën e të cilit përgatiten planet afatmesme të shtrirjes etj.</p> <p>b) ofertën transparente të bashkëinvestimit, veçanërisht:</p> <p>i) oferta të jetë e disponueshme dhe lehtësisht e aksesueshme në faqen e internetit të</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>sipërmarrjes së përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg;</p> <p>ii) kushtet e plota të detajuara të vihen në dispozicion pa vonesë për çdo ofertues të mundshëm që shpreh një interes, duke përfshirë formën ligjore të marrëveshjes së bashkëinvestimit dhe - kur është e nevojshme – dhe termat kryesore mbi të cilat udhëhiqen parimet e bashkëfinancimit; dhe,</p> <p>iii) procesin, që përfshin udhërrëfyesin për krijimin dhe zhvillimin e projektit të bashkëinvestimit dhe të gjitha momentet e rëndësishme, u komunikohen qartë të gjitha sipërmarrjeve, pa asnjë diskriminim.</p> <p>c) oferta e bashkëinvestimit të përfshijë kushte për bashkëinvestitorët e mundshëm dhe të favorizojë konkurrencën e qëndrueshme në terma afatgjatë, në veçanti:</p> <p>i) të gjitha sipërmarrjeve u ofrohen terma dhe kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese për pjesëmarrjen në marrëveshjen e bashkëinvestimit në përputhje me kohën kur ato bashkohen, duke përfshirë termat e pozicionit financiar të nevojshëm për përvetësimin e të drejtave specifike, në kushtet e mbrojtjes që u jepet bashkë-investitorëve nga këto të drejta, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së shfrytëzimit, si përmes dhënies së të drejtave të pakthyeshme të përdorimit për jetëgjatësinë e pritshme të rrjetit të bashkëinvestuar, në termat e kushtet për t'u bërë pjesë e projektit apo në përfundimin e mundshëm të marrëveshjes së bashkëinvestimit.</p> <p>Kushtet jodiskriminuese në këtë kontekst nuk nënkuptojnë që të gjithë bashkë-investitorëve potencialë t'u ofrohen saktësisht të njëjtat kushte, përfshirë kushtet financiare, por atë që të gjitha variacionet e kushteve të ofruara të justifikohen mbi bazën e kriterëve të njëjta objektive, transparente, jo diskriminuese dhe të parashikueshme sikurse numri i linjave të përdoruesve fundorë për të cilët është marrë angazhimi.</p> <p>ii) oferta lejon fleksibilitet në lidhje me vlerën dhe kohën e angazhimit të ofruar nga secili bashkëinvestitor, për shembull me anë të një marrëveshje të dakordësuar dhe rritjes së përqindjes të linjave totale të përdoruesve</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>fundorë në një zonë të caktuar, për të cilën bashkë- investitorët mundësojnë angazhim gradual në një zonë të tillë, e cila ju ofron kushte investitorëve më të vegjel me burime të kufizuara, të hyjnë në bashkëinvestim në një shkallë minimale të arsyeshme dhe të shtojnë gradualisht pjesët e tyre, nëpërmjet garantimit të angazhimeve fillestare të përshtatshme. Përcaktimi i masës së angazhimit në financimin e ofruar nga secili bashkëinvestitor reflekton faktin se investitorët e angazhuar në fazat më të hershme, injektojnë kapitalin më shpejt dhe marrin përsipër risk më të madh.</p> <p>iii) rritja e përfitimeve me kalimin e kohës, konsiderohet e justifikuar për angazhimet e bëra në fazat e mëvonshme të projektit dhe për bashkëinvestitorët e rinj, të cilët bëhen pjesë e bashkëinvestimit pas fillimit të projektit, për të pasqyruar uljen e rrezikut dhe për të kundërshtuar çdo nxitje për ta mbajtur kapitalin në burim, në fazat e mëparshme.</p> <p>iv) marrëveshja e bashkëinvestimit, lejon kalimin e të drejtave të fituara nga bashkëinvestitori te bashkë-investitorët e tjerë ose palëve të treta, që dëshirojnë të hyjnë në marrëveshjen e bashkëinvestimit, me kusht që sipërmarrësi përfitues të jetë i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet fillestare të transferuesit, sipas marrëveshjes fillestare të bashkëinvestimit të këtij të fundit.</p> <p>v) bashkëinvestitorët i ofrojnë njëri-tjetrit të drejta reciproke, mbi baza të drejta dhe terma e kushte të arsyeshme për të aksesuar infrastrukturën e bashkëinvestuar, me qëllim ofrimin e shërbimeve në rrjedhën e poshtme, <i>downstream</i>, duke përfshirë përdoruesit fundorë, në përputhje me kushte transparente që bëhen të qarta në ofertën e bashkëinvestimit dhe marrëveshjeve pasuese që mund të burojnë prej saj, veçanërisht kur bashkëinvestitorët janë përgjegjës individualisht ose më vehte për shtrirjen e pjesëve specifike të rrjetit. Pajisjet e krijuara në kuadër të bashkëinvestimit, duhet t'u ofrojnë akses në rrjet të gjithë bashkë-investitorëve, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në mënyrë ekuivalente me kontributin, në përputhje me terma dhe kushte të drejta dhe</p> | | |
|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|---------------|--|--|----------|--|---|
| | | | | <p>të arsyeshme, ku përfshihen kushtet financiare që pasqyrojnë nivele të ndryshme të riskut të ndërmarrë nga secili bashkëinvestitor.</p> <p>d) oferta e bashkëinvestimit siguron një investim të qëndrueshëm që synon të përbushë nevojat e ardhshme të tregut, ku të përfshihen elementë të rinj të rrjetit që kontribuojnë ndjeshëm në shpërndarjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë.</p> <p>2. Në përputhje me rrethanat kombëtare dhe strukturën e tregut, AKEP mund të konsiderojë në vlerësim kritere shtesë për aq sa janë të nevojshme për të siguruar aksesin e investitorëve të mundshëm në bashkëinvestim.</p> | |
| Neni77 | <p style="text-align: center;">Neni 77 Ndarja funksionale</p> <p>1. Kur autoriteti rregullator kombëtar konstaton se detyrimet e duhura të përcaktuara në nenet 69 deri në 74 nuk kanë arritur një konkurrencë efektive dhe se ka probleme të rëndësishme dhe të vazhdueshme të konkurrencës ose dështime të tregut, të identifikuara në lidhje me sigurimin e tregjeve me shumice të produkteve të caktuara të aksesit, ai mundet, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 68 (3), të imponojë një obligim për ndërmarrjet e integruara vertikalisht, që të vendosin veprimtari në lidhje me sigurimin me shumicë të produkteve përkatëse të aksesit në një enitet biznesi që vepron në mënyrë të pavarur.</p> <p>Ky enitet biznesi do të sigurojë produkte dhe shërbime të aksesit për të gjitha ndërmarrjet, përfshirë ato të subjekteve të tjera të biznesit brenda shoqërisë mëmë, në të njëjtat afate kohore, terma dhe kushte, përfshirë ato që lidhen me çmimet dhe nivelet e shërbimit, dhe me anë të të njëjtave sistemeve dhe proceseve.</p> <p>2. Kur një autoritet kombëtar rregullator synon të imponojë një detyrim të ndarjes funksionale, ai i paraqet Komisionit një kërkesë që përfshin:</p> <p>(a) prova që justifikojnë konkluzionet e autoritetit rregullator kombëtar, siç përmendet në paragrafin 1;</p> <p>(b) një vlerësim të arsyeshëm që nxjerr në konkluzion se nuk ka perspektivë për një konkurrencë efektive dhe të qëndrueshme të bazuar në infrastrukturë brenda një afati kohor të arsyeshëm;</p> <p>(c) një analizë të ndikimit të pritshëm në autoritetin rregullator kombëtar, mbi ndërmarrjen, veçanërisht në fuqinë punëtore të ndërmarrjes së ndarë, dhe sektorin e komunikimeve elektronike në tërësi, dhe për iniciativën për të investuar në të, në lidhje me nevojën për të siguruar kohezionin shoqëror dhe territorial, dhe për palët e tjera të interesuara, përfshirë ndikimin e pritshëm në konkurrencë dhe çdo efekt të mundshëm që rezultojnë te konsumatorët;</p> | | Neni 103 | <p style="text-align: center;">Neni 103 Ndarja funksionale</p> <p>1. Kur AKEP-i, arrin në përfundimin se detyrimet e vendosura në përputhje me parashikimet e neneve 93 deri në 99, të këtij ligji, kanë dështuar në arritjen e konkurrencës efektive dhe se në treg vijon ekzistenca e problemeve të rëndësishme dhe të vazhdueshme të konkurrencës, ose dështimet e tregut që lidhen me ofrimin e aksesit me shumicë për disa pjesë të tregut, atëherë, në rrethana përjashtimore, në përputhje me nënpikën e dytë të pikës 4 të nenit 92, të këtij ligji, AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve të integruar vertikalisht, detyrimin për ndarjen e aktivitetit të ofrimit të shërbimeve me shumicë në një njësi operuese biznesi të ndarë dhe të pavarur nga pjesa e tregjeve të rrjedhës së poshtme.</p> <p>2. Njësia e re e pavarur e biznesit, ofron akses në produktet dhe shërbimet e saj për të gjithë sipërmarrësit, duke përfshirë edhe bizneset që nuk janë pjesë e shoqërisë mëmë, me terma dhe kushte të njëjta, për afate kohore të njëjta, ku përfshihen edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me çmimet dhe shërbimet e ofrura, nëpërmjet sistemeve dhe proceseve të njëjta.</p> <p>3. Përpara vendimmarrjes për vendosjen e detyrimit të ndarjes funksionale, AKEP-i konsultohet me Autoritetin e Konkurrencës dhe i paraqet ministrisë një kërkesë që përfshin:</p> <p>a) dokumentacionin me provat që justifikojnë përfundimet e AKEP të përmendur në pikën 1 të këtij neni;</p> <p>b) dokumentacionin në lidhje me komentet dhe opinionet e Autoritetit të Konkurrencës;</p> <p>c) një vlerësim të arsyetuar që çon në përfundimin se nuk ka, ose nuk ka gjasa për konkurrencë efektive</p> | F |

| | | | | | | |
|--------|--|--|--------|---|---|--|
| | <p>(d) një analizë e arsyeve që justifikojnë se ky detyrim do të ishte mjeti më efikas për të zbatuar mjetet juridike që synojnë adresimin e problemeve të konkurrencës ose dështimet e tregjeve të identifikuar.</p> <p>3. Draft masa përfshin elementet vijuese:</p> <p>(a) rregullat për të siguruar transparencën e procedurave operacionale, veçanërisht ndaj palëve të tjera të interesuara;</p> <p>(b) një program monitorimi për të siguruar pajtueshmërinë, përfshirë publikimin e një raporti vjetor.</p> <p>Pas ndjekjes së vendimit të Komisionit, të marrë në përputhje me nenin 68 (3) për atë draft masë, autoriteti rregullator kombëtar, do të bëjë një analizë të koordinuar të tregjeve të ndryshme që lidhen me rrjetin e aksesit, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 67. Në bazë të asaj analize, autoriteti rregullator kombëtar vendos detyrimin, ruajtjen, ndryshimin ose tërheqjen e detyrimeve, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 23 dhe 32.</p> <p>4. Një sipërmarrje mbi të cilën është imponuar ndarja funksionale mund t'i nënshtrohet detyrimeve të përmendura në nenet 69 deri 74 në çdo treg specifik, në të cilin është caktuar të ketë një fuqi të konsiderueshme të tregut, në përputhje me nenin 67, ose çdo detyrim tjetër i autorizuar nga Komisioni në pajtim me nenin 68 (3).</p> | | | <p>dhe të qëndrueshme të bazuar në infrastrukturë, brenda një afati të arsyeshëm kohor;</p> <p>d) një analizë mbi ndikimin ndaj sipërmarrësit, veçanërisht në burimet njerëzore të shoqërisë së ndarë dhe në sektorin e komunikimeve elektronike në tërësi, si dhe mbi stimujt për të investuar në të, veçanërisht në lidhje me nevojën për të siguruar dhe kohezionin social e territorial dhe tek sipërmarrësit e tjerë, duke përfshirë, në veçanti, ndikimin e pritshëm në konkurrencën e tregut dhe efektet e mundshme tek përdoruesit fundorë;</p> <p>e) një analizë të arsyeve që justifikojnë vendosjen e këtij detyrimi, si masa më efciente për të zbatuar mjetet juridike, që synojnë adresimin e problemeve të konkurrencës ose dështimeve të tregjeve të identifikuar.</p> <p>4. Masat e ndërmarra duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:</p> <p>a) natyrën dhe nivelin e saktë të ndarjes, duke specifikuar në veçanti statusin ligjor të njësisë ekonomike të veçantë;</p> <p>b) identifikimin e aktiveve të njësisë ekonomike të ndarë, dhe produkteve ose shërbimeve që do të ofrohen nga ajo njësi ekonomike;</p> <p>c) marrëveshjet mbi strukturën administruese për të garantuar pavarësinë në punësimin e stafit nga struktura e ndarë e biznesit dhe stimujt për strukturën përkatëse;</p> <p>d) rregullat për garantimin e përmbushjes së detyrimeve;</p> <p>e) rregullat për garantimin e transparencës së procedurave operacionale, në veçanti ndaj palëve të tjera të interesuara;</p> <p>f) një program monitorimi për të siguruar përputhshmërinë e zbatimit të detyrimeve, duke përfshirë publikimin e një raporti vjetor.</p> <p>5. Procedurat e detajuara për zbatimin e këtij neni miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>6. Sipërmarrësi ndaj të cilit është vendosur detyrim për ndarje funksionale, është subjekt i vendosjes së çdo detyrimi rregullator të parashikuar në nenet 93 deri 99, të këtij ligji, në çdo treg përkatës specifik, për të cilin është shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, sipas procedurave, ose detyrimeve të tjera të parashikuara sipas nenit 92, të këtij ligji.</p> | | |
| Neni78 | <p style="text-align: center;">Neni 78 Ndarja vullnetare nga një sipërmarrje e integruar vertikalisht</p> | | Neni94 | <p style="text-align: center;">Neni 104 Ndarja vullnetare e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>1. Sipërmarrjet të cilat janë caktuar të kenë fuqi të ndjeshme të tregut në një ose disa tregje përkatëse, në përputhje me nenin 67, do të informojnë autoritetin rregullator kombëtar të paktën tre muaj para çdo transferimi të synuar të aseteve të rrjetit lokal të aksesit, ose të një pjese të rëndësishme të këtyre aseteve, tek një subjekt juridik i veçantë nën pronësi të ndryshme, ose krijimin e një entiteti të veçantë biznesi, me qëllim që tu sigurojë të gjithë ofruesve të shitjes me pakicë, përfshirë sektorët e vet të shitjes me pakicë, produkte aksesit plotësisht ekuivalente.</p> <p>Këto sipërmarrje gjithashtu informojnë autoritetin rregullator kombëtar për çdo ndryshim të këtij qëllimi, si dhe rezultatit përfundimtar të procesit të ndarjes.</p> <p>Shumë sipërmarrje mund gjithashtu të ofrojnë angazhime në lidhje me kushtet e aksesit që do të zbatohen në rrjetin e tyre, gjatë një periudhe implementimi, pasi të zbatohet forma e propozuar e ndarjes, me qëllim të sigurimit të një aksesit efektiv dhe jodiskriminues nga palët e treta. Oferta e angazhimeve, do të përmbajë detaje të mjaftueshme, duke përfshirë kohën e implementimit dhe kohëzgjatjen, në mënyrë që të lejojë autoritetin rregullator kombëtar, të kryejë detyrat e tij në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Angazhimet e tilla mund të zgjasin përtej periudhës maksimale për rishikimet e tregut, të përcaktuara në nenin 67 (5).</p> <p>2. Autoriteti rregullator kombëtar, vlerëson efektin e transaksionit të synuar, së bashku me angazhimet e ofruara, ku është e aplikueshme, mbi detyrimet ekzistuese rregullatore sipas kësaj direktive.</p> <p>Për këtë qëllim, autoriteti rregullator kombëtar do të bëjë një analizë të tregjeve të ndryshme që lidhen me rrjetin e hyrjes, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 67.</p> <p>Autoriteti rregullator kombëtar do të konsiderojë çdo angazhim të ofruar nga ndërmarrja, duke marrë parasysh objektivat e përcaktuara në nenin 3. Duke vepruar kështu, autoriteti rregullator kombëtar do të konsultohet me palët e treta në përputhje me nenin 23, dhe do të adresojë, në vecanti, ato palë të treta të cilat preken drejtpërdrejt nga transaksioni i synuar.</p> <p>Në bazë të analizës së tij, autoriteti rregullator kombëtar vendos, ruan, ndryshon ose tërheq detyrimet, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 23 dhe 32, duke zbatuar nëse është e nevojshme nenin 80. Në vendimin e tij, autoriteti rregullator kombëtar, mund t'i bëjë angazhimet detyruese, tërësisht ose pjesërisht. Sipas mënyrës së derogimit nga neni 67 (5), autoriteti rregullator kombëtar mund t'i bëjë angazhimet detyruese, tërësisht ose pjesërisht, për të gjithë periudhën për të cilën ato ofrohen.</p> <p>3. Pa paragjykuar nenin 80, subjekti i ndarë ligjërisht ose operacionalisht, që është caktuar të ketë fuqi të konsiderueshme të tregut në çdo treg specifik, në përputhje me nenin 67, mund t'i nënshtrohet detyrimeve të përmendura në nenin 69 në 74 ose çfarëdo detyrimi tjetër të autorizuar nga Komisioni në përputhje</p> | | <p>1. Sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në një ose disa tregje përkatëse në përputhje me nenin 90, të këtij ligji, informojnë AKEP-in të paktën tre muaj përpara çdo transferimi të synuar të aseteve të rrjetit të tyre për aksesin lokal, ose të një pjese të konsiderueshme të tyre, tek një person juridik tjetër me pronësi të ndryshme, ose për themelimin e një entiteti biznesi të veçantë, me qëllim sigurimin e ofrimit për të gjithë ofruesit e shitjes me pakicë, përfshirë segmentet e veta të shitjes me pakicë, të produkteve ekuivalente të aksesit.</p> <p>2. Sipërmarrësit sipas pikës 1, të këtij neni, informojnë AKEP-in, për çdo ndryshim për realizimin e këtij qëllimi, si dhe pritshmëritë për rezultatit përfundimtar të procesit të ndarjes. Sipërmarrësit ofrojnë gjithashtu angazhime në lidhje me kushtet e aksesit që zbatohen në rrjetin e tyre, gjatë një periudhe zbatimi pas ndarjes së propozuar, me synimin për të garantuar akses efektiv dhe jodiskriminues për palët e treta.</p> <p>3. Oferta e angazhimeve sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të përmbajë detaje të mjaftueshme, duke përfshirë afatet kohore të zbatimit dhe kohëzgjatjen, në mënyrë që të lejojë AKEP-in të ushtrojë kompetencat e tij në përputhje me këtë nen. Angazhime të tilla shtrihen përtej periudhës maksimale për rishikimet e analizës së tregut të përcaktuar në nenin 90, të këtij ligji.</p> <p>4. AKEP-i sipas rastit, vlerëson efektin e transaksionit të synuar, së bashku me angazhimet e propozuara, mbi detyrimet rregullatore ekzistuese. Për këtë qëllim, AKEP-i bën një analizë të tregjeve të ndryshme që lidhen me aksesin në rrjet, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 90, të këtij ligji.</p> <p>5. AKEP-i merr parasysh çdo angazhim të ofruar nga sipërmarrja, duke u mbështetur veçanërisht tek objektivat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji. AKEP-i konsultohet me palët e treta në përputhje me nenin 44, të këtij ligji në tërësi dhe në veçanti dhe konsideron pikëpamjet e tyre mbi preken drejtpërdrejt nga transaksioni i synuar. AKEP merr vendimin e ministrit në rastin e ndryshimeve të rëndësishme të njoftuara nga një sipërmarrës sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat impaktojnë përbushjen e objektivave strategjike sipas nenit 5 të këtij ligji.</p> <p>6. Në bazë të analizës së tij, AKEP-i vendos, ruan, ndryshon ose heq detyrimet, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 44, të këtij ligji dhe nëse është e nevojshme aplikon parashikimet e nenit 106, të këtij ligji. Në vendimin e tij, AKEP-i vendos t'i bëjë të detyrueshme disa ose të gjitha angazhimet e ndërmarrja. Pavarësisht parashikimit të pikës 5 të nenit 90, të këtij ligji, AKEP-i i bën të detyrueshme disa ose të gjitha</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--------|---|----------|---|--|--|
| | <p>me nenin 68 (3), kur çdo angazhim i ofruar është i pamjaftueshëm për të përmbushur objektivat e përcaktuara në nenin 3.</p> <p>4. Autoriteti rregullator kombëtar monitoron implementimin e angazhimeve të ofruara nga sipërmarrjet që ai ka bërë detyruese, në përputhje me paragrafin 2 dhe do të marrë në konsideratë zgjatjen e tyre kur periudha për të cilën ato janë ofruar fillimisht ka skaduar.</p> | | | <p>angazhimet, për të gjithë periudhën për të cilën ato ofrohen.</p> <p>7. AKEP-i monitoron zbatimin e angazhimeve të ofruara nga sipërmarrjet, të cilat i ka bërë të detyrueshme në përputhje me pikën 6, të këtij neni dhe merr në konsideratë zgjatjen e tyre kur të ketë mbaruar periudha për të cilën ato janë vendosur fillimisht.</p> | |
| Neni79 | <p style="text-align: center;">Neni 79 Procedura e angazhimeve</p> <p>1. Sipërmarrjet e përcaktuara me fuqi të ndjeshme në treg, mund t'i ofrojnë autoritetit rregullator kombëtar angazhime në lidhje me kushtet për akses, bashkë-investim, ose të dyja, të zbatueshme për rrjetet e tyre, nder te tjera, për:</p> <p>(a) marrëveshjet bashkëpunuese të rëndësishme për vlerësimin e detyrimeve të përshtatshme dhe proporcionale, në përputhje me nenin 68;</p> <p>(b) bashkë-investimin në rrjete me kapacitet shumë të lartë, në përputhje me nenin 76; ose</p> <p>(c) akses efektiv dhe jodiskriminues nga palët e treta në përputhje me nenin 78, te dyja gjatë një periudhe implementimi të ndarjes vullnetare nga një ndërmarrje e integruar vertikalisht dhe pasi të implementohet forma e propozuar e ndarjes.</p> <p>Oferta për angazhime do të jetë mjaft e hollësishme duke përfshirë kohën dhe qëllimin e implementimit të tyre dhe kohëzgjatjen e tyre, për të lejuar autoritetin rregullator kombëtar të bëjë vlerësimin e tij në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Angazhimet e tilla mund të shtrihen përtej periudhave për kryerjen e analizës së tregut, të parashikuar në nenin 67 (5).</p> <p>2. Për të vlerësuar çdo angazhim të ofruar nga një ndërmarrje, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, autoriteti rregullator kombëtar, përveçse kur angazhimet e tilla qartësisht nuk plotësojnë një ose më shumë kushte ose kritere përkatëse, bejne një provë të tregut, veçanërisht në kushtet e ofruara, duke kryer një konsultim publik të palëve të interesuara, veçanërisht palëve të treta, të cilat preken drejtpërdrejt. Bashkë-investitorët e mundshëm ose kërkuesit e aksesit mund të japin pikëpamje mbi përputhshmërinë e angazhimeve të ofruara me kushtet e parashikuara, sipas zbatimit, në nenin 68, 76 ose 78 dhe mund të propozojnë ndryshime.</p> <p>Sa i përket angazhimeve të ofruara sipas këtij neni, autoriteti rregullator kombëtar, kur vlerëson detyrimet në përputhje me nenin 68 (4), ka parasysh:</p> <p>(a) provat në lidhje me karakterin e drejtë dhe të</p> <p>(b) arsyeshëm të angazhimeve të ofruara;</p> <p>(c) hapjen e angazhimeve për të gjithë pjesëmarrësit e tregut;</p> <p>(d) disponueshmërinë në kohë të aksesit nën kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo-diskriminuese, përfshirë rrjetet me kapacitet shumë të lartë, përpara fillimit të shërbimeve të lidhura me shitjen me pakicë;</p> | Neni 105 | <p style="text-align: center;">Neni 105 Procedura e angazhimeve</p> <p>1. Sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës, mund t'i propozojnë AKEP-it ndërmarrjen e angazhimeve në lidhje me kushtet për aksesin, bashkëinvestim ose për të dyja së bashku, të zbatueshme në rrjetet e tyre, që kanë të bëjnë ndër të tjera me:</p> <p>a) marrëveshjet e bashkëpunimit relevante me vlerësimin e detyrimeve të përshtatshme dhe proporcionale, në përputhje me nenin 92, të këtij ligji;</p> <p>b) bashkëinvestimin në rrjete me kapacitet shumë të lartë, sipas nenit 101, të këtij ligji; ose,</p> <p>c) aksesin efektiv dhe jodiskriminues për palët e treta, në përputhje me parashikimet e nenit 104, të këtij ligji, si gjatë periudhës së procesit të ndarjes vullnetare nga një shoqëri e integruar vertikalisht, ashtu edhe pasi të finalizohet forma e propozuar e ndarjes.</p> <p>2. Propozimi për angazhime, duhet të jetë i detajuar mjaftueshëm, duke përfshirë afatet kohore, fushën e veprimit, si dhe kohëzgjatjen e tyre, për t'i mundësuar AKEP-it kryerjen e vlerësimit, sipas këtij neni. Angazhimet e propozuara duhet të shtrihen përtej afateve kohore për kryerjen e analizave të tregut të parashikuara në nenin 90, të këtij ligji.</p> <p>3. Për vlerësimin e çdo angazhimi të propozuar, nga një sipërmarrës sipas pikës 1 të këtij neni, AKEP-i, përveç rasteve kur angazhimet qartësisht nuk plotësojnë një ose më shumë nga kushtet apo kriteret përkatëse të parashikuara, kryen një test tregu, veçanërisht për kushtet e ofruara, duke mbajtur një këshillim publik me palët e interesuara, në veçanti me palët e treta që preken drejtpërdrejt.</p> <p>4. Bashkëinvestitorët e mundshëm ose kërkuesit e aksesit, japin pikëpamjet mbi përputhshmërinë e angazhimeve të propozuara me kushtet e parashikuara në nenin 92, 101 ose 104, të këtij ligji dhe paraqesin komente apo sugjerime për ndryshime.</p> <p>5. Përsa i përket angazhimeve të propozuara sipas këtij neni, AKEP-i, kur vlerëson detyrimet sipas pikës 5 të nenit 92, të këtij ligji, duke mbajtur parasysh në veçanti:</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>dhe</p> <p>(e) mjaftueshmëria e përgjithshme e angazhimeve të ofruara, për të mundësuar konkurrencë të qëndrueshme në tregjet në drejtim të rrymës (downstream markets) dhe për të lehtësuar vendosjen bashkëpunuese dhe marrjen e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë në interes të përdoruesve fundorë.</p> <p>Duke marrë parasysh të gjitha pikëpamjet e shprehura në konsultim, dhe masën sa këto pikëpamje përfaqësojnë palëtendryshme të interesuara, autoriteti rregullator kombëtar do t'i komunikojë ndërmarrjes së caktuar si me fuqi të rëndësishme të tregut, përfundimet paraprake, nëse angazhimet e ofruara përputhen me objektivat, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë nen dhe siç është e zbatueshme, në nenet 68, 76 ose 78, dhe nën të cilat kushte mund të konsiderojë angazhimetë detyrueshme. Ndërmarrja mund të rishikojë ofertën e saj fillestare, për të marrë parasysh përfundimet paraprake të autoritetit kombëtar rregullator dhe me qëllim të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në këtë nen dhe siç është e zbatueshme, në nenin 68, 76 ose 78.</p> <p>3. Pa cënuar nënparagrafin e parë të nenit 76 (2), autoriteti rregullator kombëtar mund të nxjerrë një vendim për t'i bërë angazhimet detyruese, tërësisht ose pjesërisht. Nëpërmjet derogimit nga neni 67 (5), autoriteti rregullator kombëtar mund t'i bëjë disa ose të gjitha angazhimet detyruese për një periudhë të caktuar, e cila mund të jetë e gjithë periudha për të cilën ato ofrohen, dhe në rastin e angazhimeve të bashkë-investimit ti bëjnë detyruese në pajtim me nënparagrafin e parë të nenit 76 (2), kështu ai i bën ato detyruese për një periudhë minimale prej shtatë vjet.</p> <p>Sipas nenit 76, ky nen nuk cënon zbatimin e procedurës së analizës së tregut në përputhje me nenin 67 dhe imponimin e detyrimeve në përputhje me nenin 68.</p> <p>Kur autoriteti rregullator kombëtar, bën angazhime detyruese në përputhje me këtë nen, ai do të vlerësojë në bazë të nenit 68 pasojat e këtij vendimi për zhvillimin e tregut dhe përshtatshmërinë e çdo detyrimi që ai ka vendosur në mungesë të këtyre angazhimeve, duke konsideruar imponim në zbatim të këtij Neni ose nenet 69 deri 74. Kur njofton draft masën përkatëse sipas nenit 68, në përputhje me nenin 32, autoriteti rregullator kombëtar shoqëron draft masën e njoftuar me vendimin e angazhimeve.</p> <p>4. Autoriteti rregullator kombëtar monitoron, mbikëqyr dhe siguron respektimin e angazhimeve që ai ka bërë detyrues, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, në të njëjtën mënyrë me të cilën monitoron, mbikëqyr dhe siguron përmbushjen e detyrimeve të vendosura në bazë të nenit 68 dhe do të marrë parasysh zgjatjen e periudhës për të cilën ato janë bërë detyruese, kur periudha fillestare skadon. Nëse autoriteti rregullator kombëtar konstaton se një ndërmarrje nuk ka përmbushur angazhimet që janë bërë detyruese në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ai mund të vendosë ndëshkime ndaj ndërmarrjes në përputhje me nenin 29.</p> | | <p>a) evidentimin e qartë të angazhimeve të drejta dhe të arsyeshme në propozimin e bërë;</p> <p>b) angazhime të hapura për të gjithë pjesëmarrësit e tregut;</p> <p>c) disponueshmërinë në kohë, për akses në rrjet me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, duke përfshirë rrjetet me kapacitet shumë të lartë, përpara fillimit të shërbimeve të ofruara në tregun e pakicës; dhe,</p> <p>d) përshtatshmërinë e angazhimeve të propozuara, që të mundësojë konkurrencë të qëndrueshme në tregun e rrjedhës së poshtme dhe të lehtësojë bashkëpunimin për shtrirjen e rrjetit për arritjen e zhvillimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë transmetues, në interes të përdoruesve fundorë.</p> <p>6. Pas vlerësimit dhe konsiderimit të gjithë komenteve dhe pikëpamjeve të paraqitura gjatë procesit të këshillimit publik nga palë të ndryshme të interesuara, AKEP-i i komunikon sipërmarrësit të shpallur me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës, gjetjet paraprake, pavarësisht nëse këto angazhime përputhen me objektivat, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë nen dhe sipas rastit me nenet 92, 101 dhe 104, të këtij ligji, mbi kushtet e të cilave, konsiderohet që i bën këto angazhime të detyrueshme.</p> <p>7. Sipërmarrësi rishikon propozimin fillestar, duke marrë në konsideratë gjetjet parapraket të AKEP-it, me qëllim përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë nen dhe sipas rastit në nenet 92, 101 dhe 104, të këtij ligji.</p> <p>8. Pa paragjykuar parashikimet e pikës 3, të nenit 101, të këtij ligji, AKEP-i merr vendim për t'i bërë pjesërisht ose plotësisht të detyrueshme angazhimet e sipërmarrësit.</p> <p>9. Me përjashtim të pikës 6 të nenit 90, të këtij ligji, AKEP-i vendos t'i bëjë të detyrueshme një pjesë, ose të gjitha angazhimet e ndërmara nga sipërmarrësi, për një periudhë kohore të caktuar, e cila përfshin të gjithë periudhën e ofrimit të tyre dhe për rastet e angazhimeve në kuadër të bashkëfinancimit t'i bëjë të detyrueshme, në përputhje me pikën 3 të nenit 101, të këtij ligji, për t'u zbatuar për një periudhë kohore minimumi 7 vite.</p> <p>10. Përcaktimet e nenit 101, të këtij ligji, aplikohen pa paragjykuar procesin e analizave të tregut në përputhje me nenin 90, të këtij ligji dhe vendosjen e detyrimeve.</p> <p>11. Në rastet kur AKEP-i, i bën të detyrueshme angazhimet sipas këtij neni, në përputhje me përcaktimet e nenit 92, të këtij ligji, AKEP vlerëson pasojat e mundshme të këtij vendimi në zhvillimin e tregut dhe përshtatshmërinë e çdo detyrimi të vendosur, apo që do të vendoset, në mungesë të këtyre angazhimeve, të konsideruara për t'u vendosur sipas nenit 92 apo neneve 93 deri në 99, të këtij</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|--|--|----------|--|---|--|
| | Pa cënuar procedurën për të siguruar pajtueshmëri të detyrimeve specifike sipas nenit 30, autoriteti rregullator kombëtar mund të rivlerësojë detyrimet e vendosura në përputhje me nenin 68 (6). | | | ligji. Në njoftimin e draft masave të parashikuara për t'u vendosur sipas nenit 92, të këtij ligji, AKEP-i e shoqëron njoftimin me vendimin për angazhimet. 12. AKEP-i monitoron, mbikëqyr dhe siguron respektimin e angazhimeve, të cilat i ka bërë të detyrueshme në përputhje me pikën 8, të këtij neni, në të njëjtën mënyrë si monitoron, mbikëqyr dhe siguron respektimin e detyrimeve të vendosura sipas nenit 92, të këtij ligji dhe merr në konsideratë shtrirjen e tyre për periudhën kohore për të cilën ato janë bërë të detyrueshme kur përfundon periudha fillestare. 13. Nëse AKEP-i arrin në përfundimin se një sipërmarrës nuk ka respektuar angazhimet që janë bërë të detyrueshme në përputhje me pikën 8, të këtij neni, vendos penalitete ndaj këtij sipërmarrësi në përputhje me parashikimet në nenet 183 dhe 184, të këtij ligji. 14. AKEP-i mund të rivlerësojë detyrimet e vendosura në përputhje me pikën 7, të nenit 92, të këtij ligji, pa paragjykuar procedurat e inspektimit dhe monitorimit për sigurimin e përputhshmërisë me detyrimet specifike, sipas këtij ligji. | | |
| Neni80 | <p style="text-align: center;">Neni 80 Vetëm ndërmarrjet e shumices</p> <p>1. Një autoritet rregullator kombëtar që përcakton një sipërmarrje që mungon nga çdo treg i shitjes me pakicë për shërbimet e komunikimeve elektronike, teksa ka fuqi të ndjeshme të tregut në një ose disa tregje me shumicë, në përputhje me nenin 67, do të marrë parasysh nëse ajo sipërmarrje ka karakteristikat e mëposhtme: (a) të gjitha kompanitë dhe njësitë e biznesit brenda sipërmarrjes, të gjitha kompanitë që kontrollohen, por jo domosdoshmërisht në pronësi të plotë të njëjtit pronar përfundimtar, dhe çdo aksioner i aftë të ushtrojë kontroll mbi sipërmarrjen, të ketë vetëm aktivitete aktuale dhe të planifikuara për të ardhmen, në tregjet me shumicë për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe për këtë arsye nuk mund të kenë aktivitete në ndonjë treg me pakicë për shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara për përdoruesit fundorë në Bashkimin Evropian; (b) sipërmarrja nuk është e detyruar të merret me një sipërmarrje të vetme dhe të veçantë që vepron në drejtim të rrymës që është aktive në çdo treg të shitjes me pakicë për shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara për përdoruesit fundorë, për shkak të një marrëveshje ekskluzive.</p> <p>2. Nëse autoriteti rregullator kombëtar konstaton se kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni janë përmbushur, ai mund t'i imponojë asaj sipërmarrje vetëm detyrime në përputhje me nenet 70 dhe 73 ose në lidhje me çmimin e drejtë dhe të arsyeshëm, nëse justifikohet në bazë të një analize</p> | | Neni 106 | <p style="text-align: center;">Neni 106 Sipërmarrje vetëm me shumicë</p> <p>1. Nëse AKEP-i në përputhje me parashikimet e nenit 90, të këtij ligji, shpall një sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg, në një ose disa tregje të shitjes me shumicë, që nuk ofron shërbime të komunikimeve elektronike në tregjet me pakicë, AKEP shqyrton nëse ky sipërmarrës plotëson karakteristikat e mëposhtme: a) të gjitha shoqëritë dhe njësitë e biznesit të sipërmarrjes, që kontrollohen por jo domosdoshmërisht zotërohen nga i njëjti pronar fundor, apo ndonjë aksioner që ushtron kontrollin mbi sipërmarrjen, aktualisht apo planet në të ardhmen, kanë aktivitet vetëm në tregun e shitjes me shumicë të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe nuk kanë asnjë aktivitet në ndonjë nga tregjet e ofrimit të shitjes me pakicë të shërbimeve të komunikimeve elektronike, që ofrohen për përdoruesit fundorë në Republikën e Shqipërisë; b) sipërmarrësi nuk është i detyruar që të angazhohet në marrëveshje të vetme me një operator të caktuar, i cili ushtron aktivitet në rrjedhën e poshtme, <i>downstream</i>, dhe që është aktiv në ndonjë treg të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike me pakicë për përdoruesit fundorë, apo është pjesë e një</p> | F | |

| | | | | | | |
|----------------------|---|--|-----------------|---|----------|--|
| | <p>të tregut duke përfshirë një vlerësim të ardhshëm të sjelljes së mundshme të ndërmarrjes të caktuar me një fuqi të konsiderueshme në treg.</p> <p>3. Autoriteti rregullator kombëtar, do të rishikojë detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrjes në përputhje me këtë nen në çdo kohë, nëse konstaton se kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk plotësohen më dhe ai, do të zbatojë nenet 67 për 74. Sipërmarrjet, pa vonesë, njoftojnë autoritetin rregullator kombëtar për çdo ndryshim të rrethanave të rëndësishme për pikat (a) dhe (b) të paragrafit 1 të këtij neni.</p> <p>4. Autoriteti rregullator kombëtar, gjithashtu do të rishikojë detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrjes, në përputhje me këtë nen, nëse në bazë të provave të termave dhe kushteve të ofruara nga sipërmarrja për klientët e saj, autoriteti nxjerr në konkluzion që problemet e konkurrencës kanë lindur ose ka të ngjarë të lindin në dëm të përdoruesve fundorë që kërkojnë vendosjen e një ose më shumë detyrimeve të parashikuara në nenet 69, 71, 72 ose 74, ose ndryshimin e detyrimeve të vendosura në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>5. Vendosja e detyrimeve dhe rishikimi i tyre në përputhje me këtë nen do të zbatohet në përputhje me procedurat e përmendura në nenet 23, 32 dhe 33.</p> | | | <p>marrëveshjeje e cila ‘de facto’ i nënshtrohet një marrëveshjeje ekskluzive.</p> <p>2. Nëse AKEP-i arrin në përfundimin, se detyrimet e vendosura në përputhje me pikën 1, të këtij neni janë plotësuar, atëherë ai mund të vendosë ndaj këtij sipërmarrësi, vetëm detyrimet e parashikuara në nenet 95 dhe 98, të këtij ligji, ose të përafërta me çmime relativisht të drejta dhe të arsyeshme, nëse kjo justifikohet mbi bazën e analizës së tregut përkatës, duke përfshirë edhe një vlerësim për sjelljen e mundshme të sipërmarrësit të shpallur me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës.</p> <p>3. AKEP rishikon detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrjes në përputhje me këtë nen në çdo kohë, nëse konstaton se kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, nuk plotësohen më dhe sipas rastit, zbaton parashikimet e neneve 90 deri në 99, të këtij ligji. Sipërmarrjet informojnë pa vonesë AKEP-in për çdo ndryshim sipas rrethanave, që lidhet me pikën 1 të këtij neni.</p> <p>4. AKEP rishikon gjithashtu detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrjes të shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, në përputhje me këtë nen, nëse bazuar në provat që termat dhe kushtet e ofruara nga sipërmarrësi për klientët e tij të rrjedhës së poshtme, <i>downstream</i>, kanë sjellë apo mund të sjellin shqetësime dhe probleme për konkurrencën në treg, të cilat afektojnë përdoruesit fundorë, e për të cilat ka nevojë për vendosjen e një ose më shumë detyrimeve të parashikuara në nenet 93, 96, 97 ose 99, të këtij ligji, ose për ndryshimin e detyrimeve të vendosura në përputhje me pikën 2, të këtij neni.</p> <p>5. Vendosja e detyrimeve dhe rishikimi i tyre në përputhje me këtë nen, do të zbatohet në përputhje me procedurat e konsultimit të parashikuara në nenin 44, të këtij ligji.</p> | | |
| <p>Neni81</p> | <p style="text-align: center;">Neni 81 Migrimi nga infrastruktura baze</p> <p>1. sipërmarrjet të cilat janë përcaktuar se kanë fuqi të ndjeshme të tregut në një ose disa tregje përkatëse, në përputhje me nenin 67, njoftojnë paraprakisht autoritetin rregullator kombëtar dhe në kohën e duhur, kur planifikojnë të dalin nga tregu ose zëvendësohen me pjesë të reja të infrastrukturës së rrjet, përfshirë infrastrukturën e trashëgimisë së nevojshme për të operuar me një rrjet bakri, të cilat janë subjekt i detyrimeve në përputhje me nenet 68 deri 80.</p> <p>2. Autoriteti rregullator kombëtar siguron që procesi i daljes nga tregu ose zëvendësimit, të kenë një orar dhe kushte transparente, duke përfshirë një periudhë të përshtatshme njoftimi për tranzicion, dhe përcakton disponueshmërinë e produkteve alternative me cilësi të krahasueshme, duke siguruar akses në</p> | | <p>Neni 107</p> | <p style="text-align: center;">Neni 107 Migrimi i infrastrukturës së trashëguar</p> <p>1. Sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, në një ose disa tregje përkatëse, në përputhje me nenin 90, të këtij ligji, njoftojnë paraprakisht dhe në kohën e duhur AKEP-in, kur planifikojnë të heqin ose zëvendësojnë me një infrastrukturë të re pjesë të rrjetit, duke përfshirë infrastrukturën e trashëguar të nevojshme për të operuar një rrjet bakri, të cilat janë subjekt i detyrimeve sipas neneve 92 deri në 106, të këtij ligji.</p> <p>2. AKEP-i siguron që procesi i çmontimit ose zëvendësimit, të përfshijë një orar dhe kushte transparente, me një periudhë të përshtatshme njoftimi për tranzicionin dhe të vendosë disponueshmërinë e produkteve alternative me cilësi të krahasueshme, duke</p> | <p>F</p> | |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|----------|---|---|--|
| | <p>infrastrukturën e përmirësuar të rrjetit që zëvendëson elementet e zëvendësuara më parë nëse është e nevojshme, për të mbrojtur konkurrencën dhe të drejtat e përdoruesve fundorë.</p> <p>Në lidhje me asetet të cilat janë propozuar për asgjësim ose zëvendësim, autoriteti rregullator kombëtar mund të tërheqë detyrimet pasi të ketë konstatuar se ofruesi i aksesit:</p> <p>(a) ka krijuar kushtet e duhura për migracionin, duke përfshirë vënien në dispozicion të një produkti alternativ të aksesit me cilësi të krahasueshme kur ishte në dispozicion, duke përdorur infrastrukturën e trashëgimisë, e duke mundësuar që kërkuiesit të aksesit të arrijnë të njëjtët përdorues fundorë; dhe</p> <p>(b) ka zbatuar kushtet dhe procesin e njoftuar tek autoriteti rregullator kombëtar në përputhje me këtë nen.</p> <p>Një tërheqje e tillë do të zbatohet në përputhje me procedurat e përmendura në nenet 23, 32 dhe 33.</p> <p>3. Ky artikull nuk cenon disponueshmërinë e produkteve të rregulluara të vendosura nga autoriteti rregullator kombëtar në infrastrukturën e rrjetit të azhurnuar, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 67 dhe 68.</p> | | | <p>siguruar akses në infrastrukturën e rrjetit të përmirësuar, duke zëvendësuar elementët e nevojshëm për të mbrojtur konkurrencën dhe të drejtat e përdoruesve fundorë.</p> <p>3. Në lidhje me asetet që propozohen për heqje ose zëvendësim, AKEP tërheq detyrimet pasi të ketë konstatuar se ofruesi i aksesit:</p> <p>a) ka krijuar kushtet e përshtatshme për migrimin, duke përfshirë vënien në dispozicion të një produkti alternativ aksesit me cilësi të krahasueshme siç kur ishte i disponueshëm, duke përdorur infrastrukturën e trashëguar dhe që u mundëson kërkuiesve të aksesit të arrijnë të njëjtët përdorues fundorë; dhe</p> <p>b) ka respektuar kushtet dhe kryer njoftimin për procesin në AKEP sipas këtij neni.</p> <p>Një tërheqje e tillë zbatohet në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 39, të këtij ligji.</p> <p>4. Ky nen nuk cenon disponueshmërinë e produkteve të rregulluara si fibrat e errëta, aksesin lokal të pakufizuar virtual ose produkte të tjera bitstream, të imponuara nga AKEP mbi infrastrukturën e përmirësuar të rrjetit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 90 dhe 92, të këtij ligji.</p> | | |
| Neni82 | <p style="text-align: center;">Neni 82 Udhëzimet e BEREC për rrjetet me kapacitete shumë të larta</p> <p>Deri më 21 dhjetor 2020, BEREC do të nxjerrë udhëzime, pas konsultimit me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, për kriteret që duhet të përmbushë një rrjet, në mënyrë që të konsiderohet një rrjet me kapacitet shumë të lartë, veçanërisht për sa i përket brezit të bandës së poshtme dhe të sipërme (down- and uplink bandwidth), elasticitetit (rezistences), parametrat që lidhen me gabimet, dhe latenca me variacionet e saj. Autoritetet rregullatore kombëtare, duhet të marrin parasysh këto udhëzime. BEREC do të aktualizojë udhëzimet deri më 31 dhjetor 2025 dhe rregullisht pas kësaj.</p> | | Neni 108 | <p style="text-align: center;">Neni 108 Udhëzime për rrjetet me kapacitet shumë të lartë</p> <p>AKEP-i nxjerr rregullore për Rrjetet me Kapacitet Shumë të Lartë, bazuar në Udhëzuesin e BEREC, për Rrjetet me Kapacitet Shumë të Lartë, dhe specifikon kriteret që duhet të plotësojë një rrjet në tregun kombëtar për t'u konsideruar si një rrjet me kapacitet shumë të lartë, veçanërisht për sa i përket parametrave të gabimit “<i>down and up-link bandwidth resilience error-related</i>”, vonësës dhe variacionit të saj. Kriteret që duhet të plotësojë një rrjet në tregun kombëtar për t'u konsideruar si një rrjet me kapacitet shumë të lartë, përditësohen nga AKEP në mënyrë periodike, bazuar në udhëzimet përkatëse të BEREC.</p> | F | |
| Neni83 | <p style="text-align: center;">Kapitulli V Kontrolli rregullator i shërbimeve të shitjes me pakicë</p> <p style="text-align: center;">Neni 83 Kontrolli rregullator i shërbimeve të shitjes me pakicë</p> <p>1. Shtetet Anëtare mund të sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare të imponojnë detyrimet e duhura rregullatore për sipërmarrjet e identifikuara që kanë fuqi të ndjeshme të tregut në një treg të caktuar pakice, në përputhje me nenin 63, kur:</p> | | Neni 109 | <p style="text-align: center;">KREU XVI KONTROLLI RREGULLATOR I SHËRBIMEVE ME PAKICË</p> <p style="text-align: center;">Neni 109 Kontrolli rregullator i shërbimeve të shitjes me pakicë</p> <p>1. AKEP-i vendos detyrime rregullatore për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, në një treg përkatës me pakicë, në përputhje me këtë ligj kur:</p> <p>a) nëse nga rezultatet e një analize tregu të kryer në përputhje me nenin 90, të këtij ligji, AKEP-i</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| | <p>(a) si rezultat i një analize të tregut të kryer në përputhje me nenin 67, një autoritet kombëtar rregullator përcakton që një treg i caktuar me pakicë i identifikuar në përputhje me nenin 64 nuk është në mënyrë efektive konkurrues;</p> <p>dhe</p> <p>(b) autoriteti rregullator kombëtar nxjerr në konkluzion, që detyrimet e vendosura në bazë të neneve 69 deri 74 nuk do të rezultojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 3.</p> <p>2. Detyrimet e vendosura në paragrafin 1 të këtij neni, bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale dhe të justifikuara në dritën e objektivave të përcaktuara në nenin 3. Detyrimet e vendosura mund të përfshijnë kërkesa që ndërmarrjet e identifikuar nuk tarifojnë çmime të tepërta, pengojnë hyrjen në treg ose kufizojnë konkurrencën, duke vendosur çmime grabitqare (predatory), tregojnë përparësi të panevojshme për përdoruesit e veçantë fundorë. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të zbatojnë ndaj ndërmarrjeve të tilla masa të përshtatshme të çmimeve të shitjes me pakicë, masa për të kontrolluar tarifatat individuale, ose masa për të orientuar tarifatat drejt kostove ose çmimeve në tregjet e krahasueshme, në mënyrë që të mbrojnë interesat e përdoruesve fundorë ndërsa promovojnë konkurrencën efektive.</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që, kur një ndërmarrje i nënshtrohet rregullimit të tarifave me pakicë ose kontrolleve të tjera përkatëse të shitjes me pakicë, zbatohen sistemet e nevojshme dhe të përshtatshme të llogaritjes së kostos. Autoritetet rregullatore kombëtare mund të specifikojnë format dhe metodologjinë e llogaritjes që do të përdoret. Pajtueshmëria me sistemin e llogaritjes së kostos verifikohet nga një organ i pavarur i kualifikuar. Autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që çdo vit, të publikohet një deklaratë, në lidhje me pajtueshmërinë.</p> <p>4. Pa çenuar nenet 85 dhe 88, autoritetet rregullatore kombëtare nuk do të zbatojnë mekanizmat e kontrollit me pakicë nga paragrafi 1 i këtij neni, në tregjet gjeografike ose ato me pakicë, kur ata janë të kënaqur që ka një konkurrencë efektive.</p> | | <p>përcakton se një treg i caktuar me pakicë, i identifikuar në përputhje me nenin 89, të këtij ligji, nuk është në konkurrencë efektive dhe,</p> <p>b) AKEP-i arrin në përfundimin se detyrimet e vendosura sipas neneve 93 deri në 99, të këtij ligji, për tregun e lidhur me shumicë nuk çojnë në arritjen e objektivave të nenit 5, të këtij ligji.</p> <p>2. Detyrimet e vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale dhe të justifikuara për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji. Detyrimet e vendosura, përfshijnë kërkesa që sipërmarrjet e identifikuar të mos ofrojnë çmime të larta, të cilat pengojnë hyrjen në treg ose kufizojnë konkurrencën duke vendosur çmime grabitqare, të mos tregojnë preferenca të panevojshme ndaj përdoruesve fundorë specifikë ose shërbime paketë, në mënyrë të paarsyeshme. AKEP zbaton ndaj këtyre sipërmarrjeve, masat e duhura të kufirit të çmimit të shitjes me pakicë, masat për të kontrolluar tarifatat individuale, ose masat për orientimin e tarifave drejt kostove ose çmimeve në tregje të krahasueshme, për të mbrojtur interesat e përdoruesve fundorë dhe nxituri konkurrencën efektive.</p> <p>3. AKEP siguron që, kur një sipërmarrje i nënshtrohet rregullimit të tarifave me pakicë ose rregullimeve të tjera përkatëse të shitjes me pakicë, të zbatohen sistemet e nevojshme dhe të përshtatshme të kontabilitetit të kostos. AKEP specifikon formatin dhe metodologjinë e kontabilitetit që përdoret. Pajtueshmëria me sistemin e kontabilitetit të kostos, verifikohet nga një organ i pavarur i kualifikuar. AKEP siguron që çdo vit të publikohet një deklaratë në lidhje me pajtueshmërinë.</p> <p>4. Përpara nxjerrjes së vendimit për rregullimin e tarifave me pakicë, AKEP-i kryen një proces konsultimi me palët e interesuara, në përputhje me nenet 44 dhe 45, të këtij ligji.</p> <p>5. Vendimi për rregullimin e tarifave, përfshin dispozita që kanë të bëjnë me:</p> <p>a) një afat të arsyeshëm kohor;</p> <p>b) detyrimin për dhënien e informacionit sipas nenit 41, të këtij ligji;</p> <p>c) kushtet për kohën e aplikimit në treg të tarifave të miratuara;</p> <p>d) kushtet shoqëruese, në rast se një tarifë zbatohet ndryshe nga ajo e miratuar, ose ajo ndryshohet pas miratimit;</p> <p>e) detyrimet për rregullimin e tarifave të miratuara në rast se ndryshojnë tarifatat e aksesit dhe të interkoneksionit;</p> | |
|--|---|--|--|--|

| | | | | | |
|---------------|---|----------|---|--|--|
| | | | | <p>f) kushtet për njoftimin e ndryshimeve në tarifatat sipas çmimeve të rregulluara.</p> <p>6. Pa paragjykuar nenet 110 dhe 115, të këtij ligji, AKEP nuk zbaton mekanizmat e kontrollit të shitjes me pakicë sipas pikës 1, të këtij neni, për tregjet gjeografike, ose të përdoruesve fundorë, kur AKEP është i bindur se ka konkurrencë efektive.</p> | |
| Neni84 | <p align="center">SHERBIMET Detyrimet e USO</p> <p align="center">Neni 84 Shërbim universal i përballueshëm</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë, që të gjithë konsumatorët në territoret e tyre, të kenë akses me një çmim të përballueshëm, në dritën e kushteve specifike kombëtare, në një shërbim adekuat të disponueshëm të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit zazor, me cilësinë e specifikuar në territoret e tyre, përfshirë lidhjen themelore në një lokacion fikse.</p> <p>2. Përveç kesaj, shtetet Anëtare gjithashtu mund të sigurojnë përballueshmërinë e shërbimeve të përmendura në paragrafin 1 që nuk ofrohen në një vend të caktuar, kur ata e konsiderojnë këtë të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e plotë sociale dhe ekonomike të konsumatorëve në shoqëri.</p> <p>3. Çdo Shtet Anëtar, në dritën e kushteve kombëtare dhe gjerësinë e brezit minimal të cilin e gëzojnë shumica e konsumatorëve brenda territorit të këtij Shteti Anëtar, dhe duke marrë parasysh raportin e BEREC për praktikën më të mirë, përcakton shërbimin adekuat të aksesit në internet me broadband, për qëllimet e paragrafit 1, me qëllim të sigurimit të gjerësisë së brezit të nevojshëm për pjesëmarrje sociale dhe ekonomike në shoqëri. Shërbimi adekuat i aksesit në internet broadband, do të jetë i aftë të ofrojë gjerësinë e brezit të nevojshëm, për të mbështetur të paktën grupin minimal të shërbimeve të përcaktuara në Shtojcën V.</p> <p>Deri më 21 qershor 2020, BEREC, për të kontribuar në zbatimin e vazhdueshëm të këtij neni, pas konsultimit me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, duke marrë parasysh të dhënat e disponueshme të Komisionit (Eurostat), harton një raport mbi praktikën më të mirë të Shteteve Anëtare, për të mbështetur përcaktimin e një shërbimi adekuat të aksesit në internet, në përputhje me nënparagrafin e parë. Ky raport do të përditësohet rregullisht për të pasqyruar përparimet teknologjike dhe ndryshimet në modelet e përdorimit të konsumatorit.</p> <p>4. Kur një konsumator kërkon një gjë të tillë, lidhja e përmendur në paragrafin 1 dhe kur është e zbatueshme në paragrafin 2, mund të kufizohet për të mbështetur shërbimet e komunikimit zazor.</p> | Neni 110 | <p align="center">KREU XVII DETYRIME TË SHËRBIMIT UNIVERSAL</p> <p align="center">Neni 110 Shërbim i përballueshëm universal</p> <p>1. AKEP-i, siguron që të gjithë konsumatorët në territorin e Republikës së Shqipërisë të kenë akses, kundrejt një çmimi të përballueshëm sipas kushteve specifike kombëtare, në shërbimet e disponueshme dhe të përshatshme të internetit broadband dhe në shërbimet e komunikimit zazor, sipas cilësisë së specifikuar nga AKEP-i, duke përfshirë sigurimin e lidhjes në rrjet nga një vendndodhje fikse.</p> <p>2. AKEP-i siguron gjithashtu disponueshmërinë e shërbimeve të përballueshme të përmendura në pikën 1, të këtij neni edhe nga vendndodhje jo fikse, kur kjo është e nevojshme për sigurimin e pjesëmarrjes së plotë sociale dhe ekonomike të konsumatorëve në shoqëri.</p> <p>3. Përkufizimi i shërbimit të aksesit të internetit broadband për qëllimet e pikës 1, të këtij neni bëhet nga AKEP, me qëllim sigurimin e kapacitetit të lidhjes broadband, të nevojshme për pjesëmarrjen sociale dhe ekonomike në shoqëri, duke marrë parasysh kapacitetin minimal të lidhjes broadband që gëzon shumica e konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>4. Shërbimi i aksesit në internet broadband, duhet të jetë në gjendje të ofrojë kapacitetin e nevojshëm për të mbështetur të paktën shërbimet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> e-mail; motorët e kërkimit që mundësojnë kërkimin dhe gjetjen e të gjitha llojeve të informacionit; instrumenta të trajnimit dhe edukimit bazë online; gazeta, lajme online; blerjen, porositjen e mallrave ose shërbimeve në internet; kërkimin për punë dhe mjetet e kërkimit të punës; rrjetet profesionale; shërbimet bankare në internet; përdorimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike; mediat sociale dhe mesazhet e çastit; thirrjet dhe video thirrjet me cilësi standarde. | F | |

| | | | | | | |
|--------|---|----------|--|--|--|--|
| | <p>5. Shtetet Anëtare mund të zgjerojnë fushën e zbatimit të këtij neni për përdoruesit fundorë, që janë mikro ndërmarrje dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme, si dhe organizata jofitimprurëse.</p> | | | <p>5. Lidhja në rrejt e përmendur në pikën 1, dhe kur është e zbatueshme në pikën 2, të këtij neni, mund të kufizohet për të mbështetur vetëm shërbimet e komunikimit zonor, kur këtë e kërkon konsumatori.</p> <p>6. AKEP, në konsultim me ministrinë dhe pas kryerjes së një konsultimi publik, në përputhje me nenin 45, të këtij ligji, mund të zgjerojë fushën e zbatimit të këtij neni duke përfshirë ndërmarrjet mikro, ose ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ose organizatat jofitimprurëse.</p> | | |
| Neni85 | <p style="text-align: center;">Neni 85 Sigurimi i një shërbimi universal të përballueshëm</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare në koordinim me autoritetet e tjera kompetente, mbikëqyrin evolucionin dhe nivelin e çmimeve të shitjes me pakicë, të shërbimeve të përmendura në nenin 84 (1) të disponueshme në treg, veçanërisht në lidhje me çmimet kombëtare dhe të ardhurat kombëtare të konsumatorit.</p> <p>2. Kur Shtetet Anëtare përcaktojnë se, në dritën e kushteve kombëtare, çmimet e shitjes me pakicë për shërbimet e përmendura në nenin 84 (1) nuk janë të përballueshme, sepse konsumatorët me të ardhura të ulëta ose nevoja të veçanta sociale janë të ndaluar të hyjnë në këto shërbime, ata do të marrin masa për të siguruar përballueshmërinë për konsumatorët e shërbimit adekuat të broadband të internetit dhe shërbimeve të komunikimit zonor në një vendndodhje fikse.</p> <p>Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare mund të sigurojnë që u këtyre konsumatorëve tu ofrohet mbështetje për qëllime komunikimi ose mund t'u kërkojnë ofruesve të shërbimeve të tilla t'u ofrojnë atyre konsumatorëve opsione tarifore ose paketa të ndryshme nga ato të parashikuara në kushte normale tregtare, ose të dyja bashkë. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë nga ofruesit e tillë të zbatojnë tarifën e zakonshme, përfshirë mesataren gjeografike, në të gjithë territorin.</p> <p>Në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht kur imponimi i detyrimeve nën nënparagrafin e dytë të këtij paragrafi për të gjithë ofruesit, do të rezultojë në një ngarkesë të tepruar administrative ose financiare të treguar për ofruesit ose Shtetin Anëtar, atëherë një Shtet Anëtar, mbi një bazë të jashtëzakonshme mund të vendosë të imponojë detyrime, për të ofruar ato mundësi ose paketa specifike tarifore vetëm për ndërmarrjet e përcaktuara. Neni 86 do të zbatohet për përcaktimet e tilla.</p> <p>Shteti Anëtar cakton ndërmarrjet, ai do të sigurojë që të gjithë konsumatorët me të ardhura të ulëta ose nevoja të veçanta sociale të përfitojnë nga një zgjedhje e ndërmarrjeve që ofrojnë mundësi tarifore, që adresojnë nevojat e tyre, përveç nëse sigurimi i një zgjedhjeje të tillë është e pamundur ose do të krijonte një ngarkesë të tepruar organizative ose financiare. Shtetet Anëtare sigurojnë që konsumatorët që kanë të drejtë për këto opsione tarifore ose paketa mund të lidhin një kontratë me një ofrues të shërbimeve të përmendura në nenin 84 (1), ose me një ndërmarrje të caktuar në</p> | Neni 112 | <p style="text-align: center;">Neni 112 Ofrimi i shërbimit universal të përballueshëm</p> <p>1. AKEP-i monitoron ecurinë dhe nivelin e çmimeve me pakicë të shërbimeve, të përcaktuara në nenin 110, të këtij ligji, të disponueshme në treg veçanërisht në raport me çmimet dhe të ardhurat e konsumatorit në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>2. Kur AKEP-i konstaton se çmimet e shitjes me pakicë për shërbimet e parashikuara në nenin 110, të këtij ligji, nuk janë të përballueshme sipas kushteve specifike të vendit, për shkak se konsumatorët me të ardhura të ulëta ose nevoja të veçanta sociale, nuk kanë mundësi të përballojnë aksesin në këto shërbime, merr masa për të siguruar përballueshmërinë për këta konsumatorë të shërbimit të aksesit internet broadband dhe shërbimet e komunikimit zonor, duke u kërkuar ofruesve të këtyre shërbimeve t'u ofrojnë këtyre konsumatorëve tarifa ose paketa tarifore alternative, të ndryshme nga ato që ofrohen në kushte normale tregtare, ose të dyja së bashku. AKEP-i mund t'u kërkojë ofruesve të shërbimeve të aplikojnë tarifa të njëjta, përfshirë ofrimin e një tarife të mesatarizuar gjeografike, në të gjithë territorin.</p> <p>3. Në rrethana të jashtëzakonshme, veçanërisht kur vendosja e detyrimeve sipas paragrafit të dytë të këtij neni, për të gjithë ofruesit, rezulton në një barrë të padrejtë administrative ose financiare për ofruesit ose Republikën e Shqipërisë, AKEP-i mund të vendosë, detyrimin për të ofruar këto tarifa ose paketa tarifore alternative specifike, vetëm për sipërmarrësit e përcaktuar si ofrues të shërbimit universal. Kërkesat e nenit 113 të këtij ligji, zbatohen për këta ofrues “<i>mutatis mutandis</i>”.</p> <p>4. Kur AKEP-i përcakton një ose më shumë sipërmarrës si ofrues të shërbimit universal, ai siguron që të gjithë konsumatorët me të ardhura të ulëta ose nevoja të veçanta sociale, të përfitojnë nga kjo mundësi zgjedhjeje e sipërmarrjeve që ofrojnë opsione tarifore për nevojat e tyre, përveç rasteve kur sigurimi i një zgjedhjeje të tillë është i pamundur ose do të krijonte një barrë shtesë të</p> | F | | |

| | | | | | |
|----------------|--|--|-----------------|---|---|
| | <p>përputhje me këtë paragraf, dhe që numri mbetet në dispozicion të tyre për një periudhë të përshtatshme. Kështu shmanget dhe shkëputja e paarsyeshme e shërbimit.</p> <p>3. Shtetet Anëtare sigurojnë që ndërmarrjet të cilat ofrojnë mundësi tarifore ose paketa për konsumatorët me të ardhura të ulëta, ose nevoja të veçanta sociale, në përputhje me paragrafin 2, t'i mbajnë autoritetet rregullatore kombëtare dhe autoritetet e tjera kompetente të informuar për detajet e ofertave të tilla. Autoritetet rregullatore kombëtare në koordinim me autoritetet e tjera kompetente, sigurojnë që kushtet në të cilat ndërmarrjet ofrojnë mundësi tarifore ose paketa, në përputhje me paragrafin 2, janë plotësisht transparente dhe janë publikuar dhe zbatuar në përputhje me parimin e mosdiskriminimit. Autoritetet rregullatore kombëtare në koordinim me autoritetet e tjera kompetente mund të kërkojnë që opsionet ose paketat e tilla tarifore të modifikohen ose tërhiqen.</p> <p>4. Shtetet Anëtare sigurojnë, në dritën e kushteve kombëtare, që ndihma t'u ofrohet, siç është e përshtatshme, konsumatorëve me aftësi të kufizuara, dhe që masat e tjera specifike të merren, me qëllim të sigurimit të pajisjeve terminale të lidhura, pajisjeve specifike dhe shërbime specifike që përmirësojnë hyrjen ekuivalente, duke përfshirë aty ku është e nevojshme, shërbimet totale të bisedës dhe shërbimet e transmetimit, të cilat janë të disponueshme dhe të përballueshme.</p> <p>5. Kur zbatohen këtë nen, Shtetet Anëtare do të përpiqen të minimizojnë shtrembërimet e tregut.</p> <p>6. Shtetet Anëtare mund të zgjerojnë fushën e zbatimit të këtij neni për përdoruesit fundorë që janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, si dhe organizata jofitimprurëse.</p> | | | <p>tepërt organizative ose financiare. AKEP-i siguron që konsumatorët që kanë të drejtë për tarifa ose paketa tarifore alternative të tilla, të lidhin një kontratë, ose me një ofrues të shërbimeve të referuara në nenin 110, të këtij ligji, ose me një ofrues të përcaktuar në përputhje me këtë paragraf dhe që numri i telefonit i tyre të mbetet në dispozicion për një periudhë të përshtatshme kohore, si dhe të shmangët ndërprerja e paarsyeshme e shërbimit.</p> <p>5. AKEP-i siguron që sipërmarrësit që ofrojnë tarifa ose paketa tarifore alternative për konsumatorët me të ardhura të ulëta ose nevoja të veçanta sociale, sipas pikës 2, të këtij neni, të mbajnë AKEP-in të informuar për detajet e ofertave të tilla. AKEP-i siguron që kushtet në të cilat sipërmarrësit ofrojnë tarifën ose paketat tarifore alternative sipas pikës 2, të këtij neni të jenë plotësisht transparente dhe të publikohen e zbatohen në përputhje me parimin e mosdiskriminimit. AKEP-i mund të kërkojë modifikimin ose tërheqjen e këtyre tarifave ose paketave tarifore alternative.</p> <p>6. AKEP-i, duke marrë në konsideratë kushtet kombëtare, siguron që për konsumatorët me aftësi të kufizuara, të ofrohet mbështetje e duhur dhe sipas rastit, të merren masa të tjera specifike për të siguruar që pajisjet fundore përkatëse dhe shërbimet që përmirësojnë aksesin ekuivalent, duke përfshirë aty ku është e nevojshme shërbimet e konvertimit të plotë të bisedave dhe shërbimet e konvertimit të tekstit, janë të disponueshme dhe të përballueshme.</p> <p>6. Gjatë zbatimit të këtij neni, AKEP-i mban parasysh minimizimin e deformimeve të tregut.</p> <p>7. AKEP-i mund të zgjerojë fushën e zbatimit të këtij neni, për të përfshirë dhe përdoruesit fundorë që janë ndërmarrje mikro, ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe organizata jofitimprurëse.</p> | |
| Neni 86 | <p style="text-align: center;">Neni 86 Disponueshmëria e shërbimit universal</p> <p>1. Kur një Shtet Anëtar ka vendosur, duke marrë parasysh rezultatet, e vëzhgimit gjeografik të kryer në përputhje me nenin 22 (1), dhe çdo dëshmi shtesë, kur është e nevojshme, që disponueshmërinë në një vend fiks të një shërbimi adekuat të aksesit në internet me broadband siç përcaktohet në përputhje me nenin 84 (3) dhe shërbimet e komunikimit zanon nuk mund të sigurohen në rrethana normale tregtare ose përmes mjeteve të tjera të mundshme të politikës publike në territorin e tij kombëtar, ose pjesë të ndryshme të tij, ai mund të imponojë detyrime të duhura të shërbimit universal për të përmbushur të gjitha kërkesat e arsyeshme nga përdoruesit fundorë për të hyrë në ato shërbime në pjesët përkatëse të territorit të tij.</p> | | Neni 113 | <p style="text-align: center;">Neni 113 Disponueshmëria e shërbimit universal</p> <p>1. Kur AKEP-i, bazuar në rezultatet e vrojtimit gjeografik të kryer në përputhje me pikën 1, të nenit 43, të këtij ligji kur ato janë të disponueshme, si dhe bazuar në çdo të dhënë shtesë të nevojshme, provon që disponueshmëria e një shërbimi të përshtatshëm aksesit në internet broadband dhe shërbimet e komunikimit zanon nga vendndodhje fikse, siç përcaktohen në nenin 110, të këtij ligji, nuk mund të sigurohen në kushte normale të tregut ose nëpërmjet mjeteve të tjera të mundshme të politikave publike të disponueshme në Republikën e Shqipërisë ose pjesë të ndryshme të saj, AKEP-i vendos detyrimet e duhura të shërbimit universal, për të përmbushur të gjitha kërkesat e arsyeshme të përdoruesve fundorë për</p> | F |

| | | | | | | |
|--------|---|--|----------|---|---|--|
| | <p>2. Shtetet Anëtare përcaktojnë qasjen më efektive dhe të përshtatshme për të siguruar disponueshmërinë në një vend të caktuar të një shërbimi adekuat të aksesit në internet, siç përcaktohet në nenin 84 (3) dhe të shërbimeve të komunikimit zanor, duke respektuar parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. Shtetet Anëtare do të kërkojnë të minimizojnë shtrembërimet e tregut, veçanërisht ofrimin e shërbimeve me çmime ose t'u nënshtrohen termave dhe kushteve të tjera që largohen nga kushtet normale tregtare, ndërsa mbrojnë interesin publik.</p> <p>3. Kur Shtetet Anëtare vendosin të imponojnë detyrime për të siguruar për përdoruesit fundorë disponueshmërinë në një vend të caktuar të një shërbimi adekuat të aksesit në internet, siç përcaktohet në përputhje me nenin 84 (3) dhe të shërbimeve të komunikimit zanor, ata mund të përcaktojnë një ose më shumë ndërmarrje, për të garantuar një disponueshmëri të tillë në të gjithë territorin kombëtar. Shtetet Anëtare mund të caktojnë ndërmarrje të ndryshme ose grupe ndërmarrjesh për të siguruar një shërbim adekuat të aksesit në internet dhe shërbime të komunikimit zanor në një vend të caktuar ose për të mbuluar pjesë të ndryshme të territorit kombëtar.</p> <p>4. Kur Shtetet Anëtare caktojnë ndërmarrje pjesërisht ose në të gjithë territorin kombëtar për të siguruar disponueshmërinë e shërbimeve në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ata përdorin një mekanizëm të efektshëm, objektiv, transparent dhe jo-diskriminues, me të cilin asnjë ndërmarrje nuk përjashtohet nga përcaktimi. Metoda të tilla të përcaktimit sigurojnë që një shërbim adekuat i aksesit në internet dhe shërbimet e komunikimit zanor në një lokacion fikse, ofrohen në një mënyrë me kosto efektive dhe mund të përdoren si një mjet për të përcaktuar koston neto të detyrimeve të shërbimit universal, në përputhje me nenin 89 .</p> <p>5. Kur një ndërmarrje e caktuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ka ndërmend të disponojë një pjesë të konsiderueshme ose të gjitha pasuritë e saj të rrjetit lokal të aksesit në një subjekt juridik të veçantë, nën pronësi të ndryshme, ai informon paraprakisht autoritetin rregullator kombëtar ose autoritetin tjetër kompetent në kohën e duhur, në mënyrë që t'i lejojë këtij autoriteti të vlerësojë efektin e transaksionit të synuar përsigurimin në një lokacion fikse të një shërbimi adekuat të aksesit në internet, siç përcaktohet në nenin 84 (3) dhe të shërbimeve të komunikimit zanor. Autoriteti rregullator kombëtar ose autoriteti tjetër kompetent mund të vendosë, ndryshojë ose tërheqë detyrime specifike në përputhje me nenin 13 (2).</p> | | | <p>akses në këto shërbime në pjesët përkatëse të territorit të tij.</p> <p>2. AKEP-i përcakton mënyrën më efektive dhe më të përshtatshme për të siguruar disponueshmërinë e një shërbimi të përshtatshëm aksesit në internet broadband dhe shërbimet e komunikimit zanor nga vendndodhje fikse, siç përcaktohet në përputhje me nenin 110, të këtij ligji, duke respektuar parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. AKEP-i do të përpiqet që të minimizojë shtrembërimet e tregut, veçanërisht ofrimin e shërbimeve me çmime ose me kushte të tjera që dalin nga kushtet normale tregtare, duke ruajtur njëkohësisht interesin publik.</p> <p>3. Kur AKEP përcakton një ose disa sipërmarrës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në pjesë të tij, për të siguruar disponueshmërinë e shërbimeve, ai duhet të përdorë një mekanizëm përcaktimi efikas, objektiv, transparent dhe mosdiskriminues, ku asnjë sipërmarrës nuk përjashtohet paraprakisht nga përcaktimi. Metoda të tilla përcaktimi, duhet të sigurojnë që shërbimi i përshtatshëm i aksesit në internet broadband dhe shërbimet e komunikimit zanor nga vendndodhje fikse, të ofrohen me kosto efektive dhe procesi mund të përdoret si një mjet për përcaktimin e koston neto të detyrimit të shërbimit universal, në përputhje me nenin 127, të këtij ligji. Rregullat për përzgjedhjen e ofruesve të shërbimit universal, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> | | |
| Neni87 | <p align="center">Neni 87 Statusi i shërbimit ekzistues universal</p> <p>Shtetet Anëtare mund të vazhdojnë të sigurojnë disponueshmërinë ose përbalueshmërinë e shërbimeve të tjera dhe shërbimin adekuat të aksesit broadband në internet, siç përcaktohet në përputhje me nenin 84 (3) dhe shërbimet e komunikimit zanor në</p> | | Neni 114 | <p align="center">Neni 114 Statusi i shërbimeve universale ekzistuese</p> <p>1. AKEP mund të vijojë të sigurojë disponueshmërinë ose përbalueshmërinë e shërbimeve të tjera, të ndryshme nga shërbimi i përshtatshëm i aksesit broadband, siç përcaktohet në përputhje me nenin 110, të këtij ligji, dhe</p> | F | |

| | | | | | |
|---------------|--|--|----------|--|---|
| | <p>një lokacion fiks që ishte në fuqi më 20 dhjetor 2018, nëse nevoja për shërbime të tilla përcaktohet në dritën e rrethanave kombëtare. Kur Shtetet Anëtare caktojnë ndërmarrje pjesërisht ose në të gjithë territorin kombëtar për ofrimin e këtyre shërbimeve, do të zbatohet neni 86. Financimi i këtyre detyrimeve duhet të jetë në përputhje me nenin 90.</p> <p>Shtetet Anëtare do të rishikojnë detyrimet e vendosura në bazë të këtij neni ,deri më 21 dhjetor 2021, dhe çdo tre vjet pas kësaj.</p> | | | <p>shërbimet e komunikimit zazor nga vendndodhje fikse që kanë qenë në fuqi me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëse nevoja për shërbime të tilla është e justifikuar në kushtet kombëtare. Kur AKEP përcakton një ose disa sipërmarrës në të gjithë territorin vendit ose në pjesë të tij, për ofrimin e këtyre shërbimeve, atëherë zbatohen përcaktimet e neni 113, të këtij ligji. Financimi i këtyre detyrimeve do të jetë në përputhje me nenin 128, të këtij ligji.</p> <p>2. AKEP rishikon detyrimet e vendosura në bazë të këtij neni, brenda tre vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe më pas çdo tre vjet.</p> | |
| Neni88 | <p style="text-align: center;">Neni 88 Kontrolli i shpenzimeve</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që, në ofrimin e faciliteteve dhe shërbimeve shtesë për ato të përmendura në nenin 84, ofruesit e një shërbimi adekuat të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit zazor, në përputhje me nenet 84 deri 87, vendosin terma dhe kushte në atë mënyrë që përdoruesi fundor nuk është i detyruar të paguajë për facilitetet ose shërbimet, të cilat nuk janë të nevojshme ose nuk kërkohen për shërbimin e kërkuar.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e një shërbimi adekuat të aksesit në broadband internet dhe shërbimeve të komunikimit zazor të përmendura në nenin 84, që ofrojnë shërbime, në përputhje me nenin 85, ofrojnë facilitete dhe shërbime specifike të përcaktuara në Pjesën A të Shtojcës VI, si të zbatueshme, në mënyrë që konsumatorët të mund të monitorojnë dhe kontrollojnë shpenzimet. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e tillë të krijojnë një sistem për të shmangur shkëputjen e paarsyeshme të shërbimeve të komunikimit zazor ose të një shërbimi adekuat të aksesit në internet broadband, në lidhje me konsumatorët, siç përmendet në nenin 85, duke përfshirë një mekanizëm të duhur për të kontrolluar interesin e vazhdueshëm për përdorimin e shërbimit.</p> <p>Shtetet Anëtare mund të zgjerojnë fushën e zbatimit të këtij paragrafi tek përdoruesit fundorë që janë ndërmarrjet mikro dhe ndërmarrje të vogla, të mesme si dhe organizata jofitimprurëse.</p> <p>3. Çdo Shtet Anëtar siguron që autoriteti kompetent të jetë në gjendje të heqë dorë nga kërkesat e paragrafit 2 në të gjithë ose një pjesë të territorit të tij kombëtar, nëse autoriteti kompetent është i bindur që objekti është i disponueshëm.</p> | | Neni 115 | <p style="text-align: center;">Neni 115 Kontrolli i shpenzimeve</p> <p>1. AKEP siguron që gjatë ofrimit të faciliteteve apo shërbimeve shtesë përtej atyre të përcaktuara në nenin 110 të këtij ligji, ofruesit e shërbimeve të aksesit të përshtatshëm në internet broadband dhe të shërbimeve të komunikimit zazor, që ofrohen në përputhje me nenin 110 deri në 113, të këtij ligji, nuk i vendosin përdoruesit fundor terma dhe kushte të tilla që të jetë i detyruar të paguajë për lehtësirat ose shërbimet që nuk janë të nevojshme ose nuk nevojiten për shërbimin e kërkuar.</p> <p>2. AKEP-i siguron që ofruesit e shërbimeve sipas pikës 1 të këtij neni:</p> <p>a) ofrojnë facilitetet dhe shërbimet specifike të përcaktuara në nenin 116 e në vijim të këtij ligji, në mënyrë që konsumatorët të kenë mundësi të monitorojnë dhe kontrollojnë shpenzimet e tyre;</p> <p>b) të kenë një sistem të brendshëm për të shmangur ndërprerjen e pajustificuar të shërbimeve të komunikimit zazor ose të një shërbimi të përshtatshëm të aksesit në internet broadband për konsumatorët, sipas përcaktimeve në nenin 116, të këtij ligji, përfshirë një mekanizëm të përshtatshëm për të kontrolluar vijueshmërinë e interesit për përdorimin e shërbimit.</p> <p>3. Nëse AKEP, është i kënaqur me shkallën e lartë të disponueshmërisë në kushte normale të tregut të faciliteteve të referuara në pikën 2, të këtij neni, AKEP mund të heqë këto detyrime në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> | F |

| | | | | | | |
|----------------------|---|--|-----------------|--|----------|--|
| <p>Neni89</p> | <p style="text-align: center;">Neni 89</p> <p style="text-align: center;">Kostoja e detyrimeve të shërbimit universal</p> <p>1. Kur autoritetet rregullatore kombëtare konsiderojnë se sigurimi i një shërbimi adekuat të aksesit në internet broadband, siç përcaktohet në përputhje me nenin 84 (3) dhe të shërbimeve të komunikimit zonor, siç përcaktohen në nenet 84, 85 dhe 86 ose vazhdimin e shërbimit ekzistues universal siç përcaktohet në nenin 87, mund të përfaqësojë një barrë të padrejtë për ofruesit e shërbimeve të tilla që kërkojnë kompensim, autoritetet rregullatore kombëtare do të llogaritin kostot neto të kësaj dispozite.</p> <p>Për këtë qëllim, autoritetet kombëtare rregullatore do të:</p> <p>(a) llogarisin koston neto të detyrimeve të shërbimit universal, duke marrë parasysh çdo përfitim të tregut që i krijon një ofruesi të një shërbimi adekuat të aksesit në internet broadband, siç përcaktohet në nenin 84 (3) dhe shërbimet e komunikimit zonor, siç përcaktohen në Artikuj 84, 85 dhe 86 ose vazhdimi i shërbimit ekzistues universal siç përcaktohet në nenin 87, në përputhje me Shtojcën VII; ose</p> <p>(b) do të përdorin kostot neto të ofrimit të një shërbimi universal të identifikuar nga një mekanizëm përcaktimi, në përputhje me nenin 86 (4).</p> <p>2. Llogaritë dhe informacionet e tjera që shërbejnë si bazë për llogaritjen e kostos neto të detyrimeve të shërbimit universal, nën pikën (a) të nënparagrafit të dytë të paragrafit 1, do të kontrollohen ose verifikohen nga autoriteti kombëtar rregullator, ose një organ i pavarur nga palët përkatëse dhe do të aprovohen nga autoriteti rregullator kombëtar. Rezultatet e llogaritjes së kostos dhe konkluzionet e auditimit do të vihen në dispozicion të publikut.</p> | | <p>Neni 127</p> | <p style="text-align: center;">Neni 127</p> <p style="text-align: center;">Kostoja e detyrimeve të shërbimit universal</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ofruesit e shërbimeve universale kanë të drejtë të kërkojnë kompensim, nëse ofrimi i shërbimit aksesit në internet broadband, i përkufizuar në përputhje me nenin 110, të këtij ligji dhe i shërbimeve të komunikimit zonor sipas përcaktimeve në nenet 110, 112 dhe 113, të këtij ligji, ose vazhdimi i ofrimit të shërbimeve ekzistuese universale sipas nenit 114, të këtij ligji, përbën një barrë të padrejtë dhe krijon kosto shtesë për ofruesin. Kur AKEP-i vlerëson se ofrimi i këtyre shërbimeve, përbën një barrë të padrejtë për ofruesit e shërbimeve që kërkojnë kompensim, AKEP do të llogarisë kostot neto të ofrimit të këtyre shërbimeve. 2. Kompensimi sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mund të kalojë në asnjë rrethanë koston neto për ofrimin e shërbimit universal. 3. Kostot neto sipas pikës 2, të këtij neni, llogariten në përputhje me nenin 129, të këtij ligji. Kostot neto llogariten si diferencë ndërmjet kostove neto për ofrimin e shërbimit universal dhe kostove që ofruesi i shërbimit universal do të kishte pasur, nëse ai nuk do ishte ofrues i shërbimit universal dhe në këtë llogaritje merret parasysh çdo përfitim, përfshirë ato jo materiale, i ofruesit të shërbimit universal që rrjedh nga ofrimi i shërbimit universal. 4. AKEP-i përcakton metodologjinë për llogaritjen e kostove neto dhe përfitimeve jomateriale që duhet të merren në konsideratë, në llogaritjen e kostove neto të ofrimit të shërbimit universal, duke marrë parasysh rekomandimin e BE-së për shërbimin universal. 5. Ofruesit e shërbimeve universale, janë të detyruar të mbajnë llogari të ndara për kostot e ofrimit të shërbimit universal. 6. Ofruesit e shërbimit universal, janë të detyruar të paraqesin në AKEP, brenda datës 30 prill të çdo viti, informacionin për kostot neto, bilancin vjetor dhe të dhënat e përdorura për llogaritjen e kostove neto për ofrimin e shërbimit universal. Në të kundërt, ata do të humbasin të drejtën e deklaramit të kostove neto. 7. AKEP-i cakton një ekspertizë të pavarur auditimi për kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e informacionit të paraqitur sipas pikës 6, të këtij neni. 8. AKEP-i konfirmon llogaritjen e kostove neto për ofrimin e shërbimit universal. Nëse ofruesi i shërbimit universal është përzgjedhur nëpërmjet një procedure tenderi publik, AKEP-i në vlerësimin e tij, merr parasysh dhe kostot e ofrimit të shërbimit universal të paraqitura nga ofruesi në procesin e tenderit. AKEP-i merr në | <p>F</p> | |
|----------------------|---|--|-----------------|--|----------|--|

| | | | | | | |
|---------------|--|--|----------|--|---|--|
| | | | | <p>konsideratë diferencat në kosto, vetëm në rastet kur kushtet në momentin e zhvillimit të tenderit publik kanë ndryshuar dhe kur ofruesi i shërbimit universal, i provon AKEP-it në mënyrë bindëse, objektive dhe transparente diferencat në kosto. AKEP-i publikon rezultatet e llogaritjes së kostove dhe ato të auditimit, të kryer për informacionin e paraqitur nga ofruesi i shërbimit universal.</p> <p>9. AKEP-i përcakton shkallën e kompensimit. Bazuar në llogaritjet e kryera, AKEP-i mund të vendosë që ofruesi i shërbimit universal të mos gëzojë të drejtën e kompensimit, ose të vendosë për një kompensim më të vogël nga ai i kërkuar nga ofruesi.</p> <p>10. Ofruesi i shërbimit universal ka të drejtë të ankimojë vendimin e marrë sipas pikës 9, të këtij neni, sipas legjislacionit në fuqi.</p> | | |
| Neni90 | <p style="text-align: center;">Neni 90 Financimi i detyrimeve të shërbimit universal</p> <p>1. Kur, në bazë të llogaritjes së kostos neto të përmendur në nenin 89, autoritetet rregullatore kombëtare zbulojnë se një ofrues bëhet subjekt i një ngarkese të padrejtë, Shtetet Anëtare, me kërkesë të ofruesit të interesuar, vendosin të konkludojnë me njerën ose të dyja pikat në vijim: (a) të prezantojnë një mekanizëm për të kompensuar atë ofrues për kostot neto të përcaktuara nën kushte transparente nga fondet publike; (b) të ndajnë koston neto të detyrimeve të shërbimit universal midis ofruesve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve.</p> <p>2. Kur kostoja neto ndahet në përputhje me pikën (b) të paragrafit 1 të këtij neni, Shtetet Anëtare krijojnë një mekanizëm ndarjeje të administruar nga autoriteti kombëtar rregullator ose një organ i pavarur nga përfituesit nën mbikëqyrjen e autoritetit rregullator kombëtar. Vetëm kostoja neto, siç përcaktohet në përputhje me nenin 89, të detyrimeve të përcaktuara në nenin 84 deri 87 mund të financohet.</p> <p>Mekanizmi i ndarjes do të respektojë parimet e transparencës, deformimit më të vogël të tregut, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetin, në përputhje me parimet e përcaktuara në Pjesën B të Shtojcës VII. Shtetet Anëtare mund të zgjedhin të mos kërkojnë kontribute nga ndërmarrjet, qarkullimi kombëtar i të cilave është më pak se një kufi i caktuar.</p> <p>Çdo tarifë në lidhje me ndarjen e kostos së detyrimeve të shërbimit universal do të ndahet dhe identifikohet veçmas për secilin ndërmarrje. Këto tarifa nuk do të vendosen, ose të mbliidhen nga ndërmarrjet që nuk ofrojnë shërbime në territorin e Shtetit Anëtar që kanë krijuar mekanizmin e ndarjes.</p> | | Neni 128 | <p style="text-align: center;">Neni 128 Financimi i detyrimeve të shërbimit universal</p> <p>1. Në rastet kur AKEP, bazuar në llogaritjet e kostove neto sipas nenit 127, të këtij ligji, konstaton se kostot neto përbëjnë një barrë të padrejtë për ofruesin, AKEP-i krijon fondin e shërbimit universal për kompensimin e kostove neto të ofrimit të shërbimit universal. Fondi i shërbimit universal menaxhohet dhe administrohet nga AKEP. Ky fond është i paprekshëm për qëllime të tjera dhe pjesa e papërdorur akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës.</p> <p>2. Fondi i shërbimit universal financohet nga sipërmarrësit që zotërojnë rrjete të komunikimeve elektronike publike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, si dhe nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publikë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të AKEP-it. Financimi i Shërbimit Universal, do të bëhet në një mënyrë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale dhe financimi duhet të rezultojë në shtrembërim sa më të vogël të konkurrencës dhe kërkesës së përdoruesve.</p> <p>3. AKEP përcakton kuotën e financimit në bazë të pikës 2, të këtij neni, e cila, për të gjithë sipërmarrësit që kanë detyrim të paguajnë për financimin e shërbimit universal, nuk duhet të jetë më e lartë se 1% e totalit të të ardhurave të siguruara nga rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.</p> <p>4. Sipërmarrësit janë të detyruar të paguajnë kontributet, sipas pikës 2, të këtij neni, në një llogari të veçantë të</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|----------|--|---|--|
| | | | | <p>AKEP-it, brenda një periudhe të caktuar, por jo më vonë se data 30 maj e vitit aktual për vitin paraardhës.</p> <p>5. Operatorët, brenda datës 30 prill të çdo viti, informojnë AKEP-in për të ardhurat e tyre në vitin paraardhës, të siguruar nga ofrimi i rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve publike në Republikën e Shqipërisë, duke depozituar në AKEP bilancin vjetor të shoqëruar me raportin e ekspertit kontabël.</p> <p>6. AKEP-i do të kryejë disbursimet nga llogaria e kontributeve të shërbimit universal në bazë vjetore, për të kompensuar çdo ofrues të shërbimit universal, të caktuar për ofrimin e shërbimit universal, në vlera të barabarta me kostot neto të miratuara për sigurimin e shërbimit universal.</p> | | |
| Neni91 | <p style="text-align: center;">Neni 91 Transparenca</p> <p>1. Kur kostoja neto e detyrimeve të shërbimit universal do të llogaritet në përputhje me nenin 89, autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që parimet për llogaritjen e kostos neto, përfshirë detajet e metodologjisë që do të përdoren të vihen në dispozicion të publikut.</p> <p>Kur është krijuar një mekanizëm për ndarjen e kostos neto të detyrimeve të shërbimit universal, siç përmendet në nenin 90 (2), autoritetet rregullatore kombëtare sigurojnë që parimet për ndarjen e kostove dhe kompensimin e kostos neto të jenë publike.</p> <p>2. Duke iu nënshtruar rregullave të Bashkimit Evropian mbi konfidencialitetin tregtar, autoritetet rregullatore kombëtare do të publikojnë një raport vjetor që jep detajet e kostos së llogaritur të detyrimeve të shërbimit universal, duke identifikuar kontributet e bëra nga të gjitha ndërmarrjet e përfshira, përfshirë çdo përfitim të tregut që mund të ketë akorduar në ndërmarrjet në përputhje me detyrimet e shërbimit universal të përcaktuara në nenin 84 deri 87.</p> | | Neni 129 | <p style="text-align: center;">Neni 129 Llogaritja dhe mbulimi i kostove të shërbimit universal</p> <p>1. AKEP-i merr në konsideratë të gjitha mjetet për të siguruar stimuj të përshtatshëm për sipërmarrësit, për të ofruar detyrimet e shërbimit universal me kosto eficiente. Kostoja neto e detyrimeve të shërbimit universal, llogaritet si diferencë midis kostos neto për çdo sipërmarrës që operon në kushtet e detyrimeve të shërbimit universal dhe operimit pa detyrime të shërbimit universal. Llogaritja e kostove neto, merr parasysh kostot që çdo sipërmarrës do të kishte zgjedhur të shmangte, nëse nuk do të kishte detyrimin e ofrimit të shërbimit universal. Llogaritja e kostos neto do të vlerësojë përfitimet, përfshirë përfitimet jomateriale, për operatorin e shërbimit universal.</p> <p>2. Llogaritja duhet të bazohet në kostot që i atribuohen:</p> <p>a) elementeve të shërbimeve të identifikuar, që mund të ofrohen vetëm me humbje ose që mund të ofrohen me kosto që nuk do të ishin kryer në kushte normale tregtare të ofrimit të shërbimeve.</p> <p>b) përdoruesve fundorë ose grupeve të përdoruesve fundorë të veçantë, të cilët, duke marrë parasysh koston e ofrimit të rrjetit dhe shërbimit të specifikuar, të ardhurat e krijuara dhe çdo mesatare gjeografike të çmimeve të vendosura nga shteti anëtar, mund të ofrohen vetëm me humbje, ose me kosto që nuk do të ishin kryer në kushte normale tregtare të ofrimit të shërbimeve.</p> <p>3. Në elementët e parashikuar në gjurmën a) të pikës 2, të këtij neni, mund të përfshihen elementë të shërbimit, si aksesit në shërbimet telefonike drejt numrave të emergjencës, ofrimi i telefonave të caktuar publikë me pagesë, ofrimi i shërbimeve ose pajisjeve të caktuara për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.</p> | F | |

| | | | | | | |
|----------------|---|--|-----------------|---|---|--|
| | | | | <p>4. Në përcaktimet e gërmës b) të pikës 2, të këtij neni, përfshihen ata përdorues fundorë, ose grupe përdoruesish fundorë, të cilët nuk do mund të merren shërbim nga një operator në kushte normale tregtare, që nuk ka detyrimin për të ofruar shërbim universal.</p> <p>5. Llogaritja e kostos neto të aspekteve të veçanta të detyrimeve të shërbimit universal, duhet të bëhet veçmas dhe në mënyrë të tillë që të shmanget llogaritja e dyfishtë e çdo përfitimi dhe kostoje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kostoja e përgjithshme neto e detyrimeve të shërbimit universal, për çdo sipërmarrës, duhet të llogaritet si shuma e kostove neto që rrjedhin nga elementët e veçantë të detyrimeve të shërbimit universal, duke marrë parasysh çdo përfitim jo-material. Përgjegjësia për verifikimin e kostos neto i takon autoritetit rregullator kombëtar.</p> <p>6. Mbulimi ose financimi i çdo lloj kostoje neto të detyrimeve të shërbimit universal, mund të nxjerrë të nevojshme kompensimin e sipërmarrësve me detyrime të shërbimit universal për shërbimet që ata ofrojnë në kushte jonormale tregtare. AKEP siguron që kompensimi të kryhet në mënyrë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale dhe të rezultojë në sa më pak shtrembërim të konkurrencës dhe kërkesës së përdoruesve.</p> <p>7. Në përputhje me pikën 3, të nenit 128, të këtij ligji, mekanizmi i financimit të përbashkët të kostove i bazuar në një fond, duhet të përdorë metoda transparente dhe neutrale për mbledhjen e kontributeve, të cilat shmangin rezikun e vendosjes së detyrimit të dyfishtë për kontribut, të llogaritur bazuar si në të ardhurat, ashtu edhe në shpenzimet e sipërmarrësve.</p> <p>8. AKEP në përputhje me nenin 19, të këtij ligji, është përgjegjës për mbledhjen e kontributeve nga sipërmarrësit, të cilët vlerësohen se kanë detyrimin për të kontribuar në koston neto të detyrimeve të shërbimit universal si dhe të mbikqyrë transferimin e shumës përkatëse ose nga pagesat administrative tek sipërmarrësit që kanë të drejtë të kompensohen nga fondi.</p> | | |
| Neni 92 | <p align="center">Neni 92 Shërbime plotësuese të detyrueshme</p> <p>Shtetet Anëtare, mund të vendosin t'i bëjnë shërbimet plotësuese të përfshira në detyrimet e shërbimit universal të përmendura në nenet 84 deri 87, të disponueshme për publikun në territoret e tyre. Në raste të tilla, nuk do të vendoset asnjë mekanizëm kompensimi që përfshin sipërmarrje të veçanta.</p> | | Neni 130 | <p align="center">Neni 130 Shërbime shtesë të detyrueshme</p> <p>Përveç shërbimeve që përfshihen në detyrimet e shërbimit universal të referuara në nenet 110 deri në 113, të këtij ligji, AKEP mund të vendosë që të sigurojë disponueshmërinë publike të shërbimeve të tjera shtesë. Në raste të tilla, ndaj sipërmarrësve, nuk do të vendoset asnjë detyrim për të kontribuar për mekanizmin e kompensimit, sipas Shërbimit Universal, për sipërmarrës të vecantë.</p> | F | |

| | | | | | |
|---------------|---|-----------------|---|----------|--|
| <p>Neni93</p> | <p align="center">PJESA III – TITULLI II Burimet e numeracionit</p> <p align="center">Neni 93 Burimet e numeracionit</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, të kontrollojnë dhënien e të drejtave të përdorimit për të gjitha burimet e numeracionit kombëtar dhe menaxhimin e planeve kombëtare të numeracionit dhe që ato të sigurojnë burime adekuate të numeracionit për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut. Shtetet Anëtare sigurojnë që të vendosen procedura objektive, transparente dhe jo-diskriminuese për dhënien e të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit kombëtar.</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente gjithashtu mund të japin të drejta të përdorimit për burimet e numeracionit nga planet kombëtare të numrave për ofrimin e shërbimeve specifike për sipërmarrje të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, me kusht që burimet e përshtatshme të numeracionit të jenë në dispozicion për të kënaqur kërkesa aktuale dhe të parashikueshme në të ardhmen. Këto sipërmarrje do të demonstrojnë aftësinë e tyre për të menaxhuar burimet e numeracionit dhe për të përmbushur kërkesat përkatëse të përcaktuara në bazë të nenit 94. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente mund të pezullojnë dhënien e mëtejshme të të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit të sipërmarrjeve të tilla, nëse demonstron se ekziston rreziku i ezaurimit të burimeve të numeracionit.</p> <p>Deri më 21 qershor 2020, për të kontribuar në zbatimin e vazhdueshëm të këtij paragrafi, BEREC do të miratojë, pas konsultimit me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, udhëzime për kriteret e zakonshme për vlerësimin e aftësisë për të menaxhuar burimet e numeracionit dhe të rrezikut të shterimit të burimeve të numeracionit.</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, sigurojnë që planet dhe procedurat kombëtare të numërimit, të zbatohen në atë mënyrë që të japin trajtim të barabartë për të gjithë ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut dhe ndërmarrjeve të ligjshme në përputhje me paragrafin 2. Në veçanti, Shtetet Anëtare sigurojnë që një ndërmarrje, së cilës i është dhënë e drejta e përdorimit për burimet e numeracionit, nuk bën diskriminim ndaj ofruesve të tjerë të shërbimeve të komunikimit elektronik, në lidhje me burimet e numeracionit, të përdorura për t'u dhënë akses shërbimeve të tyre.</p> <p>4. Secili Shtet Anëtar siguron që autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritete të tjera kompetente të vënë në</p> | <p>Neni 131</p> | <p align="center">KREU XVII BURIMET E NUMERACIONIT</p> <p align="center">Neni 131 Burimet e numeracionit</p> <p>1. AKEP-i siguron burime të përshtatshme numerike për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, sipas planit të numeracionit. Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.</p> <p>2. Bazuar në planin kombëtar të numeracionit, AKEP-i jep të drejta përdorimi për burimet e numeracionit për ofrimin e shërbimeve specifike, për sipërmarrje të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike, me kusht që burimet numerike të përshtatshme të disponueshme të përmbushin kërkesat aktuale dhe të parashikuara në të ardhmen.</p> <p>3. Sipërmarrjet e ndryshme nga ofruesit e rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike, në kërkesën për burime numeracioni, demonstrojnë aftësinë e tyre për të administruar burimet e numeracionit dhe për të përmbushur çdo kërkesë të përcaktuar në nenin 132, të këtij ligji.</p> <p>4. Në dhënien e të drejtave për përdorimin e burimeve të numeracionit AKEP-i, i përmbahet udhëzimeve të BEREC mbi kriteret e përbashkëta për vlerësimin e aftësisë për të menaxhuar burimet numerike nga sipërmarrje të ndryshme, nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe për vlerësimin e rrezikut të shterimit të burimeve të numeracionit, nëse numrat u janë caktuar sipërmarrjeve të tilla.</p> <p>5. AKEP-i pezullon dhënien e mëtejshme të të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit për sipërmarrjet e ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nëse provohet se ekziston rreziku i shterimit të burimeve të numeracionit.</p> <p>6. AKEP-i administron planin e numeracionit në mënyrë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të sigurojë strukturimin dhe përdorimin eficient të numrave dhe serive numerike; b) të kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji; c) të sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe | <p>F</p> | |
|---------------|---|-----------------|---|----------|--|

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>dispozicion një sërë numrash jo-gjeografikë, të cilat mund të përdoren për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, në të gjithë territorin e Bashkimit Evropian, pa cënuar Rregulloren (BE) Nr. 531/2012 dhe nenin 97 (2) të kësaj direktive. Kur të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit janë dhënë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni ndërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, ky paragraf do të zbatohet për shërbimet specifike për sigurimin e të cilave u janë dhënë të drejtat e përdorimit.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, sigurojnë që kushtet e listuara në Pjesën E të Shtojcës I, që mund t'i bashkohen të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit të përdorura për ofrimin e shërbimeve jashtë kodit të Shtetit Anëtar të vendit, dhe zbatimin e tyre, janë aq të rrepta sa kushtet dhe zbatimi i aplikueshëm për shërbimet e dhëna brenda Shtetit Anëtar të kodit të vendit, në përputhje me këtë Direktivë. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente gjithashtu sigurojnë, në përputhje me nenin 94 (6), që ofruesit që përdorin burimet e numeracionit të kodit të vendit të tyre në shtetet e tjera anëtare, respektojnë mbrojtjen e konsumatorit dhe rregullat e tjera kombëtare, që lidhen me përdorimin e burimeve të numeracionit, të zbatueshme në ato Shtete Anëtare ku përdoren burimet e numeracionit. Ky detyrim nuk cenon fuqitë zbatuese të autoriteteve kompetente të atyre Shteteve Anëtare.</p> <p>BEREC do të ndihmojë autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, me kërkesën e tyre, në koordinimin e veprimtarive të tyre, për të siguruar një menaxhim efikas të burimeve të numeracionit me të drejtë të përdorimit ekstraterritorial brenda Bashkimit Evropian.</p> <p>Për të lehtësuar monitorimin nga autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritete të tjera kompetente, në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, BEREC do të krijojë një bazë të dhënash për burimet e numeracionit me të drejtën e përdorimit ekstraterritorial brenda Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, do t'i transmetojnë informacionet përkatëse në BEREC. Kur burimet e numeracionit me të drejtën e përdorimit ekstraterritorial brenda Bashkimit Evropian, nuk janë dhënë nga autoriteti rregullator kombëtar, autoriteti kompetent përgjegjës për dhënien ose menaxhimin e tyre këshillohet me autoritetin rregullator kombëtar.</p> <p>5. Shtetet Anëtare sigurojnë që kodi '00 është kodi standard i hyrjes ndërkombëtare. Mund të vendosen ose të vazhdojnë të ekzistojnë, marrëveshje të posaçme për përdorimin e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numër midis vendeve të afërta me njëra-tjetrën, ose Shteteve Anëtare.</p> | | <p>jodiskriminuose, për të gjithë ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe sipërmarrjeve të kualifikuara, në përputhje me pikën 2 dhe 3, të këtij neni.</p> <p>7. AKEP-i siguron që një sipërmarrje, të cilës i është dhënë e drejta e përdorimit për burimet e numeracionit, nuk diskriminon ofruesit e tjerë të shërbimeve të komunikimit elektronik, përsa u përket burimeve të numeracionit të përdorura për të dhënë akses në shërbimet e tyre.</p> <p>8. AKEP-i vë në dispozicion numrat jogjeografikë, që mund të përdoren për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, pa paragjykuar pikën 2 të nenit 135, të këtij ligji. Kur të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit u janë dhënë sipërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, kjo pikë zbatohet dhe për shërbimet specifike për ofrimin e të cilave janë dhënë të drejtat e përdorimit.</p> <p>9. AKEP siguron që kushtet e përdorimit të burimeve të numeracionit, të përcaktuara në nenin 32, të këtij ligji, i bashkëngjiten të drejtës së përdorimit të numrave.</p> <p>10. Mbajtësi i të drejtës së përdorimit të numrave sipas këtij ligji:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) është i detyruar të kthejë numrat e caktuar ose seritë e numrave nëse nuk janë në përdorim; b) nuk mund të përdorë numrin e caktuar apo seritë e numrave për qëllime të ndryshme nga ai për të cilat janë dhënë; c) nuk mund ta transferojë ose japë me qira numrat ose seritë e numrave të caktuara, pa miratimin paraprak të AKEP-it; ç) numrat dhe seritë e numrave të caktuar mund të transferohen, së bashku me aktivitetin e ushtruar, kur mbajtësi i ri përmbush kërkesat për përdorimin e numrave dhe serive numerike në përputhje me vendimin e AKEP-it; d) është i detyruar të bëjë pagesat për numeracionin sipas këtij ligji; dh) duhet të përmbushë kërkesën për transferimin e numeracionit, në të gjitha rastet kur kërkohet një gjë e tillë; f) është i detyruar të përdorë numrat apo seritë e numrave të caktuara vetëm për qëllimin për të cilin i janë dhënë dhe të mos i shkaktojë dëm ndonjë grupi të caktuar përdoruesish; ë) të përmbushë detyrimet, që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--------|---|----------|---|---|--|
| | <p>Shtetet Anëtare mund të bien dakord të ndajnë një plan të përbashkët numërimesh, për të gjitha kategoritë specifike të numrave.</p> <p>Përdoruesit fundorë të prekur nga këto marrëveshje, do të informohen plotësisht.</p> <p>6. Pa cënuar nenin 106, Shtetet Anëtare do të promovojnë over-the-air provisioning (sigurimin jashtë ajrit), kur është teknikisht i mundshëm, për të lehtësuar ndërrimin e ofruesve të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike nga përdoruesit fundorë, në veçanti ofruesit dhe përdoruesit fundorë të shërbimeve machine-to-machine (nga njëra makineri tek tjetra).</p> <p>7. Shtetet Anëtare sigurojnë që planet kombëtare të numrave dhe të gjitha shtesat ose ndryshimet vijuese të publikohen, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të vendosura për shkak të sigurisë kombëtare.</p> <p>8. Shtetet Anëtare do të mbështesin harmonizimin e numrave specifik ose vargjeve (ranges) të numrave brenda Bashkimit Evropian, kur promovojnë funksionimin e tregut të brendshëm dhe zhvillimin e shërbimeve pan-Evropiane. Kur është e nevojshme për të adresuar kërkesën e paplotësuar ndërkufitare ose pan-Evropiane për burimet e numrave, Komisioni, duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, do të miratojë akte zbatuese që harmonizojnë numrat specifikë ose vargjet e numrave. Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> | | | <p>Shqipërisë, për caktimin dhe përdorimin e numrave.</p> <p>11. Numërformimi '00' është kodi standard ndërkombëtar i aksesit. Për përdorimin e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal bazuar në numra, ndërmjet vendndodhjeve gjeografike të afërta midis vendeve e përgjatë kufirit, nënshkruhen marrëveshje të vecanta.</p> <p>12. Për kategori të veçanta numrash, AKEP pas marrjes së mendimit nga ministri, mund të dakordësojë përdorimin e një plani të përbashkët numeracioni me shtetet anëtare të BE-së. Përdoruesit fundorë që preken, informohen përkatësisht për këto rregullime.</p> <p>13. Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe për të siguruar një sasi të kënaqshme numrash, AKEP-i mund të ndryshojë strukturën dhe konfigurimin e numeracionit dhe caktimin e numrave. Në rrethana të tilla, mbajtësi i numrave dhe i serive të numrave, nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim. AKEP-i ndryshon vendimet për ndarjen e numrave dhe serive të numrave, edhe me kërkesë të mbajtësit të tyre, në rastet kur kjo është e mundur. Përdoruesit fundorë të prekur nga këto marrëveshje ose dakordësi, informohen plotësisht.</p> <p>14. Pa paragjykuar nenin 145, të këtij ligji, AKEP kur është teknikisht e mundur dhe për të lehtësuar ndërrimin e ofruesve të rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike nga përdoruesit fundorë, promovon ofrimin përmes ajrit të këtij shërbimi, në veçanti për ndërrimin e ofruesit tek përdoruesit fundorë të shërbimeve makinë me makinë.</p> <p>15. AKEP-i ruan të gjitha të dhënat, që lidhen me administrimin e planit të numeracionit. AKEP-i publikon planin kombëtar të numeracionit dhe të gjitha shtesat ose ndryshimet e mëvonshme në të, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të vendosura për arsye sigurie kombëtare.</p> <p>16. AKEP-i mbështet harmonizimin e numrave ose serive të veçanta të numrave, ku ai promovon si funksionimin e tregut kombëtar, ashtu edhe zhvillimin e shërbimeve pan-evropiane.</p> | |
| Neni94 | <p style="text-align: center;">Neni 94 Procedura për dhënien e të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit</p> <p>1. Kur është e nevojshme të jepen të drejta individuale të përdorimit për burimet numeracionit, autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente u japin të drejta të tilla, sipas kërkesës, çdo sipërmarrjeje për sigurimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të përfshira në një autorizim të përgjithshëm të përmendur në Nenin 12, duke iu nënshtruar nenit 13 dhe pikës (c) të nenit 21 (1), si dhe rregullave</p> | Neni 132 | <p style="text-align: center;">Neni 132 Procedura për dhënien e të drejtës së përdorimit për burimet e numeracionit</p> <p>1. Kur është e nevojshme AKEP-i, me kërkesë të çdo sipërmarrësi për ofrimin e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike sipas autorizimit të përgjithshëm në përputhje me nenin 26, të këtij ligji, subjekt i kushteve të parashikuara në nenin 28, dhe germën c) të pikës 1, të nenit 42, të këtij ligji si dhe rregullave për përdorimin efikas të numeracionit në</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>të tjera që sigurojnë përdorimin efikas të burimeve të numeracionit në përputhje me këtë Direktivë.</p> <p>2. Të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit jepen përmes procedurave të hapura, objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale.</p> <p>Gjatë dhënies së të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit, autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente duhet të specifikojnë nëse ato të drejta mund të transferohen nga mbajtësi i të drejtave, dhe në cilat kushte.</p> <p>Kur autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, japin të drejta të përdorimit për burimet e numeracionit, për një periudhë të kufizuar, kohëzgjatja e kësaj periudhe do të jetë e përshtatshme për shërbimin në fjalë, me qëllim të objektivit të ndjekur, duke marrë parasysh nevojën për të lejuar një periudhë të përshtatshme për amortizimin e investimeve.</p> <p>3. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, marrin vendime për dhënien e të drejtave të përdorimit për burimet e numeracionit, sa më shpejt të jetë e mundur, pas marrjes së kërkesës së plotë dhe brenda tre javësh në rastin e burimeve të numeracionit që janë alokuar për qëllime specifike, brenda planit kombëtar të numërimit. Vendimet e tilla do të bëhen publike.</p> <p>4. Kur autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente kanë përcaktuar, pas konsultimit me palët e interesuara, në përputhje me nenin 23, se të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionitme vlerë të jashtëzakonshme ekonomike, duhet të jepen përmes procedurave konkurruese ose krahasuese të përzgjedhjes, autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente mund të zgjasin periudhën tre javore nga paragrafi 3 i këtij neni deri në tre javë të tjera.</p> <p>5. Autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente nuk e kufizojnë numrin e të drejtave individuale të përdorimit që duhen dhënë, përveç kur kjo është e nevojshme për të siguruar përdorimin efikas të burimeve të numeracionit.</p> <p>6. Kur të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit, përfshijnë përdorimin e tyreekstraterritorialnë Bashkimin Evropian, në përputhje me nenin 93 (4), autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente do t'u bashkangjiten këtyre të drejtave të përdorimit të kushteve specifike, për të siguruar pajtueshmërinë me të gjitha rregullat përkatese të mbrojtjes së konsumatorit kombëtar dhe ligjit kombëtar, që lidhen me përdorimin e burimeve të numeracionit të zbatueshëm në Shtetet Anëtare, ku përdoren burimet e numeracionit.</p> <p>Me kërkesë të autoriteteve rregullatore kombëtare ose autoriteteve të tjera kompetente të një Shteti Anëtar ku përdoren burimet e numeracionit, duke demonstruar një shkelje të rregullave përkatëse të mbrojtjes së konsumatorit ose ligjeve kombëtare që lidhen me përdorimin e burimeve të numeracionit të këtij Shteti Anëtar, autoriteteve rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera</p> | | <p>përputhje me këtë ligj, jep të drejtat individuale të përdorimit, duke përcaktuar nëse këto burime të numeracionit mund të transferohen, dhe në cilat kushte.</p> <p>2. Të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit, jepen përmes procedurave të hapura, objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale. AKEP-i vendos për këto aplikime brenda tre javësh. Vendimet e AKEP për të drejtat e përdorimit të numeracionit publikohen.</p> <p>3. Aplikimet për burimet e numeracionit përmbajnë të dhënat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> emrin, adresën e selisë dhe dokumentet që bëjnë të verifikojnë regjistrimin e aktivitetit; të dhënat për llojin, sasinë dhe qëllimin e përdorimit të numrave të caktuar ose serive të numrave për të cilët aplikohen; planin e vlerësimit të nevojave për 3 vitet e ardhshme; datën e planifikuar të fillimit të përdorimit të numrave të caktuar ose serive të numrave; të dhëna shtesë që mund të kërkojë AKEP për të administruar përdorimin e numrave. <p>4. AKEP-i përcakton në mënyrë të detajuar, nëpërmjet një dokumenti rregullator, përmbajtjen dhe formularin model të aplikimit, si dhe kërkesat që duhet të plotësojë aplikanti.</p> <p>5. AKEP-i vendos të refuzojë ndarjen e numrave në rast se:</p> <ol style="list-style-type: none"> aplikimi për ndarjen e numrave përmban të dhëna të rreme; aplikanti nuk është i përshtatshëm për dhënien e numrave ose serive të numrave, në përputhje me këtë ligj; përdorimi i synuar nuk justifikon dhënien e sasisë ose llojin e numrave të kërkuar; aplikanti ka fatura të papaguara për përdorimin e burimeve të numeracionit; aplikanti ka keqpërdorur burimet e numeracionit në të kaluarën. <p>Sipërmarrjet kanë të drejtë të përcaktojnë numrat ose seritë e numrave, për përdoruesit e tyre fundorë, brenda numeracionit të caktuar nga AKEP.</p> <p>Kur AKEP-i, jep të drejta përdorimi për burimet e numeracionit për një periudhë të kufizuar, kohëzgjatja e kësaj periudhe, duhet të jetë e përshtatshme për shërbimin që ka lidhje në funksion të objektivit të ndjekur, duke marrë parasysh nevojën për ta lejuar për një periudhë të përshtatshme për amortizimin e investimit.</p> <p>6. Kur AKEP-i ka përcaktuar, pas konsultimit me palët e interesuara, në përputhje me nenin 44, të këtij ligji, se të drejtat e përdorimit për burimin e numeracionit me vlerë</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------------|---|--|----------|--|---|--|
| | <p>kompetente të Shtetit Anëtar, ku janë dhënë të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit, zbatojnë kushtet e bashkangjitura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, në përputhje me nenin 30, duke tërhequr të drejtat e përdorimit ekstraterritorial për burimet e numeracionit të dhëna për ndërmarrjen në fjalë.</p> <p>BEREC do të strukturojë dhe koordinojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve të ndryshme Anëtare të përfshira dhe të sigurojë koordinimin e duhur të punës midis tyre.</p> <p>7. Ky nen do të zbatohet gjithashtu kur autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente u japin të drejtën e përdorimit, për burimet e numeracionit, ndërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimit elektronik, në përputhje me nenin 93 (2).</p> | | | <p>të jashtëzakonshme ekonomike, jepen nëpërmjet procedurave konkurruese ose krahasuese të përzgjedhjes, ai mund të zgjasë periudhën tre javore të përmendur në pikën 3, të këtij neni, deri në tre javë të tjera.</p> <p>7. AKEP-i nuk kufizon numrin e të drejtave individuale të përdorimit që do të jepen, me përjashtim të rasteve kur kjo është e nevojshme, për të garantuar përdorimin efikas të burimeve të numeracionit.</p> <p>8. Ky nen zbatohet edhe kur AKEP-i jep të drejta të përdorimit për burimet e numeracionit, sipërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimit elektronik, në përputhje me pikën 2 të nenit 131, të këtij ligji.</p> | | |
| Neni95 | <p style="text-align: center;">Neni 95 Tarifat për të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit</p> <p>Shtetet Anëtare mund të lejojnë autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, të vendosin tarifa për të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit, të cilat pasqyrojnë nevojën për të siguruar përdorimin optimal të këtyre burimeve. Shtetet Anëtare sigurojnë që tarifat e tilla janë të justifikuar në mënyrë objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale në lidhje me qëllimin e tyre të synuar dhe do të marrin parasysh objektivat e përcaktuara në nenin 3.</p> | | Neni 22 | <p style="text-align: center;">Neni 22 Pagesat për të drejtat e përdorimit për burimet e numeracionit</p> <p>1. Mbajtësit e të drejtave të përdorimit të numrave dhe serive të numrave, kryejnë një pagesë në AKEP, për përdorimin e numrave të alokuar dhe serisë së numrave e cila pasqyron nevojën për të siguruar përdorimin optimal të këtyre burimeve.</p> <p>2. Pagesat për përdorimin e burimeve të numeracionit, duhet të jenë të justifikuar në mënyrë objektive, transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale në lidhje me qëllimin e synuar, bazuar në objektivat e përgjithshëm sipas nenit 5, të këtij ligji.</p> <p>3. Kriteret për llogaritjen e pagesës bazohen në llojin, përdorimin dhe gjatësinë e numrave.</p> <p>4. Pagesa për përdorimin e numrave dhe serive të numrave të caktuara, paguhet para çdo viti aktual, duke filluar nga data e marrjes së vendimit për caktimin e numrave dhe serive të numrave.</p> <p>5. Pagesat për përdorimin e numrave dhe serive numerike, bëhet sipas përcaktimeve në nenin 19, të këtij ligji.</p> <p>6. AKEP vendos tarifa për caktimin e emrave të domain-it, sipas rregulloreve të përcaktuara në nenin 133 të këtij ligji.</p> | F | |
| Neni96 | <p style="text-align: center;">Neni 96 Fëmijët e humbur dhe linjat telefonike ndihmëse për fëmijët</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që përdoruesit fundorë të kenë akses falas në një shërbim që funksionon si një linjë telefonike, për të raportuar rastet e fëmijëve të zhdukur. Linja telefonike do të jetë në dispozicion në numrin "116000".</p> | | Neni 134 | <p style="text-align: center;">Neni 134 Linja telefonike dhe e ndihmës për fëmijët e humbur</p> <p>1. AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë të kenë akses pa pagesë në një shërbim që operon një linjë telefonike, për raportimin e rasteve të fëmijëve të humbur. Linja</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------------|--|--|-----------------|---|---|--|
| | <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, të jenë në gjendje të përdorin shërbimet e dhëna nën numrin '116000', në masën më të madhe të mundshme. Masat e marra për të lehtësuar aksesin nga përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara në shërbime të tilla, ndërsa udhëtojnë në Shtetet e tjera Anëtare, do të bazohen në përputhje me standardet përkatëse ose specifikimet e përcaktuara në përputhje me nenin 39.</p> <p>3. Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për të siguruar që autoriteti ose ndërmarrja, së cilës i është caktuar numri '116000', ndan burimet e nevojshme për të operuar linjën telefonike .</p> <p>4. Shtetet Anëtare dhe Komisioni, sigurojnë që përdoruesit fundorë të informohen në mënyrë të duhur për ekzistencën dhe përdorimin e shërbimeve të ofruara në numrat '116000' dhe, 116111'.</p> | | | <p>telefonike duhet të jetë e disponueshme në numrin '116000'.</p> <p>2. AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, të kenë mundësi të aksesojnë shërbimet e ofruara në numrin "116000", sa më shumë të jetë e mundur. Masat e marra për të lehtësuar aksesin e përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara, në shërbime të tilla gjatë udhëtimit në vende të tjera, bazohen në përputhjen me standardet ose specifikimet përkatëse të përcaktuara në përputhje me nenin 53, të këtij ligji.</p> <p>3. AKEP-i merr masat e duhura, për të siguruar që autoriteti ose sipërmarrja të cilës i është caktuar numri '116000', ofron burimet e nevojshme për funksionimin e linjës telefonike.</p> <p>4. AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë, të jenë të informuar në mënyrë të përshtatshme për ekzistencën dhe përdorimin e shërbimeve të ofruara në numrat '116000' dhe, sipas rastit, '116111'.</p> <p>5. Brenda gjashtë muajve nga miratimi i këtij ligji, AKEP-i rishikon sipas nevojës, të gjitha caktimet e numrave të përmendura në këtë nen.</p> | | |
| Neni97 | <p style="text-align: center;">Neni 97 Akses në numra dhe shërbime</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë aty ku është e mundur ekonomikisht, përveç kur një përdorues i quajtur fundor, ka zgjedhur për arsye tregtare për të kufizuar aksesin duke i thirrur palët të vendosura në zona specifike gjeografike, autoritetet rregullatore kombëtare ose autoritetet e tjera kompetente, të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar që përdoruesit fundorë të jenë në gjendje të:</p> <p>(a) aksesojnë dhe përdorin shërbimet, duke përdorur numra jo gjeografikë brenda Bashkimit Evropian;</p> <p>dhe</p> <p>(b) akses në të gjithë numrat e dhënë në Bashkimin Evropian, pavarësisht nga teknologjia dhe pajisjet e përdorura nga operatori, përfshirë ato në planet kombëtare të numrave të Shteteve Anëtare dhe Numrat Universale Ndërkombëtare të Telefonave (UIFN).</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet rregullatore kombëtare, ose autoritetet e tjera kompetente, të jenë në gjendje të kërkojnë nga ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshëm publikisht për të bllokuar, rast pas rasti, aksesin në numra ose shërbime, kur kjo është e justifikuar për arsye mashtrimi ose keqpërdorimi dhe të kërkojë që në raste të tilla ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të mbajnë interkoneksionin përkatës ose të ardhurat e tjera të shërbimit.</p> | | Neni 135 | <p style="text-align: center;">Neni 135 Aksesi tek numrat dhe shërbimet</p> <p>1. AKEP-i siguron, aty ku është e mundur ekonomikisht, përveç rasteve kur përdoruesi fundor i thirrur ka zgjedhur për arsye komerciale të kufizojë aksesin e palës thirrëse nga një zonë e veçantë gjeografike, që përdoruesit të jenë në gjendje:</p> <p>a) të aksesojnë të gjithë numrat e parashikuar në planin kombëtar të numeracionit të Republikës së Shqipërisë;</p> <p>b) të aksesojnë gjithë numrat pavarësisht teknologjisë dhe pajisjeve të përdorura nga operatorët, duke përfshirë numrat sipas planeve të numeracionit të vendeve të tjera dhe Numrat Falas Universal Ndërkombëtar (UIFN).</p> <p>2. AKEP-i mund t'i kërkojë ofruesve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, të bllokojnë rast pas rasti, aksesin në numra ose shërbime, kur kjo justifikohet për arsye të mashtrimit ose keqpërdorimit. Në këtë rast ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbajnë të ardhurat përkatëse nga interkoneksioni ose shërbimet e tjera.</p> | F | |

| | | | | | | |
|-----------------------|--|--|-----------------|---|----------|--|
| <p>Neni98</p> | <p align="center">PJESA III – TITULLI III Te drejtat e përdoruesit</p> <p align="center">Neni 98 Përfshirja e mikrondërmarrjeve të caktuara</p> <p>Me përfshirje të neneve 99 dhe 100, ky Titull nuk do të zbatohet për mikrondërmarrjet, të cilat ofrojnë shërbime të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, përveçse nëse ato ofrojnë edhe shërbime të tjera të komunikimit elektronik. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që përdoruesit fundorë të informohen për përfshirjen, sipas paragrafit të parë, përpara se të lidhin një kontratë me një mikrondërmarrje që përfiton nga një përfshirje e tillë.</p> | | <p>Neni 137</p> | <p align="center">KREU XVIII TË DREJTAT E PËRDORUESIT FUNDOR</p> <p align="center">Neni 137 Përfshirja e ndërmarrjeve të caktuara mikro</p> <ol style="list-style-type: none"> Dispozitat e këtij kapitulli, me përfshirje të neneve 138 dhe 139, të këtij ligji, nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ndërmarrjet mikro që ofrojnë shërbime të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri telefonik, përveç rasteve kur ato ofrojnë edhe shërbime të tjera të komunikimit elektronik. Një ndërmarrje mikro, që përfiton nga përfshirja e referuar në paragrafin e parë të këtij neni, duhet të informojë përdoruesit fundorë për një përfshirje të tillë, përpara lidhjes së një kontrate për ofrimin e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri. Ky përfshirje, nëse zbatohet nga ndërmarrja mikro, duhet të deklarohet gjithashtu qartësisht në faqen e saj të internetit dhe të përfshihet si një deklaratë e kufizimit të përgjegjësisë, në kontratën e lidhur me përdoruesin fundor. | <p>F</p> | |
| <p>Neni99</p> | <p align="center">Neni 99 Mosdiskriminimi</p> <p>Ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nuk do të zbatohen ndonjë kërkesë të ndryshme ose kushte të përgjithshme të aksesit, përdorimit të rrjeteve ose shërbimeve për përdoruesit fundorë, për arsye që lidhen me kombësinë e përdoruesve fundorë, vendbanimin ose vendin e origjinës, përveçse nëse një trajtim i tillë i ndryshëm është i justifikuar objektivist.</p> | | <p>Neni 138</p> | <p align="center">Neni 138 Mosdiskriminimi</p> <p>Ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, nuk duhet të zbatohen kërkesa ose kushte të përgjithshme të aksesit, ose të përdorimit të rrjeteve ose shërbimeve për përdoruesit fundorë, të cilat ndryshojnë për arsye që lidhen me kombësinë, vendbanimin ose vendin, apo shtetin e përdoruesit fundor, përveç rasteve kur një trajtim i tillë i diferencuar është objektivist i justifikuar.</p> | <p>F</p> | |
| <p>Neni100</p> | <p align="center">Neni 100 Mbrojtja e të drejtave themelore</p> <ol style="list-style-type: none"> Masat kombëtare në lidhje me përdorimin e përdoruesve fundorë, në përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, do të respektojnë Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Kartën') dhe parimet e përgjithshme të ligjit të Bashkimit Evropian. Çdo masë në lidhje me aksesin e përdoruesve fundorë, ose përdorimin e shërbimeve, dhe aplikacioneve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike që kanë të bëjnë me kufizimin e ushtrimit të të drejtave ose lirive të njohura nga Karta, do të vendoset vetëm nëse parashikohet me ligj dhe respekton ato të drejta ose liri, janë proporcionale, të domosdoshme dhe përmbushin me të vërtetë objektivat e interesit të përgjithshëm të | | <p>Neni 139</p> | <p align="center">Neni 139 Mbrojtja e të drejtave themelore</p> <ol style="list-style-type: none"> Masat kombëtare në lidhje me aksesin e përdoruesve fundorë në, ose për përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik, respektojnë të drejtat themelore dhe parimet e përgjithshme të së drejtës të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventat Ndërkombëtare përkatëse ku Shqipëria ka aderuar. Çdo masë në lidhje me aksesin ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve nga përdoruesit fundorë nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, të cilat mund të kufizojnë ushtrimin e të drejtave ose lirive të njohura nga aktet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, duhet të vendoset vetëm nëse parashikohet nga | <p>F</p> | |

| | | | | | | |
|---------|---|--|----------|---|---|--|
| | <p>njohura nga ligji i Bashkimit Evropian, ose nevoja për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve, në përputhje me nenin 52 (1) të Kartës dhe me parimet e përgjithshme të ligjit të Bashkimit Evropian, përfshirë të drejtën për një mjet efektiv dhe për një gjykim të drejtë. Prandaj, masa të tilla do të merren vetëm me respektimin e duhur të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës së privatësisë. Një procedurë paraprake, e drejtë dhe e paanshme do të garantohet, duke përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar për personat e interesuar, në varësi të nevojës për kushte të përshtatshme dhe rregullime procedurale, në raste urgjente të vërtetuara siç duhet në përputhje me Kartën (Charter).</p> | | | <p>legjislacioni në fuqi dhe respekton ato të drejta ose liri. Masat duhet të jenë proporcionale dhe të nevojshme për përmbushjen e objektivave të interesit të përgjithshëm, të njohura nga legjislacioni në fuqi, ose në nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve në përputhje me pikën 1, të këtij neni, dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës, duke përfshirë të drejtën për një rregullim efektiv dhe për një gjykim të drejtë.</p> <p>3. Këto masa merren vetëm duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën e privatësisë. Një procedurë paraprake, e drejtë dhe e paanshme duhet të garantohet, duke përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar të personit ose të personave të interesuar, në varësi të nevojës për kushte të përshtatshme dhe rregullime procedurale në rastet urgjente të vërtetuara siç duhet, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventat Ndërkombëtare përkatëse ku Shqipëria ka aderuar.</p> | | |
| Neni101 | <p style="text-align: center;">Neni 101 Niveli i harmonizimit</p> <p>1. Shtetet Anëtare nuk do të ruajnë ose prezantojnë në ligjin e tyre kombëtar, dispozitat e mbrojtjes së përdoruesve fundorë që ndryshojnë nga nenet 102 deri në 115, përfshirë më shumë, ose më pak, dispozita të rrepta për të siguruar një nivel të ndryshëm të mbrojtjes, përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë Titull.</p> <p>2. Deri më 21 dhjetor 2021, Shtetet Anëtare mund të vazhdojnë të zbatojnë dispozita më të rrepta kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit, që ndryshojnë nga ato të përcaktuara në nenet 102 deri 115, me kusht që ato dispozita të ishin në fuqi më 20 dhjetor 2018 dhe çdo kufizim në funksionimin e tregut të brendshëm që rezultojnë prej tij, është në përputhje me objektivin e mbrojtjes së konsumatorit.</p> <p>Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin, deri më 21 Dhjetor 2019, për çdo dispozitë kombëtare që do të zbatohet në bazë të këtij paragrafi.</p> | | 120 | <p style="text-align: center;">Neni 140 Niveli i harmonizimit</p> <p>1. Rregullat për mbrojtjen e përdoruesit fundor të zbatuara nga AKEP, ose autoriteti kompetent për mbrojtjen e konsumatorit, duhet të jenë në përputhje me parashikimet e nenit 141 deri në 154, të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.</p> <p>2. Zbatimi i dispozitave më të rrepta për mbrojtjen e konsumatorit, që ndryshojnë nga ato të parashikuara në nenin 141 deri në 154, të këtij ligji, mund të vazhdojë deri në tre vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që këto dispozita janë ende në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe çdo kufizim në funksionimin e tregut shqiptar që rrjedh prej tyre, të jetë në proporcion me objektivin e mbrojtjes së konsumatorit.</p> | | |
| Neni102 | <p style="text-align: center;">Neni 102 Kërkesat e informacionit për kontratat</p> <p>1. Para se një konsumator të jetë i lidhur me një kontratë ose ndonjë ofertë përkatëse, ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve machine-to-machine (nga njëra makineri tek tjetra), duhet të japin informacionin e përmendur në nenet 5 dhe 6 të Direktivës. 2011/83 / EU, dhe informacionin e listuar në Shtojcën VIII të kësaj direktive, në masën që këto informacione lidhen me një shërbim që ata ofrojnë.</p> | | Neni 141 | <p style="text-align: center;">Neni 141 Kërkesat për kontratat</p> <p>1. Para lidhjes së kontratës, apo pranimit të një oferte korresponduese nga konsumatori, ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, janë të detyruar t'i ofrojnë konsumatorit informacionin e kërkuar sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe sipas nenit 180 të këtij ligji, në atë masë që lidhet me shërbimin që ofrohet.</p> <p>3. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni, ofrohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme nëpërmjet një mjeti</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>Informacioni do të sigurohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në një mjedis (medium) të qëndrueshëm siç përcaktohet në pikën (10) të nenit 2 të Direktivës 2011/83 / BE ose, kur parashikimi për një mjedis (medium) të qëndrueshëm nuk është i mundur, në një dokument lehtësisht të shkarkueshëm të disponueshëm nga ofruesi. Ofruesi tërheq vëmendjen e konsumatorit për disponueshmërinë e këtij dokumenti dhe rëndësinë e shkarkimit të tij për qëllime të dokumentacionit, referencës në të ardhmen dhe riprodhimit të pandryshuar.</p> <p>Informacioni, sipas kërkesës, do të sigurohet në një format të pranueshëm për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, që harmonizon kërkesat e aksesit për produktet dhe shërbimet.</p> <p>2. Informacioni i përmendur në paragrafët 1, 3 dhe 5 do t'u jepet gjithashtu përdoruesve fundorë që janë mikrondërmarrje ose ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç nëse ata kanë rënë dakord në mënyrë të qartë, për të hequr dorë nga të gjitha pjesët e këtyre dispozitave.</p> <p>3. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve nga njëra makineri tek tjetra, do t'u ofrojnë konsumatorëve një përmbledhje të shkurtër të kontratave, të përmbledhura dhe lehtësisht të lexueshme. Kjo përmbledhje do të identifikojë elementet kryesore të kërkesave të informacionit në përputhje me paragrafin 1. Këto elementë kryesorë përfshijnë së paku:</p> <p>(a) emrin, adresën dhe informacionin e kontaktit të ofruesit dhe, nëse është ndryshe, informacionin e kontaktit për çdo ankesë;</p> <p>(b) karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar;</p> <p>(c) çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe për çdo tarifë të përsëritur ose të lidhur me konsumin, kur shërbimi ofrohet për pagesë të drejtpërdrejtë monetare;</p> <p>(d) kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj;</p> <p>(e) shkallënnë të cilën produktet dhe shërbimet janë dizajnuar për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara;</p> <p>(f) në lidhje me shërbimet e aksesit në internet, një përmbledhje e informacionit të kërkuar në përputhje me pikat (d) dhe (e) të nenit 4 (1) të Rregullores (BE) 2015/2120.</p> <p>Deri më 21 dhjetor 2019, Komisioni, pas konsultimit me BEREC, do të miratojë akte zbatuese që specifikojnë një model përmbledhës të kontratës, që do të përdoret nga ofruesit për të përmbushur detyrimet e tyre sipas këtij paragrafi.</p> <p>Këto akte zbatuese do të miratohen në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 118 (4).</p> <p>Ofruesit që i nënshtrohen detyrimeve nga paragrafi 1, duhet ta plotësojnë atë model të përmbledhur të kontratës me informacionin e kërkuar dhe do t'i japin konsumatorëve</p> | | <p>të qëndrueshëm, dhe përcaktimeve në ligjin për mbrojtjen e konsumatorit ose, në rastet kur dhënia e këtij informacioni nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm nuk është e mundur, ai vihet në dispozicion nga ofruesi i shërbimit, në një dokument që mund të aksesohet dhe shkarkohet lehtësisht nga përdoruesi.</p> <p>4. Ofruesi i shërbimit informon qartësisht konsumatorin për disponibilitetin e dokumentit të përmendur në pikën 2, si dhe për rëndësinë e shkarkimit të tij për qëllime të dokumentimit, referimit dhe riprodhimin e pandryshueshëm të tij në të ardhmen. Ky informacion, sipas kërkesës, duhet të ofrohet në një format të aksesueshëm për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislationin në fuqi që harmonizon kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet.</p> <p>5. Informacioni i referuar në pikat 1 dhe 5, të këtij neni, duhet t'u jepet gjithashtu përdoruesve fundorë që janë ndërmarrje mikro ose të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç rasteve kur këta përdorues japin pëlqimin e shprehur se heqin dorë nga të gjitha ose një pjesë e të drejtave të përfshira në këto dispozita.</p> <p>6. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, duhet t'i vënë në dispozicion konsumatorëve, një përmbledhje të shkurtër dhe lehtësisht të lexueshme të kontratës. Kjo përmbledhje duhet të identifikojë elementet kryesore të kërkesave të informacionit sipas pikës 1 të këtij neni, ku përfshihen të paktën:</p> <p>a) emri, adresa dhe detaje të kontaktit të ofruesit dhe, nëse është i ndryshëm, dhe detajet e kontaktit për ankesat;</p> <p>b) karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar;</p> <p>c) çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike, përfshirë të gjitha tarifatat fikse periodike ose në bazë të konsumit të njëjësive, kur shërbimi ofrohet kundrejt pagesës direkte monetare;</p> <p>ç) kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj;</p> <p>d) masën në të cilën produktet dhe shërbimet janë të projektuara për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara;</p> <p>dh) në lidhje me shërbimet e aksesit në internet, një përmbledhje të informacionit të kërkuar sipas gërmës d) dhe e) të pikës 1 të nenit 178, të këtij ligji.</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|---------|---|--|----------|---|---|--|
| | <p>përmbledhjen e kontratës falas, përpara përfundimit të kontratës, përfshirë kontratat në distancë. Kur për arsye teknike objektive, është e pamundur të sigurohet përmbledhja e kontratës në atë moment, ajo do të sigurohet pa vonesë, dhe kontrata do të hyjë në fuqi kur konsumatori ka konfirmuar marrëveshjen e tij, pas pranimit të përmbledhjes së kontratës.</p> <p>4. Informacioni i referuar në paragrafët 1 dhe 3, do të bëhet pjesë integrale e kontratës dhe nuk do të ndryshohet nëse palët kontraktuese janë pajtuar shprehimisht ndryshe.</p> <p>5. Kur shërbimet e aksesit në internet, ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, faturohen në bazë të konsumit të kohës ose vëllimit, ofruesit e tyre do t'u ofrojnë konsumatorëve lehtësira për të monitoruar dhe kontrolluar përdorimin e secilit prej këtyre shërbimeve. Kjo strukturë do të përfshijë akses në informacionin, në kohë e mbi nivelin e konsumit të shërbimeve të përfshira në një plan tarifor. Veçanërisht, ofruesit do të njoftojnë konsumatorët, përpara tejkalimit të çdo limiti të konsumit, siç përcaktohet nga autoritetet kompetente në koordinim, me autoritetet rregullatore kombëtare, të përfshira në planin e tyre tarifor, dhe se kur një shërbim i përfshirë në planin e tyre tarifor është arritur plotësisht.</p> <p>6. Shtetet Anëtare mund të ruajnë ose prezantojnë në dispozitat e ligjit të tyre kombëtar, që tu kërkojnë ofruesve të japin informacion shtesë mbi nivelin e konsumit dhe përkohësisht të parandalojnë përdorimin e mëtejshëm të shërbimit përkatës, të një kufiri financiar ose të volumit, të përcaktuar nga autoriteti kompetent.</p> <p>7. Shtetet Anëtare do të jenë të lira të ruajnë ose prezantojnë në ligjin e tyre dispozitat në lidhje me aspektet që nuk rregullohen nga ky nen, veçanërisht për të adresuar çështjet e reja që do të dalin.</p> | | | <p>6. Ofruesit e shërbimit, që janë objekt i zbatimit të detyrimeve sipas paragrafit 1, të këtij neni, plotësojnë në mënyrën e duhur, modelin përmbledhës të kontratës me informacionin e kërkuar, në përputhje me rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe pajisin konsumatorin me përmbledhjen e kontratës, pa pagesë dhe përpara lidhjes së kontratës, përfshirë për kontratat në largësi. Kur, për arsye objektive teknike, është e pamundur të sigurohet përmbledhja e kontratës në atë moment, ajo duhet të sigurohet më pas dhe pa vonesa të panevojshme dhe kontrata bëhet efektive kur konsumatori pas marrjes së përmbledhjes së kontratës, konfirmon dakordësinë e tij.</p> <p>7. Informacioni i referuar në paragrafët 1 dhe 5, të këtij neni, duhet të bëhet pjesë përbërëse e kontratës dhe nuk duhet të ndryshohet, përveç vetëm nëse palët kontraktuese bien dakord ndryshe shprehimisht.</p> <p>8. Kur shërbimet e aksesit në internet, ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, faturohen në bazë të kohës ose sasisë së konsumuar, ofruesit e tyre duhet t'u ofrojnë konsumatorëve, mundësinë për të monitoruar dhe kontrolluar përdorimin e secilit prej këtyre shërbimeve. Kjo lehtësi do të përfshijë aksesin e informacionit në kohën e duhur, mbi nivelin e konsumit të shërbimeve të përfshira në një plan tarifor. Në veçanti, ofruesit duhet t'u dërgojnë një njoftim konsumatorëve, përpara arritjes së çdo limiti konsumi të përfshirë në planin e tyre tarifor edhe kur sasia e një shërbimi të përfshirë në planin e tyre tarifor, konsumohet plotësisht, sipas përcaktimeve nga autoritetet kompetente në koordinim me autoritetet rregullatore kombëtare, aty ku është e nevojshme.</p> <p>9. AKEP-i mund t'u kërkojë ofruesve, të japin informacion shtesë për nivelin e konsumit dhe të parandalojë përkohësisht përdorimin e mëtejshëm të shërbimit përkatës, mbi një kufi financiar ose sasior të përcaktuar nga AKEP.</p> <p>10. AKEP-i pas konsultimit me autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorit, mund të ndërmarrë veprime në lidhje me aspekte që nuk rregullohen nga ky nen, veçanërisht për të adresuar problematikat e lindura.</p> | | |
| Neni103 | <p style="text-align: center;">Neni 103 Transparenca, krahasimi i ofertave dhe publikimi i informacionit</p> <p>1. Autoritetet kompetente në koordinim, aty ku është e nevojshme, me autoritetet kombëtare rregullatore sigurojnë që, kur ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, e bëjnë ofrimin e këtyre shërbimeve me terma dhe kushte, informacioni i përmendur në Shtojcën IX është botuar në mënyrë të qartë,</p> | | Neni 142 | <p style="text-align: center;">Neni 142 Transparenca, krahasimi i ofertave dhe publikimi i informacionit</p> <p>1. Ofruesit e shërbimit të aksesit në internet dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, kur ofrimi i këtyre shërbimeve është objekt i termave dhe kushteve të ofrimit, duhet të publikojnë informacionin si më poshtë: a) Detajet e kontaktit të sipërmarrësit;</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>gjithëpërfshirëse, të lexueshme nga makina(machine-readable)dhe në një format të arritshëm për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, që të harmonizojnë kërkesat e aksesit për produkte dhe shërbime, nga të gjithë ofruesit, ose nga vetë autoriteti kompetent në koordinim, me autoritetin rregullator kombëtar. Ky Informacion do të azhurnohet rregullisht. Autoritetet kompetente në koordinim, me autoritetet kombëtare rregullatore mund të specifikojnë kërkesa shtesë në lidhje me formën në të cilën do të publikohen këto informacione. Ky informacion, sipas kërkesës, do t'i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, autoritetit rregullator kombëtar para publikimit të tij.</p> <p>2. Autoritetet kompetente, në koordinim me autoritetet rregullatore kombëtare, sigurojnë që përdoruesit fundorë të kenë akses falas në të paktën një mjet të pavarur të krahasimit, i cili u mundëson atyre të krahasojnë dhe vlerësojnë shërbime të ndryshme të aksesit në internet dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal, të bazuar në numër në dispozicion të publikut dhe kur është e zbatueshme nga numri në dispozicion të publikut në lidhje me shërbimet e komunikimit ndërpersonal të pavarur:</p> <p>(a) çmimet dhe tarifat e shërbimeve të ofruara kundër pagesave direkte monetare përsëritëse ose të bazuara në konsumin; dhe</p> <p>(b) cilësia e performancës së shërbimit, kur ofrohet cilësi minimale e shërbimit ose ndërmarrja kërkohet të publikojë informacione të tilla në bazë të nenit 104.</p> <p>3. Mjeti i krahasimit i përmendur në paragrafin 2 do të:</p> <p>(a) jetë operacionalisht i pavarur nga ofruesit e shërbimeve të tilla, duke siguruar kështu që këtyre ofruesve t'u jepet trajtim i barabartë në rezultatet e kërkimit;</p> <p>(b) zbulojë qartë pronarët dhe operatorët e mjetit të krahasimit;</p> <p>(c) përcaktojë kritere të qarta dhe objektive mbi të cilat do të bazohet krahasimi;</p> <p>(d) përdorë gjuhë të thjeshtë dhe të qartë;</p> <p>(e) sigurojë informacion të saktë dhe të azhurnuar dhe të përcaktojë kohën e azhurnimit të fundit;</p> <p>(f) të jetë i hapur për çdo ofrues të shërbimeve të aksesit në internet ose shërbime të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, të cilët vënë në dispozicion informacionin përkatës, dhe të përfshijnë një gamë të gjerë të ofertave që mbulojnë një pjesë të rëndësishme të tregut, dhe, kur informacioni i paraqitur nuk është një përmbledhje e plotë e tregut, një deklaratë e qartë për këtë qëllim, përpara se të shfaqen rezultatet;</p> <p>(g) sigurojë një procedurë efektive për të raportuar informacion të pasaktë;</p> <p>(h) përfshijnë mundësinë për të krahasuar çmimet, tarifat dhe cilësinë e performancës së shërbimit midis ofertave të disponueshme për konsumatorët dhe, nëse kërkohet nga Shtetet</p> | | <p>b) Përshkrimin e shërbimeve të ofruara;</p> <p>b) Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshirë ato të zhvilluara nga sipërmarrësi.</p> <p>2. Përshkrimi i shërbimeve të ofruara sipas gërme b) të pikës 1, të këtij neni, duhet të përmbajë:</p> <p>a) Objektin e shërbimeve të ofruara dhe karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar, përfshirë çdo nivel minimal të cilësisë së shërbimit nëse ofrohet si dhe çdo kufizim të vendosur nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të ofruara.</p> <p>b) Tarifat e shërbimeve të ofruara, përfshirë informacionin mbi:</p> <p>i) sasinë e njësive të komunikimeve, të tilla si sasinë e përfshira në përdorimin e të dhënave, minutat për thirrjet zanore, numrin e mesazheve të përfshira në planet tarifore specifike dhe tarifat e zbatueshme për njësitë shtesë të komunikimit;</p> <p>ii) numrat ose shërbimet që janë objekt i kushteve të veçanta të tarifimit;</p> <p>iii) tarifat për aksesin dhe mirëmbajtjen, të gjitha llojet e tarifave të përdorimit, skemat tarifore të veçanta dhe të fokusuara në grupe të vecanta përdoruesish, kushtet specifike të faturimit dhe çdo tarifë shtesë, si dhe kostot në lidhje me pajisjet fundore kur është rasti.</p> <p>c) Shërbimet e ofruara pas shitjes, mirëmbajtjes dhe kujdesit ndaj klientit dhe detajet e kontaktit të tyre;</p> <p>d) Kushtet standarde të kontratës, përfshirë kohëzgjatjen e kontratës, tarifat për përfundimin e parakohshëm të kontratës, të drejtat që lidhen me përfundimin e ofertave të paketave ose të elementeve të tyre dhe procedurat dhe tarifat direkte që lidhen me portabilitetin e numrave dhe identifikuesve të tjerë, nëse është e nevojshme;</p> <p>e) Informacion mbi aksesin në shërbimet e urgjencës dhe të vendndodhjes së telefonuesit, ose ndonjë kufizim për këtë të fundit, nëse sipërmarrësi është ofrues i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra;</p> <p>f) Informacion mbi shkallën në të cilën aksesin në shërbimet e urgjencës, mund të mbështetet ose jo, nëse sipërmarrësi është një ofrues i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri;</p> <p>g) Ndryshimet që kufizojnë aksesin ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve dhe vendndodhjen e disponueshmërisë së këtyre shërbimeve;</p> <p>h) Detajet e produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë çdo funksion, praktikë, politikë ose procedurë dhe ndryshime në funksionimin e</p> | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | <p>Anëtare, midis atyre ofertave dhe standardeve në dispozicion të publikut për përdoruesit e tjerë fundorë.</p> <p>Mjetet e krahasimit që plotësojnë kërkesat në pikat (a) deri (h), me kërkesë të ofruesit të këtij mjeti, do të certifikohen nga autoritetet kompetente në koordinim, me autoritetet rregullatore kombëtare.</p> <p>Palët e treta kanë të drejtë të përdorin, falas dhe në formate të hapura të të dhënave, informacionin e publikuar nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, për qëllime të vënies në dispozicion të mjeteve të tilla të pavarura të krahasimit.</p> <p>4. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të bazuar në numër të disponueshëm publikisht, të shpërndajnë informacionin e interesit publik falas për përdoruesit fundorë ekzistues dhe të rinj, me mjetet që ata zakonisht përdorin në komunikimet e tyre me përdoruesit fundorë. Në një rast të tillë, ai informacion i interesit publik do të sigurohet nga autoritetet publike përkatëse në një format të standardizuar dhe do të përfshijë temat e mëposhtme:</p> <p>(a) përdorimet më të zakonshme të shërbimeve të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, të bazuar në numër të disponueshëm publikisht, për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme, ose për të shpërndarë përmbajtje të dëmshme, veçanërisht kur ato mund të paragjykojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të tjerëve, përfshirë shkeljet e të dhënave, të drejtat e mbrojtjes, të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, dhe pasojat e tyre ligjore; dhe</p> <p>(b) mjetet e mbrojtjes nga rreziqet ndaj sigurisë personale, privatësisë dhe të dhënave personale kur përdoren shërbime të aksesit në internet dhe shërbime të komunikimit ndërpersonal, të bazuar në numër të disponueshëm publikisht.</p> | | | <p>shërbimit, të krijuara posaçërisht për përdoruesit fundorë, me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këta përdorues fundorë duhet të informohen rregullisht për produktet e tyre.</p> <p>i) Informacion mbi procedurat për matjen dhe menaxhimin e trafikut të përcaktuar nga ofruesi, për të shmangur ngarkimin ose mbingarkimin e lidhjeve të rrjetit dhe se si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;</p> <p>j) Detajet e produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë çdo funksion, praktikë, politikë, informacion në lidhje me vendndodhjen dhe procedurat e tyre dhe ndryshimet në funksionimin e shërbimit, të krijuar posaçërisht për përdoruesit fundorë, me aftësi të kufizuara, ndryshime të kushteve në lidhje me aksesin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për harmonizimin e kërkesave të aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet.</p> <p>3. Informacioni i publikuar nga ofruesit e shërbimit të aksesit në internet ose ofrimit të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, sipas këtij neni, duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i lexueshëm nga pajisje kompjuterike, duke përfshirë publikimin në faqen e internetit të tij në një format të aksesueshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e AKEP-it. AKEP, në rastet kur e vlerëson të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë ndryshime në informacionin e publikuar. AKEP mund të kërkojë për tarifatat për kategori individuale të shërbimeve përfshirë shërbimet me vlerë të shtuar të jepet menjëherë, para realizimit të thirrjes zanore.</p> <p>4. Informacioni i kërkuar sipas këtij neni, përditësohet rregullisht. AKEP-i, në koordinim me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, mund të përcaktojë kërkesa shtesë në lidhje me formën në të cilën duhet të publikohet ky informacion. Ky informacion, sipas kërkesës, u dërgohet përpara publikimit të tij AKEP-it dhe KMK-së.</p> <p>5. AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë, të kenë akses pa pagesë në të paktën një instrument të pavarur krahasimi, i cili u mundëson atyre krahasimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ndryshme të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra të disponueshëm për publikun dhe sipas rastit, shërbimin e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun të pavarur nga numrat, në lidhje me:</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>a) çmimet dhe tarifat e shërbimeve të ofruara kundrejt pagesave monetare direkte, periodike ose për njësi të konsumuar;</p> <p>b) cilësinë e performancës së shërbimit, në rastet kur garantohet një nivel minimal i cilësisë së shërbimit, ose kur sipërmarrësi ka detyrim të publikojë këtë informacion në përputhje me nenin 143, të këtij ligji.</p> <p>6. Instrumenti i krahasimit sipas pikës 5 të këtij neni duhet:</p> <p>a) të jetë operacionalisht i pavarur nga ofruesit e këtyre shërbimeve, për të siguruar trajtim të barabartë të këtyre ofruesve në rezultatet e kërimit;</p> <p>b) të publikojë qartësisht pronarët dhe operatorët e instrumentit të krahasimit;</p> <p>c) të përcaktojë kritere të qarta dhe objektive mbi të cilat bazohet krahasimi;</p> <p>ç) të përdorë gjuhë të thjeshtë dhe të qartë;</p> <p>d) të sigurojë informacion të saktë dhe të përditësuar dhe të japë kohën e përditësimit të fundit;</p> <p>dh) të jetë i hapur për çdo ofrues të shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, duke vënë në dispozicion informacionin përkatës dhe të përfshijë një gamë të gjerë të ofertave që mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të tregut dhe kur informacioni i paraqitur nuk është një pasqyrë e plotë e tregut, një deklaratë të qartë për këtë, përpara shfaqjes së rezultateve;</p> <p>e) të sigurojë një procedurë efektive për të raportuar informacionin e pasaktë;</p> <p>ë) të përfshijë mundësinë për të krahasuar çmimet, tarifat dhe cilësinë e performancës së shërbimit midis ofertave të disponueshme për përdoruesit fundorë dhe nëse kërkohet nga legjislacioni në fuqi, midis këtyre ofertave dhe ofertave standarde publikisht të disponueshme për përdoruesit e tjerë fundorë.</p> <p>7. Instrumentet e krahasimit që plotësojnë kërkesat e pikës 6, nëse ofrohen nga një subjekt i ndryshëm nga AKEP, ata duhet të certifikohen paraprakisht nga AKEP-i. Palët e treta kanë të drejtë të përdorin pa pagesë dhe në formatin e hapur të të dhënave, informacionin e publikuar nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, me qëllim vënie në dispozicion të këtyre instrumentave të pavarura të krahasimit.</p> <p>8. AKEP-i mund të kërkojë, që ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet, ose të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra publikisht të</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|----------------|---|--|----------------|--|---|--|
| | | | | <p>disponueshëm, ose për të dy kategoritë, të shpërndajnë pa pagesë informacion me interes publik për përdoruesit fundorë ekzistues dhe të rinj, sipas rastit, nëpërmjet mjeteve të komunikimit që ata përdorin zakonisht me përdoruesit fundorë.</p> <p>9. Në rastet e parashikuara në pikën 8 të këtij neni, informacioni me interes publik, duhet të ofrohet nga autoritetet publike përkatëse në një format të standardizuar dhe ndër të tjera, duhet të mbulojë temat e mëposhtme:</p> <p>a) përdorimet më të zakonshme të shërbimeve të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal publikisht të disponueshëm të bazuar në numra, në mbështetje/kryerjen e aktiviteteve të paligjshme, ose për shpërndarjen e përmbajtjes së dëmshme, veçanërisht kur mund të paragjykojë respektimin e të drejtave dhe lirive të tjerëve, duke përfshirë shkeljen e të drejtave e mbrojtjes së të dhënave, të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, dhe pasojat e tyre ligjore;</p> <p>b) mjetet e mbrojtjes kundër rreziqeve për sigurinë personale, privatësinë dhe të dhënat personale, kur përdoren shërbimet e aksesit në internet dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal publikisht të disponueshëm të bazuar në numra.</p> | | |
| Neni104 | <p align="center">Neni 104</p> <p align="center">Cilësia e shërbimit në lidhje me shërbimet e aksesit në internet dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht</p> <p>1. Autoritetet rregullatore kombëtare, në koordinim me autoritetet e tjera kompetente, mund të kërkojnë nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet dhe të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, për të publikuar informacione gjithëpërfshirëse, të krahasueshme, të besueshme, miqësore dhe të azhuruara për përdoruesit fundorë mbi cilësinë të shërbimeve të tyre, në atë masë që ata kontrollojnë të paktën disa elementë të rrjetit, direkt ose në sajë të një marrëveshje të nivelit të shërbimit për atë qëllim, dhe në masat e marra për të siguruar ekuivalentin në aksesin për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. Autoritetet rregullatore kombëtare në koordinim me autoritetet e tjera kompetente gjithashtu mund të kërkojnë nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht për të informuar konsumatorët nëse cilësia e shërbimeve që ata ofrojnë varet nga ndonjë faktor i jashtëm, siç është kontrolli i transmetimit të sinjalit ose lidhjes së rrjetit.</p> <p>Ky informacion, sipas kërkesës, do t'u jepet autoriteteve rregullatore kombëtare dhe, autoriteteve të tjera kompetente përpara publikimit të tij.</p> | | Neni143 | <p align="center">Neni 143</p> <p align="center">Cilësia e shërbimit të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të disponueshme për publikun</p> <p>1. AKEP-i kërkon nga ofruesit e shërbimeve të internetit, ose shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të publikojnë për përdoruesit fundorë, informacion të krahasueshëm, të qartë, të besueshëm, miqësor dhe të përditësuar mbi cilësinë e shërbimeve të tyre.</p> <p>2. Informacioni për cilësinë e shërbimeve ofrohet në masën që ofruesit e shërbimit kanë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bazë të një marrëveshjeje të nivelit të shërbimit, për të paktën disa elementë të rrjetit që lidhen me këtë qëllim, si dhe masat e marra për të siguruar aksesin e barabartë për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.</p> <p>3. AKEP, mund të kërkojë gjithashtu nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të disponueshme për publikun, të informojnë pajtimtarët, nëse cilësia e shërbimeve që ata ofrojnë varet nga ndonjë faktor i jashtëm, si kontrolli i transmetimit të sinjalit ose lidhjes me rrjetin. Ky informacion, i jepet AKEP-it me kërkesë dhe sipas rastit, autoriteteve të tjera kompetente përpara publikimit të tij.</p> | F | |

| | | | | | |
|---------|---|--|----------|---|---|
| | <p>Masat për të siguruar cilësinë e shërbimit duhet të jenë në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/2120.</p> <p>2. Autoritetet rregullatore kombëtare në koordinim me autoritetet e tjera kompetente, do të specifikojnë, duke marrë parasysh maksimalisht udhëzimet e BEREC, cilësinë e parametrave të shërbimit që duhet të maten, metodat e zbatueshme të matjes, dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e informacionit që do të publikohet, përfshirë mekanizmat e mundshëm të çertifikimit të cilësisë. Kur është e përshtatshme, do të përdoren parametrat, përkufizimet dhe metodat e matjes të paraqitura në Shtojcën X.</p> <p>Deri më 21 qershor 2020, për të kontribuar në një zbatim të vazhdueshëm të këtij paragrafi dhe të Shtojcës X, BEREC do të marrë konsultimin me palët e interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, udhëzime që detajojnë cilësinë përkatëse të parametrave të shërbimit, përfshirë parametrat përkatëse për përdoruesit me aftësi të kufizuara, metodat e zbatueshme të matjes, përmbajtjen dhe formatin e publikimit të informacionit dhe mekanizmat e çertifikimit të cilësisë.</p> | | | <p>4. Masat për sigurimin e cilësisë së shërbimit, duhet të jenë në përputhje me rregullat për internetin e hapur, sipas përcaktimeve në Kreun XXII, të këtij ligji.</p> <p>5. AKEP-i specifikon parametrat e cilësisë së shërbimit që do të maten, metodat e zbatueshme të matjes, përmbajtjen, formën dhe mënyrën e informacionit që do të publikohet, duke përfshirë mekanizmat e mundshëm të çertifikimit të cilësisë sipas standardeve të ETSI dhe ITU. Parametrat, përkufizimet dhe metodat e matjes kur është e përshtatshme, përfshijnë:</p> <p>a) Për thirrjet zanore:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) kohën e vendosjes së thirrjes; ii) përqindjen e thirrjeve të pasuksesshme; iii) cilësinë e transmetimit të bisedës; iv) kohën e përgjigjes për thirrjet drejt operatorit, shërbimit ndaj klientit dhe shërbimeve të numërorit telefonik; <p>b) Për rrjetet e lëvizshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) disponueshmërinë e rrjetit; ii) probabilitetin e lidhjes së suksesshme në një zonë të mbuluar nga rrjeti; iii) raportin e rënies së thirrjeve; <p>c) Për shërbimin ndaj klientit:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) koha ndërmjet kërkesës për shërbim dhe fillimit të ofrimit të shërbimit; ii) shpeshtësia e defekteve; iii) koha për të zgjidhur dhe eliminuar defektet; frekuenca e ankesave për faturimin; <p>d) Internetin:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) shpejtësia e transferimit të të dhënave; ii) koha e ngarkimit të faqes në internet; iii) vonesa; jitter; shkalla e humbjes së paketës. <p>6. AKEP-i brenda një viti nga hyrja e këtij ligji në fuqi, përcakton parametrat e cilësisë së shërbimit, duke përfshirë parametrat përkatës për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, metodat e zbatueshme të matjes, përmbajtjen dhe formatin e publikimit të informacionit, si dhe mekanizmat e çertifikimit të cilësisë, bazuar në praktikatat më të mira evropiane dhe standardet ndërkombëtare.</p> | |
| Neni105 | <p style="text-align: center;">Neni 105 Kohëzgjatja dhe përfundimi i kontratës</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që kushtet dhe procedurat për përfundimin e kontratës, të mos veprojnë si dekurajues për ndryshimin e ofruesit të shërbimeve dhe që kontratat e lidhura midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri dhe nga shërbimet e transmetimit të përdorura për ofrimin e</p> | | Neni 144 | <p style="text-align: center;">Neni 144 Kohëzgjatja dhe përfundimi i kontratës</p> <p>1. AKEP-i siguron që kontratat e lidhura ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të pavarura nga numri dhe shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, bazohen në parimin e barazisë mes</p> | F |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p>shërbimeve nga njëra makineri tek tjetra, nuk mandatojnë një periudhë angazhimi më të gjatë se 24 muaj. Shtetet Anëtare mund të miratojnë ose mirëmbajnë dispozita që mandatojnë periudha më të shkurtra maksimale të angazhimit kontraktues.</p> <p>Ky paragraf nuk do të zbatohet për kohëzgjatjen e një kontrate me këste, kur konsumatori ka rënë dakord në një kontratë të veçantë për pagesa me këste ekskluzivisht për vendosjen e një lidhje fizike, në veçanti për rrjetet me kapacitet shumë të lartë. Një kontratë me këste për vendosjen e një lidhje fizike nuk përfshin pajisje terminale, të tilla si një ruter ose një modem, dhe nuk do t'i ndalojë konsumatorët të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas këtij neni.</p> <p>2. Paragrafi 1 do të zbatohet gjithashtu për përdoruesit fundorë që janë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç nëse ata kanë rënë dakord në mënyrë të qartë për të hequr dorë nga këto dispozita.</p> <p>3. Kur një kontratë ose ligji kombëtar, parashikon zgjatjen automatike të një kontrate me kohëzgjatje fikse për shërbimet e komunikimeve elektronike, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri dhe nga shërbimet e transmetimit, të përdorura për ofrimin e shërbimeve nga njëra makineri tek tjetra, Shtetet Anëtare sigurojnë që pas një zgjatjeje të tillë, përdoruesit fundorë kanë të drejtë të ndërpresin kontratën në çdo kohë me një periudhë maksimale njoftimi një mujore, siç përcaktohet nga shtetet anëtare, dhe pa patur ndonjë kosto, përveç tarifave për marrjen e shërbimit gjatë periudhës së njoftimit. Para se kontrata të zgjatet automatikisht, ofruesit duhet të informojnë përdoruesit fundorë, në kohë dhe me një mjet (media) medium të qëndrueshëm, për përfundimin e angazhimit kontraktues dhe për mënyrat me të cilat duhet të ndërpritet kontrata. Në të njëjtën kohë, ofruesit do t'u japin përdoruesve fundorë këshilla për tarifën me të mira, në lidhje me shërbimet e tyre. Ofruesit duhet t'u japin përdoruesve fundorë informacionin më të mirë tarifor të paktën një here në vit.</p> <p>4. Përdoruesit fundorë kanë të drejtë të ndërpresin kontratën e tyre pa bërë asnjë kosto të mëtejshme, me njoftimin e ndryshimeve në kushtet e kontratës të propozuara nga ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, përveç shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, përveç nëse ndryshimet e propozuara janë ekskluzivisht në dobi të përdoruesve fundorë, kanë një natyrë thjesht administrative dhe nuk kanë asnjë efekt negativ mbi përdoruesit fundorë, ose imponohen drejtpërdrejt nga ligji i Bashkimit Evropian ose ai kombëtar.</p> <p>Ofruesit do të njoftojnë përdoruesit fundorë të paktën një muaj përpara për çdo ndryshim në kushtet e kontratës, dhe njëkohësisht do t'i informojnë ata për të drejtën e tyre për të ndërprerë kontratën pa bërë ndonjë kosto të mëtejshme nëse nuk pranojnë kushtet e reja. E drejta për të përfunduar kontratën mund të ushtrohet brenda një muaji nga njoftimi. Shtetet Anëtare mund ta zgjasin atë periudhë deri në tre muaj. Shtetet Anëtare sigurojnë që njoftimi të</p> | | <p>palëve. Kushtet dhe procedurat për zgjidhjen e kontratës nuk duhet të pengojnë ose dekurajojnë përdoruesin fundor për ndryshimin e ofruesit të shërbimit, si dhe nuk duhet të detyrojnë lidhjen e kontratës me një afat fillestar prej më shumë se 24 muaj.</p> <p>2. AKEP-i mund të miratojë ose vijojë të mbajë dispozita të cilat detyrojnë lidhjen e kontratave me periudha më të shkurtra maksimale të angazhimit kontraktual.</p> <p>3. AKEP-i siguron gjithashtu që ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të pavarura nga numrat dhe përveç shërbimeve të transmetimit që përdoren për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, do t'u ofrojnë konsumatorëve mundësinë për të nënshkruar një kontratë për një periudhë maksimale prej 12 muajsh.</p> <p>4. Përcaktimet e mësipërme të këtij neni, nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar për kohëzgjatjen e një kontrate për pagesë me këste, ku përdoruesi fundor ka rënë dakord me një kontratë të veçantë për pagesa me këste, ekskluzivisht për instalimin e një lidhjeje fizike, veçanërisht për lidhjen në rrjet me shpejtësi shumë të lartë. Kontrata e instalimit për lidhje fizike, nuk përfshin pajisjen fundore si <i>ruter</i> apo <i>modem</i> dhe nuk duhet të pengojë përdoruesit fundorë nga ushtrimi i të drejtave të tyre sipas këtij neni.</p> <p>5. Përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, janë gjithashtu të zbatueshme për ndërmarrje mikro, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç rasteve kur ata kanë rënë dakord shprehimisht të heqin dorë nga këto dispozita. Këto rregullime nuk i përfshijnë përdoruesit e tjerë të biznesit.</p> <p>6. Kur një kontratë ose një dispozitë ligjore, parashikon zgjatje automatike të një kontrate me kohëzgjatje fikse për shërbimet e komunikimeve elektronike, të ndryshme nga shërbimet e komunikimeve ndërpersonale të pavarura nga numri dhe të tjera nga shërbimet e transmetimit që përdoren për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë, AKEP-i siguron që, pas një zgjatjeje të tillë, pajtimtarët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën në çdo kohë me një periudhë njoftimi maksimal prej një muaji, siç përcaktohet nga legjislativi në fuqi, dhe pa asnjë kosto, përveç tarifave të aplikueshme për marrjen e shërbimit gjatë periudhës së njoftimit.</p> <p>7. Përpara se kontrata të zgjatet automatikisht sipas pikës 6, të këtij neni, ofruesit duhet të informojnë pajtimtarët, në mënyrë të qartë dhe nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm në kohë, për përfundimin e afatit të angazhimit kontraktual dhe për mënyrat se si pajtimtari mund të zgjidhë kontratën. Njëkohësisht me këtë</p> | |
|--|--|--|--|--|

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>bëhet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në një media të qëndrueshme.</p> <p>5. Çdo mospërputhje e vazhdueshme ose e përsëritur shpesh ndermjet performancës aktuale të një shërbimi të komunikimeve elektronike, dhe një shërbimi të aksesit në internet ose një shërbim të pavarur të komunikimeve ndërpersonale, si dhe performanca e treguar në kontratë do të konsiderohet të jetë një bazë për nxitjen e mjeteve juridike në dispozicion të konsumatorit, në përputhje me ligjin kombëtar, duke përfshirë të drejtën e ndërprerjes së kontratës pa kosto.</p> <p>6. Kur një përdorues fundor, ka të drejtë të ndërpresë një kontratë, për një shërbim të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, përveç një shërbimi të pavarur të komunikimeve ndërpersonale, të pavarur nga numri, para përfundimit të periudhës së kontratës së rënë dakord, në përputhje me këtë Direktivë ose dispozitat e tjera të Bashkimit Evropian ose ligji kombëtar, asnjë përdorim i dëmit nuk duhet të paguhet nga përdoruesi fundor, përveç pajisjeve terminale të subvencionuara. Kur përdoruesi fundor zgjedh të mbajë pajisjet terminale të bashkuara, në momentin e lidhjes së kontratës, çdo kompensim i detyruar nuk duhet të kalojë vlerën e tij siç është rënë dakord në momentin e lidhjes së kontratës ose pjesën e mbetur të tarifës së shërbimit deri në përfundimin e kontratës.</p> <p>Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë metoda të tjera për të llogaritur shkallën e kompensimit, me kusht që metoda të tilla të mos rezultojnë në një nivel kompensimi që tejkalon atë të llogaritur në përputhje me nënparagrafin e dytë.</p> <p>Ofruesi heq çdo kusht për përdorimin e kësaj pajisje terminale në rrejetet e tjera falas, në një kohë të përcaktuar nga shtetet anëtare dhe më së voni pas pagimit të kompensimit.</p> <p>7. Sa i përket shërbimeve të transmetimit të përdorura për shërbimet nga njëra paisje tek tjetra, të drejtat e përmendura në paragrafët 4 dhe 6 do ti përfitojnë vetëm përdoruesit fundorë që janë konsumatorë, mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse.</p> | | <p>informim, ofruesit u japin pajtimtarëve edhe këshilla për tarifat më të mira në lidhje me shërbimet e tyre. Ofruesit u ofrojnë pajtimtarëve informacion me këshilla, për tarifat më të mira të paktën çdo vit.</p> <p>8. Pajtimtarët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën e tyre pa asnjë kosto shtesë, me marrjen e njoftimit të ndryshimeve në kushtet e kontratës të propozuara nga ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, të ndryshme nga shërbimet e komunikimeve ndërpersonale të pavarura nga numrat, përveç rasteve kur ndryshimet e propozuara, janë ekskluzivisht në dobi të pajtimtarit, janë të natyrës administrative dhe nuk kanë efekt negativ mbi pajtimtarin, ose kur ato janë imponuar për zbatim drejtpërdrejt nga legjislati në fuqi.</p> <p>9. Ofruesit njoftojnë pajtimtarët të paktën një muaj përpara, për çdo ndryshim në kushtet kontraktuale dhe njëkohësisht informojnë ata për të drejtën e tyre për të zgjidhur kontratën pa ndonjë kosto shtesë, nëse ata nuk i pranojnë kushtet e reja. E drejta për zgjidhjen e kontratës do të jetë e zbatueshme brenda një muaji nga marrja e njoftimit. AKEP-i mund ta zgjasë këtë periudhë deri në tre muaj. AKEP-i siguron që njoftimi të bëhet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi.</p> <p>10. Çdo mospërputhje e rëndësishme, e vazhdueshme në kohë ose e përsëritur shpesh, midis performancës aktuale të një shërbimi të komunikimeve elektronike, përveç shërbimit të aksesit në internet ose një shërbimi komunikimi ndërpersonal të pavarur nga numri dhe performancës së përfshirë në kontratë, konsiderohet se përbën arsye për të kërkuar zbatimin e masave rregulluese kompensuese, në dispozicion të përdoruesit, në përputhje me legjislati në fuqi, duke përfshirë të drejtën për të zgjidhur kontratën pa kosto.</p> <p>11. Kur një përdorues fundor, ka të drejtë të zgjidhë një kontratë për një shërbim të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun, përveç një shërbimi të komunikimeve ndërpersonale të pavarur nga numrat, përpara përfundimit të afatit të kontratës së rënë dakord në përputhje me këtë ligj, me dispozita të tjera rregullatore ose me Ligjet e Republikës së Shqipërisë, përdoruesi fundor nuk duhet të paguajë asnjë kompensim përveç pajisjeve fundore të subvencionuara dhe të ruajtura.</p> <p>12. Kur përdoruesi fundor, zgjedh të mbajë pajisjet fundore të përfshira në paketën tarifore të integruar, në momentin e lidhjes së kontratës, kompensimi për t'u paguar për pajisjen fundore nuk duhet të jetë më i lartë se vlera proporcionale e tij, e llogaritur në bazë të vlerës</p> | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | | | |
|---------|---|--|--------------------------|---|---|--|
| | | | | <p>monetare të deklaruar të pajisjes, në momentin e lidhjes së kontratës, ose në bazë të pjesës së tarifës së shërbimit për muajt e mbetur, deri në fund të afatit të kontratës, duke aplikuar vlerën më të ulët midis tyre.</p> <p>13. AKEP-i mund të përcaktojë metoda të tjera për llogaritjen e shkallës së kompensimit, me kusht që metoda të tilla, të mos rezultojnë në një nivel kompensimi që tejkalon atë të llogaritur në përputhje me paragrafin e dytë të kësaj pike.</p> <p>14. Ofruesi ka detyrim që të heqë të gjitha kufizimet për përdorimin e pajisjes fundore në rrjetet e tjera pa pagesë, në një kohë të përcaktuar nga AKEP dhe jo më vonë se data e pagesës nga pajtimtari të kompensimit për pajisjen fundore.</p> <p>15. Në lidhje me shërbimet e transmetimit të përdorura për shërbimet makinë- makinë, të drejtat e referuara në pikat 8, 11 dhe 12, të këtij neni, janë të zbatueshme vetëm për përdoruesit fundorë që janë konsumatorë, ndërmarrje mikro, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse.</p> | | |
| Neni106 | <p align="center">Neni 106 Ndërrimi i ofruesit dhe transportueshmëria e numrave</p> <p>1. Në rastin e ndërrimit midis ofruesve të shërbimeve të aksesit në internet, ofruesit e interesuar do t'i sigurojnë përdoruesve fundorë informacionin e duhur para dhe gjatë procesit të ndërrimit dhe të sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit të aksesit në internet, vetëm nëse teknikisht nuk është i mundshëm. Ofruesi pranues do të sigurojë që aktivizimi i shërbimit të aksesit në internet të ndodhë brenda kohës sa më të shkurtër të mundshme, në datën dhe brenda afatit kohor të dakordësuar shprehimisht me përdoruesin fundor. Ofruesi transferues do të vazhdojë të sigurojë shërbimin e tij të aksesit në internet me të njëjtat kushte derisa ofruesi pranues të aktivizojë shërbimin e tij të aksesit në internet. Humbja e shërbimit gjatë procesit të ndërrimit nuk duhet të kalojë një ditë pune.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare duhet të sigurojnë efikasitetin dhe thjeshtësinë e procesit të ndërrimit për përdoruesit fundorë.</p> <p>2. Shtetet Anëtare sigurojnë që të gjithë përdoruesit fundorë me numra nga plani kombëtar i numrave, të kenë të drejtë të mbajnë numrat e tyre, sipas kërkesës, në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja që ofron shërbimin, në përputhje me Pjesën C të Shtojcës VI.</p> <p>3. Kur një përdorues fundor përfundon një kontratë, Shtetet Anëtare sigurojnë që përdoruesi fundor të mund të ruajë të drejtën për të transferuar një numër nga plani kombëtar i numrave, tek një ofrues tjetër për një minimum prej një muaji nga data e përfundimit, përveç nëse e drejta i hiqet përdoruesit fundor.</p> <p>4. Autoritetet rregullatore kombëtare, sigurojnë që çmimet midis ofruesve, të lidhura me sigurimin e</p> | | Neni 145 Neni 146 | <p align="center">Neni 145 Ndërrimi i ofruesit dhe portabiliteti i numrave</p> <p>1. Në rastin kur përdoruesi fundor, kërkon ndërrimin e ofruesit të shërbimit të aksesit në internet, ofruesit e përfshirë në proces, duhet t'i ofrojnë përdoruesit fundor informacionin e duhur, përpara dhe gjatë procesit të ndërrimit dhe sigurojnë vazhdimësinë e shërbimit të aksesit në internet, përveç rasteve kur nuk është e mundur teknikisht.</p> <p>2. Ofruesi marrës, siguron që aktivizimi i shërbimit të aksesit në internet, të ndodhë brenda kohës më të shkurtër të mundshme, në datën dhe brenda afatit kohor të rënë dakord shprehimisht me pajtimtarin.</p> <p>3. Ofruesi transferues, vazhdon të ofrojë shërbimin e tij të aksesit në internet, me të njëjtat kushte, derisa ofruesi marrës të aktivizojë shërbimin e tij të aksesit në internet. Mungesa e shërbimit gjatë procesit të ndërrimit, nuk duhet të jetë më e gjatë se një ditë pune. AKEP-i siguron që procesi i ndërrimit të ofruesit, të jetë i thjeshtë dhe efektiv për përdoruesit fundorë.</p> <p>4. AKEP siguron që të gjithë përdoruesit fundorë të pajisur me numra nga Planit Kombëtar i Numeracionit, të kenë të drejtë të mbajnë numrat e tyre sipas kërkesës, pavarësisht nga sipërmarrësi që ofron shërbimin, në përputhje me parashikimet e nenit 126 të këtij ligji.</p> <p>5. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike fikse, janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit gjeografik, për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>transportueshmërisë së numrave, të jenë të orientuara drejt kostos dhe që asnjë tarifë direkte të mos aplikohet për përdoruesit fundorë.</p> <p>5. Dorëzimi i numrave dhe aktivizimi i tyre pasues, do të bëhet brenda kohës sa më të shkurtër të mundshme, në datën e dakortësuar, në mënyrë të shprehur qartë me përdoruesin fundor. Në çdo rast, përdoruesit fundorë që kanë lidhur një marrëveshje për transferimin e një numri tek një ofrues i ri, do ta aktivizojnë atë numër brenda një dite pune nga data e rënë dakord me përdoruesin fundor. Në rast të dështimit të procesit të transportimit, ofruesi transferues, do të riaktivizojë numrin dhe shërbimet përkatëse të përdoruesit fundor, derisa transportimi të jetë i suksesshëm. Ofruesi transferues do të vazhdojë të ofrojë shërbimet e tij me të njëjtat terma dhe kushte, deri sa të aktivizohen shërbimet e ofruesit pranues. Në çdo rast, humbja e shërbimit gjatë procesit të ndërrimit të ofruesit dhe transferimit të numrave nuk duhet të kalojë një ditë pune. Operatorët, rrjetet ose lehtësirat e aksesit të cilat janë përdorur nga transferuesi ose nga marrësi, ose nga të dy, sigurojnë që të mos ketë humbje të shërbimit që do të vononte procesin e kalimit dhe transferimit.</p> <p>6. Ofruesi pritës do të udhëheqë proceset e ndërrimit dhe transportimit, të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 5 dhe të dy ofruesit pritës dhe transferues do të bashkëpunojnë me mirëbesim. Ata nuk do të vonojnë ose abuzojnë me proceset e ndërrimit dhe transferimit, as nuk do të dërgojnë numra ose do të ndërrojnë përdoruesit fundor pa pëlqimin e përdoruesve fundor. Kontratat e përdoruesve fundorë me ofruesin transferues ndërpriten automatikisht pas përfundimit të procesit të ndërrimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Autoritetet rregullatore kombëtare, mund të përcaktojnë detajet e proceseve të ndërrimit dhe të transportimit, duke marrë parasysh dispozitat kombëtare për kontratat, fizibilitetin teknik dhe nevojën për të ruajtur vazhdimësinë e shërbimit ndaj përdoruesve fundorë. Kjo do të përfshijë, një kërkesë që transportimi të kryhet përmes sigurimit të ajrit, përveç nëse një përdorues fundor kërkon ndryshe. Autoritetet rregullatore kombëtare, marrin gjithashtu masa të përshtatshme që sigurojnë që përdoruesit fundorë janë informuar dhe mbrojtur në mënyrë të duhur, gjatë gjithë procesit të ndërrimit dhe transportimit dhe nuk i kalojnë një ofruesi tjetër pa pëlqimin e tyre. • Ofruesit e transferimit do të rimbursojnë, sipas kërkesës, çdo kredi të mbetur për konsumatorët që përdorin shërbime të parapaguara. Rimbursimi mund t'i nënshtrohet një tarife vetëm nëse parashikohet në kontratë. Çdotarifë e tillë do të jetë proporcionale dhe në përpjesëtim me kostot aktuale të bëra nga ofruesi transferues në ofrimin e rimbursimit. <p>7. Shtetet Anëtare vendosin rregulla mbi gjokat në rastin e dështimit të një ofruesi, për të përbushur detyrimet të përcaktuara në këtë nen, duke përfshirë vonesat ose abuzimet e transportimit në emër të një ofruesi.</p> | | <p>ndryshojnë sipërmarrësin që u ofron shërbimin publik telefonik fiks.</p> <p>6. Të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të lëvizshme, janë të detyruar të mundësojnë portabilitetin e numrit jogeografik për të gjithë pajtimtarët e tyre, kur ata ndryshojnë sipërmarrësin, që u ofron shërbimin publik telefonik të lëvizshëm.</p> <p>7. Sipërmarrësit mund të aplikojnë një tarifë për sipërmarrësit e tjerë për portabilitetin e numrit. Tarifat duhet të jenë të orientuara në kosto dhe të mos shërbejnë si faktorë frenues për përdorimin e shërbimit të portabilitetit të numrit nga përdoruesit fundorë.</p> <p>8. Kostot e përshtatjes dhe të mirëmbajtjes së rrjeteve, në mënyrë që të mundësohet portabiliteti i numrit, përballohen nga sipërmarrësit përkatës.</p> <p>9. AKEP siguron që sipërmarrësit nuk aplikojnë pagesa direkte për përdoruesit fundor për portimin e numrave të tyre.</p> <p>10. Mbartja e numrave dhe aktivizimi i tyre, bëhen brenda një afati sa më të shkurtër kohor në datën e dakordësuar shprehimisht me përdoruesin fundor. Në rastet kur përdoruesi fundor ka lidhur kontratë për mbartjen e numrit me një sipërmarrës i ri, aktivizimi i numrit bëhet brenda një dite pune.</p> <p>11. Në rastin e dështimit të procesit të portimit, ofruesi transferues riaktivizon numrin dhe shërbimet e lidhura për përdoruesin fundor deri në portimin e suksesshëm të numrit. Ofruesi transferues, vazhdon ofrimin e shërbimeve të tij me të njëjtat kushte dhe terma deri sa shërbimet në ofruesin marrës të jenë aktivizuar. Në çdo rast ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë pune. Operatorët, rrjetet e aksesit apo facilitetet e tyre përdoren nga ofruesi dhënë apo marrës, ose nga të dy bashkë, marrin masa për kryerjen pa vonesa të portimit dhe ofrimin e shërbimit pa ndërperje përdoruesit.</p> <p>12. AKEP me rregullore, përcakton detajet e procesit të portimit, duke marrë në konsideratë kushtet teknike për realizimin e portimit, si dhe nevojën e vazhdimet të marrjes së shërbimit nga përdoruesi fundor. AKEP-i mund të parashikojë, në rregullore, përjashtimet nga parimi i përcaktuar në pikën 11 të këtij neni, për rastet e justifikuara dhe kur është e nevojshme, në lidhje me procese specifike për portabilitetin e shumë numrave në të njëjtën kohë.</p> <p>13. Ofruesi marrës dhe ofruesi dhënë në një proces portimi bashkëpunojnë me njëri tjetrin mbi bazën e besimit të mirë, pa vonuar dhe abuzuar me proceset e portimit të numrave dhe nuk portojnë numrat, pa miratimin e</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>8. Shtetet Anëtare vendosin rregulla për kompensimin e përdoruesve fundorë nga ofruesit e tyre, në një menyrë të lehtë dhe në kohën e duhur, në rast të dështimit të një ofruesi për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë nen, si dhe në rastin e vonesave, ose abuzimeve me të, proceset e transportimit dhe ndërrimit, dhe emërimet e shërbimit dhe instalimeve të humbura.</p> <p>9. Përveç informacionit të kërkuar në Shtojcën VIII, Shtetet Anëtare sigurojnë që përdoruesit fundorë të informohen në mënyrë të duhur për ekzistencën e të drejtave të kompensimit, të përmendura në paragrafët 7 dhe 8.</p> | | <p>shprehur në mënyrë të qartë nga përdoruesi fundor. Kontrata e përdoruesit fundor me ofruesin transferues përfundon automatikisht me përfundimin e procesit të portimit.</p> <p>14. Kur një përdorues përfundon një kontratë sipas pikës 13 të këtij neni, AKEP siguron që përdoruesi fundor mund të ruajë të drejtën për portimin e një numri nga Plani Kombëtar i Numeracionit tek një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dore nga kjo e drejtë.</p> <p>15. Ofruesit transferues do të rimburojnë konsumatorët, sipas kërkesës, për çdo kredit të mbetur ose të papërdorur të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim. Ofruesi mund të aplikojë një tarifë për rimbursimin vetëm nëse një tarifë e tillë parashikohet në kontratë. Çdo tarifë e tillë duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të sipërmarrësit transferues për ofrimin e rimbursimit.</p> <p>16. AKEP miraton rregullat për kompensimin e përdoruesve fundorë nga ofruesit, sipas pikës 15 të këtij neni, me qëllim sigurimin e kompensimit në kohë dhe në mënyrë të thjeshtë.</p> <p>17. Përveç sa parashikohet në nenin 141 të këtij ligji, AKEP siguron që përdoruesit fundorë informohen në mënyrë të përshtatshme në kontratë, për të drejtat e portimit dhe të kompensimit sipas pikës 15 dhe 16 të këtij neni.</p> <p>18. Në rastet e dështimit të sipërmarrësve në përmbushjen e detyrimeve të portimit të përcaktuara në këtë nen, AKEP merr masa administrative në lidhje me vonesat, abuzimin në procesin e portimit sipas parashikimeve në nenin 184, të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 146 Zbatimi i portabilitetit të numrit</p> <p>1. AKEP-i, nëpërmjet një rregulloreje të veçantë, përcakton mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit dhe afatet kohore përkatëse.</p> <p>2. Në hartimin e rregullores së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i duhet të këtë parasysh:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësitë teknike të portabilitetit të numrit; b) parametrat teknike, që duhet të sigurohen gjatë portabilitetit të numrit, që të mos sjellë përkeqësim të cilësisë së shërbimit apo të besueshmërisë së rrjetit; c) periudha kohore për zbatimin e portabilitetit të numrit nuk duhet të jetë më shumë se 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij ligji; | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|----------------|--|----------|---|---|--|
| | | | | ç) provat teknike, që duhen parashikuar për sistemin e propozuar për portabilitetin e numrit. | |
| Neni107 | <p style="text-align: center;">Neni 107 Ofertat paketë</p> <p>1. Nëse një pako shërbimesh ose një paketë shërbimesh dhe pajisje terminale që i ofrohen një konsumatori, përmbajnë të paktën një shërbim të aksesit në internet ose një shërbim të komunikimit ndërpersonal, të bazuar në numër në dispozicion të publikut, neni 102 (3), neni 103 (1), neni 105 dhe neni 106 (1), do të zbatohen për të gjithë elementët e paketës përfshirë ato që nuk janë të përfshira ndryshe nga ato dispozita.</p> <p>2. Kur konsumatori, sipas ligjit të Bashkimit Evropian, ose ligjit kombëtar, në përputhje me ligjin e Bashkimit Evropian, ka të drejtën për të ndërprerë çdo element të paketës, siç përmendet në paragrafin 1, para përfundimit të afatit të kontratës së rënë dakord, për shkak të mungesës së konformitetit me kontratën ose mosarritjen e furnizimit, Shtetet Anëtare do të parashikojnë që konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën në lidhje me të gjithë elementët e paketës.</p> <p>3. Çdo abonim në shërbime shtesë ose pajisje terminale të ofruara ose të shpërndara nga i njëjti ofrues i shërbimeve të aksesit në internet ose i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numër të disponueshëm publikisht, të cilat nuk e zgjasin kohëzgjatjen origjinale të kontratës së cilës i shtohen këto shërbime ose pajisje terminale, përveç nëse konsumatori bie dakord kur rregjistrohet në shërbimet shtesë ose pajisjet terminale.</p> <p>4. Paragrafët 1 dhe 3, do të zbatohen gjithashtu për përdoruesit fundorë që janë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla ose organizata jofitimprurëse, përveç nëse ata kanë rënë dakord për të hequr dorë nga të gjitha ose pjesët e këtyre dispozitave.</p> <p>5. Shtetet Anëtare mund të zbatojnë paragrafin 1 në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në këtë Titull.</p> | Neni 147 | <p style="text-align: center;">Neni 147 Ofertat nëpërmjet paketave</p> <p>1. Nëse një paketë shërbimesh ose një paketë shërbimesh që përfshin dhe pajisje fundore që i ofrohen një përdoruesi fundor, përmban të paktën një shërbim aksesit në internet ose një shërbim komunikimi ndërpersonal të bazuar në numra të disponueshëm për publikun, atëherë përcaktimet e pikës 3 të nenit 141, pikës 1 të nenit 142, dhe pikës 1 të nenit 145, të këtij ligji, zbatohen për të gjithë elementët e paketës, përfshirë ato elementë, duke bërë ndryshimet e nevojshme, që nuk janë të parashikuara në dispozitat e cituara.</p> <p>2. Në rastet kur përdoruesi fundor gëzon të drejtën, sipas ligjit shqiptar, që të ndërpresë ndonjë prej elementëve të paketës sipas përcaktimeve në pikën 1, përpara përfundimit të afatit të kontratës së rënë dakord për shkak të mos përbushjes së kushteve të kontratës ose dështimit të ofrimit të shërbimit, pajtimtari do të ketë të drejtën të zgjidhë kontratën për të gjithë elementët e paketës.</p> <p>3. Çdo shtim i shërbimeve apo pajisjeje fundore në një kontratë pajtimi me të njëjtin ofrues të shërbimit të aksesit në internet ose të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra të disponueshëm për publikun, nuk duhet të zgjasë kohëzgjatjen aktuale të kontratës në të cilën janë shtuar këto shërbime ose pajisje fundore, përveç rastit kur pajtimtari bie dakord shprehimisht ndryshe gjatë shtimit në kontratë, të shërbimeve shtesë ose pajisjes fundore.</p> <p>4. Pikat 1 dhe 3, të këtij neni, zbatohen gjithashtu për përdoruesit fundorë që janë mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla, siç përcaktohet në legjisllacionin në fuqi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ose organizatat jofitimprurëse, përveç rasteve kur ata kanë rënë dakord shprehimisht të heqin dorë nga të gjitha ose një pjesë e të drejtave të parashikuara në këto dispozita.</p> <p>5. AKEP-i mund të zbatojë pikën 1 të këtij neni edhe për dispozitat e tjera të parashikuara në këtë ligj.</p> | F | |

| | | | | | | |
|---------|---|--|----------|---|---|--|
| Neni108 | <p style="text-align: center;">Neni 108 Disponueshmëria e shërbimeve</p> <p>1. Shtetet Anëtare do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar disponueshmërinë sa më të plotë të shërbimeve të komunikimit zanor dhe shërbimet e aksesit në internet, të ofruara përmes rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, në rast të prishjes katastrofike të rrjetit, ose në rastet e forcave madhore. Shtetet Anëtare sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të komunikimit zanor të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, për të siguruar akses të pandërprerë në shërbimet e urgjencës dhe transmetimin e pandërprerë të paralajmërimeve publike.</p> | | Neni 148 | <p style="text-align: center;">Neni 148 Disponueshmëria e shërbimeve</p> <p>1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar disponueshmërinë sa më të plotë të shërbimeve të komunikimit zanor dhe shërbimeve të aksesit në internet, të ofruara nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në rast dëmtimi katastrofik të rrjetit ose në raste të forcës madhore. Ofruesit e shërbimeve të komunikimit zanor, marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar akses të pandërprerë në shërbimet e emergjencës dhe transmetim të pandërprerë të paralajmërimeve publike.</p> <p>2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, sipërmarrësit që ofrojnë akses në një rrjet publik të komunikimeve elektronike, mund të kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht aksesin në shërbimet e tyre, pa miratimin e përdoruesve, nëse kjo është e nevojshme për përmirësimin, modernizimin, mirëmbajtjen ose në rast defektesh apo dëmtimi të rrjetit.</p> <p>3. Sipërmarrësit duhet të informojnë AKEP-in dhe njoftojnë pajtuesit për kufizimin ose ndërprerjet e shërbimit që do të zgjasin më shumë se 30 minuta. Ky informim bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të paktën 48 orë përpara, në rast të një përmirësimi, modernizimi ose mirëmbajtjeje të planifikuar të rrjetit; b) sa më shpejt të jetë e mundur, por në asnjë rast më vonë se 48 orë, pas ndodhjes së kufizimit ose ndërprerjes të shkaktuar nga defekte ose dëmtime të rrjetit. | F | |
| Neni109 | <p style="text-align: center;">Neni 109 Komunikimet e urgjencës dhe numri i vetëm evropian i urgjencës</p> <p>1. Shtetet Anëtare sigurojnë që të gjithë përdoruesit fundorë të shërbimeve të përmendura në paragrafin 2, përfshirë përdoruesit e telefonave publike, të jenë në gjendje të përdorin shërbimet e urgjencës përmes komunikimeve emergjente falas dhe pa pasur nevojë të përdorin asnjë mënyrë pagese, duke përdorur numrin e vetëm evropian të urgjencës '112' dhe çdo numër kombëtar të urgjencës kombëtare të specifikuar nga Shtetet Anëtare.</p> <p>2. Shtetet Anëtare do të promovojnë aksesin në shërbimet e urgjencës, përmes numrit të vetëm evropian të urgjencës '112', nga rrjetet e komunikimeve elektronike, të cilat nuk janë të disponueshme publikisht, por që mundësojnë thirrje në rrjetet publike, veçanërisht kur sipërmarrja përgjegjëse për atë rrjet nuk ofron një alternative dhe akses të lehtë në një shërbim urgjencë.</p> | | Neni149 | <p style="text-align: center;">Neni 149 Komunikimet e emergjencës dhe numri evropian i emergjencës</p> <p>1. Sipërmarrësit duhet të sigurojnë, që të gjithë përdoruesit fundorë, përfshirë përdoruesit e telefonave publik me pagesë, të kenë akses në shërbimet e emergjencës nëpërmjet komunikimeve të emergjencës pa pagesë dhe pa pasur nevojë të përdorin asnjë mjet pagese, duke përdorur numrin unik evropian të emergjencave '112' dhe çdo numër kombëtar të emergjencës të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. AKEP promovon aksesin në shërbimet e emergjencës, nëpërmjet numrit unik evropian të emergjencave '112' nga rrjetet e komunikimeve elektronike, që nuk janë publike, por e mundësojnë thirrjen drejt rrjeteve publike të komunikimit elektronik, veçanërisht kur sipërmarrësi</p> | F | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | <p style="text-align: center;">ANEKSI VII</p> <p>LLOGARITJA E KOSTOVE NETO, NËSE KA, E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT UNIVERSAL DHE KRIJIMI I NDONJE KOMPENSIMI APO MEKANIZMI NDARJEJE SIPAS NENEVE 89 DHE 90</p> <p style="text-align: center;"><i>Pjesa A</i> Llogaritja e kostove neto</p> <p>Detyrimet e shërbimit universal i referohen atyre detyrimeve të vendosura mbi një sipërmarrës nga një Shtet Anëtar që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimit universal siç përcaktohet në nenet 84 deri në 87.</p> <p>Autoritetet rregullatore kombëtare duhet të marrin në konsideratë të gjitha mjetet për të siguruar stimuj të përshtatshëm për sipërmarrësit (të caktuara ose jo) për të ofruar detyrime të shërbimit universal me kosto efikase. Në ndërmarrjen e një ushtrimi llogaritës, kostoja neto e detyrimit të shërbimit universal duhet të llogaritet si diferencë ndërmjet koston neto për çdo sipërmarrës që operon me detyrimin e shërbimit universal dhe funksionimi pa detyrimin e shërbimit universal. Vëmendja e duhur duhet t'i kushtohet duke vlerësuar saktë kostot që çdo sipërmarrës do të kishte zgjedhur të shmangte nëse nuk do të kishte detyrimin e shërbimit universal. Llogaritja e koston neto do të vlerësojë përfitimet, përfshirë përfitimet jomateriale, për ofruesin e shërbimit universal.</p> <p>Llogaritja duhet të bazohet në kostot që i atribuohen:</p> <p>(i) Elementeve të shërbimeve të identifikuar të cilat mund të ofrohen vetëm me humbje ose të ofrohen në kushte kostoje që janë jashtë standardeve normale tregtare.</p> <p>Kjo kategori mund të përfshijë elemente shërbimi si aksesin në shërbimet telefonike të urgjencës, ofrimin e disa telefonave publikë me pagesë, ofrimin e shërbimeve ose pajisjeve të caktuara për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, e kështu me radhë;</p> <p>(ii) përdoruesit fundorë specifikë ose grupet e përdoruesve fundorë të cilët, duke marrë parasysh koston e ofrimit të rrjetit të specifikuar dhe shërbimi, të ardhurat e krijuara dhe çdo mesatare gjeografike të çmimeve të vendosura nga Shteti Anëtar, mund të</p> | <p>Neni 129 Neni 128</p> | <p style="text-align: center;">Neni 129</p> <p>Llogaritja dhe mbulimi i kostove të shërbimit universal</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AKEP-i merr në konsideratë të gjitha mjetet për të siguruar stimuj të përshtatshëm për sipërmarrësit, për të ofruar detyrimet e shërbimit universal me kosto eficiente. Kostoja neto e detyrimeve të shërbimit universal, llogaritet si diferencë midis koston neto për çdo sipërmarrës që operon në kushtet e detyrimeve të shërbimit universal dhe operimit pa detyrime të shërbimit universal. Llogaritja e kostove neto, merr parasysh kostot që çdo sipërmarrës do të kishte zgjedhur të shmangte, nëse nuk do të kishte detyrimin e ofrimit të shërbimit universal. Llogaritja e koston neto do të vlerësojë përfitimet, përfshirë përfitimet jomateriale, për operatorin e shërbimit universal. 2. Llogaritja duhet të bazohet në kostot që i atribuohen: <ol style="list-style-type: none"> a) elementeve të shërbimeve të identifikuar, që mund të ofrohen vetëm me humbje ose që mund të ofrohen me kosto që nuk do të ishin kryer në kushte normale tregtare të ofrimit të shërbimeve. b) përdoruesve fundorë ose grupeve të përdoruesve fundorë të veçantë, të cilët, duke marrë parasysh koston e ofrimit të rrjetit dhe shërbimit të specifikuar, të ardhurat e krijuara dhe çdo mesatare gjeografike të çmimeve të vendosura nga shteti anëtar, mund të ofrohen vetëm me humbje, ose me kosto që nuk do të ishin kryer në kushte normale tregtare të ofrimit të shërbimeve. 3. Në elementët e parashikuar në gjurmën a) të pikës 2, të këtij neni, mund të përfshihen elementët të shërbimit, si aksesin në shërbimet telefonike drejt numrave të emergjencës, ofrimi i telefonave të caktuar publikë me pagesë, ofrimi i shërbimeve ose pajisjeve të caktuara për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. 4. Në përcaktimet e gjurmës b) të pikës 2, të këtij neni, përfshihen ata përdorues fundorë, ose grupe përdoruesish fundorë, të cilët nuk do mund të merrnin shërbim nga një operator në kushte normale tregtare, që nuk ka detyrimin për të ofruar shërbim universal. 5. Llogaritja e koston neto të aspekteve të veçanta të detyrimeve të shërbimit universal, duhet të bëhet veçmas dhe në mënyrë të tillë që të shmanget llogaritja e dyfishtë e çdo përfitimi dhe kostoje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kostoja e përgjithshme neto e detyrimeve të shërbimit universal, për çdo sipërmarrës, duhet të llogaritet si shuma e kostove neto që rrjedhin nga elementët e veçantë të detyrimeve të shërbimit universal, duke marrë parasysh çdo përfitim jo-material. | <p style="text-align: center;">F</p> |
|--|--|------------------------------|--|--------------------------------------|

| | | | |
|--|--|---|--|
| <p>jenë vetëm me humbje ose në kushte kostoje që janë jashtë standardeve normale tregtare.</p> <p>Kjo kategori përfshin ata përdorues fundorë ose grupe përdoruesish fundorë që nuk do të marrin shërbime nga një ofrues komercial, i cila nuk ka detyrim për të ofruar shërbim universal.</p> <p>Llogaritja e kostonetë të aspekteve specifike të detyrimeve të shërbimit universal duhet të bëhet veçmas dhe në mënyrë që të shmangët numërimi i dyfishtë i çdo përfitimi dhe kostoje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kostoja e përgjithshme neto e detyrimeve të shërbimit universal ndaj çdo sipërmarrësi duhet të llogaritet si shuma e kostove neto që rrjedhin nga komponentët specifikë të detyrimit të shërbimit universal, duke marrë parasysh çdo përfitim jo-material. Përgjegjësia për verifikimin e kostonetë bie mbi autoritetin rregullator kombëtar.</p> <p style="text-align: center;"><i>Pjesa B</i> Kompensimi i kostove neto të detyrimit të shërbimit universal</p> <p>Rikuperimi ose financimi i çdo kostoje neto të detyrimit të shërbimit universal mund të kërkojë që sipërmarrës me detyrimin e shërbimit universal për t'u kompensuar për shërbimet që ofron në kushte jotregtare. Duke qenë se një kompensim i tillë përfshin transferta financiare, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ato të ndërmerren në një objektiv, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale. Kjo do të thotë që transferimet rezultojnë në shtrembërimin më të vogël të konkurrencës dhe kërkesës së përdoruesve.</p> <p>Në përputhje me nenin 90(3), një mekanizëm i ndarjes i bazuar në një fond do të përdorë një mjet transparent dhe neutral për mbledhja e kontributeve që shmang rrezikun e një imponimi të dyfishtë të kontributeve në outpute dhe në inpute të sipërmarrësve.</p> <p>Autoriteti i pavarur që administron fondin është përgjegjës për mbledhjen e kontributeve nga sipërmarrësit që janë vlerësuar si përgjegjës për të kontribuar në kostonetë të detyrimit të shërbimit universal në Shtetin Anëtar dhe është për të mbikëqyrur transferimin e shumave të detyrimeve ose pagesave administrative për sipërmarrësit që kanë të drejtë të marrin pagesa nga fondi.</p> | | <p>Përgjegjësia për verifikimin e kostonetë i takon autoritetit rregullator kombëtar.</p> <ol style="list-style-type: none"> 6. Mbulimi ose financimi i çdo lloj kostoje neto të detyrimeve të shërbimit universal, mund të nxjerrë të nevojshme kompensimin e sipërmarrësve me detyrime të shërbimit universal për shërbimet që ata ofrojnë në kushte jonormale tregtare. AKEP siguron që kompensimi të kryhet në mënyrë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale dhe të rezultojë në sa më pak shtrembërim të konkurrencës dhe kërkesës së përdoruesve. 7. Në përputhje me pikën 3, të nenit 128, të këtij ligji, mekanizmi i financimit të përbashkët të kostove i bazuar në një fond, duhet të përdorë metoda transparente dhe neutrale për mbledhjen e kontributeve, të cilat shmangin rrezikun e vendosjes së detyrimit të dyfishtë për kontribut, të llogaritur bazuar si në të ardhurat, ashtu edhe në shpenzimet e sipërmarrësve. 8. AKEP në përputhje me nenin 19, të këtij ligji, është përgjegjës për mbledhjen e kontributeve nga sipërmarrësit, të cilët vlerësohen se kanë detyrimin për të kontribuar në kostonetë të detyrimeve të shërbimit universal si dhe të mbikëqyrë transferimin e shumës përkatëse ose nga pagesat administrative tek sipërmarrësit që kanë të drejtë të kompensohen nga fondi. <p style="text-align: center;">Neni 128 Financimi i detyrimeve të shërbimit universal</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në rastet kur AKEP, bazuar në llogaritjet e kostove neto sipas nenit 127, të këtij ligji, konstaton se kostonetë neto përbëjnë një barrë të padrejtë për ofruesin, AKEP-i krijon fondin e shërbimit universal për kompensimin e kostove neto të ofrimit të shërbimit universal. Fondi i shërbimit universal menaxhohet dhe administrohet nga AKEP. Ky fond është i paprekshëm për qëllime të tjera dhe pjesa e papërdorur akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës. 2. Fondi i shërbimit universal financohet nga sipërmarrësit që zotërojnë rrjete të komunikimeve elektronike publike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, si dhe nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publikë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të AKEP-it. Financimi i Shërbimit Universal, do të bëhet në një mënyrë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale dhe financimi duhet | |
|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|--|--|--|----------|--|---|--|
| | | | | <p>të rezultojë në shtrembërim sa më të vogël të konkurrencës dhe kërkesës së përdoruesve.</p> <p>3. AKEP përcakton kuotën e financimit në bazë të pikës 2, të këtij neni, e cila, për të gjithë sipërmarrësit që kanë detyrim të paguajnë për financimin e shërbimit universal, nuk duhet të jetë më e lartë se 1% e totalit të të ardhurave të siguruara nga rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe ofrimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.</p> <p>4. Sipërmarrësit janë të detyruar të paguajnë kontributet, sipas pikës 2, të këtij neni, në një llogari të veçantë të AKEP-it, brenda një periudhe të caktuar, por jo më vonë se data 30 maj e vitit aktual për vitin paraardhës.</p> <p>5. Operatorët, brenda datës 30 prill të çdo viti, informojnë AKEP-in për të ardhurat e tyre në vitin paraardhës, të siguruara nga ofrimi i rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve publike në Republikën e Shqipërisë, duke depozituar në AKEP bilancin vjetor të shoqëruar me raportin e ekspertit kontabël.</p> <p>6. AKEP-i do të kryejë disbursimet nga llogaria e kontributeve të shërbimit universal në bazë vjetore, për të kompensuar çdo ofrues të shërbimit universal, të caktuar për ofrimin e shërbimit universal, në vlera të barabarta me kostot neto të miratuara për sigurimin e shërbimit universal.</p> | | |
| | <p style="text-align: center;">ANEKSI VIII KËRKESAT PËR INFORMACION DUHET TË JEPEN NË PËRPUTHJE ME NENIN 102 (KËRKESAT E INFORMACIONIT PËR KONTRATAT)</p> <p>A. Kërkesat për informacion për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-me-makinë</p> <p>Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-me-makinë do të sigurojnë informacionin e mëposhtëm:</p> <p>(1) si pjesë e karakteristikave kryesore të çdo shërbimi të ofruar, çdo nivel minimal i cilësisë së shërbimit në masën që ato ofrohen dhe, për shërbime të tjera nga shërbimet e aksesit në internet, parametrat specifikë të cilësisë të garantuara.</p> <p>Kur nuk ofrohen nivele minimale të cilësisë së shërbimit, duhet të bëhet një deklaratë për këtë;</p> <p>(2) si pjesë e informacionit mbi çmimin, ku dhe në masën e zbatueshme, çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe për çdo tarifë të përsëritur ose të lidhur me konsumin;</p> | | Neni 180 | <p style="text-align: center;">Neni 180 Informacioni i kërkuar për kontratat</p> <p>1. Ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshëm për publikun, përveç shërbimeve të transmetimit, të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë me makinë, do të ofrojnë në kontratë informacionin si më poshtë:</p> <p>a) karakteristikat kryesore të çdo shërbimi, duke dhënë nivelin minimal të cilësisë së çdo shërbimi, dhe në masën që këto ofrohen. Për shërbimet e ndryshme nga shërbimet e aksesit në internet sipas kuptimit të nenit 177, të këtij ligji, të ofrohen parametrat specifikë të cilësisë të garantuara. Kur nuk ofrohen nivele minimale të cilësisë së shërbimit, bëhet një deklaratë.</p> <p>b) informacion mbi çmimin dhe në masën e zbatueshme, çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe për çdo tarifë të lidhur me konsumin;</p> <p>c) informacion për kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, duke përfshirë tarifat e mundshme të përfundimit, në masën që këto kushte zbatohen;</p> | F | |

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| | <p>(3) si pjesë e informacionit për kohëzgjatjen e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, duke përfshirë tarifën e mundshme të terminimit, në masën që zbatohen këto kushte;</p> <p>(i) çdo përdorim minimal ose kohëzgjatje që kërkohet për të përfituar nga kushtet promovionale;</p> <p>(ii) çdo tarifë në lidhje me ndërrimin dhe kompensimin dhe marrëveshjet e rimbursimit për vonesa ose abuzim të kalimit, si dhe informacion për procedurat përkatëse;</p> <p>(iii) informacion mbi të drejtën e konsumatorëve që përdorin shërbimet e parapaguara për një rimbursim, sipas kërkesës, të çdo mbetur në rast ndërrimi (ndërrimi), siç përcaktohet në nenin 106(6);</p> <p>(iv) çdo tarifë për përfundimin e parakohshëm të kontratës, duke përfshirë informacionin për zhbllokimin e pajisjes fundore dhe çdo mbulim të kostos në lidhje me pajisjet fundore;</p> <p>(4) çdo marrëveshje kompensimi dhe rimbursimi, duke përfshirë, aty ku është e aplikueshme, referencë të qartë për të drejtat e konsumatorëve, të cilat zbatohen nëse nivelet e kontraktuara të cilësisë së shërbimit ose nuk përmbushen nëse ofruesi i përgjigjet në mënyrë joadekuate një incidenti sigurie, kërcënimi ose cenueshmërie;</p> <p>(5) llojin e veprimit që mund të ndërmerret nga ofruesi i shërbimit si reagim ndaj incidenteve të sigurisë, kërcënimeve ose dobësive.</p> <p>B. Kërkesat e informacionit për ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të disponueshme për publikun do të ofrojnë informacionin e mëposhtëm:</p> <p>I. Përveç kërkesave të përcaktuara në Pjesën A, ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të disponueshme për publikun do të ofrojnë informacionin e mëposhtëm:</p> <p>(1) si pjesë e karakteristikave kryesore të secilit shërbim të ofruar:</p> <p>(i) çdo nivel minimal të cilësisë së shërbimit në masën që këto ofrohen, dhe duke marrë parasysh udhëzimet e BEREC të miratuara në përputhje me nenin 104(2) në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> — shërbimet e aksesit në internet: vonesa të pakëta, jitter, humbje të paketave, — për shërbimet e komunikimeve ndërpersonale të disponueshme për publikun, ku ato ushtrojnë kontroll mbi të paktën disa elementet e rrjetit ose kanë një marrëveshje të nivelit të shërbimit për këtë qëllim me sipërmarrësit që ofrojnë akses në rrjet: të paktën koha për lidhjen fillestare, probabiliteti i dështimit, vonesat e sinjalizimit të thirrjeve në përputhje me Aneksin X; dhe <p>(ii) pa cenuar të drejtën e përdoruesve fundorë për të përdorur pajisjet fundore të zgjedhjes së tyre në përputhje me Nenin 3(1) të Rregullores (BE) 2015/2120, çdo kusht, duke përfshirë tarifën, të vendosura nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të ofruara;</p> | | <p>i) çdo përdorim ose kohëzgjatje minimale që kërkohet për të përfituar nga kushtet promovionale;</p> <p>ii) çdo tarifë në lidhje me ndërrimin dhe marrëveshjet e kompensimit dhe rimbursimit për vonesën ose abuzim të ndërrimit, si dhe informacion në lidhje me procedurat përkatëse;</p> <p>iii) informacion mbi të drejtën e konsumatorëve, që përdorin shërbimet e parapaguara për një rimbursim, sipas kërkesës të çdo kredie të mbetur në rast ndërrimi, siç përcaktohet në nenin 145, të këtij ligji;</p> <p>iv) çdo tarifë që duhet për përfundimin e parakohshëm të kontratës, duke përfshirë informacionin për zhbllokimin e pajisjeve terminale dhe çdo mbulim të kostos në lidhje me pajisjet terminale;</p> <p>ç) çdo marrëveshje kompensimi dhe rimbursimi, duke përfshirë aty ku është e zbatueshme, referencë të qartë për të drejtat e konsumatorëve, të cilat zbatohen nëse nivelet e cilësisë së shërbimit të kontraktuar nuk përmbushen ose nëse ofruesi i përgjigjet në mënyrë joadekuate një incidenti sigurie, kërcënimi ose cenueshmërie;</p> <p>d) lloji i veprimit që mund të ndërmerret nga ofruesi, në reagim ndaj incidenteve të sigurisë ose kërcënimeve dhe dobësive.</p> <p>2. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të disponueshme për publikun, përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1, të këtij neni, ofrojnë informacionin e mëposhtëm:</p> <p>a) si pjesë e karakteristikave kryesore të çdo shërbimi të ofruar:</p> <p>i) çdo nivel minimal të cilësisë së shërbimit në masën që këto ofrohen, dhe duke marrë parasysh udhëzimet e BEREC në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1) shërbimet e aksesit në internet: vonesat e pakëta, jitter, humbjet e paketave; 2) shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, të cilat ushtrojnë kontroll mbi të paktën disa elementet e rrjetit, ose kanë një marrëveshje të nivelit të shërbimit për këtë qëllim me sipërmarrësit që ofrojnë akses në rrjet: të paktën | |
|--|---|--|---|--|

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>(2) si pjesë e informacionit mbi çmimin, ku dhe në masën e zbatueshme, çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe për çdo tarifë të përsëritur ose të lidhur me konsumin;</p> <p>(i) detajet e planit tarifor specifik ose planeve sipas kontratës dhe, për secilin plan tarifor të tillë, llojet e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë aty ku është e aplikueshme, vëllimet e komunikimeve (si MB, minutat, mesazhet) të përfshira për periudhën e faturimit, dhe çmimin për njësitë shtesë të komunikimit;</p> <p>(ii) në rastin e planit tarifor ose planeve me një vëllim komunikimi të paracaktuar, mundësinë e konsumatorëve për të shtyrë çdo vëllim të papërdorur nga periudha e mëparshme e faturimit në periudhën e ardhshme të faturimit, ku ky opsion përfshihet në kontratë;</p> <p>(iii) lehtësirat për të ruajtur transparencën e faturave dhe për të monitoruar nivelin e konsumit;</p> <p>(iv) informacion tarifor në lidhje me çdo numër ose shërbim që i nënshtrohet kushteve të veçanta të çmimit; në lidhje me kategoritë individuale të shërbimeve, autoritetet kompetente në koordinim, sipas rastit, me autoritetet rregullatore kombëtare mund të kërkojnë që ky informacion të jepet menjëherë përpara lidhjes së telefonatës ose lidhjes me ofruesin e shërbimit;</p> <p>(v) për shërbimee paketave dhe paketat, duke përfshirë shërbimet dhe pajisjet fundore, çmimin e elementeve individuale të paketës në masën që ato tregtohen gjithashtu veçmas;</p> <p>(vi) detajet dhe kushtet, duke përfshirë tarifën, për çdo shërbim pas shitjes, mirëmbajtjes dhe kujdesit ndaj klientit; dhe</p> <p>(vii) mjetet me të cilat mund të merret informacion i përditësuar mbi të gjitha tarifën e zbatueshme dhe tarifën e mirëmbajtjes;</p> <p>(3) si pjesë e informacionit mbi kohëzgjatjen e kontratës për shërbimet e paketave dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, kur është e zbatueshme, kushtet e përfundimit të paketës ose të elementeve të saj;</p> <p>(4) pa cënuar nenin 13 të Rregullores (BE) 2016/679, informacionin se cilat të dhëna personale do të sigurohen para kryerjes së shërbimit ose do të mblidhen në kontekstin e ofrimit të shërbimit;</p> <p>(5) detaje mbi produktet dhe shërbimet e krijuara për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara dhe se si mund të merren përditësime mbi këtë informacion;</p> <p>(6) mjetet për fillimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përfshirë mosmarrëveshjet kombëtare dhe ndërkufitare në përputhje me nenin 25.</p> <p>II. Përveç kërkesave të përcaktuara në Pjesën A dhe në pikën I, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të bazuara</p> | | <p>koha për lidhjen fillestare, probabiliteti i dështimit, sinjalizimi i thirrjeve vonesat; dhe,</p> <p>ii) pa cënuar të drejtën e përdoruesit për të përdorur pajisjet fundore sipas zgjedhjes së tij në përputhje me nenin 177, të këtij ligji, çdo kusht, duke përfshirë tarifën e vendosura nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të furnizuara.</p> <p>(b) si pjesë e informacionit mbi çmimin, ku dhe në masën e zbatueshme, çmimet përkatëse për aktivizimin e shërbimit të komunikimeve elektronike dhe për çdo tarifë të përsëritur ose të lidhur me konsumin:</p> <p>i) detajet e planit ose planeve tarifore specifike sipas kontratës dhe, për secilin plan tarifor të tillë, llojet e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë aty ku është e aplikueshme, vëllimet e komunikimeve si MB, minutat, mesazhet të përfshira për periudhën e faturimit, dhe çmimin për njësitë shtesë të komunikimit,</p> <p>ii) në rastin e planit tarifor ose planeve me një vëllim komunikimi të paracaktuar, mundësinë e konsumatorëve për të shtyrë çdo vëllim të papërdorur nga periudha e mëparshme e faturimit në periudhën e ardhshme të faturimit, kur ky opsion përfshihet në kontratë,</p> <p>iii) lehtësirat për të ruajtur transparencën e faturave dhe monitorimin e nivelit të konsumit,</p> <p>iv) informacion tarifor në lidhje me çdo numër ose shërbim që i nënshtrohet kushteve të veçanta të çmimit; në lidhje me kategoritë individuale të shërbimeve, autoritetet kompetente në koordinim, sipas rastit, me autoritetet rregullatore kombëtare kërkojnë që ky informacion të jepet menjëherë, përpara lidhjes së telefonatës ose lidhjes me ofruesin e shërbimit,</p> <p>v) për shërbimet e paketave dhe paketat, duke përfshirë shërbimet dhe pajisjet fundore, çmimin e elementeve individuale të paketës në masën që ato tregtohen gjithashtu veçmas,</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|--|--|--|----------|--|---|--|
| | <p>në numra të disponueshëm publikisht do të ofrojnë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:</p> <p>(1) çdo kufizim në aksesin në shërbimet e urgjencës ose informacionin e vendndodhjes së telefonuesit për shkak të mungesës së fizibilitetit teknik për aq sa shërbimi i lejon përdoruesit fundorë të fillojnë thirrjet drejt një numri në një plan numërimi kombëtar ose ndërkombëtar;</p> <p>(2) të drejtën e përdoruesve përfundimtarë për të përcaktuar nëse do të përfshijë të dhënat e tij/saj personale në një direktori, dhe llojet e të dhënave në fjalë, në përputhje me nenin 12 të Direktivës 2002/58/KE;</p> <p>III. Përveç kërkesave të përcaktuara në pjesën A dhe në pikën I, ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet do të ofrojnë gjithashtu informacionin e kërkuar në përputhje me nenin 4(1) të Rregullores (BE) 2015/2120.</p> | | | <ul style="list-style-type: none"> vi) detajet dhe kushtet, përfshirë tarifat, për çdo shërbim pas shitjes, mirëmbajtje dhe ndihmë ndaj klientit, dhe, vii) mjetet me të cilat merret informacion i përditësuar mbi të gjitha tarifat e zbatueshme dhe tarifat e mirëmbajtjes. <p>c) si pjesë e informacionit mbi kohëzgjatjen e kontratës për shërbimet e paketave dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës, kur është e zbatueshme, kushtet e përfundimit të paketës ose të elementeve të saj;</p> <p>d) informacion se cilat të dhëna personale do të sigurohen përpara kryerjes së shërbimit ose të mbledhura në kontekstin e ofrimit të shërbimit;</p> <p>e) detaje mbi produktet dhe shërbimet e krijuara për përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe se si mund të merren përditësime mbi këtë informacion.</p> <p>3. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 dhe gjermën a), të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale, bazuar në numra të disponueshëm publikisht, ofrojnë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) çdo kufizim në aksesin në shërbimet e emergjencës ose informacionin e vendndodhjes së telefonuesit, për shkak të mungesës së fizibilitetit teknik, për aq sa shërbimi i lejon përdoruesit të fillojnë thirrjet drejt një numri, në një plan numërimi kombëtar ose ndërkombëtar; b) të drejtën e përdoruesit për të përcaktuar nëse do të përfshijë ose jo të dhënat e tij/saj personale në një numërorator telefonik, dhe llojet e të dhënave në fjalë, në përputhje me parashikimet në nenin 167, të këtij ligji. <p>4. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 dhe gjermën a), të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet ofrojnë gjithashtu informacionin e kërkuar në bazë të nenit 178, të këtij ligji.</p> | | |
| | <p style="text-align: center;">ANEKSI IX</p> <p>INFORMACIONI TË PUBLIKOHET NË PËRPUTHJE ME NENIN 103 (TRANSPARENCA DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT)</p> <p>Kur është e nevojshme, autoriteti kompetent në koordinim me autoritetin rregullator kombëtar janë përgjegjës për të siguruar që informacioni në këtë Aneks të publikohet në përputhje me nenin 103. Autoriteti kompetent, sipas rastit, në koordinim me autoritetin rregullator kombëtar vendos se cili informacioni është i rëndësishëm për t'u publikuar nga ofruesit e shërbimeve të</p> | | Neni 142 | <p style="text-align: center;">Neni 142</p> <p>Transparenca, krahasimi i ofertave dhe publikimi i informacionit</p> <p>5. Ofruesit e shërbimit të aksesit në internet dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, kur ofrimi i këtyre shërbimeve është objekt i termave dhe kushteve të ofrimit, duhet të publikojnë informacionin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Detajet e kontaktit të sipërmarrësit; b) Përshkrimin e shërbimeve të ofruara; | F | |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | <p>aksesit në internet, ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, dhe se cili informacion duhet të publikohet nga vetë autoriteti kompetent, në koordinim me autoritetin rregullator kombëtar, në mënyrë që të sigurohet që të gjithë përdoruesit e fundorë janë në gjendje të bëjnë zgjedhje të informuara. Nëse konsiderohet e përshtatshme, autoritetet kompetente, sipas rastit, në koordinim me autoritetet rregullatore kombëtare mund të promovojnë masa vetë-rregulluese ose bashkërrregulluese përpara se të vendosin ndonjë detyrim.</p> <p>1. Detajet e kontaktit të sipërmarrësit 2. Përshkrimi i shërbimeve të ofruara 2.1. Objekti i shërbimeve të ofruara dhe karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar, duke përfshirë çdo nivel minimal të cilësisë së shërbimit ku ofrohet dhe çdo kufizim të vendosur nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve terminale të ofruara. 2.2. Tarifat e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë informacionin mbi vëllimet e komunikimeve (si kufizimet e përdorimit të të dhënave, numrat e minutave zanore, numrat e mesazheve) të planeve tarifore specifike dhe tarifave të zbatueshme për njësitë shtesë të komunikimit, numrat ose shërbimet që i nënshtrohen kushteve të veçanta të çmimit, tarifave për aksesin dhe mirëmbajtjen, të gjitha llojet e tarifave të përdorimit, skemat tarifore të veçanta dhe të synuara dhe çdo tarifë shtesë, si dhe kostot në lidhje me pajisjet terminale. 2.3. Shërbimet e ofruara pas shitjes, mirëmbajtjes dhe ndihmës ndaj klientit dhe detajet e kontaktit të tyre. 2.4. Kushtet standarde të kontratës, duke përfshirë kohëzgjatjen e kontratës, tarifave për përfundimin e parakohshëm të kontratës, të drejtat që lidhen me përfundimin e ofertave të bashkuara ose të elementeve të tyre, dhe procedurat dhe tarifave direkte që lidhen me transportueshmërinë e numrave dhe identifikuesve të tjerë, nëse është e nevojshme. 2.5. Nëse sipërmarrja është ofrues i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra, informacion mbi aksesin në shërbimet e urgjencës dhe vendndodhjen e telefonuesit, ose ndonjë kufizim për këtë të fundit. Nëse ndërmarrja është një ofrues i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri, informacion mbi shkallën në të cilën aksesin në shërbimet e urgjencës mund të mbështetet ose jo. 2.6. Detajet e produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë çdo funksion, praktikë, politikë dhe procedurë dhe ndryshime në funksionimin e shërbimit, të krijuara posaçërisht për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, në përputhje me ligjin e Bashkimit që harmonizon kërkesat e aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet. 3. Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshirë ato të zhvilluara nga sipërmarrja.</p> | | <p>f) Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshirë ato të zhvilluara nga sipërmarrësi.</p> <p>6. Përshkrimi i shërbimeve të ofruara sipas gërmeve b) të pikës 1, të këtij neni, duhet të përmbajë:</p> <p>a) Objektin e shërbimeve të ofruara dhe karakteristikat kryesore të secilit shërbim të ofruar, përfshirë çdo nivel minimal të cilësisë së shërbimit nëse ofrohet si dhe çdo kufizim të vendosur nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të ofruara.</p> <p>b) Tarifat e shërbimeve të ofruara, përfshirë informacionin mbi:</p> <p>i) sasinë e njësisve të komunikimeve, të tilla si sasinë e përfshira në përdorimin e të dhënave, minutat për thirrjet zanore, numrin e mesazheve të përfshira në planet tarifore specifike dhe tarifave të zbatueshme për njësitë shtesë të komunikimit;</p> <p>ii) numrat ose shërbimet që janë objekt i kushteve të veçanta të tarifimit;</p> <p>iii) tarifave për aksesin dhe mirëmbajtjen, të gjitha llojet e tarifave të përdorimit, skemat tarifore të veçanta dhe të fokusuara në grupe të veçanta përdoruesish, kushtet specifike të faturimit dhe çdo tarifë shtesë, si dhe kostot në lidhje me pajisjet fundore kur është rasti.</p> <p>c) Shërbimet e ofruara pas shitjes, mirëmbajtjes dhe kujdesit ndaj klientit dhe detajet e kontaktit të tyre;</p> <p>k) Kushtet standarde të kontratës, përfshirë kohëzgjatjen e kontratës, tarifave për përfundimin e parakohshëm të kontratës, të drejtat që lidhen me përfundimin e ofertave të paketave ose të elementeve të tyre dhe procedurat dhe tarifave direkte që lidhen me portabilitetin e numrave dhe identifikuesve të tjerë, nëse është e nevojshme;</p> <p>l) Informacion mbi aksesin në shërbimet e urgjencës dhe të vendndodhjes së telefonuesit, ose ndonjë kufizim për këtë të fundit, nëse sipërmarrësi është ofrues i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra;</p> <p>m) Informacion mbi shkallën në të cilën aksesin në shërbimet e urgjencës, mund të mbështetet ose jo, nëse sipërmarrësi është një ofrues i shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të pavarur nga numri;</p> <p>n) Ndryshimet që kufizojnë aksesin ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikacioneve dhe vendndodhjen e disponueshmërisë së këtyre shërbimeve;</p> <p>o) Detajet e produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë çdo funksion, praktikë, politikë ose procedurë dhe ndryshime në funksionimin e shërbimit, të krijuara posaçërisht për përdoruesit</p> | |
|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>fundorë, me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këta përdorues fundorë duhet të informohen rregullisht për produktet e tyre.</p> <p>p) Informacion mbi procedurat për matjen dhe menaxhimin e trafikut të përcaktuar nga ofruesi, për të shmangur ngarkimin ose mbingarkimin e lidhjeve të rrjetit dhe se si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;</p> <p>q) Detajet e produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë çdo funksion, praktikë, politikë, informacion në lidhje me vendndodhjen dhe procedurat e tyre dhe ndryshimet në funksionimin e shërbimit, të krijuar posaçërisht për përdoruesit fundorë, me aftësi të kufizuara, ndryshime të kushteve në lidhje me aksesin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për harmonizimin e kërkesave të aksesueshmërisë për produktet dhe shërbimet.</p> <p>7. Informacioni i publikuar nga ofruesit e shërbimit të aksesit në internet ose ofrimit të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, sipas këtij neni, duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i lexueshëm nga pajisje kompjuterike, duke përfshirë publikimin në faqen e internetit të tij në një format të aksesueshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e AKEP-it. AKEP, në rastet kur e vlerëson të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë ndryshime në informacionin e publikuar. AKEP mund të kërkojë për tarifatat për kategori individuale të shërbimeve përfshirë shërbimet me vlerë të shtuar të jepet menjëherë, para realizimit të thirrjes zanore.</p> <p>8. Informacioni i kërkuar sipas këtij neni, përditësohet rregullisht. AKEP-i, në koordinim me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit, mund të përcaktojë kërkesa shtesë në lidhje me formën në të cilën duhet të publikohet ky informacion. Ky informacion, sipas kërkesës, u dërgohet përpara publikimit të tij AKEP-it dhe KMK-së.</p> <p>5. AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë, të kenë akses pa pagesë në të paktën një instrument të pavarur krahasimi, i cili u mundëson atyre krahasimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ndryshme të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra të disponueshëm për publikun dhe sipas rastit, shërbimin e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun të pavarur nga numrat, në lidhje me:</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>a) çmimet dhe tarifat e shërbimeve të ofruara kundrejt pagesave monetare direkte, periodike ose për njësi të konsumuar;</p> <p>b) cilësinë e performancës së shërbimit, në rastet kur garantohet një nivel minimal i cilësisë së shërbimit, ose kur sipërmarrësi ka detyrim të publikojë këtë informacion në përputhje me nenin 143, të këtij ligji.</p> <p>6. Instrumenti i krahasimit sipas pikës 5 të këtij neni duhet:</p> <p>a) të jetë operacionalisht i pavarur nga ofruesit e këtyre shërbimeve, për të siguruar trajtim të barabartë të këtyre ofruesve në rezultatet e kërkit;</p> <p>b) të publikojë qartësisht pronarët dhe operatorët e instrumentit të krahasimit;</p> <p>c) të përcaktojë kritere të qarta dhe objektive mbi të cilat bazohet krahasimi;</p> <p>ç) të përdorë gjuhë të thjeshtë dhe të qartë;</p> <p>d) të sigurojë informacion të saktë dhe të përditësuar dhe të japë kohën e përditësimit të fundit;</p> <p>dh) të jetë i hapur për çdo ofrues të shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të disponueshëm për publikun, duke vënë në dispozicion informacionin përkatës dhe të përfshijë një gamë të gjerë të ofertave që mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të tregut dhe kur informacioni i paraqitur nuk është një pasqyrë e plotë e tregut, një deklaratë të qartë për këtë, përpara shfaqjes së rezultateve;</p> <p>e) të sigurojë një procedurë efektive për të raportuar informacionin e pasaktë;</p> <p>ë) të përfshijë mundësinë për të krahasuar çmimet, tarifat dhe cilësinë e performancës së shërbimit midis ofertave të disponueshme për përdoruesit fundorë dhe nëse kërkohet nga legjislacioni në fuqi, midis këtyre ofertave dhe ofertave standarde publikisht të disponueshme për përdoruesit e tjerë fundorë.</p> <p>7. Instrumentet e krahasimit që plotësojnë kërkesat e pikës 6, nëse ofrohen nga një subjekt i ndryshëm nga AKEP, ata duhet të certifikohen paraprakisht nga AKEP-i. Palët e treta kanë të drejtë të përdorin pa pagesë dhe në formatin e hapur të të dhënave, informacionin e publikuar nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet ose shërbimet e komunikimit ndërpersonal të disponueshëm publikisht, me qëllim vënie në dispozicion të këtyre instrumentave të pavarura të krahasimit.</p> <p>8. AKEP-i mund të kërkojë, që ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet, ose të shërbimeve të komunikimit ndërpersonal të bazuar në numra publikisht të</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | <p>disponueshëm, ose për të dy kategoritë, të shpërndajnë pa pagesë informacion me interes publik për përdoruesit fundorë ekzistues dhe të rinj, sipas rastit, nëpërmjet mjeteve të komunikimit që ata përdorin zakonisht me përdoruesit fundorë.</p> <p>9. Në rastet e parashikuara në pikën 8 të këtij neni, informacioni me interes publik, duhet të ofrohet nga autoritetet publike përkatëse në një format të standardizuar dhe ndër të tjera, duhet të mbulojë temat e mëposhtme:</p> <p>a) përdorimet më të zakonshme të shërbimeve të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal publikisht të disponueshëm të bazuar në numra, në mbështetje/kryerjen e aktiviteteve të paligjshme, ose për shpërndarjen e përmbajtjes së dëmshme, veçanërisht kur mund të paragjykojë respektimin e të drejtave dhe lirive të tjerëve, duke përfshirë shkeljen e të drejtave e mbrojtjes së të dhënave, të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, dhe pasojat e tyre ligjore;</p> <p>b) mjetet e mbrojtjes kundër rreziqeve për sigurinë personale, privatësinë dhe të dhënat personale, kur përdoren shërbimet e aksesit në internet dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal publikisht të disponueshëm të bazuar në numra.</p> | | | | | | | | | | | | | | |
|--|---|-----------------------|-------------|--|--|-----------------|-----------------|--|-----------------|-----------------|-----------------------------|-----------------|-----------------|--|--|--|---|-----------------------------------|
| | <p align="center">Aneksi X Parametrat e cilësisë së shërbimit Parametrat e cilësisë së shërbimit, përkufizimet, dhe metodat e matjes sipas nenit 104 Për ofruesit e aksesit në rrjetin e komunikimeve elektronike publike</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>PARAMETRI (Shënimi 1)</th> <th>PERKUFIZIMI</th> <th>METODA E MATJES</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Koha e furnizimit për lidhjen fillestare</td> <td>ETSI EG 202 057</td> <td>ETSI EG 202 057</td> </tr> <tr> <td>Koeficienti i gabimit për aksesin e linjes</td> <td>ETSI EG 202 057</td> <td>ETSI EG 202 057</td> </tr> <tr> <td>Koha e riparimit të gabimit</td> <td>ETSI EG 202 057</td> <td>ETSI EG 202 057</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve ndërpersonale të cilët kontrollojnë aksesin mbi disa elemente të rrjetit ose kanë një marrëveshje të nivelit të shërbimit që ndikon në sipërmarrjet që ofrojnë aksesin në rrjet.</p> | PARAMETRI (Shënimi 1) | PERKUFIZIMI | METODA E MATJES | Koha e furnizimit për lidhjen fillestare | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | Koeficienti i gabimit për aksesin e linjes | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | Koha e riparimit të gabimit | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | N | Per t'u adresuar me akt nenligjor |
| PARAMETRI (Shënimi 1) | PERKUFIZIMI | METODA E MATJES | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Koha e furnizimit për lidhjen fillestare | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Koeficienti i gabimit për aksesin e linjes | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Koha e riparimit të gabimit | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | | | | | | | | | | | |

| PARAMETRI (Shënimi 2) | PERKUFIZIMI | METODA E MATJES | | | | | | |
|---|--------------------|-----------------|--|--|--|--|---|-----------------------------------|
| Koha e vendosjes së thirrjes | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | |
| Abkesat për korrëgjimin e faturës | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | |
| Cilësia e lidhjes telefonike | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | |
| Koeficienti i rënies së thirrjes | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | |
| Koeficienti për thirrjet e pasuksesshme (Shënimi 2) | ETSI EG 202 057 | ETSI EG 202 057 | | | | | | |
| Probabiliteti gabimit | | | | | | | | |
| Vonesat në sinjalizimin e thirrjes | | | | | | | | |
| Numri i Versionit të ETSI EG 202 057-1 është 1.3.1 (Korrik 2008) | | | | | | | | |
| Për ofruesit e shërbimit të aksesit në Internet | | | | | | | | |
| PARAMETRI | PERKUFIZIMI | METODA E MATJES | | | | | | |
| Latency (delay) | ITU-T Y.2617 | ITU-T Y.2617 | | | | | | |
| Jitter | ITU-T Y.2617 | ITU-T Y.2617 | | | | | | |
| Humbja e paketave | ITU-T Y.2617 | ITU-T Y.2617 | | | | | | |
| <i>Shënim 1</i> Parametrat do të lejojnë që performanca të analizohet në nivel rajonal (domethënë, të paktën në nivelin 2 të nomenklaturës së njësisve territoriale për statistikat (NUTS) të krijuar nga Eurostat). | | | | | | | | |
| <i>Shënim 2</i> Shtetet Anëtare, mund të vendosin të mos kërkojnë informacion të përditësuar në lidhje me këto parametra nëse disponon evidencë që tregon se performancat në këto dy zona janë të kenaqshme. | | | | | | | | |
| Aneksi XI Ndërvesprueshmëria e radiove të makinave dhe pajisjeve marrese digjitale televizive të konsumatorit | | | | | | | N | Per t'u adresuar me akt nenligjor |

| | | | | | | | | |
|---|--|---|--|--|--|----------------|---|--|
| | <p>INTEROPERABILITETI I MARRËSVE TË RADIO S TË MAKINAVE DHE PAJISJEVE TELEVISIONI DIGJITAL TË KONSUMATORËVE TË REFERUARA NË NEN 113</p> <p>1. Algoritmi i zakonshëm i gërshetimit dhe marrja pa pagesë Të gjitha pajisjet e konsumatorit të destinuara për marrjen e sinjaleve televizive dixhitale (përkatësisht, transmetimi nëpërmjet transmetimit tokësor, kabllor ose satelitor), për shitje ose me qira ose përndryshe të disponueshme në Bashkimin Evropian, të afta për të rrëfyer sinjalet televizive dixhitale, duhet të kenë aftësinë për:</p> <p>(a) të lejojë përbërjen e sinjaleve të tilla në përputhje me një algoritëm të përbashkët evropian të rrëshqitjes siç administrohet nga një organizatë standardizimi evropiane e njohur (aktualisht ETSI);</p> <p>(b) të shfaqë sinjalet që janë transmetuar në mënyrë të qartë, me kusht që, në rast se një pajisje e tillë merret me qira, qiramarrësi është në përputhje me marrëveshjen përkatëse të qirasë.</p> <p>2. Ndërveprueshmëria për televizionet dixhitale Çdo televizor dixhital me një ekran integral me diagonale të dukshme më të madhe se 30 cm i cili është vënë në treg për shitje ose me qira në Union duhet të pajiset me të paktën një prizë të hapur të ndërfaqes (të standardizuar ose në përputhje me një standard të miratuar nga, një organizatë standardizimi evropiane e njohur, ose në përputhje me një specifikim në të gjithë industrinë) që lejon lidhjen e thjeshtë të pajisjeve periferike dhe në gjendje të kalojë të gjithë elementët përkatës të një sinjali televiziv dixhital, duke përfshirë informacionin në lidhje me shërbimet ndërvepruese dhe të aksesueshme me kusht.</p> <p>3. Ndërveprueshmëria për marrës radio makinash Çdo marrës radio makine i integruar në një automjet të ri të kategorisë M, i cili vihet në dispozicion në treg për shitje ose me qira në Bashkim nga 21 dhjetori 2020, duhet të përbëhet nga një marrës i aftë për të marrë dhe riprodhuar të paktën shërbimet radio të ofruara nëpërmjet transmetimit radiodixhital tokësor. Marrësit që janë në përputhje me standardet e harmonizuara, referencat e të cilëve janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose me pjesë të tyre, do të konsiderohen se janë në përputhje me atë kërkesë të mbuluar nga ato standarde ose pjesë të tyre.</p> | | | | | | | |
| | <p style="text-align: center;">Aneksi XII Direktivat e shfuqizuara</p> <p><i>Pjesa A</i> Direktivat e shfuqizuara me listën e ndryshimeve të njëpasnjëshme (referuar nenit 125)</p> <table border="1" data-bbox="325 1268 884 1372"> <tr> <td data-bbox="325 1268 745 1372"> Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 108, 24.4.2002, p. 33) </td> <td data-bbox="745 1268 884 1372"></td> </tr> </table> | Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 108, 24.4.2002, p. 33) | | | | E pazbatueshme | N | |
| Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 108, 24.4.2002, p. 33) | | | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|--|---|----------------------------|--|--|--|
| | Direktiva 2009/140/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 337, 18.12.2009, p. 37) | Neni 1 | | | | |
| | Rregullorja (EC) No 544/2009 Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 167, 29.6.2009, p. 12) | Neni 2 | | | | |
| | Rregullorja (EC) No 717/2007e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 171, 29.6.2007, p. 32) | Neni 10 | | | | |
| | Direktiva 2002/20/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 108, 24.4.2002, p. 21) | | | | | |
| | Direktiva 2009/140/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 337, 18.12.2009, p. 37) | Neni 3 dhe Aneksi | | | | |
| | Direktiva 2002/19/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 108, 24.4.2002, p. 7) | | | | | |
| | Direktiva 2009/140/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 337, 18.12.2009, p. 37) | Neni 2 | | | | |
| | Direktiva 2002/22/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 108, 24.4.2002, p. 51) | | | | | |
| | Direktiva 2009/136/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 337, 18.12.2009, p. 11) | Neni 1 dhe Aneksi I | | | | |
| | Rregullorja (EU) 2015/2120 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (OJ L 310, 26.11.2015, p. 1) | Neni 8 | | | | |
| Pjesa B | | | | | | |
| Afatet kohore për transpozimin në ligjin kombëtar dhe data e zbatimit (referuar nenit 125) | | | | | | |
| | Direkti va | Afati kohor per transpozimin | Data e zbatimit | | | |

| | | | | | | | | |
|--|-------------------------------------|----------------|----------------|--|--|----------------|---|--|
| | 2002/19/E C | 25 Korrik 2003 | 25 Korrik 2003 | | | | | |
| | 2002/20/E C | 25 Korrik 2003 | 25 Korrik 2003 | | | | | |
| | 2002/21/E C | 25 Korrik 2003 | 25 Korrik 2003 | | | | | |
| | 2002/22/E C | 25 Korrik 2003 | 25 Korrik 2003 | | | | | |
| | Aneksi XIII Tabela e korrelances | | | | | E pazbatueshme | N | |